

## Fjala e Avokatit të Popullit

### **Zoti Kryetar i Kuvendit të Republikës së Shqipërisë Të nderuar deputetë,**

Kam nderin dhe kënaqësinë që, si Avokat i Popullit i Republikës së Shqipërisë, duke patur rastin që të paraqes para jush raportin e pestë vjetor për veprimtarinë e Institucionit, njëkohësisht t'ju falenderoj për vlerësimin që më bëtë në seancën e datës 17 shkurt 2005 duke më rizgjedhur në detyrën e lartë të Avokatit të Popullit.

Kur vendosa të kandidoja për mandatin tim të parë si Avokat i Popullit, e them hapur se përcaktuese ishte dëshira për të provuar veten në një detyrë, të cilën nuk mund të them se e njihja në detaje. Kështu pra, pas pesë viteve kam kuptuar se Avokati i Popullit nuk është vetëm një post, që rastisi ta kishte një jurist me emrin Ermir Dobjani, sikundër mund ta kishte patur çdo qytetar tjetër i Republikës së Shqipërisë, mjaft që të përmbushte kërkesat e ligjit. Përvoja e këtyre pesë viteve më ka mësuar të pohoj qartë se Avokati i Popullit është njëkohësisht mision dhe funksion. Mision për të ndërgjegjësuar sa veten, ashtu dhe të tjerët për një çështje madhore sikundër janë të drejtat e njeriut. Dhe njëkohësisht është një funksion që të ngarkon me përgjegjësi për investimin profesional, human në këtë fushë si dhe për rezultatet e arritura, të cilat janë të prekshme për një individ, të cilit i zgjidhet ankesa, por edhe të pandjeshme, teksa pret të krijosh precedentin për dhjetra e dhjetra raste të tjera.

Efekti afatgjatë i rasteve të zgjidhura pozitivisht nga Zyra synon pikërisht ngulitjen e praktikave të mira administrative, zbatimi i të cilave kërkon jo vetëm zbatimin e ligjit, por edhe etikën e zyrtarit, humanizmin e shoqërisë ku jetojmë, si edhe mirëfunksionimin e shtetit të së drejtës.

Me pak fjalë do të nënvizojë para jush sot se në harkun e pesë viteve, Zyra e Avokatit të Popullit ka rregjistruar rreth 15 000 raste ankesash dhe kërkesash të qytetarëve të ndryshëm, me një mesatare rreth 20 përqind të rasteve të trajtuara, që janë zgjidhur pozitivisht, pra në favor të ankuesve.

Tipari kryesor i funksionimit të Institucionit të Avokatit të Popullit është shumëdisiplinshmëria e ndërhyrjeve të tij. Pa qenë e nevojshme të listojmë këtu kompetencat dhe juridiksionin e Avokatit të Popullit, mund të them se në mandatin e tij të parë, Avokati i Popullit në Shqipëri ka arritur të krijojë imazhin

e një institucioni modern, demokratik dhe transparent, bazuar në rregullat e demokracisë, të ndarjes së pushteteve, të kontrollit dhe balancimit të tyre, pra të shtetit ligjor.

Gama e ndërhyrjeve të Avokatit të Popullit është shumë e gjerë. Rastet e trajtuara nga ne fillojnë, le të themi, nga një gjobë e padrejtë, vendosuar nga një polic i pandërgjegjshëm, deri tek përmirësimet ligjore apo rrëzimet e vendimeve të padrejta qeveritare nga Gjykata Kushtetuese, me kërkesë të Avokatit të Popullit. Përmendim gjithashtu ndërhyrjet tona në drejtim të përmirësimit të shërbimeve publike, të zbutjes së kostos së qytetarëve për shërbimet e korporatës energjitike dhe telefonisë fikse në Shqipëri, sensibilizimi i strukturave shtetërore për të drejtat e fëmijëve dhe më shumë se kaq, vendosja e bashkëpunimit me zyrat homologe të rajonit ballkanik e më gjerë. Të gjitha këto kanë krijuar tek sytë e qytetarit shqiptar, por edhe të zyrtarit shqiptar, besimin se Avokati i Popullit është një institucion me frymëmarrje të gjerë demokratike që funksionon në shërbim të njerëzve të thjeshtë.

Sikundër kam deklaruar vazhdimisht qysh në fillim të mandatit të parë e në vazhdimësi, nuk kam harruar për asnjë çast se kontratën time e kam lidhur me kusht që të mbroj të drejtat e qytetarëve shqiptarë. Këtë detyrim e konsideroj pjesë të kontratës sociale, që të gjithë e njohin, por jo të gjithë e zbatojnë. Sikundër kam thënë vazhdimisht, çdo trokitje në derën e zyrtarit është një zile zgjimi për të gjithë zyrtarët e ulët apo të lartë të shtetit tonë, që sinjalizon se të gjithë kemi detyrime ndaj taksapaguesve shqiptarë.

Përveç përballimit të volumit të punës, gjithmonë kemi patur parasysh parimin se ankesa e qytetarit nuk ka ngjyresa politike. Problemet e njerëzve janë sa të rëndomta në shfaqjen e tyre, aq edhe të mprehta për efektin që japin mbi jetën e njerëzve të thjeshtë, mbi cilësinë e saj, mbi realitetin që u ofrohet, mbi humorin dëshpërues që u ngjallin plagë të tilla si papunësia, trafiket dhe lënda e parë njerëzore për to, deri tek korrupsioni i zyrtarëve të papërgjegjshëm. Të gjitha këto sëbashku shkaktojnë edhe letargjinë dëshpëruese të shtresave të tëra që kërkojnë politika më të mira sociale, që do t'ua bënin fshatin apo qytetin e tyre, thjesht Shqipërinë tonë një vend për të jetuar diçka më mirë se dje.

Si Avokat i Popullit unë shpreh besimin se Shqipëria në një të ardhme jo të largët do të bëjë pjesë me të gjitha të drejtat dhe detyrimet në Bashkimin European. Ndërkaq jam edhe i ndërgjegjshëm se shtresat më të varfëra e më të prekshme të shoqërisë, ende do të duhet të paguajnë çmim për këtë. Nëse ka një detyrë madhore për mua si Avokat i Popullit, ajo është që pikërisht këto shtresa që janë edhe grupet e synuara për t'u mbrojtur nga Avokati i Popullit, të paguajnë një çmim sa më të ulët. Kjo është një arsye më shumë se përse Avokati i Popullit nuk mund të bëjë indiferentin edhe ndaj problematikës së mësipërme.

Duke ushtruar funksionin e tij për të ndikuar në mirëqeverisje, institucioni ynë i ri, me një mënyrë procedimi disi jashtë skemave tradicionale, ka vlerësuar dhe ka marrë në konsideratë çdo analizë dhe kritikë të shprehur nga cilido dhe nga të gjitha anët pa dallim. Kjo sepse, qëllimi ynë është të zgjidhim ankesat e kërkesat e njerëzve të zakonshëm, të cilëve, para së gjithash, ju intereson mirëadministrimi i pushtetit dhe rritja e cilësisë së jetës nga shërbimet që ata presin prej atyre që qeverisin vendin.

Sikundër vlerësoi edhe në konferencën e shtypit, me 19 Janar 2005, miku dhe kolegu im i nderuar dhe një ndër Ombudsmanët më me përvojë në botë, z. Hans Gammeltoft Hansen, Ombudsman i Mbretërisë së Danimarkës që prej 18 vjetësh, “Puna e Ombudsmanit është art i mbajtjes së ekuilibrave. Nga njëra anë Ombudsmani duhet të jetë rojtar i të drejtave të njeriut dhe i mirëqeverisjes dhe natyrisht që ai nuk duhet të trembet për të marrë dhe trajtuar çështjet që mund të jenë, le të themi, kundërthënëse dhe problematike. Nga ana tjetër është shumë e rëndësishme që Ombudsmani të sigurojë pranueshmërinë nga ana e organeve të administratës, të cilët atij do t’i duhet të kontrollojë. Prandaj unë këtë e quaj art të mbajtjes së ekuilibrave. Dhe kjo ka më tepër rëndësi për Ombudsmanin e Parë, i cili duhet të shtrojë rrugën në drejtimin e duhur”.

Realizimi i misionit për lehtësimin e komunikimit të qytetarëve me shtetin e tyre, mbetet gjithmonë një sfidë për tu vlerësuar në vazhdimësi nga popullit dhe nga ju, të nderuar përfaqësues të popullit.

Ju faleminderit edhe një herë për besimin që patët, duke më dhënë nderin dhe kënaqësinë për të vazhduar që të jem Avokati i parë i Popullit në Republikën e Shqipërisë.

**AVOKATI I POPULLIT**

**Ermir DOBJANI**

**Tiranë, 20 shkurt 2005**

## PERMBAJTJA

Fjala e Avokatit të Popullit	3
Përmbajtja	6
Hyrje	9
Prezantim i shkurtër i Raportit	12

### **KREU I PARE**

1. Struktura, organika dhe cilësitë e personelit të zyrës së Avokatit të Popullit	14
2. Bashkepunimi dhe mbështetja ndërkombëtare për institucionin	18
3. Buxheti i institucionit për vitin 2004	23
4. Sfidat dhe objektivat e institucionit për vitin 2005 e në vazhdim	24

### **KREU I DYTE**

1. Statistika përmbledhëse e vitit 2004	27
2. Marrëdhëniet me Kuvendin e Shqipërisë	31
3. Opinione të përgjithshme për të Drejtat e Njeriut në Shqipëri	34
4. Marrëdhëniet e Avokatit të Popullit me publikun	41
a. Sektori i Pritjes së Popullit	44
b. Ditët e hapura – përvojë për t'u vazhduar	48

0.	Konferenca Kombëtare për të drejtat	
5.	e punonjësve	49
6.	Aktivitete të tjera të Institucionit të Avokatit të Popullit gjatë vitit 2004	55

## **KREU I TRETE**

Veprimtaria konkrete e Avokatit të Popullit për ankesat, kërkesat dhe njoftimet, të grupuara sipas institucioneve qeveritare

1.	Këshilli i Ministrave (Qeveria)	57
	Grupi mbikqyres i firmave piramidale	58
	Zyrat e Rregjistrimit të Pasurive të Paluajtëshme	62
	Komisionet e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave	65
	Instituti i te perndjekurve politikë	66
2.	Ministria e Drejtësisë	68
	Burgjet	68
	Zyrat e permbarimit	79
3.	Ankesat për pushtetin gjyqësor dhe administratën gjyqësore	83
4.	Ankesat për Prokurorinë	92
5.	Ministria e Rendit Publik	100
6.	Ministria e Mbrojtjes	126
7.	Ministria e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit	133
	Komunat	136
	Bashkite	139
	Prefekturat	149
8.	Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale	151
9.	Ministria e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit	157
	Ndertimet pa leje	159
	Ujësjellës kanalizime	169

10. Ministria e Ekonomisë	170
11. Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit	173
12. Ministria e Financave	177
Agjensia Kombëtare e Privatizimi	181
13. Ministria e Arsimit dhe e Shkencës	182
14. Ministria e Shëndetësisë	186
15. Ministria e Punëve të Jashtme	188
16. Ministria e Transporteve dhe Telekomunikacioneve	190
Telekomi	
17. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve	194
18. Ministria e Mjedisit	195
19. Ministria e Industrisë dhe Energjetikës	197
KESH	198
20. Ankesat për Shërbimet Sekrete	201
21. Konkluzione që dalin nga ankesat për punën e administratës publike shqiptare	203

## **KREU I KATERT**

1. Në ndjekje të rasteve të prezantuara në Raportin vjetor 2003	206
2. Çështje të filluara me iniciativën e Avokatit të Popullit (“ex officio”)	207

## **ANEKSE**

1. Letra falenderimi nga qytetarët	208
2. Tabela dhe grafikët	213

## HYRJE

Historia e institucionit të Ombudsmanit daton zyrtarisht që në vitin 1809, kur mbi baza kushtetuese, Parlamenti Suedez krijoi Ombudsmanin Parlamentar, të parin në botë të këtij lloji. Është fakt se edhe pas mbi 200 vjetësh, Ombudsmani Parlamentar Suedez vlerësohet si institucioni me funksionim më të mirë në shoqëri të sudeze, i cili me kritikën e tij në rastet e ankesave të veçanta e rrit respektin tek nëpunësit e shtetit, u qëndron pranë njerëzve me këshilla të dobishme ligjore si dhe mund të dërgojë edhe para gjyqit nëpunës që shkelin ligjet e shtetit apo abuzojnë me to në dëm të të drejtave të njeriut.

Nga fillimi i viteve '50 të shekullit të kaluar pas ndryshimeve demokratike në Evropë, Ombudsmani pati një zhvillim të madh dhe sot të numërohen rreth 350 ombudsmanë ose mediatorë që veprojnë në të gjithë kontinentet. Instituti Ndërkombëtar i Ombudsmanit, anëtar i të cilit është edhe Avokati i Popullit, ka anëtarë në rreth 120 vende.

Praktika e qeverisjes së mirë dhe ndërveprimi i binomit autoritet publik-taksapagues sigurohen nga funksionimi i mekanizmave të pavarur e të paanshëm për të shqyrtuar mënyrën se si ka vepruar Qeveria. Sistemi i kontrollit dhe balancës sot është një parim bazë i qeverisjes moderne në të gjithë botën.

Institucioni kushtetues i Avokatit të Popullit, si instancë kombëtare, garante e demokracisë, u parashikua për herë të parë në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, të miratuar më 28 Nëntor 1998. Kjo Kushtetutë, në 5 nene të saj përcakton detyrat, statusin dhe kompetencat e Avokatit të Popullit. Në zbatim të saj, në shkurt të vitit 1999, Kuvendi miratoi Ligjin Nr.8454, dt.04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, kurse me Ligjin 8600, datë 10.04.2000, bëri një plotësim në nenin 35 të këtij ligji.

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, duke miratuar legjislacionin për Avokatin e Popullit, ka përcaktuar vlerat dhe parimet mbi të cilat vepron ky Institucion. Ato janë pavarësia, paanshmëria, profesionalizmi dhe konfidencialiteti, të përcaktuara si Parimet e Parisit.

Tashmë ne mund të deklarojmë me modesti se i kemi zbatuar këto parime, të cilat faktikisht janë edhe standarte të nivelit të lartë, mbi bazën e të cilave bëhet vlerësimi i këtij institucioni kudo në botë. Prandaj, në Maj 2004, Kryetari i Komitetit Koordinues Ndërkombëtar të institucioneve Kombëtare të Drejtave të Njeriut (ICC), Morten Kjaerum informoi se Institucioni i Avokatit

të Popullit në Shqipëri ka fituar statusin A të akreditimit, që do të thotë anëtar me të drejta të plota të këtij komiteti.

Anëtarët e këtij komiteti (ICC), i cili koordinon nismat dhe politikat në forumet ndërkombëtare të Institucioneve Kombëtare të Drejtave të Njeriut, miratuan Rekomandimin e bërë nga nënKomiteti i Akreditimit, gjatë sesionit të 14-të të ICC-së më 15 prill 2004 në Gjenevë. Nga ana e tij, Komiteti mori në shqyrtim raportin e nënKomitetit për veprimtarinë e Avokatit të Popullit brenda vendit, si edhe bashkëpunimin e tij me institucionet e tjera ndërkombëtare. Në përfundim të këtij shqyrtimi u pranua se Institucioni i Avokatit të Popullit në Shqipëri vepron në përputhje me Parimet e Parisit, e për rrjedhojë fitoi statusin A të akreditimit. Parimet e Parisit janë dokumenti bazë i miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, që parashikon standartet për funksionimin e Institucioneve Kombëtare për Promovimin dhe Mbrojtjen e Drejtave të Njeriut. Në këtë mënyrë institucioni i Avokatit të Popullit në Shqipëri është certifikuar edhe nga institucionet kompetente ndërkombëtare për standartet e larta që përmbush.

Parë nën perspektivën e proceseve integruese të vendit tonë, nënvizojmë se, përveçse ndikimit pozitiv në mirëqeverisje, ngritja dhe konsolidimi i Avokatit të Popullit në Shqipëri plotëson një kusht për pranimin në Bashkimin Europian. Me vizionin se tashmë në demokraci, graviteti i kahjes së mbrojtjes së të drejtave të njeriut ka ndryshuar nga shteti tek qytetari, Institucioni i Avokatit të Popullit synon që me precedentet e krijuar, qoftë edhe me zgjidhjen e ankesave më të thjeshta, të arrijë të krijojë tek qytetari bindjen se nëpunësi civil apo autoriteti publik tashmë paguhet nga taksat e tij për t'i shërbyer atij, pra qytetarit. Nga ky këndvështrim, sa qytetar, aq edhe politik, pozicioni social dhe mentaliteti i qytetarit shqiptar nuk ka se si të mos ridimensionohet dhe përafrohet me atë të qytetarit Europian.

Në këtë drejtim, përveç mbrojtjes së të drejtave të njeriut, një nga synimet e tona kryesore është të zhvillojë atë që quhet *kultura e qeverisjes së mirë*. Ky nocion përmban administrim të mirë të pronës publike, çiltërsi, transparencë dhe llogaridhënie të administratës publike para njerëzve që paguajnë taksa për ta mbajtur atë.

Kemi rastin të theksojmë se veçori themelore e institucionit të Avokatit të Popullit, veç pavarësisë nga qeveria dhe nga çdo ndikim politik, lehtësisë së kontaktimit, shpejtësisë dhe fleksibilitetit në kapjen e problemeve, ka qënë sidomos efektiviteti dhe forca e rekomandimeve të tij. Theksojmë “forcën e rekomandimeve”, sepse dihet se, kur mungon forca detyruese, ajo që kushtëzon fitoren në çdo rast është forca argumentuese. Është pikërisht kjo “forcë argumentuese” e bazuar në ligj, që ka bërë shpesh që rekomandimet e Avokatit



të Popullit, nga formalisht “jo detyruet”, në thelb të jenë “bindës për t’u pranuar e për t’u zbatuar”.

Çdo zyrë ombudsmani në botë, sikundër edhe në Shqipëri, faktikisht ndeshet çdo ditë edhe me forma të rezistencës të organeve të administratës apo të autoriteteve publike. Në kushtet tona, kur institucionet ende rezultojnë jo të mësuarat e të konsoliduara me ndërgjegjen e shtetit të së drejtës, kjo është edhe më e dukshme. Por, nëse secili do të udhëhiqet nga parimi demokratik i pushteteve të kufizuara, mendojmë se ekzistojnë hapësira të mjaftueshme për njëri-tjetrin, ku bashkëpunimi të jetë sa më efikas. Fakti që ligja i mundëson Avokatit të Popullit ngritjen e problemit si për kryetarin e komunës dhe për ministrin deri në Parlament, tregon qartë se instrumenti ynë kryesor, që është Rekomandimi, kur ka brenda argumentin ligjor, ka edhe forcën reale të “imponimit” të butë. Në kushtet kur kjo bëhet me të vetmin qëllim, për të rivendosur të drejtën e shkelur të qytetarit në raport me administratën, rezultati merr edhe më shumë vlerë, sepse para se të jemi shtetarë, policë, prokurorë apo zyrtarë, të gjithë jemi qytetarë.

Avokati i Popullit ka deklaruar se nuk është një institucion akuze dhe as gjurmimi ndaj administratës publike në Shqipëri. Kritikën apo kërkesat tona për masa ndëshkuese ndaj punës së administratës apo zyrtarëve të veçantë, nuk përbëjnë qëllim në vetvete. Ne kritikojmë veprimet ose mosveprimet e administratës në rekomandimet dhe raportet tona, sikurse veprojnë ombudsmenët në të gjitha vendet. Qëllimi ynë nuk është për të punuar kundër institucioneve publike, as për të marrë meritat e punës së të tjerëve.

Të mos harrojmë se qëndrimi që administrata mban ndaj rekomandimeve të Avokatit të Popullit është tregues i përgjegjshmërisë së saj ndaj shkeljeve që kryen si edhe i faktit se sa e gatshme është ajo për t’i riparuar ato. Prandaj, veprimtaria jonë, ashtu si edhe deri tani, është mirëkuptuar e trajtuar me drejtësi nga të gjitha palët që bëjnë politikën në Shqipëri. Me fuqinë dhe kompetencat që na njohin Kushtetuta dhe Ligji, të provuara tashmë prej pesë vjetësh në raportet tona me administratën, kemi krijuar bindjen se hallet e njerëzve, të shprehura në kërkesat dhe ankesat e tyre nuk njohin asnjë ngjyrë politike.

Avokati i Popullit do të funksionojë gjithmonë si Oponencë për Mirëqeverisje. Ky është, ka qenë e do të jetë thelbi i filozofisë së funksionimit të këtij institucioni.

## PREZANTIMI I SHKURTËR I RAPORTIT

Në mbështetje të përcaktimeve të bëra në nenin 63 të Kushtetutës së Shqipërisë dhe në nenin 26 të Ligjit nr.8454 dt.04.02.1999, “Për Avokatin e Popullit”, Avokati i Popullit ka përgatitur Raportin e 5-të vjetor. Ky raport pasqyron veprimtarinë e Institucionit të Avokatit të Popullit gjatë vitit 2004. Ai është konceptuar në mënyrë të tillë që të merret një informacion i plotë për metoden e përdorur dhe fushat e veprimtarisë së institucionit, duke u shoqëruar gjithashtu dhe me të dhëna statistikore.

Raporti përmban katër krerë dhe tre anekse.

Kreu i parë është një prezantim i bërë nga Avokati i Popullit, i cili ndër të tjera i kushton vëmendje bashkëpunimit të Institucionit tonë me zyrat homologe dhe pjesëmarrjes aktive të Institucionit të Avokatit të Popullit në aktivitete të ndryshme ndërkombëtare. Po kështu ai shpjegon shkurtimisht arritjet e Institucionit dhe objektivat e tij për të ardhmen.

Kreu i dytë ka të bëjë me aktivitete të informimit dhe komunikimit të Institucionit të Avokatit të Popullit. Ky kapitull është ndarë në 5 seksione ku një vënd të veçantë zënë opinionet për situatën e të drejtave të njeriut si dhe për mirëqeverisjen në Shqipëri. Një seksion i veçantë i është kushtuar bashkëpunimit me mediat, që siç kemi përmendur gjithmonë, e kemi parë si mjetin më efikas për të siguruar aksesin e nevojshëm në publik dhe krijimin e individualitetit të domosdoshëm të Institucionit, për ushtrimin e funksionit sipas Kushtetutës dhe Ligjit “Për Avokatin e Popullit”.

Kreu i tretë, i cili zë dhe pjesën më të madhe në raport, ka të bëjë me rastet e trajtuara nga Avokati i Popullit, të ndara sipas ministrive përkatëse dhe organeve të tjera të administratës publike, hetimet e kryera për këto raste dhe rezultatet. Këtu kemi prezantuar dhe mjetet për zgjidhjen e rasteve tipike dhe të përsëritura, të cilat mendojmë se duhet të shërbejnë si udhërrëfytes për veprimet e organeve përgjegjëse të administratës në situata të ngjashme. Ky kre gjithashtu përmban rekomandime dhe propozime për eliminimin e të shkeljeve dhe padrejtësive, të cilat janë identifikuar gjatë shqyrtimit të ankesave të paraqitura tek Avokati i Popullit.

Kreu i katërt paraqet shkurtimisht rastet e papërfunduara të prezantuara në Raportin Vjetor 2003, shqyrtimi i të cilave ka përfunduar gjatë vitit 2004 si dhe çështjet e filluara me iniciativë nga Avokati i Popullit.

Në aneksin 1 kemi paraqitur disa nga letrat e falenderimit të qytetarëve drejtuar Institucionit të Avokatit të Popullit.

Aneksi 2 paraqet në mënyrë grafike statistikat e punës së Institucionit.

Raporti Vjetor i Avokatit të Popullit është një ndër mjetet kryesore nëpërmjet të cilit ai mund të ndikojë për mirëfunksionimin e shtetit të së drejtës, respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, forcimin e demokracisë, mirëadministrimin e punëve nga Administrata Publike dhe formulimin prej saj të politikave më të mira për zhvillimin e vendit.

## KREU I

### **1. Struktura, organika dhe cilësitë e personelit të zyrës së Avokatit të Popullit**

Ligji nr. 8600, dt.10.04.2000, “Për disa ndryshime në ligjin 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit””, i jep Avokatit të Popullit të drejtën e përcaktimit të strukturës, dhe numrit të personelit të tij, kurse pagat janë caktuar me vendim të veçantë të Qeverisë.

Zyra e Avokatit të Popullit funksionon me tre seksione të specializuara, siç i ka përcaktuar neni 31 i ligjit nr.8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”

**Seksioni i parë** merret me ankesat dhe kërkesat për organet e administratës qendrore, pushtetit vendor dhe të tretëve që veprojnë për llogari të tyre dhe drejtohet nga z. Gëzim Lleshi.

**Seksioni i dytë** merret me ankesat dhe kërkesat për policinë, shërbimin sekret, burgjet, Forcat e Armatosura, prokurorinë dhe pushtetin gjyqësor dhe drejtohet nga z. Jorgo Dhrami.

**Seksioni i tretë**, ose seksioni i përgjithshëm, trajton çështjet jashtë fushave të mësipërme, ndjek bashkëpunimin me organizatat joqeveritare dhe kryen studime në fushën e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Ky drejtohet nga z. Riza Poda.

Veç këtyre seksioneve, hallkë tjetër e rëndësishme e strukturës së institucionit është Kabineti, në përbërje të të cilit janë Shefi i Kabinetit dhe këshilltarët, të cilët janë në vartësi direkte nga Avokati i Popullit.

Sektorët ndihmës që ndihmojnë për realizimin e detyrave kryesore të Institucionit janë Drejtoria e Personelit dhe Administratës, Drejtoria e Marrëdhënieve me Jashtë, Sektori i Pritjes dhe regjistrimit të ankesave dhe Sektori i Financës, të cilët janë në varësi të Sekretarit të Përgjithshëm. Për 5 vite

zyra ka funksionuar në bazë të strukturës së mësipërme, por ligji ka lënë mundësi për fleksibilitet. Në varësi të prioriteteve të caktuara për të ardhmen kjo strukturë mund të ndryshohet për të sjellë më tepër efektivitet në punë.

Avokati i Popullit ka miratuar gjithsej 47 punonjës. Por Kuvendi në ligjin për Buxhetin e Shtetit për vitin 2005 ka miratuar vetëm 45 punonjës. Faktikisht aktualisht kemi të punësuar 45 punonjës. Nga këta janë 15 juristë që quhen ndihmëskomisionerë dhe merren direkt me zgjidhjen e ankesave, Juristë janë edhe 2 këshilltarë, 3 komisionerët dhe vetë Avokati i Popullit.


Ndihmëskomisionerët i janë nështruar konkursit të hapur në zbatim të ligjit nr. 8549, dt.11.11.1999 “Statusi i Nëpunësit Civil”. I gjithë stafi i punonjësve punon për ngritjen e tyre profesionale. Këtë e tregojnë edhe trajnimet e ndryshme që janë kryer edhe gjatë vitit 2004 brënda dhe jashtë vendit.

Me ftesë të Institutit të Trajnimit të Departamentit të Administratës Publike specialistë të Institucionit të Avokatit të Popullit kanë kryer kurse trajnimi me tematika të ndryshme gjatë vitit 2004 dhe janë paisur me çertifikatën përkatëse si dhe kanë marrë pjesë edhe si trajnues për llogari të Institutit të Trajnimit.

Përsa i përket cilësive profesionale të personelit të zyrës sonë vemë në dukje se Avokati i Popullit mban titullin “Profesor i Asociuar Doktor” kurse z. Jorgo Dhrami mban gradën shkencore “Doktor i Shkencave Juridike”, 4 të tjerë aktivizohen për mësimdhënie si pedagogë të jashtëm në Fakultetet e Drejtësisë dhe në Shkollën e Magjistraturës.

Nga ekspertët e zyrës sonë 4 kanë kryer ose vazhdojnë studimet pasuniversitare, 20 prej tyre zotërojnë dhe përdorin mirë një ose më shumë gjuhë të huaja, kryesisht anglisht, frëngjisht, italisht, gjermanisht apo rusisht.

# STRUKTURA E INSTITUCIONIT TE AVOKATIT TE POPULLIT



## Pasqyra nr.2

### ORGANIKA E INSTITUCIONIT TË AVOKATIT TË POPULLIT

Nr.	EMËRTIMI	NËPUNËS
<b>I.</b>	<b>AVOKATI I POPULLIT</b>	<b>(1)</b>
<b>II.</b>	<b>KABINETI</b> Shefi i Kabinetit Zëdhënës i Avokatit të Popullit Këshilltarë të Avokatit të Popullit Sekretare e Avokatit të Popullit	<b>(5)</b> 1 3 1
<b>III.</b>	<b>SEKSIONI I ORGANEVE TË ADMINISTRATËS QENDRORE DHE VENDORE</b> Komisioner Ndihmëskomisionerë (jurist) Sekretare + Rregjistruese	<b>(6)</b> 1 4 1
<b>IV.</b>	<b>SEKSIONI I SHËRBIMEVE TË VEÇANTA</b> Komisioner Ndihmëskomisionerë (jurist) Sekretare + rregjistruese	<b>(8)</b> 1 6 1
<b>V.</b>	<b>SEKSIONI I PËRGJITHSHËM</b> Komisioner Ndihmëskomisionerë (jurist) Sekretare + rregjistruese	<b>(6)</b> 1 4 1
<b>VI.</b>	<b>SEKRETARI I PËRGJITHSHËM</b>	<b>(1)</b>
<b>VII.</b>	<b>DREJTORIA E MARRËDHËNIEVE ME JASHTË</b> Drejtor Përgjegjës i sektorit të përkthimit dhe bibliotekës	<b>(2)</b> 1 1
<b>VIII.</b>	<b>DREJTORIA E PERSONELIT DHE ADMINISTRATËS</b> Drejtor Shef Sektori Shofer Pastrues	<b>(11)</b> 1 1 7 2
<b>IX.</b>	<b>SEKTORI I FINANCËS</b> Shef Sektori Llogaritar i parë, Arkëtar Magaznier	<b>(3)</b> 1 1 1
<b>X.</b>	<b>SEKTORI I PRITJES SE POPULLIT</b> Shef Sektori Ndihmeskomisioner	<b>(2)</b> 1 1
<b>XI.</b>	<b>SEKTORI I SEKRETARISE DHE ARKIVIT</b> Shef Sektori Arkivist+sekretare e Sekretarit të Përgjithshëm	<b>(2)</b> 1 1

Punonjës gjithsej të Institucionit të Avokatit të Popullit janë 47 veta

## **2. Bashkëpunimi dhe mbështetja ndërkombëtare për Institucionin**

Këshilli i Europës dhe institucione të tjera të rëndësishme ndërkombëtare, gjatë viteve të fundit kanë punuar për ngritjen dhe mbështetjen e institucionit të Ombudsmanit në shtetet anëtare. Këshilli i Europës drejton bashkërendimin e projekteve të Paktit të Stabilitetit në Europën Juglindore, për institucionet kombëtare të mbrojtjes së të drejtave të njeriut, përfshirë këtu edhe institucionin e Avokatit të Popullit në Shqipëri.

Që në fillim të veprimtarisë së Avokatit të Popullit në vendin tonë, një rëndësi të veçantë ka patur mbështetja ndërkombëtare e Institucionit. Ne kemi qenë nën mbikqyrjen e afërt dhe koordinuese të OSBE-së, kemi patur ndihmën e vazhdueshme të Këshillit të Europës, Grupit të Miqve të Avokatit të Popullit si dhe mbështetjen financiare projektit Danida të Qeverisë së Mbretërisë së Danimarkës. Kjo mbështetje ka qenë konkrete, tepër e pranishme dhe mjaft efiçente. Në grupin e quajtur Miqtë e Avokatit të Popullit, bënin pjesë përfaqësuesit e Këshillit të Europës dhe të OSBE-së në Tiranë, ambasadat e Mbretërisë së Danimarkës dhe të SHBA, organizata si USAID, Banka Botërore, ABA-Ceeli, CAFOD, QSHDNj etj. Në Qershor 2004, Prezenca e OSBE-së në Shqipëri ka marrë nismën që institucionet e mësipërme të krijojnë Grupin e Partnerëve të Avokatit të Popullit.

Duke patur parasysh statusin unik të Ombudsmanit, ka rezultuar që ky institucion forcohet më shumë dhe zhvillohet më tej kryesisht përmes bashkëpunimit me zyrat homologe si dhe pjesëmarrjes aktive në forumet ndërkombëtare, cilësuar joformalisht si Familja Ndërkombëtare e Ombudsmanit.

Avokati i Popullit është aktualisht anëtar me të drejta të plota i Institutit Ndërkombëtar të Ombudsmanit, i Ombudsmanit Evropian dhe Shoqatës së Ombudsmanit Frankofon. Të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga anëtarësia Avokati i Popullit i realizon përmes pjesëmarrjes në aktivitete si brenda, ashtu edhe jashtë vendit.

### **I. Aktivitete të organizuara nga Këshilli i Europës:**

1. Në kuadrin e Paktit të Stabilitetit, nga 19-20 janar 2004, Këshilli i Europës në bashkëpunim me Ministrinë e Punës dhe Çështjeve Sociale, organizuan në Tiranë konferencën ndërkombëtare me temë “Të luftojmë kundër trafikimit të fëmijëve në Europë”. Avokati i Popullit në këtë aktivitet foli për shkaqet e trafikimit të fëmijëve, faktorët nga ku e kanë burimin këto shkaqe si dhe u bëri thirrje autoriteteve shtetërore si dhe strukturave të Bashkimit



European dhe të Këshillit të Europës për vlerësimin e kësaj situate drejt gjetjes së rrugëve që do të zvogëlonin shkallën e të gjithë trafikeve, përfshirë edhe trafikun e fëmijëve.

2. Avokati i Popullit mori pjesë në Seminarin “Roli i Ombudsmanit në një shoqëri të bazuar në shtetin e së drejtës”, që u zhvillua në Cappadocia, Turqi më 9-10 maj 2004, organizuar nga Komisioneri për të Drejtat e Njeriut të Këshillit të Europës në bashkëpunim me Parlamentit turk. Në këtë seminar u diskutua rëndësia e ngritjes së Institucionit të Ombudsmanit në Turqi si dhe u dhanë përvojat e ndryshme të zyrave homologe të Ombudsmanit, për të mundësuar arritjen e qëllimit për ngritjen e këtij institucioni në Turqi.

3. Në datat 26-28 Nëntor 2004, në Berlin, Gjermani, u zhvillua Takimi i Pestë Europjan i Institucioneve Kombëtare për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut si dhe Tryeza e 3-të e Rrumbullaket e Institucioneve Kombëtare për të Drejtat e Njeriut, organizuar nga Këshilli i Europës në bashkëpunim me Institutin Gjerman për të Drejtat e Njeriut. Pjesëmarrës ishte edhe një përfaqësues nga Institucioni i Avokatit të Popullit.

## **II. Aktivitete të organizuara nga Organizata e Kombeve të Bashkuara (OKB):**

1. Në Maj 2004, Institucioni i Avokatit të Popullit, në bashkëpunim me Zyrën e Komisionerit të Lartë për të Drejtat e Njeriut të Kombeve të Bashkuara organizoi në Tiranë seminarin me rastin e 10 vjetorit të miratimit të Parimeve të Parisit me temë: “Një shikim historik të Parimeve të Parisit, angazhimi i strukturave të Kombeve të bashkuara për zbatimin e tyre nga shtetet anëtare. Përvoja e Avokatit të Popullit në Shqipëri”.

Në këtë seminar mori pjesë edhe Z. Brice Dickson, Kryekomisioner i Komisionit për të Drejtat e Njeriut të Irlandes së Veriut, i cili vlerësoi mjaft përvojën shqiptare.

2. Një përfaqësues nga Institucioni i Avokatit të Popullit, i ftuar nga Ministria jonë e Punëve të Jashtme, mori pjesë në sesionin e 82-të të Komitetit për të Drejtat e Njeriut të Kombeve të Bashkuara që u mbajt në Gjenevë me 19-20 tetor 2004. Në këtë sesion u paraqit Raporti i I-rë Kombëtar mbi zbatimin e Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike në Republikën e Shqipërisë.

3. Me ftesë të Presidentit të Komisionit Kombëtar Meksikan për të Drejtat e Njeriut, Dr. Jose Luis Soberanes Fernandez, mbështetur nga Zyra e Komisionerit të Lartë për të drejtat e Njeriut të Kombeve të Bashkuara, një përfaqësues nga Institucioni i Avokatit të Popullit mori pjesë në Seminarin Ndërkombëtar me temë “Shkaqet, efektet dhe pasojat e fenomenit të migrimit

në mbrojtjen e të drejtave të njeriut”, që u zhvillua në qytetin Zacatecas, Meksike, me 13-15 tetor 2004.

### **III. Konferenca të tjera ndërkombëtare:**

1. Një delegacion i Institucionit të Avokatit të Popullit, kryesuar nga z. E.Dobjani mori pjesë në Konferencën e Shoqatës së Ombudsmanëve të SHBA (TOA) me temë: “Vlera e Ombudsmanit në përballimin e Sfidave Profesionale, Ligjore dhe Ekonomike, të një bote në ndryshim”, që u mbajt në Tuscon, Arizona me 18-21 Prill 2004.

2. Me 26-29 prill 2004, në Seul, Koreja e Jugut, u zhvillua Konferenca e Tetë e Shoqatës së Ombudsmanëve Aziatikë. Në të mori pjesë edhe një delegacion i institucionit të Avokatit të Popullit. Tema ishte “Ombudsmani dhe forcimi i të drejtave civile në Azi”. Në këtë aktivitet, Avokati i Popullit dha kontributin e tij, duke mbajtur fjalën mbi përvojën shqiptare të këtij institucioni.

Avokati i Popullit dhe kryetarët e delegacioneve të tjera patën një takim të përbashkët me Presidentin në detyrë dhe Kryeminister i Koresë së Jugut, Z. Goh Kun.

3. Një delegacion nga Zyra e Avokatit të Popullit mori pjesë në Asambleshën e Përgjithshme të Ombudsmanit Europian, që u mbajt në Budapest me 10 maj 2004. Asambleja e përgjithshme u zhvillua në vijim të Sesionit me temë: “Mbrojtja e Minoriteteve dhe Realiteti i Ombudsmanit”.

4. Një përfaqësues nga Zyra e Avokatit të Popullit mori pjesë në Konferencën e 3-të Ndërkombëtare të Këshillit të Gjykatave Administrative të Kanadasë, me temë: “Ta sjellim të Drejtën Administrative pranë njerëzve në të gjithë botën – të mësojmë nga njëri tjetri”, që u zhvillua në Toronto me 20-23 qershor 2004.

5. Me ftesë të përfaqësueses speciale të OSBE-së për luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore, dy përfaqësues të Institucionit të Avokatit të Popullit morën pjesë në konferencën ndërkombëtare me temë: “Aleancë kundër trafikimit të qenieve njerëzore”, që u mbajt në Vienë, me 23 korrik 2004.

6. Një delegacion i kryesuar nga Avokati i Popullit, mori pjesë në Konferencën e 8-të të Institutit të Ombudsmanit Ndërkombëtar, që u mbajt në Quebec City, Kanada, me 7-10 shtator 2004. Tema e kësaj konference ishte “Roli i Ombudsmanit në balancimin e detyrimeve të shtetësisë dhe njohjes së të drejtave dhe përgjegjësisive të individit”. Qëllimi i kësaj konference ishte promovimi i ideve të reja dhe lehtësimi i debatit mbi shqetësimet ekzistuese të Ombudsmanëve.

Njekohësisht, Avokati i Popullit mori pjesë edhe në Forumin e Shoqatës së Ombudsmanit dhe Mediatorit Frankofon, ku Institucioni i Avokatit të Popullit është anëtar votues me të drejta të plota.

Gjatë qëndrimit në Kanada, Avokati i Popullit, me kërkesë të tij organizoi një takim me përfaqësues të komunitetit shqiptar në Toronto. Ata kërkuan ndihmën dhe ndërmjetësinë e Avokatit të Popullit pranë organeve përkatëse të shtetit shqiptar për të ndihmuar më shumë emigrantët, në drejtim të sigurimit të programeve dhe librave për mësimin e gjuhës shqipe për fëmijët e tyre si dhe për lehtësimin e procedurave konsullore.

7. Një përfaqësues nga Zyra e Avokatit të Popullit mori pjesë në Konferencën e 7-të Ndërkombëtare të Institucioneve për të Drejtat e Njeriut, me temë “Mbrojtja e të drejtave të njeriut gjatë konflikteve dhe rasteve të terrorizmit”, që u mbajt në Seul të Korese së Jugut, me 14-17 shtator 2004.

8. Në kuadrin e Paktit të Stabilitetit dhe Projektit Eunomia të Zyrës së Ombudsmanit Grek, Avokati i Popullit, Z. Ermir Dobjani mori pjesë në Konferencën Rajonale me temë “Ombudsmani në vendet e Europës Juglindore – rritja e bashkëpunimit rajonal”, që u zhvillua në Beograd me 28-29 shtator 2004. Në fjalën e tij Avokati i Popullit u ndal në marrëdhëniet e Avokatit të Popullit dhe Pushtetit Gjyqësor.

9. Nga 6-7 Tetor 2004, Avokati i Popullit, z. Ermir Dobjani mori pjesë në Konferencën Rajonale për Ngritjen e Institucionit të Ombudsmanit në Jordani, organizuar nën kujdesin e Madhërisë së Tij, Mbretit Abdullah të Jordanisë, në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Jashtme të Danimarkës dhe Zyrën e Ombudsmanit Danez.

Avokati i Popullit u ftua në veçanti nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe Zyra e Ombudsmanit të Danimarkës, për të shpjeguar përvojën e tij në ngritjen e Institucionit të Avokatit të Popullit në Shqipëri.

#### **IV. Vizitat e Ombudsmanëve të shteteve të tjera në Shqipëri**

Gjatë vitit 2004, në vijim të shkëmbimit të përvojave nëpërmjet vizitave të disa homologëve, të realizuara në zyrën e Avokatit të Popullit të Shqipërisë, përveç vlerësimeve për arritjet e këtij Institucioni të ri, është shprehur edhe gadishmëria për bashkëpunim të mëtejshëm.

1. Me 18-20 shkurt 2004, në kuadrin e shkëmbimit të përvojave midis zyrave homologe të Ombudsmanit European, ishte për një vizitë zyrtare në Shqipëri, Z. Roel Fernhout, Ombudsmani Kombëtar i Holandës.

Në takimet e Z. Fernhout me autoritetet e larta të Shqipërisë ai vlerësoi ndër të tjera marrëdhëniet e mirëkuptimit, të vendosura midis Avokatit të Popullit dhe përfaqësuesve të lartë të administratës shtetërore shqiptare.

2. Me 16-18 mars 2004, erdhi në Tiranë për një vizite zyrtare Ombudsmani i Republikës së Polonisë, Z. Andrzej Zoll. Qëllimi i kësaj vizite ishte bashkëpunimi midis dy zyrave homologe, duke patur parasysh që Polonia është i pari vend i Europës Lindore që ka ngritur Institucionin e Ombudsmanit që në vitin 1989 dhe ka një legjislacion mjaft të përparuar në këtë fushë.

#### **V. Vizitat e Avokatit të Popullit në zyrat e Ombudsmanëve të vendeve të tjera.**

1. Me 17-19 Qershor 2004, me ftesë të Ombudsmanit të Maqedonisë, Z. Branko Naumoski, një delegacion i Avokatit të Popullit bëri një vizitë zyrtare në Shkup. Avokati i Popullit, Z. Dobjani u prit dhe bisedoi me personalitetet më të larta të Maqedonisë, përfshirë edhe Presidentin e Maqedonisë, z. Branko Cervenkovski.

#### **VI. Vizitat për shkëmbim eksperience dhe trajnime të stafit të zyrës së Avokatit të Popullit**

1. Me 20-23 tetor 2004, dy ekspertë të Zyres së Avokatit të Popullit morën pjesë në trajnimin e organizuar nga Qendra Europiane për Çështje të Minoritetit, që u zhvillua në Ohër të Maqedonisë.

2. Me 8-12 Nëntor 2004, katër përfaqësues të zyrës së Avokatit të Popullit morën pjesë në aktivitetin e trajnimit me temë “Të forcojmë zbatimin e rekomandimeve të traktateve për të drejtat e njeriut nëpërmjet përmirësimit të masave mbrojtëse kombëtare”, që u zhvillua në Gjenevë, organizuar nga Zyra e Komisionerit të Lartë për të drejtat e njeriut.

#### **VII. Vizitat për shkëmbim eksperience në Institucionin e Avokatit të Popullit**

1. Në kuadrin e shkëmbimit të eksperiencave midis zyrave homologe dhe me mbështetje financiare të zyrës së OSBE-së në Prishtinë, erdhi për trajnim profesional pranë Institucionit të Avokatit të Popullit, për periudhën një mujore, 1-30 nëntor 2004, një ekspert nga Institucioni i Ombudspersonit të Kosovës.

2. Njëkohësisht, gjatë të njëjtës periudhë dhe për të njëjtën arsye, një ekspert nga Zyra e Avokatit të Popullit të Shqipërisë shkoi pranë Institucionit të Ombudspersonit të Kosovës.

## VIII. Ekspertët e huaj në zyrën e Avokatit të Popullit

1. Me 9-11 shkurt 2004 erdhën në Zyrën e Avokatit të Popullit për të dhënë kontributin profesional në vazhdim, Këshilltari Ligjor pranë Ombudsmanit Danez, Z. Jens Olsen dhe specialisti i sistemit kompjuterik Z. Christian Moller nga Zyra e Ombudsmanit Parlamentar te Danimarkes.

2. Me 19-22 tetor 2004, Këshilltari Ligjor pranë Ombudsmanit Danez, z.Jens Olsen dhe specialisti i sistemit kompjuterik Z. Christian Moller erdhën përsëri në Tiranë për të vlerësuar ecurinë e Institucionit të Avokatit të Popullit dhe efikasitetin e kontributit të tyre në vazhdimësi.

Pjesa më e madhe e aktiviteteve ndërkombëtare të mësipërme janë financuar nga institucionet ndërkombëtare që i kanë organizuar ato.

## 3. Buxheti i Institucionit për vitin 2004

Për të funksionuar me efikasitet një institucion i tillë siç është Avokati i Popullit, kërkohet jo vetëm mbështetje politike, institucionale, potenciale njerëzore, por dhe mbështetje financiare. Në këtë vështrim një konceptim i tillë i drejtë ka egzistuar nga Kuvendi dhe Qeveria Shqiptare. Për vitin 2004 është dhënë një buxhet në shumën 85.500.000 lekë ose rreth 855.000 USD, i cili për periudhën objekt raportimi është konsumuar në masën 93.4% e konkretisht:

<b>Nr.Llog.</b>	<b>Emërtimi</b>	<b>Plan lekë</b>	<b>Realizim lekë</b>	<b>Realizim %</b>
600	Pagat	43.000.000	41.819.213	97%
601	Sigurim shoqëror	7.000.000	7.000.000	100%
602	Shp operative	27.700.000	27.609.046	100%
605	Kuotë anëtarësie	210.000	167.500	80%
231	Investime	7.590.000	3.238.680	43%
	<b>Totali</b>	<b>85.500.000</b>	<b>79.923.439</b>	<b>93,4%</b>

Ky buxhet është përdorur për paga punonjësish, dieta brenda dhe jashtë vendit, blerje kancelarie, karburant, parkim automjetesh, shpenzime për energji elektrike, impulse telefoni, pritje të delegacioneve të huaja etj. Në lidhje me kuotat e anëtarësisë kemi bërë pagesën për Institutin Europian të Ombudsmanëve, Institutin Ndërkombëtar të Ombudsmanëve, Shoqatën e Ombudsmanëve Frankofonë.

Investimet nuk janë harxhuar për shkak se nuk na u vunë në dispozicion disa zyra në Tiranë dhe nuk u miratua hapja e zyrave rajonale në rrethe. Por në fund të vitit 2004 patëm mungesë buxheti për shpenzimet operative, për të paguar dieta për shërbime, për të riparuar mjetet që janë vjetëruar pas 5 vjet pune, për të paguar telefonat fikse sepse janë rritur çmimet etj. Faktikisht për vitin 2005 nuk kemi rritje buxheti.

#### **4. Sfidat dhe objektivat e Institucionit për vitin 2005 e në vazhdim**

Ngritja e një Institucioni nuk është qëllim në vetvete. Përtej legjislacionit dhe zgjedhjes së Ombudsmanit, ajo që ka më shumë rëndësi është mirëfunksionimi i institucionit. Prej këtej del vetvetiu sfida themelore për të ndërtuar një institucion të pavarur shërbimi për qytetarët, të drejtat e të cilëve mund të shkelen eventualisht nga Administrata Publike Shqiptare. Është e rëndësishme të kuptohet se pavarësia institucionale nuk është një privilegj që i jepet Kreut të Zyres dhe punonjësve të saj, por një garanci për të vepruar me profesionalizëm dhe përkushtim për të ndërmjetësuar midis qytetarit dhe autoritetit publik, kur ky i fundit me veprime apo mosveprime lejon të shkelen të drejtat e individit, të njohura ligjërisht.

Kështu, duke ndjekur çështjet rast pas rasti, ne kemi rekomanduar masa administrative dhe dhënë opinione për parandalimin e shkeljeve nga Administrata Publike në të ardhmen. Disa nga drejtimet e punës që ne kemi zbatuar për të realizuar sa më sipër kanë qenë: dhënia e ndihmës ligjore nëpërmjet rekomandimeve dhe këshillave në rastet e konflikteve midis administratës dhe publikut, zbulimi i defekteve të administratës, denoncimi i sjelljeve të këqia të nëpunësve kundrejt qytetarëve, presioni për ndryshimin e procedurave të rënuara dhe të paqarta të Administratës Publike, krijimi i kushteve që qytetarët të gëzojnë të drejtat e tyre në marrjen e informacioneve të nevojshme nga Administrata Publike, nxitja e transparencës së kësaj të fundit në veprimtarinë e saj, angazhimi në rritjen e cilësisë së shërbimeve publike si dhe zgjerimi gjeografik i ushtrimit të kompetencave të Zyrës.

Në funksion të këtyre sfidave që mbeten edhe për të ardhmen, do t'i kushtojmë vëmendje të veçantë ndër të tjera këtyre objektivate:

1-Bashkëpunimi i vazhdueshëm me Parlamentin, jo vetëm për ta informuar më mirë për situatën e të drejtave të njeriut dhe shkeljet e administratës publike në Shqipëri, por edhe për të bërë ndryshimet e nevojshme ligjore, që do të sillnin një efektivitet më të madh të Zyrës së Avokatit të Popullit.

2-Forcimi i bashkëpunimit me të gjitha segmentet e Administratës publike shqiptare për rritjen e standarteve të qeverisjes ose thënë më thjeshtë, për mirëqeverisje.

3-Forcimi i bashkëpunimit me organizma të shoqërisë civile si grupe “presioni” pozitiv mbi administratën. Ky bashkëpunim si dhe ai me median do të konsolidojë më tej arritjet e deritanishme, me synim rritjen e efektshmërisë së ndërhyrjeve të Institucionit tonë për ngulitjen e praktikave të mira administrative.

4-Vazhdimi i veprimtarisë ndërgjegjësuese të publikut dhe administratës për vendin dhe rolin e Avokatit të Popullit. Organizimi i ditëve të hapura në mënyrë periodike në zona të ndryshme të vendit, duke zbatuar edhe forma të tjera për t’ju afruar sa më shumë publikut.

5-Publikimi më mirë dhe më shumë i problemeve kryesore të evidentuara nga shkeljet e Administratës Publike në fushën e të drejtave të njeriut.

6-Hapja e zyrave rajonale dhe caktimi i përfaqësuesve vendorë të Avokatit të Popullit sa më shpejt të jetë e mundur.

7-Mirëfeksionimi i nënseksionit për mbrojtjen e të drejtave të femijëve, me qëllim krijimin në të ardhmen e një Zyre të Ombudsmanit të Femijëve.

8-Angazhimi i mëtejshëm për rritjen cilësore dhe sasiore të nivelit të raportimeve pranë orgamizmave ndërkombëtare. Kjo do të bëhet si në përditësimin e raporteve të paraqitura nga pala shtetërore, ashtu edhe të raporteve alternative, të përgatitura në bashkëpunim me shoqërinë civile.

9-Rritja e racionalitetit të shpërndarjes dhe menaxhimit të rasteve në varësi të rritjes së volumit të punës. Zbatimi më i shpeshtë i mediacionit në punën tonë, dhe funksionimi i një njesie të veçantë pranë zyrës për këtë qëllim. Kjo do të kushtëzohet si nga shtesa në numrin e stafit të ekspertëve, që do t’ia kërkojmë autoriteteve shqiptare për të na e miratuar, ashtu edhe nga trajnimi i kësaj njesie në zyra të tjera homologe që e aplikojnë këtë teknikë të re për ne.

10-Vazhdimi i programit të trajnimit vazhdues për forcimin dhe motivimin e mëtejshëm të kapaciteteve të zyrës.

11-Ruajtja e qëndrueshmërisë teknike, e kushtëzuar kjo deri diku edhe nga ajo financiare. Rrjeti i sistemit informativ kushtëzon mirëmbajtje të vazhdueshme. Rritja e ngarkesës së punës ka bërë të domosdoshme nevojën për shtesën e ambjenteve përkatëse për krijimin e Arkivit të Institucionit, për risistemimin e Zyrës së Pritjes së Popullit si dhe për një akomodim më të mirë të stafit të ekspertëve që duhet të rritet.

12-Qëndrueshmëria financiare mund të vihet në pikëpyetje, pasi shteti shqiptar është i detyruar të ndjekë një politikë të rreptë fiskale, përmes shkurtimit të buxhetit. Ritmet e deritanishme të suksesit, veç përkushtimit të stafit drejtues dhe të specialistëve, janë kushtëzuar në një masë thelbësore edhe

nga frekuenca e trajnimeve që ne kemi realizuar, si duke shkuar në zyra homologe, ashtu edhe duke ftuar ekspertë të huaj në Shqipëri. Por në buxhetin e akorduar nga shteti, ne nuk shikojmë të jemi prioritarë në krahasim me institucionet e tjera shtetërore buxhetore.

Garanci për përballimin e këtyre sfidave dhe të tjerave që lidhen me to është përvoja e deritanishme si dhe orientimi i drejtë i organeve të administratës publike në përmbushjen e standarteve të mirëqeverisjes.



## KREU II

### **1. Statistika përmbledhëse e vitit 2004**

(Rastet sipas fushave përkatëse dhe mënyra e përfundimit të tyre)

Në Raportet Vjetorë që ne i kemi paraqitur Parlamentit, një vend të veçantë ka zënë pasqyrimi i statistikës për prezantimin e numrit të ankesave të shqyrtuara nga Institucioni i Avokatit të Popullit gjatë vitit për të cilin është raportuar.

Ashtu siç kemi thënë më parë, numrin e përgjithshëm të ankesave e kemi parë të lidhur ngushtë me numrin e të drejtave të shkelura apo dhe me mënyrën se si individët i konceptojnë të drejtat e tyre. E rëndësishme në këtë pikë, ka qenë evidentimi i numrit të ankesave të bazuara dhe numri i ankesave të pabazuara, çka na ka lejuar të krijojmë mendimin tonë mbi masën e shkeljes së të drejtave të njeriut dhe mënyrën e perceptimit të këtyre shkeljeve si nga ana e qytetarëve, ashtu dhe ana e Administratës Publike Shqiptare.

Gjatë periudhës 1 Janar - 31 Dhjetor 2004 janë trajtuar nga Zyra e Avokatit të Popullit 3840 ankesa, kërkesa dhe njoftime (duke përfshirë dhe ato të Zyrës së Pritjes së Popullit, të cilave ju është dhënë përgjigje menjëherë). Nga 3840 ankesa, 513 kanë qenë të mbartura nga viti 2003 dhe janë raportuar si të tilla në Raportin Vjetor 2003. Ankesa, kërkesa dhe njoftime të cilat i janë nënshtruar shqyrtimit nga ana e Zyrës sonë kanë qenë 2520. Nga këto, 408 ankesa ose 16 % e tyre kanë kaluar për shqyrtim në vitin 2005. Nga trajtimi i 2112 ankesave të përfunduara gjatë vitit 2004, ka rezultuar se 1057 ankesa, ose 50 % e tyre, kanë qënë jashtë juridiksionit. Por për këto ankesa është bërë punë efektive, sepse qytetarët janë sqaruar për rrugën që ata duhej të ndiqnin për zgjidhjen e problemit të prezantuar tek ne. Nga 1055 ankesat që kanë qënë brenda juridiksionit dhe kompetencës së Avokatit të Popullit, 553 ose 52 % e ankesave kanë rezultuar të padrejta, kurse 395 ose 38 % e tyre janë zgjidhur në favor. Nga 395 ankesat e drejta, për 90 prej tyre janë bërë rekomandime apo propozime përkatëse me shkrim, drejtuar autoriteteve publike me qëllim që të rritet cilësia e administrimit publik dhe të sigurohen standarte mirëqeverisje. Për pjesën tjetër zgjidhjet pozitive janë arritur që në fazën e marrjes së shpjegimeve apo ndërmjetësimit tonë verbal me organet e Administratës Publike, të cilat pas komunikimit me ne, kanë rregulluar gabimin e bërë, ose kanë hequr dorë nga

qëndrimet refuzuese apo negative që kanë mbajtur me ankuesit. Rekomandimet e bëra nga Avokati i Popullit dhe të pranuar nga organet të cilave ato u janë drejtuar tregojnë për ndërhyrje të argumentuara nga institucioni ynë për rivendosjen në vend të të drejtave të shkelura qytetarëve.

Në këtë Raport Vjetor do të prezantojmë, ashtu si dhe vitin e kaluar, rastet e trajtuara nga Zyra e Avokatit të Popullit, të ndara sipas Ministrive përkatëse dhe organeve apo enteve të tjera të Administratës Publike Shqiptare në vartësi të tyre, ndaj të cilave janë drejtuar ankesat apo kërkesat, duke shprehur shpesh dhe opinionet tona për fushat përkatëse.

Më poshtë po paraqesim numrin e ankesave, kërkesave apo njoftimeve të trajtuara në vitin 2004, të ndara sipas Ministrive përkatëse, organeve apo enteve të tjera të administratës publike.

<b>1. Këshilli i Ministrave</b>	<b>128</b> , nga të cilat për:
vetë Qeverinë	13
a. Grupin Mbikqyrës të Firmave Piramidale	7
b. Zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme	69
c. Komisionet e kthimit dhe kompensimit të pronave	33
ç. Instituti i Integritit të ish të Përndjekurve politikë	6
<b>2. Ministria e Drejtësisë</b>	<b>391</b> , nga të cilat për:
vetë ministrinë	22
a. Burgjet	177
b. Zyrat e Përmbarimit	192
<b>3. Organet e pushtetit gjyqësor</b>	
Gjykatat	<b>252</b>
<b>4. Prokuroria</b>	<b>159</b>
<b>5. Ministria e Rendit Publik</b>	<b>169</b>
<b>6. Ministria e Mbrojtjes</b>	<b>69</b>
<b>7. Ministria e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit</b>	<b>402</b> nga të cilat për:
vetë ministrinë	25
<i>Organet e pushtetit vendor</i>	
a. Komunat	64
b. Bashkite	287
c. Prefekturat	17
d. Qarqet	9

<b>8. Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale</b>	<b>241</b> , nga të cilat për:
vetë ministrinë	9
a. Institutin e Sigurimeve Shoqërore	209
b. Shërbimi Social Shtetëror	28
<b>9. Ministria e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit</b>	<b>142</b> , nga të cilat për:
vetë Ministrinë	22
a. Ndërtimet pa leje	117
b. Ujësjetës kanalizime	3
<b>10. Ministria e Ekonomisë</b>	<b>3</b>
<b>11. Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit</b>	<b>63</b>
<b>12. Ministria e Financave</b>	<b>35</b> , nga të cilat për:
vetë ministrinë	27
a. Agjensinë Kombëtare të Privatizimit	8
<b>13. Ministria e Arsimit dhe Shkencës</b>	<b>64</b>
<b>14. Ministria e Shëndetësisë</b>	<b>33</b>
<b>15. Ministria e Punëve të Jashtme</b>	<b>13</b>
<b>16. Ministria e Transporteve dhe Telekomunikacioneve</b>	<b>38</b> , nga të cilat për:
vetë Ministrinë	15
a. Telekom-in	23
<b>17. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve</b>	<b>10</b>
<b>18. Ministria e Mjedisit</b>	<b>4</b>
<b>19. Ministria e Industrisë dhe Energjitikës</b>	<b>63</b> , nga të cilat për:
vetë Ministrinë	16
a. Korporatën Elektroenergjitike	47
<b>20. Shërbimet Sekrete</b>	<b>12</b>
<b>Të tjera</b>	<b>229</b>
<b><u>TOTALI</u></b>	<b>2520 ankesa</b>

Objektivi kryesor i Institucionit të Avokatit të Popullit është që t'i sigurojë qytetarëve të cilët i drejtohen atij, ndihmën dhe këshillat e nevojshme në kohën dhe mënyrën e duhur.

Gjatë 5 viteve të funksionimit të Institucionit tonë, ne kemi qënë të aftë t'i ndihmojmë ankuesit si nëpërmjet fillimit të hetimeve tona apo transferimit të çështjeve tek organet përkatëse të administratës publike si dhe nëpërmjet këshillave se ku duhet ta drejtojnë ata kërkesën apo ankesën e tyre për të zgjidhur problemin e prezantuar. Kuptohet që rezultate të tilla janë të mundura vetëm atëherë kur Institucioni i Avokatit të Popullit është konstruktiv në punën e tij në lidhje me institucionet, organet apo entet e tjera të administratës publike, kundër të cilave drejtohen ankuesit me ankesën e tyre. Gjatë vitit 2004 organet e ndryshme të administratës kanë vazhduar të demostrojnë dëshirën e tyre për të zgjidhur problemet që Institucioni i Avokatit të Popullit i ka sjellë atyre në vëmendje duke pranuar dhe zbatuar rekomandimet e Institucionit të Avokatit të Popullit. Gjatë 5 viteve, Avokati i Popullit ka realizuar mjaft takime me përfaqësues të administratës qëndrore dhe vendore për t'i shpjeguar atyre se çfarë pritet dhe kur ka qënë e nevojshme ka tërhequr vëmendjen në fusha ku përmirësimet kanë qënë të domosdoshme. Këto takime kanë kontribuar në rritjen e kuptimit të rolit të Avokatit të Popullit si një Institucion i pavarur, mekanizëm i jashtëm i kontrollit mbi administratën dhe si një mjet mediacioni. Rritja e familjarizimit me këtë rol të fundit ka ndihmuar në demonstrimin organeve të administratës publike, të përfitimit që ka bashkëpunimi me Institucionin e Avokatit të Popullit. Ne besojmë se është rritur ndërgjegjësimi i organeve të ndryshme të administratës publike se zgjidhja e çështjeve të ankuesve rezulton të ketë përfitim të dyfishtë: jo vetëm në reduktimin e mundësisë për paraqitjen e të njëjtës ankesë në të ardhmen me të njëjtin objekt, por edhe në rritjen e aftësisë së institucioneve të monitorojnë kapacitetet e tyre në përgjigje të hapave që ato ndërmarrin në lidhje me keqadministrimin që përfshin shërbimin e tyre. Për këtë ne kemi rekomanduar transparencë në procedurat administrative. Kryesore për Avokatin e Popullit gjatë gjithë këtyre viteve të ushtrimit të kompetencave të tij ka qënë forcimi i komunikimit të tij me publikun dhe administratën. E megjithë këtë, përsëri rezulton një perqindje e konsiderueshme e rasteve të paraqitura përpara nesh që kanë qënë jashtë juridiksionit tonë. Për këtë ne do të vazhdojmë të intensifikojmë përpjekjet, të nxitim informimin e përdoruesve potencial të shërbimit të Avokatit të Popullit. Njëra nga mënyrat mund të jetë bashkëpunimi më i mirë me organet e administratës. Këto të fundit mund dhe duhet të informojnë sistematikisht aplikantët për të përfituar ndër të tjera nga mundësia për t'i drejtuar ankesën dhe Institucionit të Avokatit të Popullit lidhur me keqadministrimin. Ne kemi

punuar për të marrë ankesa nga persona të ndryshëm dhe nëpërmjet seminareve, takimeve dhe konferencave. OJF-të e ndryshme në aktivitetet e organizuara prej tyre me grupe të ndryshme të interesit, na kanë dhënë mundësinë të prezantojmë punën tonë dhe të presim në përgjigje të këtij prezantimi, ankesa nga qytetarët e ndryshëm. Kuptohet që Institucioni i Avokatit të Popullit është në rritje dhe konsolidim. Në këtë periudhë ne duhet të mendojmë të gjejmë rrugë të reja në shërbim të qytetarëve, për informimin e tyre me të drejtat e tyre, duke nxitur fuqizimin e ketyre të drejtave nëpërmjet rritjes së respektimit të shtetit të së drejtës, luftës sistematike ndaj keqadministrimit dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut. Institucioni i Avokatit të Popullit ka jo vetëm një obligim ligjor, por edhe moral t'u shërbejë qytetarëve dhe duke bërë këtë, të kontribuojë në rritjen e cilësisë së demokracisë në Shqipëri.

Më poshtë po paraqesim në mënyrë të përmbledhur të dhëna lidhur me numrin e ankesave të trajtuara nga Qershori 2000- 31 Dhjetor 2004.

Numri i ankesave të trajtuara nga Zyra e Avokatit të Popullit duke përfshirë dhe ato të Zyrës së Pritjes së Popullit, të cilave ju është dhënë përgjigje menjëherë, është 14836. Nga ankesat, kërkesat dhe njoftimet të cilat i janë nënshtruar shqyrtimit nga ana e Zyrës sonë rezulton se 46% e ankesave kanë qënë jashtë juridiksionit, 31% e tyre kanë qënë të pabazuara dhe 23 % e ankesave janë zgjidhur në favor të ankuesve.

## **2. Marrëdhëniet me Kuvendin e Shqipërisë**

Që nga krijimi i tij në vitin 2000 dhe në vazhdimësi Institucioni i Avokatit të Popullit ka ndjerë kujdesin e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë për forcimin dhe konsolidimin e tij. Siç ka thënë Ombudsmani parlamentar i Mbretërisë së Danimarkës, z. Hans Gammeltoft Hansen “Ombudsmani është krahu i zgjatur i Parlamentit mbi Administratën Publike, me qëllim që gjatë zbatimit të ligjit, të punojë që të arrihen qëllimet e ligjvënësit”. Edhe gjatë vitit 2004 Avokati i Popullit ka vazhduar të informojë herë pas here me shkrim ose verbalisht Kryesinë e Kuvendit, apo dhe komisionet parlamentare përkatëse për veprimtarinë e tij ose ka bashkëvepruar me grupe deputetësh për çështje të veçanta.

Kemi marrë pjesë në diskutime të projektligjeve të ndryshme, si dhe kemi dërguar edhe rekomandime për çështje të ndryshme, duke sugjeruar që deputetët në komisionet parlamentare jo vetëm të informohen për veprimtarinë dhe opinionet tona, por edhe që të ndërmarrin iniciativën legjislative për ndryshimin dhe përmirësimin e ligjeve, kur i vlerësojnë me vend Rekomandimet tona.

Kryesia e Kuvendit është treguar e gatshme dhe në çdo rast ka pritur homologët e Avokatit të Popullit që kanë zhvilluar vizita zyrtare tek ne, si dhe ka shprehur opinionet pozitive të Kuvendit për veprimtarinë tonë. Komisioni parlamentar i Financës ka mirëkuptuar kërkesat tona për buxhetin financiar, që të garantojë funksionimin normal të veprimtarisë sonë. Por theksojmë se akoma nuk kemi gjetur zgjidhje për iniciativën tonë për të caktuar përfaqësues vendorë në Shkodër e Gjirokastrë, ashtu siç kemi shpjeguar edhe me hollësi kur flasim për buxhetin e Institucionit. Gjithashtu vazhdon të mbetet problem çështja e organikës (numrit të personelit) të zyrës sonë, sepse sipas nenit 35 të ligjit “Për Avokatin e Popullit” kemi fiksuar 47 veta, kurse ligji për buxhetin e vitit 2005 ka miratuar vetëm 45 persona. Mbase ngelet që këtë çështje t’ia dërgojmë për shqyrtim Gjykatës Kushtetuese.

A- Në Raportet vjetorë të vitit 2001, 2002, 2003 ne i bëmë të ditur Kuvendit se në tre raste i kemi rekomanduar Qeverisë që të marrë masa për të përgatitur ligje e akte të tjera që të plotësohen detyrimet që rrjedhin nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.

Rekomandimi për zbatimin e nenit 181/1 të Kushtetutës për rregullimin e drejtë të çështjeve që lidhen me pronat. Dihet tashmë se projektligji i përgatitur edhe me asistencën e Zyrës së OSBE në Tiranë u miratua në Kuvendin e Shqipërisë. Shoqatat e ish pronarëve u shprehën kundër disa dispozitave të këtij projektligji dhe u ankuan edhe pranë institucionit tonë, duke kërkuar që projekti t’i dërgohet për studim dhe asistencë juridike Komisionit të Venecias pranë Këshillit të Europës. Ne e realizuam këtë kërkesë të këtyre shoqatave. Mendimet që na dërgoi Komisioni i Venecias ne ja vumë në dispozicion Kuvendit të Shqipërisë dhe ato i shërbyen qëllimit që ligji i miratuar të jetë brenda standarteve të zbatuara edhe në vende të tjera ish socialiste për çështjet e kthimit dhe kompensimit të pronave.

Me këtë rast vemë në dukje se për dy çështje detyrimet e përcaktuara nga nenet 10 dhe 44 të Kushtetutës nuk janë plotësuar.

1. Për lidhjen e marrëveshjeve me bashkësitë fetare, siç kërkon neni 10 i Kushtetutës. Nga informacioni zyrtar që kemi patur nga Kryetari i Komitetit të Kulteve pranë Këshillit të Ministrave, nga ky Komitet, është përgatitur projekti i marrëveshjes tip me bashkësitë fetare dhe është depozituar për shqyrtim e miratim nga Qeveria që në vitin 2002. Për nxitjen e këtij procesi, ja kemi kujtuar Qeverisë detyrimin e plotësimit të detyrës që rrjedh nga neni 10 i Kushtetutës. Por edhe viti 2004 kaloi pa u zbatuar kjo detyrë kushtetuese. Theksojmë përsëri se plotësimi i këtij detyrimi duhet shpejtuar, me qëllim që të rregullohen ligjërisht çështje të tilla siç janë prapaganda fetare tek fëmijët, mbulimi i trupit dhe i kokës nga femrat, rritja e mjekrës nga meshkujt dhe tendenca për të penetruar në institucionet shkollore publike, por sidomos të

devijimit të riteve tradicionale të fesë islame në zona të prapambetura, çka për të ardhmen mund të përbëjë një rrezik për traditën shqiptare të harmonisë fetare. Kjo u nënvizua edhe nga Konferenca Rajonale e organizuar nga Presidenti i Republikës, në muajin dhjetor 2004 me pjesëmarrjen e disa Presidentëve dhe kryeministrave të rajonit ballkanik e më gjërë.

2. Për nxjerrjen e ligjit për rehabilitimin apo zhdëmtimin nga aktet apo veprimet e paligjshme të organeve shtetërore, siç kërkon neni 44 i Kushtetutës. Qeveria ja ka ngarkuar si detyrë Ministrisë së Drejtësisë që të përgatitë projektligjin që gjatë vitit 2003. Por akoma nuk kemi dijeni që ky projekt nga Qeveria t'i ketë kaluar Kuvendit për miratim.

B. Gjatë vitit 2004, i kemi nisur direkt Kuvendit edhe këto Rekomandime për përmirësimin e ligjeve:

1. Rekomandim për plotësimin e Kodit Zgjedhor, për të drejtën e personave për të votuar në zgjedhjet vendore kur ndodhen në paraburgim jo në vendin ku janë të regjistruar. Ky rekomandim ju drejtua Komisionit Bipartizan që përgatiti Kodin Zgjedhor të vitit 2003. Verbalisht na u tha se rekomandimi është i drejtë, por nuk u pasqyrua në Kod. Duke qenë se Kodi u ripunua përsëri në vitin 2004, e kemi përsëritur Rekomandimin tonë.

2. Rekomandim drejtuar Komisionit Parlamentar për të Drejtat e Njeriut, me qëllim që të dënuarve që kanë ndenjur në dhomat e paraburgimit tej kohës mbasi vendimi i tyre kishte marrë formë të prerë, t'u llogaritet kjo kohë sipas nenit 57 të Kodit Penal, pra një ditë paraburgim baraz me një ditë e gjysmë burgim. Rekomandimi në parim u pranua, por ju dërgua Ministrisë së Drejtësisë me qëllim që ta përfshinte në paketën e ndryshimit të ligjeve penale, të realizuara në vitin 2004. Për fat të keq deri tani kjo ministri nuk ka paraqitur ndonjë projekt dhe si rrjedhojë mjaft persona të dënuar padrejtësisht nuk kanë përfituar nga kjo gjendje paraburgimi që shkel të drejtat e tyre. Ky rekomandim do përsëritet, duke synuar që një grup deputetësh të paraqesin projekt ligjin e duhur.

3. Propozimet për përmirësimin e Kodit Zgjedhor përfshinin ato dispozita që rregullojnë procesin e numërimit të votave. Së pari, që votat të numërohen jo në qendrat e votimit, por në qendrat e komisioneve zgjedhore të zonave elektorale. Ky propozim u pranua. Së dyti, që votat të mos numërohen nga anëtarët e komisioneve zgjedhore, të cilët janë zakonisht militantë të partive politike, por nga tre gjyqtarë për çdo zonë elektorale me qëllim që të garantohet paanshmëria dhe shmanget zvarritja e procesit elektoral. U pranua varianti i propozuar nga ekspertët e OSBE-së që numërimi të bëhet nga skuadrat e posaçme të numërimit.

Pa u vetëkënaqur për sa më sipër, për të ardhmen ndiejmë si detyrë që të informojmë më tepër Kuvendin për veprimtarinë tonë, për gjendjen e

ligjshmërisë dhe të zbatimit të të drejtave të njeriut nga ana e Administratës Publike Shqiptare. Gjithashtu, të shfrytëzojmë akoma më tepër mundësinë për të rekomanduar në komisionet parlamentare marrjen e iniciativës legislative direkt nga deputetët, në interes të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të njerëzve në Shqipëri.

### **3. Opinione të përgjithshme për të Drejtat e Njeriut në Shqipëri**

Në Republikën e Shqipërisë janë miratuar pothuajse të gjitha ligjet specifike që kanë si objekt respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Vendin kryesor e zë Kushtetuta shqiptare e vitit 1998 që ka përcaktuar qartë se “të drejtat e njeriut dhe liritë themelore janë të patjetërsueshme dhe i takojnë çdo njeriu me lindjen e tij”. Ajo gjithashtu thekson që “njohja dhe respektimi i të drejtave të njeriut është detyrë e shtetit”.

Por hartimi i ligjeve të reja nuk është i mjaftueshëm. Aftësia për t’i zbatuar ato mirë është një element po aq thelbësor i garantimit të demokracisë dhe sundimit të ligjit. Tashmë në Shqipëri është fakt që në drejtim të zbatimit me efikasitet të kuadrit ligjor pozitiv hasen një sërë problemesh serioze që kërkojnë zgjidhje. Në këto kushte në jetën e përditshme kanë marrë jetë mjaft fenomene negative, që në thelb janë shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut.

Në Shqipëri janë krijuar disa organizma qeveritare për fusha të veçanta të të drejtave të njeriut, si Komiteti Shtetëror i Minoriteteve, Komiteti për Mundësi të Barabarta, është hartuar një Strategji Kombëtare për përmirësimin e kushteve të jetesës për Romët dhe zbatuar masa të tjera me karakter pozitiv. Është gjithashtu pozitive që megjithëse me një vonesë 11 vjeçare, shteti shqiptar paraqiti në tetor 2004 pranë Komitetit të OKB për të drejtat e njeriut në Gjenevë Raportin e parë mbi zbatimin e Paktit Ndërkombëtar për të drejtat civile dhe politike.

Por Avokati i Popullit është i vetmi institucion kombëtar me status kushtetues për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut në Shqipëri. Prandaj mendojmë se kemi të drejtë për të dhënë konsiderata të veçanta apo të përgjithshme për çështje të të drejtave të njeriut. Në lidhje me gjendjen e të drejtave dhe lirive të individëve në Shqipëri jemi shprehur çdo vit në Raportet tona, apo në analiza, diskutime apo rekomandime, kur kemi analizuar raste apo fusha të caktuara. Por për disa probleme që do të prezantojmë më poshtë, nuk jemi bazuar vetëm në ankesat e paraqitura tek Institucioni ynë, por dhe në informacionet e marra nga organizatat jofitimprurëse për fusha të veçanta të së drejtës, nga sondazhet e publikuara në Mediat shqiptare, si dhe në raportet e



organizmave dhe institucioneve prestigjioze kur flasin për gjendjen e të drejtave dhe lirive të njeriut në Shqipëri, siç janë ato të Bashkimit Europian, Këshillit të Europës, Departamentit të Shtetit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Human Rights, Amnesty International, Komitetet e të drejtave të njeriut pranë organizmave të Kombeve të Bashkuara, Komiteti Shqiptar i Helsinkit etj.

E drejta e jetës, si e drejtë themelore e njeriut ka qenë në qendër të Konferencës Kombëtare që Avokati i Popullit organizoi në Dhjetorin e vitit 2001. Synimi i saj ishte inicimi i një strategjie kombëtare të përbashkët nga të gjithë organet shtetërore dhe OJF-të, për masat parandaluese të ngutshme dhe të qëndrueshme, në mbrojtje të së drejtës së jetës dhe në veçanti, ndaj fenomenit të gjakmarrjes. Konkluzionet dhe rekomandimet e kësaj konference janë publikuar. Por këto rekomandime, gjatë viteve 2002-2003 nuk janë zbatuar nga të gjitha autoritetet, të cilave ato u janë drejtuar, veç Presidentit të Republikës, i cili disa herë publikisht ka kërkuar që organet shtetërore të merren më shumë me gjakmarrjen. Masat parandaluese ndaj gjakmarrjes mesa duket ju lanë vetëm disa organizatave joqeveritare apo punës spontane të organeve të pushtetit vendor. Është pozitive se në vitin 2004 ka patur një angazhim serioz ndaj gjakmarrjes. Ministria e Rendit ka krijuar një task force në Shkodër dhe në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit. Po diskutohet për një projekt për të mbledhur bashkë fëmijët e ngujuar që të vazhdojnë shkollat. Po kështu edhe për një “qytet” ku të mblidhen e të ruhen familjet e kërcënuara nga gjakmarrja. Mendojmë se të gjitha institucionet qeveritare duhet të angazhohen më seriozisht për këtë “plagë” që e bën të papranueshme Shqipërinë në familjen e madhe të Bashkimit Europian.

E drejta e jetës në Shqipëri, si e drejtë themelore e njeriut, vazhdon të jetë e rrezikuar për sa kohë që armët vazhdojnë të jenë pa kontrollin e duhur në duart e popullsisë civile. Këto armë përditë marrin jetë njerëzish nëpërmjet krimeve brenda familjes, vetvrasjeve, krimeve me dashje apo pakujdesive në administrimin e tyre. Ashtu siç e kemi prezantuar dhe në Raportet e mëparshme, ligji për mbledhjen e armëve nuk ka dhënë dhe nuk po jep rezultatet e pritshme. Struktura e posaçme e policisë së shtetit që është ngritur për këtë qëllim nuk duket të ketë efektivitetin e duhur.

Ndonëse nga policia ka patur disa rezultate të bujshme për trafikun e armëve dhe zbatimin e ligjit për armëmbajtësit pa leje është forcuar, numri i armëve pa leje në duart e popullsisë është ende i madh.

Liritë dhe të Drejtat Vetjake si liria e shprehjes, e shtypit, medias e televizionit, liria e ndërgjegjes dhe e fesë, liria individuale, paprekshmëria e banesës, liria e fshehtësia e korrespondencës janë të garantuara me ligj. Për to ka patur dhe do të ketë ankesa apo dhe mbrojtje të tyre si nga ana e Avokatit të Popullit ose me anë të proçeseve gjyqësore. Por mendimi ynë, ashtu sikundër

është thënë dhe më parë, është se këto të drejta dhe liri përgjithësisht respektohen. Janë ndëshkuar shkaktarët, kur pas proceseve ligjore të rregullta janë vërtetuar shkelje të tyre të kryera nga autoritete publike, apo nga individë të veçantë që ju kanë cënuar këto të drejta atyre individëve që janë ankuar tek Avokati i Popullit apo në organet gjyqësore.

Për lirinë e shtypit, medias e televizionit, duhet thënë se vazhdon të ketë raste kur kjo liri është shkelur, por më tepër raste kur ajo është tejkaluar. Mediat tona duket se akoma nuk e konsiderojnë shkelje të japin me hollësi të dhëna personale që shkelin të drejtën e privacisë, të rregulluar nga dispozitat e Ligjit nr. 8517, datë 22.07.1999, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”. Më e theksuar është kjo kur ka akuza për vepra penale dhe, aq më tepër, kur janë të akuzuar dhe të dëmtuar të miturit apo femrat e shfrytëzuara për trafikë të paligjshme, për krime seksuale në familje etj. Ndonëse më pak se në vitet e shkuara, por gazetarët kanë rendur të marrin intervista dhe të botojnë foto, me identitete të plota e të sakta për fëmijë të vetëruarë apo femra të dhunuara si nga trafikantët, përsëritësat në krimet seksuale apo prindër dhunues, duke harruar se publikimi i këtyre fakteve i sjell dëme të pariparueshme auditorit, sidomos fëmijëve apo personit të dhunuar. Është fakt se për shkak të mungesës së nivelit të duhur arsimor, kulturor e juridik, personat e cënuar nuk kanë ngritur padi apo bërë ankesa, por kjo nuk do të thotë se këto shkelje nuk ekzistojnë. Rol të madh parandalues duhet të lozin shoqatat e gazetarëve, nëpërmjet aftësimit profesional të tyre.

Liritë dhe të Drejtat Politike, si e drejta e zgjedhjeve, e organizimit dhe tubimeve dhe manifestimeve paqësore, janë të garantuara me ligj dhe të gjitha institucionet publike janë shprehur dhe punojnë që do të respektohen. Për fat të keq akoma ka diskutime dhe dyshime, mungesë besimi reciprok për proceset elektorale të shkuara dhe atë për zgjedhjet e afërta parlamentare të vitit 2005. Natyrisht ka dhe do të ketë dhe opinione të ndryshme në këto drejtime. Avokati i Popullit është shprehur pozitivisht për masat legjislative dhe administrative për të zbatuar Rekomandimet e ODIHR-it. Kur ka qenë rasti kemi punuar konkretisht për respektimin e të drejtës themelore të votës së lirë për çdo qytetar të Republikës së Shqipërisë, duke dhënë edhe rekomandime konkrete për të mos lejuar asnjë mundësi manipulimi nga cilado palë apo subjekt elektorale. Në vitin 2003, duke marrë shkas nga ekzistenca e të vdekurve në regjistrat e gjendjes civile, rekomanduam që të hiqeshin ata nga listat e zgjedhjeve. Ky rekomandim u muar parasysh dhe po punohet të zbatohet plotësisht. Gjithashtu kemi rekomanduar që të mos pranoheshin nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve si anëtarë të komisioneve zgjedhore personat që në proceset elektorale të mëparshme kishin bërë fallsifikime, grindje etj, duke ndikuar gjithmonë në prishjen e procesit elektorale dhe imazhit të tij. Ky rekomandim mbetet që të

mbahet parasysh si nga subjektet elektorale, ashtu dhe nga Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve.

Veç krijimit të Regjistrit të saktë të zgjedhësve ne kemi rekomanduar që të ndryshohet Kodi Zgjedhor dhe të caktohen gjykatësit që të bëjnë numërimin e votave dhe nxjerrjen e rezultateve të votimit, në prani të komisionerëve të caktuar nga subjektet elektorale. Pjesa e rekomandimit që numërimi i votave të bëhet në zonat zgjedhore është pranuar, kurse në vend të gjyqtarëve është pranuar zgjidhja e krijimit të skuadrave të numërimin të votave në prani të komisioneve dhe Mediave. Le të shpresojmë që procesi elektoral i vitit 2005 të jetë i pakontestueshëm dhe të zhduket nga axhenda e organizmave ndërkombëtare sllogani se “në Shqipëri nuk realizohen standartet për zgjedhje të lira e të ndershme.” Nuk duhen mohuar rezultatet pozitive të viteve të fundit që kanë patur të bëjnë sidomos me rritjen e kontrollit të kufijve. Këtë e vërteton vetëm fakti se tashmë shqiptarët nuk mund të kalojnë ilegalisht nga Shqipëria direkt në Itali, por janë kapur në tentativë duke kaluar nga vende të treta p.sh. në Kroaci, apo ka disa procedime për trafik të fëmijëve, apo hartimin nga Qeveria shqiptare të Strategjisë Kombëtare për Fëmijët.

Në konferencën ndërkombëtare mbi trafikimin e fëmijëve, organizuar në Tiranë më 19 janar 2004 nga Këshilli i Europës dhe Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale u nënvizua se ndonëse Shqipëria qysh në vitin 1992 ratifikoi Konventën e OKB-së për të drejtat e fëmijëve, trafikimi i fëmijëve shqiptarë përbën një plagë mjaft shqetësuese. Dihet që ky është një fenomen jo vetëm shqiptar, por për të gjitha vendet ish komuniste që filluan proceset e tranzicionit drejt demokracisë pas vitit 1990. Deri në vitin 2002 është veçori për Shqipërinë që ndërsa për trafiket e tjera të drogës, prostitucionit, të klandestinëve etj, kemi qënë më tepër vend tranziti se sa vend origjine, për trafikun e fëmijëve kemi qënë veçse vend origjine.

Avokati i Popullit gjatë shqyrtimit të rasteve konkrete, për abuzime me fëmijët ka shqyrtuar nëse janë zbatuar detyrimet që rrjedhin nga nenshkrimi i konventave ndërkombëtare apo nga legjislacioni vendas. Në këto raste ndërhyrjet e Avokatit të Popullit kanë qënë frutdhënëse, jo vetëm sepse janë vene në levizje strukturat e përmbarimit, ato të shkollës apo ndihmës sociale, por se duke ju bërë ketyre rasteve edhe publiciteti i nevojshëm, është krijuar precedenti pozitiv, janë hartuar Rekomandime për Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Rendit, Ministrinë e Punës dhe Çështjeve Sociale, Ministrinë e Arsimit dhe shumë struktura të tjera, për t’i sensibilizuar që të kontrollojnë e t’u kërkojnë llogari organeve të tyre vartëse, për të vlerësuar në radhë të parë interesin e fëmijëve.

Në bashkëpunim me “Save the Children”, në vitin 2004 në zyrën tonë ka filluar funksionimi i një nënseksioni që merret në mënyrë specifike me

problemet e fëmijëve në Shqipëri. Synimi është që edhe në Shqipëri të krijohet një autoritet i fortë shtetëror, i cili jo vetëm që do të nxitë autoritetet dhe organet shtetërore për zhvillimin e fëmijëve, por do të jetë edhe një organ specifik si mbrojtës i të drejtave të fëmijëve. Por për këtë kuptohet që duhet vullnet politik, angazhim financiar si dhe ndryshimet e duhura në legjislacion, kushte të cilat kërkojnë disa kohë që të plotësohen.

Ministria e Drejtësisë ka ndërmarrë hapa pozitive për hartimin e një ligji të posaçëm për të drejtat e fëmijëve, dhe krijimin e një sistemi gjyqësor dhe penitenciar, të veçantë për minorenët, krijimin e qendrës për edukimin e minorenëve, por duhet parashikuar edhe një burg i veçantë për minorenët.

Problematike janë edhe shkeljet e të drejtave të Grave. Konstatohet që vitet e fundit ka rënie të trafikut të femrave në mënyrë të ndjeshme. Kjo ka ardhur edhe si rrjedhojë e fushatave ndërgjegjësuese të ndërmarra nga OJF-të e ndryshme në media, shkolla, universitete etj. Por kryesore ka qenë ndjekja dhe zbatimi me rreptësi i ligjit ndaj trafikantëve, miratimi dhe zbatimi i politikave dhe programeve të posaçme për mbrojtjen e viktimave të trafikut, si dhe monitorimin e këtij procesi nga organizmat që janë krijuar enkas nga strukturat qeveritare. Por çështjet që kanë të bëjnë me keqtrajtimin bashkëshortor apo dhunën në familje ndaj grave dhe vajzave janë të shumta. Situata nuk duket që të përmirësohet, prandaj puna parandaluese nuk duhet lënë vetëm në dorë të organizatave joqeveritare.

Organizmat ndërkombëtare kanë rekomanduar që shteti shqiptar duhet të ndërmarrë hapa të menjëhershme për ndryshimin e sjelljes së publikut ndaj pjesëmarrjes së gruas në çështjet publike, si dhe të marrë në konsideratë miratimin e një politike pozitive veprimi në këtë drejtim. Shteti duhet të marrë masat e duhura për të siguruar pjesëmarrjen efikase të gruas në jetën politike, publike si dhe në sektorë të tjerë të shtetit.

Komiteti për Mundësi të Barabarta, që ka kaluar në vartësi të Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale me një personel prej 13 personash, i cili ka pothuajse aq ekspertë sa ka dhe Institucioni i Avokatit të Popullit, mendojmë se duhet ristrukturuar për të mos qenë një organizëm që bën vetëm studime dhe propozon politika, por të ketë mjete efektive për të ndikuar që të ruhen dhe zbatohen të drejtat e grave. Miratimi i Kodit të ri të Familjes duhet shfrytëzuar sepse ka krijuar mundësi për të përmirësuar trajtimin dhe pozitën e femrave në familje dhe në shoqërinë shqiptare.

Trajtimi i të dënuarve dhe të paraburgosurve në dhomat e izolimit pranë komisariateve të policisë, megjithë përmirësimet nga viti në vit, vazhdon të ketë probleme dhe ankesa. Edhe trajtimi i të sëmurëve mendorë në spitalet tona psikiatrike vazhdon të jetë problem shqetësues. Problemet dihen dhe kanë filluar të zbatohen disa masa parandaluese. Por konstatimet që ngrihen në të dy

raportet e Komitetit European për parandalimin e torturës dhe trajtimit ose dënimit ç'njerëzor dhe poshtëruës (CPT) dhe të organizmave të tjera kombëtare e ndërkombëtare vazhdojnë të jenë mjaft kritike. Paraburgimi akoma nuk po i kalon Ministrisë së Drejtësisë. Në Vëzhgimet përfundimtare të Komitetit për të Drejtat e Njeriut në Gjenevë në lidhje me shqyrtimin e Raportit fillestar të Shqipërisë mbi zbatimin e Paktit Ndërkombëtar për të drejtat civile dhe politike, më 1 nëntor 2004 thuhet:

“16. Komiteti është i shqetësuar për kushtet jo-njerëzore të paraburgimit, për shembull në paraburgimin në polici, rreth numrit të personave të arrestuar dhe kushteve të paraburgimit, kushtet e të paraburgosurve fëmijë dhe femra si dhe mungesës së kompensimit për arrestime apo paraburgim të padrejtë (neni 9 dhe 10).

Shtetit palë i kërkohet të përmirësojë kushtet e paraburgimit për ata që janë të paraburgosur dhe për personat e dënuar. Personat e paraburgosur duhen veçuar nga personat e dënuar. Shteti palë duhet gjithashtu të sigurojë masat e duhura për viktimat e ndalimeve apo paraburgimeve të paligjshme që kërkojnë kompensim. Shteti palë kujtohet se sipas nenit 9 (3) fakti që personat e dyshuar të paraburgosen ndërsa pritet gjyqi, nuk duhet të jetë rregull i përgjithshëm. Shteti palë duhet të ngrejë një sistem efektiv të garancisë.”

Qeveria Shqiptare mendojmë se ndonëse ka nxjerrë disa vendime për këto çështje duhet t'i kërkojë më tepër llogari institucioneve vartëse të drejtësisë, policisë e mjekësisë që të punojnë më seriozisht për zbatimin e këtyre rekomandimeve, ndaj të cilave edhe ne reagojmë vazhdimisht.

Institucioni i Avokatit të Popullit është i ndërgjegjshëm se ndonëse ka mjaft përmirësime në trajtimin e të dënuarve dhe të të paraburgosurve në dhomat e izolimit pranë komisariateve të policisë, ka akoma mjaft ankesa dhe kërkesa për të cilat kemi bashkëpunuar mirë me Ministrinë e Drejtësisë dhe atë të Rendit.

Por Komiteti i OKB është i shqetësuar për rastet arbitrare të arrestimit dhe ndalimit, përdorimin e dhunës nga oficerët e policisë, keqtrajtimin e të ndaluarve në dhomat e paraburgimit si dhe përdorimin e dhunës për të detyruar të ndaluarit të pranojnë fajin. Komiteti shpreh keqardhjen që rastet e keqtrajtit konsiderohen si “raste arbitrare” dhe se vazhdohet më tej me këtë mënyrë. Ai është gjithashtu i shqetësuar se pavarësisht nga disa raste të identifikimit dhe dënimit të të akuzuarve për keqtrajtime, shumë raste nuk janë identifikuar dhe se viktimat nuk janë dëmshpërblyer (neni 7).

Shteti palë duhet të marrë masa të rrepta për eliminimin e të gjitha rasteve të keqtrajtimeve nga punonjësit e policisë si dhe të sigurojë hetim të plotë, të pavarur, të paanshëm për të gjitha rastet e torturave dhe keqtrajtimeve.

Duhet të dënohen autorët dhe të sigurohet që ato janë dënuar sipas masës së krimit, si dhe duhet bërë kompensimi i viktimave.”

Edhe për prokurorinë dhe gjykatat vazhdohet të ketë një numër të madh ankesash tek Avokati i Popullit. Por akoma më i madh është numri i ankesave për këto organe pranë institucioneve të tjera duke filluar nga Kuvendi, Presidenti, Këshilli i Lartë i Drejtësisë etj. Sidoqoftë për ankesat para nesh mendojmë se këto organe duhet të jenë më të kujdesshëm dhe objektivë kur para tyre personat ankohen për këto dhunime të rënda të drejtave të tyre ose kur ankesat e tyre përcillen nga Avokati i Popullit. Ashtu si institucioni ynë edhe institucioni i rëndësishëm i OKB ka konstatuar në tetor 2004:

“Komiteti ka vënë re përpjekjet e ndërmarra nga Shqipëria për të forcuar pavarësinë dhe efikasitetin e gjyqësorit. Ai mbetet i shqetësuar megjithatë rreth çështjeve të supozuara të presionit të ekzekutivit mbi gjyqësor dhe problemeve të vazhdueshme të korrupsionit, mungesës së aksesit në ndihmën ligjore e këshillimore dhe vonesës së paarsyeshme të çështjeve gjyqësore (neni 14).

Shteti palë duhet të garantojë pavarësinë e gjyqësorit, të marrë masa për të zhdukur të gjitha format e ndërhyrjes në pavarësinë e tij, të sigurojë hetimin e duhur, të plotë, të pavarur dhe të paanshëm për të gjitha rastet ku mendohet të ketë patur ndërhyrje dhe të ndalojë e ndëshkojë të gjithë shkelësit e ligjit. Duhet të krijojë mekanizmat për të përmirësuar kapacitetin dhe efikasitetin e gjyqësorit, të lejojë aksesin tek drejtësia për të gjithë pa diskriminimin dhe të sigurojë se të paraburgosurit e padënuar të dalin para gjyqit sa më shpejt që të jetë e mundur”.

Duke patur këtë situatë edhe ne kemi rekomanduar vazhdimisht se duhet vazhduar puna për përmirësimin dhe hartimin e ligjeve të reja, lufta kundër korrupsionit brenda sistemit gjyqësor; përmirësimi i punës të inspektoriatit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë; zbatimi pa kushte i vendimeve gjyqësore; reforma për përqasjen e legjislacionit vendas me marrëveshjet ndërkombëtare, përmirësimi i marrëdhënieve konkrete të punës së përditshme midis prokurorisë, policisë gjyqësore dhe gjykatave kundër krimit të organizuar etj.

Në vitin 2002 Kuvendi i Shqipërisë ka ratifikuar edhe Kartën Sociale të Ndryshuar, por duhet shumë punë që kjo Kartë të zbatohet në praktikë. Kuptohet që për kushtet e Shqipërisë jo të gjitha të drejtat ekonomike dhe sociale mund të realizohen plotësisht. Ndonëse mund të jetë e pamundur për çdo njeri të ketë një punë, Qeveria duhet të përpiqet maksimalisht për të krijuar mundësira punësimi e banimi, shanse të barabarta dhe një mjedis të përshtatshëm për të punuar, nëpërmjet politikave të shprehura me legjislacionin stimulues dhe duke nxitur sidomos organet e pushtetit vendor në këto drejtime.

Avokati i Popullit si institucion që ka dalë nga Parlamenti e ka të qartë rolin dhe ka bërë dhe do të vazhdojë të bëjë pa u lodhur apo pa u dekurajuar

detyrën e tij kushtetuese për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në Republikën e Shqipërisë. Dihet nga të gjithë se përgjegjëse për gjendjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në çdo vend janë Parlamenti dhe Qeveritë që dalin prej tij. Përmirësimi i mëtejshëm i gjëndjes së të drejtave të njeriut në Shqipëri, varet gjerësisht nga njohja dhe respektimi i shtetit të së drejtës, rritja e përgjegjshmërisë të të gjithë Administratës publike shqiptare për rëndësinë që kanë të drejtat e njeriut në botën e sotme.

#### **4. Marrëdhëniet e Avokatit të Popullit me publikun**

Një Ombudsman apo Avokat i Popullit është aq i zoti sa edhe shkalla e tij e njohjes. Imazhi dhe shkalla e njohjes krijohen dhe thellohen vetëm me afat të gjatë dhe përmes një pune të vazhdueshme po me vizion afatgjatë dhe jo si zjarrfikëse në raste krize. Kushti i parë për një sukses të tij është njohja, sikundër sukses për Avokatin e Popullit do të thotë që ai të mund t'u ndihmoje qytetarëve në procese dhe situata pa rrugëdalje, pra në rrethana të vështira. Dhe për ta bërë të mundur këtë, qytetarët duhet ta dijnë që ai ekziston. Sukses i vërtetë është atëhere kur njerëzit jo vetëm e dinë që Avokati i Popullit ekziston, por edhe mënyrën se si duhet të drejtohen tek ai, dhe ku, kur dhe si ta arrijnë atë. Pra, qytetarët duhet ta dijnë se tek ai mund të drejtohen relativisht në mënyre joburokratike. Por kjo është vetëm njëra palë. Pala tjetër që duhet të njohë është administrata dhe autoritetet publike.

Performanca e tërë kontakteve të përfaqësuesve të Institucionit tonë me individin, administratën dhe publikun në tërësi ka si rezultante imazhin institucional, duke reflektuar kompetencat dhe juridiksionin që atij i njeh Kushtetuta dhe Ligji “Për Avokatin e Popullit”.

Por si ka punuar Zyra e Avokatit të Popullit për t'u bërë e njohur?

Marrëdhëniet publike fillojnë që nga elementet etike në kontaktet e para me ankuesit, deri tek ato institucionale me zyrtarët e shtetit, pavarësisht nga hierarkia. Natyrisht që dimensionin e tyre më të plotë, marrëdhëniet publike e fitojnë përmes marrëdhënieve me pushtetin e katërt, pra me shtypin e shkruar dhe median në tërësi.

Ne jemi të ndërgjegjshëm se në kohet e sotme, rruga më efektive e të bërit të njohur është përmes mediave. Metoda se si Avokati i Popullit ka menaxhuar njohjen dhe promovimin e punës së tij kanë qenë kontaktet e përditshme me gazetarët dhe furnizimi i tyre me informacione në mënyrë profesionale, pa sekretomani, pa rendur pas lajmeve që shkaktojnë skandale, por edhe pa iu lidhur duart atyre vetëm me njoftime të thata për shtyp.

Vetëm duke rritur shkallën e njohjes, ndryshuar dhe forcuar imazhin dhe pozicionuar Institucionin drejt në opinionin publik ose qofte edhe në mendimin e një pjese të publikut, ne na rezulton që të kemi krijuar mirëkuptimin dhe mirëdashjen e nevojshme për të realizuar komunikimin me mjedisin dhe integritetin tonë institucional në shoqërinë shqiptare.

Marrëdhëniet me median gjithmonë i kemi parë me përparësi, sepse kemi patur dhe kemi si objektiv të rritim besueshmërinë e publikut ndaj institucionit tonë në praktikë. Jemi të bindur se suksesi arrihet duke u bazuar në dy shtylla, të cilat janë zgjidhjet me kompetencë profesionale dhe transparenca në punën tonë. Ajo që kemi synuar është mënjanimi i çdo elementi demagogjik në marrëdhëniet me median. Ne mendojmë se këtë e kemi arritur, duke zbatuar një strategji disi të veçantë të informimit për punën tonë. Paradigma tashmë e konsoliduar në marrëdhëniet me median është përqendruar në tre nivele komunikimi. E para, mediave u kemi dhënë materiale, kryesisht mbi bazën e rasteve konkrete. E dyta, jemi munduar të bëjmë edhe përgjithësime, duke shpjeguar rolin, kompetencat dhe juridiksionin tonë pas çdo rasti konkret, të trajtuar gjithmonë me mjaft transparenca nga ekspertët tanë. E treta, njoftimet për shtypin, të shpërndara për median sipas rasteve dhe aktivitetit të Zyres.

Në raportimet tona vjetore para Kuvendit, ne bëjmë evidentimin e çdo informacioni në shtyp nga ne dhe për ne. Këtë nuk e kemi parë thjesht si element teknik. Tabelat përkatëse të mbulimit mediatik pasqyrojnë praktikën tonë njëvjeçare, duke evidentuar problematikën që ne kemi bërë publike në Media. Sipas monitorimit që kemi mundur të bëjmë, rezulton se Institucioni i Avokatit të Popullit, gjatë vitit 2004, ka qënë 157 herë i pranishëm në Median e shkruar, dhe 41 herë në Median elektronike. Megjithatë, ne nuk e shohim praninë në shtyp si qellim në vetvete, pasi kjo është diçka e ndryshueshme nga viti në vit, pa mohuar këtu edhe pamundësinë objektive dhe subjektive të evidentimit në masën njëqind përqind të të gjithë paraqitjeve në Media. Tregues cilësor është zgjerimi i gjeografisë dhe shumëllojshmërisë tematike të këtij mbulimi mediatik.

Përmes Medias ne jemi njohur edhe me ankimet e mjaft njërëzve, por dhe me prioritetet e Qeverisë shqiptare. Në këtë mënyrë, fokusin e punës tonë e kemi drejtuar për të krijuar precedentë në ato sektorë të qeverisjes, tek të cilët kërkohet krijimi dhe rritja e standarteve për shërbimet publike, presioni për uljen e kostos së shërbimeve të KESH dhe Albtelekom, domosdoshmëria e zbatimit të vendimeve gjyqësore, të drejtat e fëmijëve jo vetëm në Shqipëri, por edhe të atyre jashtë vendit, zbatimin e të drejtës së informimit, përmirësimin të legjislacionit për pronësinë, lufta kundër korrupsionit, kundër abuzimeve të zyrtarëve si dhe fusha të tjera që janë pasqyruar në kreun përkatës sipas rasteve. Tek media gjithashtu kemi patur aleatin më të sigurtë, për tu bërë pjesë e



opinionit publik, në rastet kur na është dashur të ndeshemi me rezistencën e atyre zyrtarëve publikë, të cilët fatkeqësisht ende e konsiderojnë rekomandimin e Avokatit të Popullit si diçka bezdisëse, aq më shumë ne rastet kur harrojnë se ky instrument, vërtetë është jo detyrues formalisht, por sa kohë që ai është mirëbazuar në ligj, është e qartë se askush nuk i shpëton detyrimit për zbatimin e tij.

Bashkëpunimi me Mediat na ka mundësuar aksesin e nevojshëm në publik si dhe krijimin e integritetit të domosdoshëm për ushtrimin e funksionit të parashikuar, si nga Kushtetuta, ashtu edhe nga ligji “Për Avokatin e Popullit”.

Duke përqafuar vlerësimin se gazetarët janë “rojtare publikë”, bashkëpunimin me ta e kemi parë si mjetin, pa të cilin edhe publiku nuk do të dinte si të na drejtohej, sikundër edhe zyrtarët nuk do të njiheshin me forcën praktike të instrumentit tonë të vetëm, që është Rekomandimi i bazuar në ligj dhe i përpiluar me fuqinë më të madhe të mundshme argumentuese. Veçoria e rekomandimit të Avokatit të Popullit është se për të arritur deri tek ai kërkohet dhe mundësohet një kohë më e madhe fizike dhe intelektuale, për më tepër kur operohet nga një këndvështrim edhe më i gjerë, sikundër është mbrojtja e të drejtave të njeriut.

Larmia e problematikës, që është pasqyruar në Media është pasqyruar pa komente në tabelat përkatëse me statistikat e mbulimit mediatik. Në një farë mënyre, duke u nisur qoftë edhe nga titujt e informacioneve, bëhet e qartë edhe veprimtaria që kemi kryer dhe sa kemi mundur ta bëjme të njohur atë për publikun.

Informacionet nga shtypi përbëjnë bazën e një drejtimi të rëndësishëm të punës tonë, sikundër është vënia në lëvizje edhe me iniciativë, parashikuar nga neni 13-te i Ligjit “Për Avokatin e Popullit”. I gjithë spektri i shtypit të përditshëm, atij periodik shqiptar si dhe shtypi i plotë i ATSH-se, filtrohet posaçërisht çdo ditë në zyrën tonë. Raste si ai i fatit të rreth 500 femijëve shqiptarë, të zhdukur nga një qendër kujdesi në Athinë të Greqisë, apo keqtrajtimet e emigrantëve shqiptarë nga ana e policisë greke janë raste të nisura fill pas njoftimeve që ne kemi marrë nga media.

Në strategjinë e mbulimit mediatik janë patur parasysh si ndërgjegjësimi i publikut, ashtu edhe efekti edukativ i informacionit. Kjo është bërë me pasqyrimin e vazhdueshëm në Mediat të të gjitha rasteve, kur administrata na ka mirëkuptuar, duke rivendosur të drejtën e shkelur të qytetarit.

Mjetet që kemi përdorur kanë qënë ato të parashikuara në strategjinë që kemi formuluar që në fillim të veprimtarisë sonë njohëse dhe sqaruese për grupe të ndryshme të komunitetit. Produktet e Zyrës së Avokatit të Popullit si broshura “Avokati i Popullit në Shqipëri – Ombudsmeni Parlamentar” (në shqip dhe anglisht), posterat tematikë për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, përmbledhjet

me tituj “Akte ligjore në ndihmë të të burgosurve shqiptarë jashtë vendit” si dhe “E drejta e informimit – e drejtë themelore e njeriut”, apo pesë fletëpalosje për grupe të ndryshme interesi, përmes të cilave shpjegojmë rolin, kompetencat dhe rrugët si mund t’i drejtohen Avokatit të Popullit kanë qenë në qarkullim përgjatë gjithë vitit. Dokumentari njohës dhe promovues për Institucionin e Avokatit të Popullit tashmë është vënë në dispozicion dhe transmetuar në shumicën e televizioneve lokale dhe kombëtare. Të disponueshme kanë qenë edhe pesë spotet televizive që informojnë publikun për shërbimet që ne ofrojmë dhe rrugët e përfitimit të këtyre shërbimeve. Instalimi i teknologjisë informative na ka mundësuar që tashmë të kemi edhe faqen tonë në Internet, ku të interesuarit mund të gjejnë të gjithë informacionin e nevojshëm lidhur me zyrën tonë dhe aktivitetin që kryen ajo. Mbulimi mediatik ka qenë gjithmonë në përshtatje me problematikën dhe intensitetin e punës që institucioni ka kryer.

Duke bërë herë pas here një analizë të secilit seksion për punën e kryer, ne kemi punuar paralelisht edhe për zbatimin e pikave bazë të strategjisë sonë në fushën e marrëdhënieve me publikun, sidomos përmes Medias. Në tërësinë e saj, kjo **Strategji** e mbulimit mediatik, si pjesa thelbësore e **Marrëdhënieve me Publikun** është formuluar që në vitin 2000 dhe është publikuar edhe në raportet e viteve të mëparshme.

E qëndrueshme ka qenë dhe do të mbetet qasja jonë ndaj gazetarëve si partnerë, duke u ofruar atyre informacione të përshtatura për shtypin, që u shërbejnë nevojave të mediave, si dhe duke i planifikuar nga ana strategjike temat, momentet e publikimit si dhe instrumentet e punës së mediave për të përcjellë jo vetëm atë që synojmë të japim ne, por edhe atë që publiku ka nevojë dhe të drejtë të dijë.

## **A. Sektori i Pritjes së Popullit**

### **1) Organizmi i Punës**

Detyrë e rëndësishme për Avokatin e Popullit ka qenë të ndërtojë brenda Institucionit një sistem të atillë që të jetë i gatshëm në çdo kohë e pa pengesa për qytetarët që vijnë për ankesa apo kërkesa dhe t’i bëjë ata të ndjehen të mirëpritur siç duhet dhe të përfitojnë aty për aty ato çfarë kanë të drejtë të presin prej administratës. Për këtë janë adoptuar prej nesh modele të zyrave të tjera homologe në Evropë, për të rritur shërbimin ndaj qytetarëve në zyrën tonë. Kështu që në qershor 2001, ka filluar funksionimin Zyra e Pritjes së Popullit, e cila që prej vitit 2003 për shkak të fluksit të madh të ankuesve që pret dhe ndihmës që i jep atyre, është shndërruar në Sektor të Pritjes së Popullit. Këtu

qytetarët në çdo orë të ditës, gjatë orarit zyrtar, mund të paraqesin ankesat apo kërkesat e tyre dhe të marrin sqarimet e nevojshme nga një ekspert i zyrës. Këtë sistem e kemi adoptuar sipas modelit të Zyrës së Ombudsmanit të Provincës së Katalonjës, në Spanjë. Një punë e tillë ka bërë që numri i shtetaseve që përfitojnë nga shërbimet që ofron Institucioni i Avokatit të Popullit të jetë më i madh dhe ekspertet e zyrës të shfrytëzojnë maksimalisht orët e punës duke u marrë me hetimin e rasteve që janë brenda juridiksionit dhe kompetencës së Institucionit të Avokatit të Popullit.

Përmbushjen e funksioneve kushtetuese të Avokatit të Popullit e kemi parë të lidhur ngushtë me marrëdhënien me publikun. Në këtë kuptim jemi munduar që shërbimi që ju ofrojmë qytetarëve të cilët na drejtohen, të jetë i një niveli mjaft të lartë e cilësor.

Në këtë aspekt, Sektori i Pritjes së Popullit pranë Institucionit, çdo ditë i ka dhënë ndihmën e tij qytetarëve të paraqitur si nëpërmjet përpilimit të ankesës ose kërkesës që ata parashirojnë në mënyrë të shkruar, ashtu dhe nëpërmjet orientimeve dhe këshillimeve ligjore të dhëna me përgjegjësi dhe profesionalizëm kur çështjet që prezantonin si shqetësim nuk përbëjnë objekt të veprimtarisë së Avokatit të Popullit. Në të njëjtën kohë, nga Zyra e Pritjes së Popullit, qytetarëve u behet i njohur në çdo kohë informacioni i kërkuar dhe njohja me legjislacionin në fuqi si dhe i jepen sqarimet e mëtejshme për rrugën që ndiqet pas pranimit të ankesës.

## 2) Statistikat Përmbledhëse

Mbështetur në numrin e individëve të paraqitur, si dhe në gamën e larmishme të problematikave të bëra prezent, mendojmë që ashtu si dhe në raportimet e kaluara, të pasqyrojmë me detaje aktivitetin në shifra të Sektorit të Pritjes së Popullit.

Në lidhje me statistikën e vitit 2004, numri i përgjithshëm i ankesave të paraqitura pranë Zyrës së Pritjes së Popullit është **1941 ankesa/kërkesa**. Në pasqyrën e mëposhtme janë ankesat e paraqitura çdo muaj dhe numri i pranimit të atyre, që kanë qënë brenda juridiksionit dhe kompetencave të Avokatit të Popullit.

Muaji Janar ankesa gjithsej	141	pranuar për shqyrtim	33 ankesa	
Shkurt	143	“-“	“-“	43
Mars	194	“-“	“-“	71
Prill	186	“-“	“-“	51
Maj	204	“-“	“-“	51
Qershor	177	“-“	“-“	55
Korrik	185	“-“	“-“	54
Gusht	51	“-“	“-“	28
Shtator	198	“-“	“-“	71
Tetor	168	“-“	“-“	64
Nentor	162	“-“	“-“	54
Dhjetor	132	“-“	“-“	46
<b>Totali</b>	<b>1940</b>	“-“	“-“	<b>621</b>

Pra nga numri i përgjithshëm i ankesave apo kërkesave të paraqitura pranë Sektorit të Pritjes së Popullit janë pranuar për shqyrtim **621 ankesa/kërkesa ose 32%**. Ato e tyre kanë gjetur pasqyrim në pjesët e tjera të raportit sipas fushave dhe organeve të administratës publike.

Zyra e Pritjes së Popullit duke përmbushur detyrat e saj funksionale gjatë vitit 2004, ka pritur, trajtuar, këshilluar, orientuar dhe kthyer përgjigje të menjëhershme **1319 ankesa ose 68%** të numrit të përgjithshëm të individëve apo kërkesave dhe ankesave të paraqitura. Këta qytetarë për vetë llojin dhe klasifikimin e ankesës apo kërkesës së paraqitur, janë klasifikuar në dy grupe si më poshtë:

1-Ankesa apo kërkesa që janë konstatuar jashtë juridiksionit dhe kompetencave të Avokatit të Popullit janë **611 ose 46%** të numrit të përgjithshëm të pritur.

2-Individë të paraqitur për këshillime apo ndihmë të ndryshme ligjore janë **709 ose 54%** të numrit të përgjithshëm të pritur.

### 3) Problematikat e shfaqura

Nga problemet e prezantuara nga individë të ndryshëm pranë Zyrës së Pritjes, edhe këtë vit rezulton se shumica e ankesave, kërkesave apo njoftimeve të paraqitura drejtohen kundër vendimeve të gjykatave të të gjitha niveleve, të cilat sipas individëve mbartin padrejtësi, pavërtetësi, paragjykim dhe njëanshmëri. Mjaft nga këto ankesa lidhen edhe me avokatë të ndryshëm, të cilët janë përkufizuar si ndërlidhës apo sekser për afëra të dyshimta mitmarrje

dhe mospërbushje të detyrës së tyre karshi klientëve, si dhe mos kthim të shumave në lekë për një punë të pa kryer. Për këto ankesa apo kërkesa duhet bashkëpunuar më mirë me Këshillin e Lartë të Drejtësisë dhe Ministrinë e Drejtësisë.

Një problem tjetër që është evidentuar gjatë pritjes së qytetarëve janë edhe konfliktet e shumta të pronësisë ndërmjet tyre.

Ashtu si dhe në vitet e kaluara ka mjaft ankesa të shoqëruara me protestë për procedurat e aplikimit për vizë në ambasadat e huaja në Shqipëri dhe sjellje aspak dinjitoze të autoriteteve të huaja jashtë vendit me individët shqiptarë. Nga dëshmitë është evidentuar se përfaqësitë diplomatike veçanërisht Greke dhe Italiane, veprojnë me mungesë respekti, dinjiteti, rregulli dhe lehtësie gjatë aplikimit për vizë të qytetarëve shqiptarë. Gjatë refuzimit të vizës që përfaqësitë konsullore Italiane apo Greke bëjnë ndaj individëve, shpesh ato nuk japin arsyen e refuzimit. Për shumë individë është e pamundur e drejta e ankimit për këtë refuzim, pasi organi i cili shqyrton këto ankesa ndodhet në shtetin e huaj dhe në Shqipëri nuk ekziston një infrastrukturë e mirëfilltë ndihme ligjore private avokatore për ndjekjen e ankesave në gjykatat e huaja. Ky fenomen haset shpesh edhe për personat të cilët shpallen të pa dëshirueshëm në shtetet fqinje dhe dëbimi i tyre nuk ka mundësi reale ankimimi pasi afatet për ta kryer këtë janë të shkurtra. Edhe për këto ankesa duhet bashkëpunuar më mirë me Ministrinë e Punëve të Jashtme.

Një grupim tjetër ankesash e kërkesash jashtë juridiksionit dhe kompetencave të Avokatit të Popullit, por që gjithsesi bëhen prezent dhe jepen orientime nga ana e zyres tonë janë edhe ato të cilat bëjnë fjalë për konfliktet familjare dhe personale që qytetarët kanë ndërmjet tyre si dhe marrëdhëniet midis qytetarit dhe subjekteve juridike private që kanë të bëjnë me marrëdhëniet e punës që vendosen mes tyre.

Në çdo rast është bërë e qartë se Avokati i Popullit është i gatshëm të ndërhyjë me kompetencat që i jep ligji vetëm kur organet apo autoritetet për të cilat ka ankesa apo kërkesa janë pjesë e Administratës Publike dhe nuk konstatohet angazhimi dhe përkushtimi i duhur institucional. Në rastet e tjera qytetareve i është ofruar këshillim ligjor ose orientim dhe sugjerim për zgjidhjen e problemeve të prezantuara.

Nga konkluzionet e arritura si rrjedhim i një eksperience prej më shumë se 3 vjetësh të Zyrës së Pritjes së Popullit dhe të marrëdhënieve me individët në përgjithësi, mendojmë se angazhimi ynë i mëtëjshëm është i domosdoshëm veçse duhet thelluar më tej metoda e punës për t'i ardhur sa më tepër në ndihmë qytetarëve që kërkojnë ndihmën e Avokatit të Popullit.

## **B. “Ditët e hapura”- Përvojë për t’u vazhduar**

Për të qënë më afër publikut dhe për të ofruar më shumë ndihmë në zgjidhjen e problemeve konkrete të prezantuara, Institucioni i Avokatit të Popullit, që nga viti 2002, ka zbatuar një formë të re komunikimi të drejtpërdrejtë me qytetarët, që ne e kemi quajtur “Ditët e hapura”.

Në kushtet e një decentralizimi gjithnjë e në rritje në favor të kompetencave të qeverisjes vendore, Avokati i Popullit mendon se më e mira është që problemet të zgjidhen atje ku lindin dhe me personat që, me dashje apo nga padituria, ua krijojnë atyre këto probleme.

Ne e kemi konsideruar zbatimin e “Ditëve të hapura” një praktikë shumë efiçente që shkurton së tepërmi procedurat burokratike, rrugët e gjata drejt Tiranës, shpenzimet ekonomike, e pse jo, edhe manipulimet e mundshme me të drejtat e qytetarëve. Nëse procedurat zbatohen me korrektesë, qytetari nis të rrisë besimin tek shteti i vet, tek institucionet dhe ligji.

Në muajt Qershor-Korrik 2004, Institucioni i Avokatit të Popullit, organizoi “Ditë të hapura”, në 38 qytete të vëndit. Gjatë atyre ditëve, u pranuan 443 ankesa nga qytetarët, 197 prej të cilave iu nënshtruan shqyrtimit të mëtejshëm nga ana e zyres sonë, kurse 246 të tjera rezultojnë të ishin jashtë kompetencës dhe juridiksionit të Avokatit të Popullit. Kuptohet që në shifrat e sipërpërmedura, nuk është përfshirë numri i atyre qytetarëve që kanë kërkuar këshilla ligjore për probleme të ndryshme dhe që janë orientuar me mjaft profesionalizëm për rrugën që duhej të ndiqnin për realizimin e të drejtës së pretenduar prej tyre. Takimeve tona nëpër rrethe në “ditët e hapura” u kanë paraprirë bisedat në 15 televizione lokale me ekspertë të Zyrës së Avokatit të Popullit, që publiku të njihej më parë me kompetencat dhe rolin e Avokatit të Popullit, me qëllim që ky i fundit të ishte sa më ndihmues për qytetarët. Nga takimet me qytetarët, rezultoi se në shumicën e rasteve objekti i ankesave të tyre, kishte të bënte me objektivat sociale të shtetit (punësimi, strehimi, ndihma sociale etj), me mosekzekutim të vendimeve gjyqësore, me procedurat e ndjekura nga Zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, konflikte të lindura në marrëdhëniet e punës, probleme të lindura në lidhje me shtesat e pensioneve apo dhe probleme të tjera për invalidët në miniera etj.

Sikundër kemi bërë të ditur edhe ne raportimin e kaluar, Avokati i Popullit ka menduar që shërbimin e tij ta ofrojë në mënyrë permanente, fillimisht në pesë rrethe në skajet e largëta të vëndit. Për këtë është përgatitur edhe një projekt i cili deri tani fatkeqesisht ka ngelur ende në letër.

Megjithatë ky projekt po synohet të kthehet në një projekt bashkëpunimi rajonal, që Avokati i Popullit ka inicuar me zyrat e Ombudsmanit në vëndet e tjera të Ballkanit, si Maqedonia, Kosova, Mali i Zi.

## 5. Konferenca Kombëtare “Të drejtat e punonjësve”

Sipas nenit 30 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, “Për Avokatin e Popullit”, Institucioni ynë në bashkëpunim me organizatat joqeveritare duhet të organizojë, të paktën një herë në vit, veprimtari kombëtare për gjendjen e të drejtave dhe lirive të njeriut në Republikën e Shqipërisë. Në zbatim të këtij detyrimi, më datën 17 Dhjetor 2004, u zhvillua Konferenca Kombëtare “Të drejtat e punonjësve”.

Për përgatitjen e Konferencës u punua gjatë gjithë vitit 2004, duke shqyrtuar të gjitha ankesat që lidhen me të drejtat e punonjësve, problemet që paraqesin ato si në drejtim të legjislacionit që mbron të drejtat e punonjësve dhe të zbatimit konkret të tij nga ana e organeve të administratës shtetërore.

Më poshtë do të rendisim përfundimet dhe rekomandimet e kësaj konference:

1. Organizimi i Konferencës lidhur me të drejtat e punonjësve, u organizua si një detyrim kushtetues në mbrojtje të të drejtave dhe interesave të ligjshme të individëve.

Ky aktivitet u organizua me inisiativë të Institucionit të Avokatit të Popullit, në bashkëpunim me Ministrinë e Punës dhe Çështjeve Sociale, Prezencën e OSBE në Shqipëri, Konfederatën e Sindikatave dhe Bashkimin e Sindikatave të Pavarura, Këshillin e Organizatave të Punëdhënësve dhe Organizatën e Biznesmenëve të Shqipërisë.

2. Prej më shumë se 10 vjetësh Shqipëria është një vend i hapur dhe demokratik, që synon të ndërtojë një ekonomi solide të tregut të lirë. Ajo ka marrë përsipër shumë angazhime për të ndërtuar një proces pune të denjë për të gjithë personat aktivë, jashtë diskriminimeve, që përjashton shfrytëzimin e punës së fëmijeve, që respekton të drejtat e punëmarrësve për tu bashkuar në shoqata sindikaliste dhe për dialog midis tyre dhe me shtetin, si një faktor i tretë. Serioziteti i këtyre angazhimeve shikohet në ratifikimin deri më sot prej Republikës së Shqipërisë të 41 Konventave Ndërkombëtare të Punës. Për të gjithë është më se e qartë se ratifikimi i këtyre Konventave (si edhe i të gjithë Konventave të tjera në përgjithësi), nuk është një qëllim në vetvete, por është shprehje zyrtare e angazhimit të shtetit dhe shoqërisë për të ndërtuar sistemin e kushteve që garanton vetëm punë të denjë. Në numrin 41 të Konventave të ratifikuara bëjnë pjesë edhe 8 Konventat të identifikuara nga Zyra Nderkombetare të Punës si **Themelore**, të cilat janë:

- Konventat 87 dhe 98 që kanë të bëjnë me Lirinë e Asocijimit;
- Konventat 29 dhe 105 që kanë të bëjnë me Eleminimin e Punës së Detyrueshme;
- Konventat 138 dhe 182 që kanë të bëjnë me Eleminimin e Punës së Fëmijëve, dhe
- Konventat 100 dhe 111 që kanë të bëjnë me Eliminimin e Diskriminimit në Punë dhe Profesion.

Duke ratifikuar këto instrumenta bazë, Shqipëria ka hyrë në grupin e vendeve që merr përsipër të zbatojë Deklaratën e Organizatës Ndërkombëtare të Punës mbi Parimet Themelore dhe të Drejtat në Punë, adoptuar prej Konferencës Ndërkombëtare të Punës të vitit 1998. Ky proces zbatimi është sa i vështirë në raport me problemet që mbulon, aq edhe problematik në kushtet e një zhvillimi të vullshëm ekonomik, i mpleksur me lëvizje të konsiderueshme të popullsisë jashtë dhe brenda vendit.

3. Të drejtat e punonjësve si një nga të drejtat e shumta të individëve apo grupeve të tyre janë parë me prioritet nga Institucioni i Avokatit të Popullit. Prandaj Institucioni i Avokatit të Popullit që në fillimet e punës së tij, ka qënë tepër i ndjeshëm lidhur me respektimin e të drejtave të punonjësve, si të atyre që punojnë në sektorin publik, ashtu dhe atyre që punojnë në sektorin privat. Ankesat e trajtuara kanë qënë të ndryshme dhe të larmishme, duke filluar që nga parregullsitë në lidhjen e kontratave individuale apo kolektive të punës. Ka akoma mjaft shtetas shqiptarë që bëjnë “punë të zezë”. Ka mungesa të kontratave individuale, mos zbatim të rregullave të mbarimit të kontratës, mos derdhje të kontributeve të sigurimeve shoqërore nga ana e punëdhënësve, si në sektorët shtetërore ashtu dhe ato privatë, etj. Ndërhyrja e Avokatit të Popullit ka qënë në dy drejtime:

**Së pari;** në drejtim të konstatimit të shkeljeve dhe të problemeve lidhur me legjislacionin konkret, qoftë Kodi i Punës, Ligji “Për statusin e nënpunësit civil” etj;

**Së dyti;** të ndërhyrjes në organet shtetërore që kanë kompetence zgjidhjen e ankesave dhe marrjen e masave parandaluese për mospërsëritjen shkeljeve në të ardhmen,

4. Problemet që dalin nga zbatimi në jetë i Kodit të Punës dhe gjithë legjislacioni përkatës që rregullon çështjet e punës janë të shumta dhe jo rrallë edhe shumë të ndërlikuara. Duke vlerësuar përmirësimet e bëra në Kodin e Punës në vitin 2004, vërejmë se me dispozitat e tij ka rregulluar juridikisht statusin dhe veprimtarinë e Sindikatës në vendin e punës, kontraktimin kolektiv, zgjidhjen e konflikteve të punës, grevat deri në njohjen e të drejtës së sindikatës për përfaqësimin dhe mbrojtjen e anëtareve të vet në gjykatë. Por në të vërtetë



në praktikë ka jo pak raste që Sindikatat ndeshen me një prirje të punëdhënësve, vendas e të huaj, për të mos lejuar krijimin e tyre por edhe kur krijohen refuzojnë t'i njohin ato. Gjithashtu ka tendenca për të mos respektuar në tërësi Kodin e Punës edhe kur Sindikatat veprojnë si subjekte të njohura juridikisht. Sidomos punëdhënësit privatë që praktikojnë punën ilegale nuk duan të dëgjojnë fjalën “sindikatë” nga punëtorët e tyre.

5. Në kohën kur konfliktet në punë në vendin tonë janë në rritje për shkak të zbatimit të reformave ristrukturuese apo privatizimit të sektorëve kryesore të ekonomisë publike, nevojitet të parashikohet një zgjidhje më e shpejtë dhe me shpenzime minimale të konflikteve. Prandaj nevojitet krijimi i gjykatave të specializuara për konfliktet e punës, të cilat gjatë shqyrtimit të çështjeve kane më shumë parasysh natyrën e veçantë të konflikteve të punës.

6. Legjislacioni i punës ndalon shfrytëzimin e punës së fëmijëve, ndalon diskriminimin e grave, por ende përdoren mënyra të ndryshme për shfrytëzimin e punës së tyre dhe diskriminimin në trajtimin e tyre. Bie veçanërisht në sy puna e grave në kushte jo njërezore, sidomos nga firmat e huaja, kryesisht në artizanat dhe në industrinë e lëkurë-këpucëve. Këto punësojnë vajza dhe gra të reja, bile dhe fëmijë dhe jo vetëm që nuk investojnë për përmirësimin e kushteve të punës, por nëpërmjet aplikimit të punës në banesat e punëtorëve, nuk zbatojnë as dispozitat për sigurime, për vjetërsi, asistencë mjekësore etj.

7. Ka veprime abuzive dhe subjektive nga ana e disa punëdhënësve kundrejt punëmarrësve të cilat rrjedhin jo nga padijenja dhe moskuptimi i ligjit, por nga veprime të qëllimta dhe aspak justifikuese, duke i mbuluar këto me nje mbulose formale ligjore.

8. Në Administratën publike Qendrore dhe Vendore, për ata punonjës marrëdhëniet e punës të të cilëve rregullohen me dispozita të Kodit të Punës, është konstatuar se në disa raste nuk bëhen kontrata individuale. Në rastet e kontratave kolektive të nivelit të parë me Sindikatat, shpesh ato janë formale, pasi nuk gjejnë zbatim në degët e tjera, apo nuk kanë përfaqësimin e duhur. Duke anashkaluar momentin fillestar të lindjes së marrëdhënies së punës, edhe detyrimet e tjera që burojnë nga ky akt janë të pacaktuara, të paqarta dhe shpesh bëhen burim konfliktesh.

9. Lidhur me kontraktimin kolektiv, Kodi i Punës merr përsipër rregullimin në detaje të procedurës së kontraktimit dhe nuk i le hapësirë lirisë së palëve. Por, liria e kontraktimit shpesh është kufizuar nga respektimi i një kuadri të ngushtë ligjor, duke krijuar shpesh një kontratë kolektive të njëjtë për të gjitha kategoritë e profesioneve dhe me një përmbajtje të varfer për të drejtat e punonjësve. Shkaku i nivelit dhe përmbajtjes së ulët të kontraktimit nuk është për shkak të ligjit, por është një reflektim i drejtëpërdrejtë i nivelit të ulët të

zhvillimit të marrëdhënieve industriale, i mungesës së traditës dhe kulturës të kontraktimit dhe dialogut social si dhe të dobësisë së sindikatave.

10. Konstatohet që mjaft nga punëdhënësit nuk zbatojnë kërkesat e ligjit për rastet e largimit nga puna. Mjaft herë dhe organet gjyqësore e anashkalojnë këtë moment të rëndësishëm dhe nuk thellohen në procedurën e largimit nga puna. Për shumë arsye, punëmarrësit shqiptarë nuk i njohin mirë të drejtat e tyre dhe shpesh kjo padijeni kundrejt legjislacionit të punës shfrytëzohet mjaft herë nga punëdhënësit privatë, por edhe publikë, duke bërë viktime punonjësit që gjënden të pambrojtur dhe pa mbështetje.

11. Në praktikë ka mjaft probleme që punëdhënësi ka vënë si kusht për punësimin, mosangazhimin në sindikatë, ose mospjesmarrje në aksione sindikale. Kështu shkelet hapur Konventa nr.98 “Mbi të drejtat e organizimit dhe negociatat kolektive”. Në nenin nr.1 të saj parashikohet se “Punonjësit duhet të gëzojnë një mbrojtje të plotë ndaj çdo veprimi diskriminues që përpiqet të çënojë liritë sindikale në fushën e punësimit”

12. Lidhur me marrëdhëniet e punës do të veçojmë ankesat që lidhen me mosekzekutimin e vendimeve gjyqësore, për të cilat gjykatat kanë vendosur në favor të punëmarrësve për përfitimin e dëmshpërblimit me pagën e një viti. Shpesh këto ankesa kanë mbetur pa zgjidhje dhe janë mbartur nga viti në vit. Përgjigjet e marra nga të gjitha organet justifikohen me mungesë fondesh.

13. Një çështje mjaft e kundërshtuar nga Sindikatat janë dispozitat e Kodit të Punës mbi grevat, me pretendimin se e ngushtojnë shumë hapësirën e realizimit të të drejtës së grevës.

14. Aktualisht në vendin tonë ka shumë punonjës, të cilët në mungesë totale të të ardhurave pranojnë të punojnë në “të zezë” pa patur asnjë garanci qoftë në drejtim të pagesës, të sigurimeve shoqërore apo dhe të kushteve të punës ku këta punojnë. Vetëm në rastet kur shperthen ndonjë “bombë” sociale si ajo e Minierës së Selenicës shtrohet problemi se si punojnë strukturat shtetërore që duhet të kontrollojnë në bazë të ligjit respektimin e të drejtave të punëtorëve.

15. Nga momenti i miratimit të Ligjit “Për Inspektoriatin shtetëror të Punës” në vitin 1995, vendi ynë ka pësuar mjaft ndryshime që kanë nxjerrë si domosdoshmëri përgatitjen e një projekt ligji të ri, për forcimin e Inspektoriatit Shtetëror të Punës dhe rritjes së efektivitetit të këtij institucioni.

Mbi bazën e përfundimeve dhe konstatimeve të mësipërme Konferenca doli me këto rekomandime:

1. Të punohet më tepër nga organizatat sindikale për informimin dhe ndërgjegjësimin e punëmarrësve për rëndësinë që ka ekzistenca e kontratës kolektive dhe asaj individuale të punës për respektimin e të drejtave të punonjësve nga ana e punëdhënësve.

2. Te organizohen dhe fuqizohen strukturat sindikale në sektorin privat.
3. Krahas forcimit të organizatave sindikale të punëmarrësve dhe organizatave të punëdhënësve, të krijohen hapësira më të plota ligjore dhe të përmirësohen marrëdhëniet institucionale të partnerëve sociale si në sektorin privat dhe publik, në nivel qendror, rajonal dhe lokal.
4. Nevojitet që Qeveria të diskutojë me partnerët socialë në të gjitha ato raste kur diskutohen dhe formulohen politikat e strategjitë e zhvillimit të vendit. Partneriteti dhe dialogu social duhet të bëhet një metodë normale pune e qeverisjes.
5. Të rritet efektiviteti i konsultimeve në Këshillin Kombëtar të Punës duke zgjeruar fushën e konsultimit për të gjitha çështjet ekonomike dhe sociale, rritjes së cilësisë së përfaqësimit, rritjes progresive të autonomisë, fuqizimit të strukturave të menaxhimit dhe buxhetit të pavaruar të këtij Këshilli.
6. Përmirësimi i Funkcionimit të Këshillit Kombëtar të Punës, dhe përmirësimi i sistemit dhe mekanizmave për parandalimin e konflikteve paragjyqësore të punës të realizohet nëpërmjet zhvillimit të projekteve.
7. Të realizohet përqasja e legjislacionit të punës me standartet e Bashkimit Europian, si përmirësimi i Kodit të Punës, i ligjit për Inspektoriatin Shtetëror të Punës etj. Përveç 8 Konventave themelore, përpjekjet të përqëndrohen në punën për ratifikimin e Konventave Prioritare, konkretisht të Konventës Nr. 122 “Mbi politikën e punësimit”, Nr. 129 “Mbi inspektimin e punës në bujqësi” dhe Konventës 102 për standartet minimale në fushën e Sigurimeve Shoqërore.
8. Të intensifikohet puna për ndërgjegjësimin e partnerëve sociale për respektimin e të drejtave të punonjësve, duke rritur efektivitetin e organeve të kontrollit, veçanërisht të Inspektoriatit Shtetëror të Punës.
9. Të konsolidohet Inspektoriatit Shtetëror i Punës nëpërmjet reformave strukturore, shtrirjes së kontrollit jo vetëm në zonat urbane, por dhe në ato rurale, rritjes së shkallës së profesionalizmit, luftës kundër korrupsionit, shkëmbimit të eksperiencave me institucione homologe vendase dhe të huaja. Këtij Institucioni t’i jepet kompetenca të mjaftueshme për kontrollin e punës së zezë, proces i cili do të ndikojë në minimizimin e tregut informal të punës. Lidhur me këtë lipset edhe të përmirësohen metodat dhe mjetet e punës të kontrollit të Inspektoriatit Shtetëror të Punës. Kuadri i ri ligjor të synojë në forcimin dhe konsolidimin e mekanizmave të kontrollit, për të siguruar presionin e duhur ndaj abuzimeve në tregun e punës, në atë të prodhimit dhe në të njëjtën kohë përmirësimin e legjislacionit për shmangien e barrierave administrative.
10. Të përmirësohet bashkëpunimi i I.S.Sh-së me Sindikatat dhe Organizatat e Punëdhënësve për zbatimin e legjislacionit të punës.

11. Të bëhen përpjekje për të rritur shkallën e kualifikimit të punonjësve të strukturave të kontrollit të zbatimit të legjislacionit dhe të strukturave të menaxhimit të konflikteve.

12. Me qëllim rritjen e efikasitetit të luftës kundër punës së zezë, nevojitet edhe përmiresimi i kuadrit ligjor, për të rritur dhe forcuar bashkëpunimin ndërinstytucional, me konkretisht ndërmjet organeve tatimore, Inspektoriatit Shtetëror të Punës, Institutit të Sigurimeve Shoqërore, Prokurorisë, organeve të rendit etj.

13. Të punohet për vendosjen e një rrjeti të informatizuar dhe të kompjuterizuar për marrjen e një informacioni permanent dhe vendosjen e një kontrolli kompjuterik mbi rregjistrimin e punëmarrësve të tregut privat të punës me qëllim minimizimin e punësimit ilegal.

14. Të përgatitet një studim për efektivitetin e krijimit të rrjetit të gjykatave të punës.

15. Të shikohet mundësia e përmiresimit dhe plotësimit të legjislacionit të punës me dispozita që marrin në mbrojtje punën që krijohet nga biznesi vendas për të shmangur tendencën globaliste të transferimit të punës të investitorëve të huaj në ato vende ku puna dhe aktorët e saj janë të pa mbrojtur, ku krahu i punës kushton më lirë dhe shpenzimet janë tepër minimale.

16. Në marrëveshjet e tregëtisë së lirë që nënshkruhen me vende të tjera, duhet të kihet në konsideratë:

- Negociatat për këto marrëveshje të kryhen në mënyrë transparente
- Të drejtat themelore të punëtorëve duhet të bëhen një pjesë integrale e vetë marrëveshjes.
- Mekanizmat që sigurojnë mbrojtjen e këtyre të drejtave duhet të kenë të njëjtën forcë sikurse edhe mekanizmat që sigurojnë respektimin e pjesëve të tjera të marrëveshjes.

\* \* \*

Zhvillimi i kësaj Konference, pjesëmarrja e drejtuesve dhe kuadrove të disa ministrive kryesore, e përfaqësuesve të organizatave të punëdhënësve, të Sindikatave në qendër dhe në rrethe, si dhe fjalimet, problemet dhe sugjerimet e tyre për çështjet e trajtuara në Konferencë, janë një tregues që premtojnë për ndryshime pozitive në drejtim të respektimit të të drejtave të punonjësve në të ardhmen.

Sipas mendimit të përgjithshëm, Konferenca ia arriti qëllimit të caktuar për sensibilizimin dhe angazhimin më të madh të të gjitha organeve dhe autoriteteve të administratës publike shqiptare për zbatimin e Kushtetutës, të ligjeve përkatëse si dhe rekomandimeve të kësaj Konference.

Përfundimet dhe rekomandimet përkatëse që dolën gjatë punimeve të saj i janë dërguar Presidentit të Republikës, Kryeministrit, Kryesisë së Kuvendit të Shqipërisë, Komisioneve Parlamentare të Çështjeve Kushtetuese dhe Ligjore, të Punës, Problemeve Sociale dhe Gruas, si dhe të gjithë ministrave.

Të shpresojmë se rekomandimet e kësaj Konference do të vlerësohen me seriozitet dhe do fillojnë të zbatohen nga gjithë organet kompetente.

## **6. Aktivitete të tjera të Institucionit të Avokatit të Popullit gjatë vitit 2004**

Krahas ndjekjes së problematikës së përditshme, për të shqyrtuar ankesat e qytetarëve, Avokati i Popullit ose përfaqësues të tij, kanë marrë pjesë duke dhënë kontributin e tyre në aktivitete të ndryshme, organizuar nga organizma qeveritare dhe të shoqërisë civile. Ashtu siç kemi theksuar dhe në Raportin Vjetor 2003 një gjë e tillë ka qenë dhe mbetet një angazhim sa institucional, aq edhe qytetar i Institucionit të Avokatit të Popullit, për tu investuar dhe thënë fjalën e tij për një problematikë edhe më të gjerë se ajo që paraqitet në statistikat e punës së tij normale.

Më poshtë po ju njohim thjesht me tematikën e këtyre aktiviteteve, duke menduar të paraqesim edhe grupet e interesit, të synuara prej tyre.

1. Konference rajonale me temë: “Lufta kundër trafikimit të fëmijëve në Evropë” organizuar nga Këshilli i Evropës dhe Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale, Janar 2004.

2. Seminar me temë: “Mbi luftën kundër korrupsionit” organizuar nga Departamenti i Administratës Publike, Shkurt 2004.

3. Seminar me temë: “Mbi ekzekutimin e vendimeve penale”, organizuar nga Komiteti Shqipar i Helsinkit, Shkurt 2004.

4. Seminar me temë: “Shërbimi i psikiatrisë ligjore” organizuar nga Ministria e Drejtësisë, Maj 2004.

5. Seminar me temë: “Mbi Këshillin e Evropës dhe Bashkimin Evropian”, organizuar nga Instituti i Trajnimit të Administratës Publike, Maj, 2004.

6. Pjesëmarrje në analizën e punës së Zyrave të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Qershor 2004.

7. Tryezë e rumbullakët me temë: “Lufta kundër trafikimit të fëmijëve romë”, organizuar nga Këshilli i Evropës, Korrik 2004.

8. Seminar me temë “Problemet ligjore, etika në Agjensitë Publike. Operacionet brenda vendit” organizuar nga Ministria e Mbrojtjes dhe Instituti i Mbrojtjes i SH.B.A-së, Shtator 2004.

9. Seminar me temë: “Legjislacioni shqiptar për personat me aftësi të kufizuar” organizuar nga Ministria e Shëndetësisë në bashkepunim me OJF-të, Tetor 2004.

10. Seminar me temë: “Roli i Ombudsmanit për mbrojtjen e pakicave kombëtare” organizuar nga Qendra Evropiane për problemet e minoriteteve me qendër në Gjermani, Tetor 2004.

11. Seminar me temë: “Prezantimi i masterplanit për paraburgimin” organizuar nga Ministria e Drejtësisë, Tetor 2004.

12. Seminar me temë: “Kontrolli kushtetues i iniciuar nga subjektet e nenit 134/2 të Kushtetutës” i organizuar nga Gjykata Kushtetuese dhe Fondacioni gjerman IRZ, Nëntor 2004.

13. Seminar me temë: “Planifikimi strategjik në kuadër të shërbimeve sociale për fëmijët e rrugës në qytetin e Tiranës” organizuar nga Bashkia Tiranë, Nëntor 2004.

14. Seminar me temë: “Mbi mënyrat e komunikimit dhe negocimit” organizuar nga Departamenti i Administratës Publike pranë Këshillit të Ministrave, Nëntor 2004.

15. Seminar me teme: Legjitimiteti i Avokatit të Popullit për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese, organizuar nga Gjykata Kushtetuese, Nëntor 2004.

16. Konferencë kombëtare me temë: “Bashkëekzistenca e minoriteteve dhe respektimi i të drejtave të tyre” organizuar nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit, Dhjetor 2004.

17. Konferenca Gjyqësore Kombëtare, Dhjetor 2004.

18. Pjesëmarrje në tryezën e rumbullakët me temë: “Rritja e çmimit të energjisë elektrike” organizuar nga Enti Rregullator i Energjisë, Dhjetor 2004.

19. Pjesëmarrje në Grupin e Monitorimit Anti Korrupsion. (periodike).

Në të gjitha këto aktivitete, Institucioni i Avokatit të Popullit ka promovuar rolin, kompetencat dhe juridiksionin e tij në ndërveprimin me institucionet e tjera shtetërore dhe ato të shoqërisë civile. Problematika e diskutuar në to na ka ndihmuar në sqarimin e pozicioneve të ndryshme, në të cilat ndodhemi, në raport me instancat të cilave u drejtohem, nisur nga ankesat konkrete që vijnë pranë zyrës tonë. Kjo pjesëmarrje aktive do të vazhdojë të jetë përparësi e punës tonë edhe në të ardhmen, pasi bashkëpunimin me organet e administratës dhe të të tre pushteteve, si dhe me organizmat e shoqërisë civile e shohim si domosdoshmëri për perfeksionimin e mëtejshëm të punës tonë, si mbikqyrës të respektimit të të drejtave të njeriut në të gjitha dimensionet e tyre.

## KREU III

### Veprimtaria konkrete e Avokatit të Popullit për ankesat, kërkesat dhe njoftimet (rastet), të grupuara sipas institucioneve qeveritare

#### **1. Këshilli i Ministrave (Qeveria)**

Duke realizuar detyrën e tij kryesore, mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në Shqipëri, Avokati i Popullit në të njëjtën kohë, ka informuar, rekomanduar apo i ka bërë propozime Kryeministrit dhe ministrave për të gjitha çështjet kryesore që kanë dalë gjatë punës së tij. Pavarësisht nga forma në të cilën janë paraqitur opinionet e Avokatit të Popullit, mendojmë se, në njërën ose tjetrën mënyrë, ato kanë ndikuar në rritjen e standarteve të mirëqeverisjes.

Gjatë vitit 2004, Qeverisë, të kryesuar nga kryeministri, zoti Fatos Nano, i kemi dërguar zyrtarisht këto rekomandime, propozime apo njoftime:

1. Njoftimi se Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E.) i është rekomanduar që të rishikoheshin për ulje tarifat e shitjes së energjisë elektrike, të miratuara me vendimin e E.R.E., të datës 30.12.2003 (dërguar data 12.02.2004).

Siç dihet publikisht ky rekomandim nuk u mor në konsideratë për uljen e tarifave, veçse pati vlerë në kuadrin e përmirësimit të transparencës së punës së Korporatës Elektroenergjitike dhe të nxitjes së procesit të vendosjes së aparateve matës të energjisë elektrike.

2. Kërkesa për nxitjen e problemit për ndryshimin dhe përmirësimin e Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.552, datë 27.11.1999 “Për trajtimin ekonomik dhe financiar të familjeve të punonjësve të policisë të vrarë apo plagosur për shkak të detyrës” (datë 16.02.2004). Ky është një problem që vazhdon të ngrihet prej 3 vitesh nga zyra jonë dhe padrejtësisht ka mbetur pa u zgjidhur, sepse vendimi në fuqi ja ka mohuar të drejtëne trajtimit familjeve të punonjësve të policisë të vrarë apo të plagosur nga viti 1991 deri më datën 1 janar 1999. Nuk kemi përgjigje.

3. Propozimi për shfuqizimin e urdhërit të Ministrit të Rendit Publik nr.1661, datë 09.04.2002 “Për komunikimin me mediat”(datë 29.03.2004). Ky

propozim është bërë sepse ndërsa vetë Kryeministri me Urdhërin e tij nr.157 datë 12.11.2003 ka revokuar Urdhërin e tij të mëparshëm nr.226 datë 20.08.2002 “Për komunikimin me organet e medias së shkruar dhe elektronike”, fakt ky i konfirmuar edhe nga Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr.34 datë 08.12.2003, Ministri i Rendit Publik, në mënyrë paradoksale vazhdon të mbajë në fuqi urdhërin e tij antikushtetues. Nuk kemi përgjigje.

4. Rekomandim për shfuqizimin e tarifës së shërbimit të vendosur nga Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare në ngarkim të pronarëve të vilave pranë rezidencave qeveritare (datë 02.06.2004). Në këtë rekomandim argumentohet se vendosja e tarifës vjetore prej 1000 lek për lejen e hyrjes për secilin anëtar të familjeve që kanë prona në zonat rezidenciale nuk mund të bëhet nga D.Sh.Q.-ja, sepse nuk është organ i deleguar me ligje për të zbatuar këtë taksë apo tarifë. Jemi informuar se i është sugjeruar D.SH.Q. të pranojë rekomandimin tonë.

5. Rekomandim për përfshirjen në listën e subjekteve që përfitojnë pension suplementar të nëpunësve të Komisionit të Shërbimit Civil dhe të institucionit të Avokatit të Popullit (datë 08.07.2004). Ky rekomandim është bërë me qëllim që nëpunësit civilë të këtyre institucioneve të gëzojnë të drejtat e tyre që rrjedhin nga Statusi i Nëpunësit civil, ashtu si edhe mjaft nëpunës të tjerë të institucioneve të tjera të administratës publike shqiptare. Nuk është vënë në lëvizje.

6. Kërkesa për ndërhyrjen e Kryeministrit që të ekzekutohen vendime gjyqësore në favor të ish punonjësve të Ministrisë së Rendit Publik dhe të Policisë së Shtetit nga këto institucione (datë 19.07.2004). Kjo kërkesë argumenton antikushtetutshmërinë e qëndrimit të Ministrisë së Rendit Publik ndaj vendimeve gjyqësore. I është dërguar Ministrisë së Rendit për zbatim.

7. Rekomandimi për revokimin e vendimit të marrë në mbledhjen e KRRTRSH-së të datës 11.09.2004 në favor të shoqërisë “TID” shpk, sepse çështja e konfliktit me shoqërinë “Rexhepi” shpk është në proces gjyqësor (datë 22.10.2004). Është në shqyrtim.

Kryeministri është informuar rast pas rasti edhe në lidhje me problemet me interes për Qeverinë që kemi diskutuar me homologët gjatë takimeve në Shqipëri, raporteve të tyre apo vizitave tona jashtë shtetit.

### **a) Grupi Mbikqyrës i Firmave Piramidale pranë Këshillit të Ministrave**

Veprimtaria e Grupit Mbikqyrës pranë Këshillit të Ministrave, vazhdon të mbetet një nga problematikat, e trajtuara nga ana e institucionit tonë edhe gjatë vitit 2004.

Numri i ankesave të marra nga ana jonë për këtë vit është 7, numër ky i njëjtë me atë të vitit parardhës. Kanë përfunduar së shqyrtuari 6 ankesa, ndërsa



1 ankesë është ende në shqyrtim. Nga ankesat e shqyrtuara rezultojnë katër prej tyre të pabazuara dhe 2 prej tyre jashtë juridiksionit dhe kompetencës.

Vërehet se në krahasim me vitet e tjera, numri i ankesave të paraqitura për veprimtarinë e Grupit Mbikqyrës pranë Këshillit të Ministrave, ka ardhur në ulje, ndërkohë që problematika e evidentuar për vitin 2004, mbetet më e reduktuar.

Si një problem i mbartur nga vitet e mëparshme, është mosekzekutimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë, të detyrueshme për pagimin e vlerave të caktuara monetare nga ana e Grupit Mbikqyrës ndaj subjekteve të ndryshme.

Problemet e parashtruara në ankesat e marra në shqyrtim kanë qenë:

1. Për zvarritje dhe bllokim në procesin e kthimit të parave kreditorëve të ish firmave piramidale nga ana e Grupit Mbikqyrës.

2. Për mosderdhje të kontribucioneve të sigurimeve shoqërore nga ana e ish firmave piramidale për punonjësit e tyre apo edhe administratorët aktualë të këtyre firmave në administrim, për punonjësit që kanë punuar me kontrata për ta.

3. Për mosmarrje informacioni të saktë apo për mosdijeni, lidhur me procedurat e likuidimit të firmes “Angli-Adriatika”, nga ana e kreditorëve të kësaj firme.

Shqetësimi i ngritur nga ana jonë në raportet e mëparshme për transparencën e veprimtarisë së Grupit Mbikqyrës pranë Këshillit të Ministrave, ka gjetur pasqyrimin e tij me të qartë në punën e Komisionit Parlamentar për shqyrtimin e veprimtarisë së Grupit Mbikqyrës, në lidhje me administrimin e ish firmave piramidale, përfshirë këtu edhe veprimtarinë e administratorëve të pavarur të caktuar për këtë qëllim.

Ritheksojmë se në tërësinë e punës së tij, ky Komision arriti të krijojë tek publiku i gjerë një tablo më të qartë dhe më të kuptueshme, se çfarë ka ndodhur dhe po ndodh me procesin e administrimit të ish firmave piramidale dhe në fund te fundit, kush janë rezultatet e mundshme të pritshme.

Problemi i mospërfundimit të plotë të procesit të transparencës dhe mospërcaktimi i afateve konkrete të procesit të kthimit të parave ndaj kreditorëve të firmave piramidale, gjykojmë se tanimë ka kaluar në kuadrin e përcaktimit të afateve të shlyerjes së përqindjeve përkatëse, të shumave të derdhura nga ana e kreditorëve në firmat piramidale.

Megjithatë gjykojmë përsëri se transparenca në punën e administratorëve të firmave piramidale dhe të Grupit Mbikqyrës pranë Këshillit të Ministrave, vazhdon të mbetet problem, fakt që është evidentuar edhe në çështjet e shqyrtuara prej nesh në këtë vit.

Kështu në procesin e shpërndarjes së parave sipas përqindjes përkatëse të depozituar në firmat piramidale, për të cilat ka përfunduar procesi i

administrimit dhe transparencës nga Grupi Mbikqyrës, del se ka probleme lidhur me gjeneralitetet e pakta që kanë kreditorët në listat e këtyre kompanive piramidale. Për këtë pranë sporteleve të Bankes së Kursimeve është vënë kushti i kërkitimit të një dokumentacioni të rregullt dhe autentik të kreditorit, për një saktësi sa më të madhe në përkatësinë e personit që tërheq lekët.

Gjykojmë se ky problem i shfaqur, duhej të ishte kapercyer me kohë, pasi në punën që është bërë nga administratorët përkatës të firmave piramidale në administrim për listat e kreditorëve të këtyre firmave, të dhënat personale në listë, duhej të ishin të plota dhe të mjaftueshme për shmangjen e një fenomeni të tillë, për më tepër kur është e dukshme se koha në dispozicion për këtë qëllim ka qënë mëse e mjaftueshme.

Problem kryesor mbetet mosekzekutimi i disa vendimeve gjyqësore të formës së prerë, të cilat i ngarkojnë Grupit Mbikqyrës, shlyerjen e detyrimeve financiare ndaj subjekteve të ndryshëm. Ky fakt behet akoma dhe më i mprehtë, në kushtet kur tashmë ka filluar shpërndarja e përqindjeve për kreditorët për një sërë prej firmave piramidale ne administrim.

Rekomandimet e bëra nga ana jonë në këtë drejtim, kanë vazhduar të ngelen me një mosveprim real apo veprim të pjesshëm të pajustificuar, pavarësisht se shkelet parimi kushtetues për zbatimin e vendimeve gjyqësore.

Çështje tjetër e vërejtur në punën e administratorëve të ish firmave piramidale dhe Grupit Mbikqyrës, është mosderdhja e kontribucionit të sigurimeve shoqërore për punonjësit që kanë vazhduar të punojnë në asetet e pashitura të shoqërive piramidale edhe pas marrjes së tyre në administrim. Në përgjigjet e kthyera në këto raste mbahet qëndrimi zyrtar i trajtimit të këtyre pagesave në kuadër të përfundimit të procesit të transparencës së shoqërive huamarrëse.

Ne gjykojmë se qëndrimi që mbahet në këto raste është jo i bazuar, pasi që nga momenti i fillimit të punës nga individët e ndryshëm në bazë të administrimit që u bëhet ish shoqërive huamarrëse nga administratorët dhe Grupi Mbikqyrës, kemi të bëjmë me marrëdhënie direkte ndërmjet një punëdhënësi të ri, i cili është i detyruar ligjërisht të parashikojë dhe derdhë si pagesë të gjitha detyrimet ndaj punëmarrësit, përfshirë edhe kontribucionin për sigurimet shoqërore. Në këtë kuadër është i pakuptueshëm qëndrimi i mbajtur ndaj rekomandimit tonë, drejtuar Ministrit të Punës dhe Çështjeve Sociale që në vitin 2001, ku rekomandohet ndërmarrja e insiativës legislative për ndryshimin e nenit 6, pika 2, të Ligjit Nr.8360 date 10.06.1998 “Për kriteret dhe mënyrat e shpërndarjes të pasurive të personave juridike, jobankare që kanë marrë hua nga publiku i gjerë”. Ndryshimi i këtij neni rrjedhimisht në llogjikën e cituar më lart, do të zgjidhte edhe këtë çështje që në fund të fundit ka të bëjë me

veprimtarinë direkte të administratorëve të ish firmave piramidale dhe Grupit Mbikqyrës, pranë Këshillit të Ministrave.

Lidhur me sa është evidentuar më sipër po paraqesim një rast të shqyrtuar nga ana jonë:

*Shtetasi H.S*, në ankesën drejtuar Avokatit të Popullit tonë, me cilesinë e kreditorit të Shoqërisë Huamarrëse “Kamberi”, ka ngritur pretendimin se administratorët e kësaj firme në mënyrë të paargumentuar kanë bllokuar kthimin e shumave të lekëve të akorduara në favor të qytetarëve kreditorë. Konkretisht ai ka sqaruar se edhe pse ka qenë në listën e kreditorëve të shpallur në Gazetën Shqiptare, të cilët përfitojnë nga kthimi i shumave të përlllogaritura nga administratorët e Shoqërisë “Kamberi”, me një urdhër të padrejte kjo procedurë është pezulluar deri në një afat të pacaktuar.

Me marrjen në shqyrtim të kësaj çështje nga ana jonë, është kërkuar informacion nga Administratorët e Shoqërisë “Kamberi”, lidhur me vërtetësinë e pretendimeve në fjalë dhe të mundësisë reale që ekziston për zgjidhjen e këtij problemi.

Me anë të shkreses Nr.165 Prot dt.07.12.2004, Administratori i shoqërisë në administrim “Kamberi sh.p.k” Z.Ymer Liksala ka sqaruar se nga ana e tyre nuk i është bërë asnjë shkresë ish Bankës së Kursimeve për të bllokuar procesin e shpërndarjes së parave. Ky proces vazhdon normalisht, por paraqet probleme lidhur me gjeneralitetet e pakta që kanë kreditorët në listat e kompanisë piramidale (vetëm emër mbiemër). Për këtë qëllim pranë sporteleve të bankës së kursimeve kërkohet një dokumentacion i rregullt dhe autentik i kreditorit, për të qenë sa më të saktë në përkatësinë e personit i cili tërheq lekët.

Lidhur me këtë fakt ankuesi është vënë në dijeni në përgjigjen përkatëse të dhënë nga ana jonë, ndërkohë që çështja në fjalë është konsideruar si e pabazuar në pretendimet që ngrihen.

*Shtetasi P.Sh*, në ankesën drejtuar Avokatit të Popullit, shpreh shqetesimin lidhur me faktin se Grupi Mbikqyrës pranë Këshillit të Ministrave, nuk ka kaluar për veprime të mëtejshme pranë Entit Kombëtar të Banesave dokumentacionin e tij për evidentimin e humbjes së banesës në firmat piramidale. Kjo procedurë është zvarritur për më shumë se tre vjet me rradhë, duke i mohuar të drejtën ankuesit për të përfituar nga fondet që do të ofrojnë qeveria apo donatorë të huaj për këtë kategori personash.

Pas marrjes në shqyrtim të kësaj ankese janë kërkuar shpjegime nga ana e Grupit Mbikqyrës pranë Këshillit të Ministrave, i cili ka sqaruar me hollësi procedurat e ndjekura si nga vetë ky organ, ashtu edhe për organet e tjera të cilat detyrohen të trajtojnë si të pastrehë ankuesin në kategorinë emergjente. Ndër të tjera jemi informuar se ankuesi figuron në listat e trajtimit emergjent në Këshillin Bashkiak Tiranë me Numër rendor 793 dhe se do të përfitojë sipas

legjislacionit në fuqi. Krahas kësaj Grupi Mbikqyrës ka konfirmuar se është prononcuar pranë Këshillit Bashkiak vetëm për verifikimin si i pastrehë, me cilesine e kreditorit në firmat piramidale të ankuesit.

Në këto kushte, duke e konstatuar ankesen e paraqitur si te pabazuar, kemi vene ne dijeni ankuesin ne lidhje me kete fakt, duke e informuar njekohesisht për trajtimin përkates që i ishte bërë paraprakisht çështjes së tij.

## **b) Ankesa për zyrat e regjistrimit të pasurive të palujtëshme (ZRPP)**

Për vitin 2004 pranë Institucionit tonë kanë ardhur 51 ankesa, që si objekt të tyre kanë patur pretendime për zvarritje në rregjistrimin e pasurisë të tyre të palujtëshme dhe mos rregjistrimin e oborreve të banesave private dhe mos marrjen e çertifikatës së pronësisë. 18 ankesa të tjera kanë qënë të mbartura nga viti 2003. Nga të gjitha këto çështje, janë shqyrtuar 55, nga të cilat 6 janë zgjidhur në favor të ankuesve, ndërsa 13 të tjera kanë kaluar për shqyrtim të mëtejshëm për vitin 2005.

Konstatojmë se edhe këtë periudhë kohore, bashkëpunimi dhe mirëkuptimi midis ZRPP ne rrethe dhe Institucionit të Avokatit të Popullit ka vazhduar të jetë i mire, duke i veçuar në sensin pozitiv. Të gjitha kerkesave tona per shpjegime dhe sqarime ju janë përgjigjur në kohë dhe me arsytim ligjor nëse qëndron apo jo ankimi i shtetasve, shoqëruar edhe me kopjet e veprimeve te kryera për kalimin e pronësisë për çdo praktikë. Ankesat qe jane zgjidhur pozitivisht ne favor te ankuesve ju perkasin respektivisht ZRPP Tirane, Kavaje dhe Korçe. Asnjera prej ketyre ankesave, pas verikimeve, nuk ka rezultuar të këtë qenë e shoqeruar me veprime ose mosveprime të punonjësve të ZRPP të kryera në kundërshtim me Ligjin “Për regjistrimin e pasurive të palujtëshme”. Shkak i vonesave të kontestuara, ka qënë mos plotësimi, nga ana e ankuesve, të dokumentacionit për aplikim. Pas sugjerimit tonë për plotësimin e këtyre mangesive, kërkesat e tyre janë realizuar nga ZRPP. Këtu mund te permendim rastin e ankueses D.V. që prej dy vitesh nuk po mund të regjistronte në ZRPP të rrethit Tiranë, apartamentin e blerë nga një firmë ndertimi. Pasi plotesoi aktet me dokumentin qe i mungonte, ju bë regjistrimi dhe ju dha edhe çertifikata e pronësisë. Per zgjidhjen e shqetesimit të saj, ankuesja i ka adresuar edhe nje leter falenderimi institucionit tone. Te njejtin problem ka ngritur edhe shtetasi V.S.banues në Korçë, qe ju be i mundur regjistrimi i pasurisë së palujtëshme, njohur dhe kthyer fizikisht me vendim të KKKte Pronave, nga ZRPP Korçë, pasi plotësoi edhe proces verbalin e dorëzimit të truallit nga organi përkatës i pushtetit vendor. Ndërsa objekti i ankimit të shtetasit K.B, banues në Tiranë,

ishte mos dhënia e certifikatës së bashkëpronësisë të një pasurie, si dokument i domosdoshëm në pjestimin gjyqësor të saj midis bashkëpronarëve. Me ndërhyrjen tonë ankuesi u pajis me certifikatën e kerkuar dhe i hapi rrugë procesit gjyqësor. Veçojmë për nivelin e mire të bashkëpunimit Zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Palujtëshme në rrethin e Tiranës dhe të Kavajës duke marrë për kriter rastet e zgjidhura shpejt dhe thjeshtë vetëm në saj të kërkesave tona. Edhe këtë vit, në asnjë rast të shqyrtuar, nuk ka rezultuar që veprimet ose mosveprimet për të cilat ankohen qytetarët, të kenë ardhur nga qëndrime dhe praktika abuzive të punonjësve të tyre ose për zbatim të gabuar të ligjit “Për regjistrimin e pasurive të palujtëshme” dhe të Rregullores të Brëndëshme të këtyre Zyrave. Të gjitha rastet e tjera, përveç atyre të përfunduara në favor të shtetasve, kanë rezultuar të pa bazuara ose jashtë juridiksionit tonë, pasi kanë qënë në vetvete konflikte pronësie që kërkojnë zgjidhje gjyqësore. Janë të pabazuara për faktin se thujtë të gjithë ankuesit konsiderojnë veprime korruptive dhe cënim të të drejtave të tyre, kur vihen në dijeni se pjesa e pronës që mendonin se ju rridhte nga trashëgimia, në saj të veprimeve të tilla të trashëgimlënsve, që në të gjallë të tyre, me testament dhe kontrata dhurimi, kanë shprehur vullnetin për kalimin e pronësisë personave të veçantë ose në favor të një trashëgimtari, duke përjashtuar trashëgimtarët e tjerë nga kjo pronësi. Ndërsa pjesa që është vlerësuar jashtë kompetencave tona, por që përsëri ankuesit akuzojnë ZRPP se ju ka vjedhur ose tjetërsuar pronën e tyre në favor të personave të tretë, nuk është gjë tjetër veçse bllokimi me të drejtë të pasurisë, pasi me vendim të KKK të Pronave, të Komisioneve të tokave ose me vendime gjyqësore të formës së prerë, janë krijuar mbivendosje pronash. Këto pasoja janë rrjedhim i veprimeve të nxituara të organeve të ngarkuara nga ligji për kalimin e pronësisë, të cilat pa bërë verifikimet e duhura japin, kthejnë në pronësi apo pjestojnë prona që pjesërisht apo tërësisht janë të regjistruara në emër të pronarëve të tjerë, duke krijuar në fakt një konflikt të ri pronësie. Edhe mos regjistrimin e oborrit funksional të banesave private nga ZRPP, në mungesë të akteve ligjore për fitimin e pronësisë, ankuesit i pretendojnë si të drejta të shkelura haptazi nga këto zyra, pasi sipas tyre kanë me dhjetra vjet që e shfrytëzojnë apo mbajnë këtë truall. Për të mos thënë se ka edhe raste kur qytetarët blejnë banesa të paregjistruara, dhe mos regjistrimin e tyre, pasi janë ndërtime të paligjeshme, e vlerësojnë si të qëllimshëm dhe me motive korruptive. Me këto konstatime, nuk kemi për qëllim mbrojtjen e veprimeve të ndonjë punonjësi të këtyre zyrave, që në kundërshtim me përmbushjen e rregullt të detyrës të tyre, mundohen të përfitojnë materialisht nga personat që paraqiten në sportelet e ZRPP. Nëse do të konstatojmë ose do të konsatojmë raste të kësaj natyre, në asnjë rast nuk do të hezitojmë të bëjmë kallzim penal pranë organit të

akuzës, siç mund ta bëjë edhe çdo aplikues nëse konstaton se ka elementë të mitmarrjes, falsifikimit të dokumentave apo të shpërdorimit të detyrës

Siç e përmendëm edhe më lart, mos njohja e ligjit dhe mos përgatitja e dokumentave të duhura për regjistrimin fillestar të pasurive të palujtshme, janë shkak kryesor që mosveprimet e ZRPP në rrethe, një pjesë e madhe e individëve i konsiderojnë shkelje të të drejtave dhe interesave të tyre të ligjëshme.

Ankesat e tjera kanë qënë të pabazuara, pasi regjistrimi nuk ju është bërë për shkak të mbivendosjes së pronave me njëra tjetrën dhe të mos pasjes së aktit të pronësisë për oborret funksionale. Ankuesit janë orientuar rast pas rasti dhe j'u është sugjeruar forma dhe menyra e veprimeve që duhet të bëjnë, përfshirë edhe ndjekjen e rrugës gjyqësore për zgjidhjen e konflikteve të pronësisë në rastet e mbivendosjeve të pasurive, ose për fitimin e pronësisë së oborreve të banesave private me parashkrimin fitues. Një mangësi që sjell zvarritje në shqyrtimin e këtyre ankesave dhe keq kuptime në marrëdhëniet tona me ankuesit, janë vonesat e pajustificuara në kthimin e përgjigjeve nga disa ZZPP në rrethe, që nuk respektojnë afatet ligjor në kthimin e përgjigjeve apo të ecurise se rekomandimeve konkrete.

Problem i evidentuar dhe ngritur për trajtim edhe gjatë vitit 2004, ka qënë ai i hezitimit të pakuptueshëm të ndonjë Zyre të Regjistrimit të Pasurive të Palujtshme për regjistrimin e pasurive të fituara me vendim gjyqësor të formës së prerë, duke shkelur haptazi të drejtat dhe interesat e ligjëshme të individëve që kanë fituar gjyqësisht një të drejtë të shkelur.

Zyra qëndrore e Regjistrimit të Pasurive të Palujtshme duhet të unifikojë sa më shpejt praktiken e Zyrave në vartësi të saj për zbatimin e kërkesave të pikës 3 të nenit 142 të Kushtetutës që i detyron organet shtetërore të ekzekutojnë vendimet gjyqësore të formës së prerë. Çdo kontestim ndaj këtyre vendimeve gjyqësore, duhet bërë vetëm në rrugë gjyqësore, me anë të rishikimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, parashikuar në nenin 494 të Kodit të Proçedurës Civile. Në të kundërt, të jene koshiente dhe të veprojnë në regjistrimin e tyre.

Një problem tjetër i cili do një optikë më racionale, është ai i rritjes së shkallës së transparencës të ZRPP në marrëdhëniet dhe komunikimin e tyre me qytetarët. Forcimi i infrastrukturës së tyre, siç është rasti i përmirësimeve rrenjësore me ambientet e reja të funksionimit të ZRPP Tirane, ku përveç të tjerave, është rritur ndjeshëm numuri i sperteleve dhe i juristëve që kontaktojnë direkt gjatë gjithë orarit zyrtar me aplikuesit, padydshim që është shoqëruar dhe do të vazhdojë edhe në të ardhmen me të njëjtën tendencë, do të shërbejë më mirë nevojave të qytetareve dhe do të çojë në fund të fundit në rritjen e besimit të tyre ndaj këtyre “bankave të pasurive të palujtshme”.

### **c) Ankesat për Komisionet e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ish pronarëve (KKKP)**

Ankesat e shtetasve për Komisionet e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (KKKP) për vitin 2004 janë në të njëjten sasi me ato të vitit 2003, gjithsej 27; ndersa 6 ankesa të tjera ishin të mbartura nga viti paraardhës. Nga këto janë përfunduar 26 dhe 7 të tjera kanë kaluar për trajtim për në vitin 2005. Objekti i ankesave vazhdojnë të jenë pretendimet për zvarritje në shqyrtimin e kërkesave nga Komisionet për njohjen dhe kthimin fizik të pasurive të palujtëshme, si dhe kundër vendimeve të tyre përfundimtare. Nga verifikimet e bëra rast pas rasti, ka dalë se thuajse të gjitha ishin të pabazuara, pasi dokumentacioni i depozituar pranë Komisioneve ka patur mangësi të theksuara, të tilla si mungesa e gen-planeve, mospërcaktimin e saktë të kufinjve për identifikimin e saktë të pronës së pretenduar, të mungesës të vendimeve gjyqësore në vënd të mos pasjes së aktit të pronësisë, e tjera si këto, që kanë bërë praktikisht të pamundur shqyrtimin e tyre. Një pjesë e ish pronarëve apo trashëgimtarëve të tyre, duke u ndodhur jashtë shtetit për motive ekonomike, nuk kanë patur kontakte me Komisionet për të verifikuar vonesat në trajtimin e kërkesave për njohje dhe kthimin e pronave. Për të gjitha këto raste, të vlerësuara si të pabazuara, j'u është sugjeruar ankuesve të plotësojnë sa më shpejt dokumentacionin e duhur, shoqëruar me kopjen e ligjit të ri dhe sqarimet e duhura për hyrjen në fuqi të tij dhe të kërkesave kryesore proceduriale për realizimin e këtij procesi. Pjesa tjetër nga çështjet e shqyrtuara, ato që kishin të bënin me kontestimet për vendimet e KKK të Pronave, duke qene se janë jashtë juridiksionit tonë, ju është bërë e ditur ankuesve kundërshtimin e tyre në rrugë gjyqësore. Një ankesë tjetër, ajo që i takonte shtetasit A. P., banues në Korçë, është zgjidhur pozitivisht. Personi në fjalë kundërshtonte vendimin e Kryetarit të Komitetit Shtetëror të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave që e kishte shkarkuar nga detyra e anëtarit të KKK të Pronave pranë Prefekturës Korçë. Këtë vendim institucioni tonë e vlerësoi të marrë në kundërshtim me gërmën "c" të pikës 1 të nenit 16 të Ligjit nr.9235, datë 29.7.2004 "Për kthimin dhe kompensimin e pronës", që të drëjtën e emërimit dhe shkarkimit të kryetarit dhe të anëtarëve të Komisioneve vendore ja ka lënë në kompetencë Komitetit Shtetëror të Komisionit të Kthimit të Pronave dhe jo Kryetarit të këtij Komisioni. Rekomandimi ynë lidhur me këtë praktikë administrative u mor parasysh nga Kryetari i Komitetit Shtetëror të Kthimit të Pronave, i cili në përgjigjen e tij na bëri të ditur rishikimin e vendimit të mëparshëm.

Meqë përmendëm hyrjen në fuqi të ligjit të ri "Për kthimin e kompensimin e pronës" shprehim kënaqësinë tonë, që në nenin 30 të tij, krahas çfuqizimit të akteve të ndryshme ligjore, janë çfuqizuar edhe gërma "ç" e nenit 7 dhe neni 13

i Ligjit nr. 7665, datë 21.1.1993 “Për zhvillimin e zonave që kanë përparësi turizmin”. Në muajin Tetor të vitit 2001, kemi kërkuar nga Ministria e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit, me rekomandim të bazuar në argumenta ligjorë, çfuqizimin e këtyre dy neneve, pasi ato duke ja kaluar tagrat e pronarit të trojeve në zonat me përparësi zhvillimin e turizmit, Kryetarit të Komitetit të Zhvillimit të Turizmit dhe duke cënuar rëndë të drejta të tjera të ligjshme të pronarëve, binin ndesh me Kushtetutën dhe me te gjitha aktet ndërkombëtare që sanksiononin dhe mbronin pronën private. Meqë nuk u morën iniciativat përkatëse ligjvënëse, i njëjti rekomandim është përsëritur edhe në muajin Maj të vitit 2002. Edhe këtë herë, në përgjigjen e ardhur nga Ministri i Rregullimit të Territorit dhe Turizmit, jepeshin garanci se në hartimin e një projekt ligji të ri, do të synohej përputhja e plotë e tij me Kushtetutën. Do të ishte në të mirë të të gjithëve që vullneti i mirë i organeve të administratës publike, në relacion me rekomandimet e bëra nga institucioni tonë, të konkretizohen sa më shpejt.

Marrëdhëniet tona institucionale me Komisionet e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, për periudhën që trajtojmë, kanë qënë të mira. Përgjigjet e kthyer kanë qënë brënda afateve ligjore dhe të argumentuara në shpjegimet e tyre për çdo rast. Megjithatë specifike për vitin 2004 ka qënë koha shumë e shkurtër gjatë të cilës KKK të Pronave kanë ushtruar kompetencat e tyre. Kjo ka ardhur në pjesën më të madhe, si pasojë e pezullimit të aktivitetit të tyre para hyrjes në fuqi të Ligjit nr.9235, datë 29.7.2004 (16 Shtator 2004) e në vazhdim, në pritje të daljeve të akteve nënligjore në zbatim të tij dhe riorganizimit të Komisioneve vendore, meqë anëtarëve të tyre, ligji ju ka dhënë statusin e nëpunësve civilë. Edhe shkak që 6 ankime janë mbartur për shqyrtim të mëtejshëm për në vitin 2005, ka qënë pezullimi i tyre deri në përgatitjen e kuadrit të plotë nënligjor dhe rifillimit të punës normale të Komisioneve vendore, që për shkaqe të vështirësive që mbart zgjidhja teknike e problemit të kompensimit të pronave, janë kapercyer afatet e parashikuara nga vetë ligji.

### **ç) Instituti i Integritit të të Përndjekurve Politikë (IIPP)**

Numri i ankesave ndaj Institutit të Integritit të të Përndjekurve Politikë (IIPP) është 4, nga të cilat 2 kanë rezultuar jashtë juridiksionit, 1 e pabazuar dhe 1 me heqje dore nga ana e ankuesit. Nga ankesat e mbartura nga viti 2003 kanë rezultuar 1 ankesë jashtë juridiksionit dhe 1 në favor të ankuesit.

Një nga problemet që kjo ish shtresë e persekutuar e popullsisë ka adresuar pranë Zyrës sonë dhe që e kemi parashtruar dhe në raportin e vitit 2003, është problemi i strehimit. Ekziston një kuadër ligjor për një kategori të caktuar të përndjekurish politikë të pastrehë, të cilët përfitojnë strehim falas



(VKM nr.476 datë 10.10.1994 “Për procedurat e strehimit të ish të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist”). Megjithëse ekziston një numër mjaft i madh kërkesash nga të përndjekurit që duhet të përfitojnë banesa nga shteti pranë këtij Instituti, del se nga IIPP çdo vit janë kërkuar fonde strehimi për këtë kategori personash. Por kjo gjë edhe në vitin 2004 nuk është realizuar për mungesë të fondeve nga buxheti i shtetit.

Problematika më emergjente që shtrohej për zgjidhje në disa prej ankesave të vitit të kaluar, ishte ajo e mosdhënies së dëmshpërblimit për vitet e vuajtjes në burgjet e periudhës së diktaturës komuniste. Ndërmjetësimi i Avokatit të Popullit bëri që debati të institucionalizohet dhe të unifikohet qëndrimi dhe kërkesat e të përndjekurve, duke i përfshirë palët në angazhime konkrete.

Pozitiv mund të konsiderojmë faktin se gjithçka e arritur në nivel bisedimesh mes Qeverisë dhe perfaqësuesve të shoqatave të ish të burgosurve politike shërbeu si bazë sensibilizuese për zgjidhjen konkrete dhe në terma financiare të këtij problemi, me miratimin e Ligjit nr.9260 date 15.07.2004 “Për disa shtesa e ndryshime në Ligjin nr.7748 date 29.07.1993 “Per Statusin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist” i ndryshuar. Pavarësisht nga kundërshtimet që janë shfaqur për këtë ligj, tashmë ky Ligj duhet materializuar dhe Këshilli i Ministrave siç përcaktohet në nenin 4, duhet të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të tij, pasi i ka kaluar afati 3 muajor i hyrjes në fuqi.

Një problem, i paraqitur në një numër të konsiderueshëm ankesash edhe nga viti i kaluar është ai i mospërfitimit të statusit të të përndjekurit politik. Ky problem prek rreth 200 persona që presin të fitojnë statusin e ish të përndjekurit politik, dhe që nëpërmjet statusit pretendojnë të përfitojnë të gjitha benefitet që mund të përfitohen prej zotërimit të tij. Kjo si pasojë e mosfunksionimit të Komisionit Shtetëror Trepalësh si organi kompetent për dhënien e së drejtës së Statusit të ish të Përndjekurit Politik. Ky komision ka funksionuar gjatë periudhës Nëntor 1993-Korrik 1997, më pas edhe pse ka qenë detyrim ligjor ekzistenca e tij, ky funksionim është ndërprerë.

Pra mungesa e miratimit të një Vendimi të Këshillit të Ministrave, i cili do të përcaktonte mënyrën e funksionimit të Komisionit Trepalësh për dhënien e statusit të të përndjekurit politik, ka shkaktuar privim të të drejtave të subjekteve, që pretendojnë marrjen e këtij statusi. Ndaj nga Këshilli i Ministrave duhen përshpejtuar procedurat lidhur me funksionimin e Komisionit shtetëror Tre palësh, gjë që do të zgjidhte këtë problem.

## **2. Ministria e Drejtësisë**

Gjatë vitit 2004 janë trajtuar gjithsej 391 ankesa e kërkesa që kanë të bëjnë me autoritete në juridiksionin e Ministrisë së Drejtësisë, e konkretisht me Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve dhe Zyrat e Permbarimit.

Edhe gjatë vitit 2004 bashkëpunimi me këtë ministri ka rezultuar efektiv dhe cilësor.

### **a) Ankesat për burgjet dhe administratën e burgjeve**

Në lidhje me burgjet dhe personelin e burgjeve kemi patur 177 ankesa. Burgjet janë institucione të mbyllura dhe liria në të gjitha shprehjet e saj është e kufizuar dhe mund të shkelen më lehtë të drejtat e të burgosurve. Prandaj nga ana jonë, ankesave nga këta persona ju është kushtuar dhe do t'i kushtohet vëmendje e veçantë. Gjatë vitit 2004, punonjës të stafit të Avokatit të Popullit kanë vizituar pothuajse të gjitha burgjet që janë në përdorim, si dhe dhomat e izolimit të komisarivateve të policisë në rrethe, ku qëndrojnë të burgosur, për të cilët vendimi i gjykatës ka marrë formën e prerë si dhe të paraburgosurit, që presin të gjykohen. Në fund të vitit 2004 ka patur 2321 të burgosur në burgje dhe 189 të dënuar që mbaheshin në dhomat e izolimit të komisarivateve të policisë. Po kështu kanë qënë dhe 1144 persona nën hetim në paraburgimet pranë Komisarivateve të Policisë sepse akoma nuk kishte përfunduar gjykimi i tyre. Gjithashtu në paraburgimin e Burgut 313 Tiranë dhe në paraburgimin e Vlorës, që tashmë janë nën administrimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, janë edhe 533 të paraburgosur. Pra gjithsej kanë qënë 4487 persona të privuar nga liria, nga 3200 persona që ishin në fund të vitit 2003.

Gjatë vizitave në këto institucione janë takuar personalisht 248 të dënuar apo të paraburgosur. Në 115 raste ankesat e të dënuarve janë bërë me shkrim. Gjithsej janë ankuar 177 persona, ku përfshihen të burgosur, familjarë të tyre apo personel i administratës së burgut që kanë aplikuar në zyrën tonë për çështje që lidhen me administratën gjyqësore, të prokurorisë dhe burgjeve.

Si veçori të vitit 2004 për burgjet mund të përmendim organizimin e disa inspektimeve në burgje, në dhomat e izolimit dhe në Institucionet Psikiatrike. Ky fakt tregon se nga njëri vit në tjetrin vjen duke u rritur dhe konsoliduar besimi i publikut në drejtim të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të të burgosurve, të paraburgosurve, të sëmurëve mendor etj. Në vitin 2004 të burgosurve ju është ardhur në ndihmë më mirë nëpërmjet linjës telefonike 08001111 për të bërë falas ankesat e tyre. Është verifikuar disa herë dhe ka rezultuar se ajo ka funksionuar rregullisht. Në disa raste (që janë përfshirë në numrin e përgjithshëm të ankesave) të burgosurit ankesat i kanë paraqitur

nëpërmjet telefonit që është vendosur në dispozicion të tyre. Kjo tregon për një hapje akoma më të madhe të burgjeve shqiptare dhe është një arritje në drejtimin e duhur e institucionit të Avokatit të Popullit. Telefonata ka patur edhe nga të burgosurit tanë në Greqi. Të ndarë sipas burgjeve, gjëndja e ankesave paraqitet si më poshtë:

1.Nga burgu 313	Tiranë	janë ankuar	10
2. Nga burgu 302	Tiranë	janë ankuar	9
3.Nga burgu 325	Tiranë	janë ankuar	4
4.Nga burgu i	Lushnjës	janë ankuar	16
5.Nga burgu i	Tepelenës	janë ankuar	1
6. Nga burgu i	Burrelit	janë ankuar	8
7.Nga burgu i	Vaqarrit	janë ankuar	2
8.Nga Spitali	burgjeve	janë ankuar	4
9.Nga burgu i	Rrogozhinës	janë ankuar	11
10.Nga burgu i	Krujës	janë ankuar	3
11. Nga paraburgimi		janë ankuar	17
12.Nga burgjet jashtë	vëndit	janë ankuar	3

Në këtë numër nuk janë përfshirë edhe ankesat apo kërkesat me shkrim të familjarëve të burgosurve si dhe kërkesa të tjera që janë paraqitur nga drejtoritë e burgjeve apo komisariatet e policisë në rrethe.

Të ndarë sipas gjinisë, në 126 raste kanë bërë ankesë burrat, në 5 raste gratë dhe në rastet e tjera ankesat apo kërkesat janë dërguar nga drejtoritë e burgjeve apo komisariatet e policisë në rrethe.

### **Sipas mënyrës së përfundimit ankesat paraqiten si vijon:**

Për vitin 2004 janë përfunduar 165 ankesa apo kërkesa të ardhura me shkrim, nga 177 të ardhura, ndërsa janë në shqyrtim 12 çështje. Nga 9 ankesat e mbartura nga viti 2003 në muajt e parë të vitit 2004 janë përfunduar 8, 4 prej tyre janë zgjidhur në favor, 2 jashtë juridiksioni dhe kompetence, 1 e pabazuar, 1 ka hequr dorë, 1 është akoma në shqyrtim.

Ne rastet e përfunduara të vitit 2004, 36 ose 23.5 % prej tyre janë zgjidhur në favor, 79 ose 51.5% janë jashtë juridiksioni dhe kompetence, 21 ose 13.9% janë konsideruar si të pabazuara në ligj, duke u refuzuar si të padrejta, 12 raste janë në shqyrtim.

Duke bërë grupimin sipas natyrës së ankesave rezulton:

1. *Mjaft të burgosur janë ankuar se mbahen padrejtësisht në dhomat e izolimit të komisariateve të policisë, në të njëjtën kohë kur vendimet e gjykatave kanë kohë që kanë marrë formën e prerë.*

Ata kanë pretenduar se ju është shkelur e drejta e njohur nga neni 462 i K.Pr.Penale që urdhëron ekzekutimin e menjëhershëm të vendimit të gjykatës që ka marrë formën e prerë.

Numri i ankesave të kësaj natyre për vitin që raportojmë në krahasim me vitin e 2003 është në rritje. Institucioni i Avokatit të Popullit ndërmori një proces hetimi, në përfundim të të cilit, rezultoi se ende në dhomat e izolimit pranë komisariateve të policisë në rrethe, kishte dhe vazhdon të ketë një numër jo të vogël të dënuarish. Me 31 dhjetor 2004 ndodheshin 183 të dënuar me vendim të formës së prerë në dhomat e izolimit, të cilët qëndrojnë në kundërshtim të hapur me ligjin në këto dhoma. Shkaku i qëndrimit të këtyre të burgosurve në këto ambiente është mungesa e kapaciteteve në burgje.

### **TE ARRESTUAR NE SHKALLE REPUBLIKE NE DHOMAT E IZOLIMIT NE VARTESI TE MINISTRISE SE RENDIT PUBLIK**

<b>Rrethet</b>	<b>Të arrestuar</b>	<b>Me vendim të formës së prerë</b>	<b>Të mitur</b>	<b>Gra</b>
Berat	57	17	5	
Durrës	182	11	6	1
Krujë	44	6	6	
Dibër	26	2		
Mat	31	10		
Elbasan	76	3	4	
Librazhd	10	2	1	
Gramsh	15	4		
Fier	104	22	4	
Lushnjë	61	13		
Gjirokastër	28	4	3	
Përmet	10	1		
Tepelenë	15	4		
Kukës	34	4		
Tropojë	18	6		

Korçë	87	21	4	1
Pogradec	28	8		
Lezhë	43	5	1	
Kurbin	43	6	4	
Shkodër	105	17		
Pukë	22	6		
MalësiMadhe	33	7	1	
Sarandë	24	4	2	
Tiranë	48			
<b>TOTALI</b>	<b>1144</b>	<b>183</b>	<b>41</b>	<b>2</b>

## GJENDJA DHE KAPACITETI NE BURGJE DHE PARABURGIME

Nr.	Emërtimi i Institucionit të Riedukimit dhe Burgut	Gjendja								Totali	Kapaciteti	Mbipopullim
		Burra		Gra		Të mitur		Psiqikë				
		Të dënuar	Të arrestuar	Të dënuara	Të arrestuara	Të dënuar	Të arrestuar	Burra	Gra			
1	Burgu 313 Tiranë		467		38		26			531	395	136
2	Burgu 325 Tiranë	81		57						138	140	-2
3	Burgu Vaqarr	198				22				220	150	70
4	Burgu Lushnjë	333								333	240	93
5	Burgu Burrel	172								172	145	27
6	Burgu Tepelenë	87								87	105	-18
7	Spitali i Burgjeve	22	12	2	4			55	2	97	80	17
8	Burgu 302 Tiranë	173								173	182	-9
9	Burgu Rrogozhinë	318								318	280	38
10	Inst. Veçantë Krujë	207								207	200	7
11	Paraburgimi Vlorë	1	66				2			69	46	23
12	Burgu Peqin	660								660	700	-40
<b>TOTALI</b>		<b>2252</b>	<b>545</b>	<b>59</b>	<b>42</b>	<b>22</b>	<b>28</b>	<b>55</b>	<b>2</b>	<b>3005</b>	<b>2663</b>	<b>342</b>

Për rastet konkrete të të dënuarve që bëjnë ankesat me shkrim pranë zyrës së Avokatit të Popullit, ne kemi ndërhyrë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve që ata të dërgohen sa më parë në burgje. Si rrjedhojë ata janë transferuar nga dhomat e paraburgimit për në sistemin e burgjeve.

Ashtu si edhe më parë, problemi i të dënuarve që mbahen në dhomat e izolimit pa të drejtë ka qënë dhe do të mbetet, një nga drejtimet kryesore të punës sonë deri në zgjidhjen përfundimtare të tij.

Në takimet me drejtuesit e Ministrisë së Rendit Publik dhe atyre të Ministrisë së Drejtësisë në vazhdimësi është kërkuar që të pëfundojë kalimi gradual i dhomave të izolimit në vartësi të Ministrisë së Drejtësisë, deri në zgjidhjen përfundimtare të këtij problemi. Kështu në takimin e muajit Prill të vitit 2002, drejtuesit e Ministrisë së Rendit dhe Ministrisë së Drejtësisë u angazhuan se do të merrnin masa për zgjidhjen përfundimtare të problemit. Ky problem është ndjekur në vazhdimësi, duke bërë presion mbi Administratën e Burgjeve deri sa Qeveria nxorri vendimin nr 327, datë 15.05.2003, për kalimin e sistemit të paraburgimit në vartësi të Ministrisë së Drejtësisë.

Zyra jonë është duke e ndjekur këtë problem mbasi deri tani, faktikisht kanë kaluar pjesërisht në vartësi të Ministrisë së Drejtësisë vetëm dhomat e izolimit në Vlorë.

Ne mendojmë se ka edhe rrugë të tjera për zgjidhjen e këtij problemi kaq delikat. Problemi i mbipopullimit të burgjeve nuk mund të zgjidhet vetëm duke ndërtuar burgje të reja. Më shumë rëndësi duhet t'i jepet në radhë të parë punës parandaluese që duhet të bëjë gjithë shoqëria dhe shteti Shqiptar, dhe së dyti prokuroritë dhe gjykatat duhet të bëjnë një politikë më të drejtë në zbatimin e masave alternative të dënimit. Ne duhet të jemi më racionalë, jo çdo gjë duhet të zgjidhet me burg. Kufizimi i lirisë është një masë ekstreme, e cila duhet të jepet dhe të përdoret vetëm nëse masa të tjera alternative do të ishin pa vënd për shkak të rrezikshmërisë së krimit të kryer dhe autorit. Këto janë rekomandime të përsëritura jo vetëm të Avokatit të Popullit, por edhe të organizmave ndërkombëtare që merren me këto probleme.

**INFORMACION MBI GJENDJEN DHE PËRBËRJEN E TË DENUARVE NE DHJETOR 2004**

Emërtimi	Nën 18 vjeç	18-25 vjeç	26-45 vjeç	46-60 vjeç	Mbi 60 vjeç	Tot	Vjedhje me dhunë	Vjedhje	Vrasje	Plagosje	Marredhëni e Seksuale	K/vajtje	Droga	Të tjera	0-1 vjet	1-2 vjet	2-5 vjet	5-15 vjet	16-25 vjet	Përfjetshëm	Aktiv punë
Burgu 313	1	1	3	1		6	2						4			1	4	1			5
I.R.325 (B)		21	40	6	15	82	6	9	20	6	4	4	8	25	9	19	19	25	10		25
I.R.325(G)		24	25	9	1	59		6	38	2	1	1	1	10		4	25	22	8		24
I.R.Lushnjë		98	201	31	4	334	78	23	127	8	7	1	64	26	3	7	36	174	114		89
B. Burrel		40	104	19	10	137	51		112		1		3	6	1	3		76	72	21	31
B. Tepelenë		14	59	12	1	86	9		65		4		1	7				21	38	27	10
B. Vaqarr	21	54	129	19		223	59	9	99	4	15		30	7		11	41	133	38		27
B. 302		20	133	16	6	175	26		107	1	3		2	36			2	63	79	31	17
B. Rrogizhinë		103	192	18	3	316	85	27	108	6	27		43	20	2	8	57	219	30		87
B. Kruje		32	100	43	36	211	15	29	127	4	12	2	13	9	2		35	132	42		35
B. Peqin		242	312	96	6	656	281	143	154	8	21		35	14	7	18	176	344	103		8 109
<b>Shuma</b>	<b>22</b>	<b>649</b>	<b>1298</b>	<b>270</b>	<b>82</b>	<b>2321</b>	<b>610</b>	<b>248</b>	<b>957</b>	<b>39</b>	<b>95</b>	<b>8</b>	<b>204</b>	<b>160</b>	<b>24</b>	<b>71</b>	<b>395</b>	<b>1210</b>	<b>534</b>	<b>87</b>	<b>372</b>

## *2. Të sëmure mendore që mbahen ende padrejtësisht në spitalin e burgut.*

Edhe në vitin 2004, problemi i personave për të cilët gjykata ka marrë masën mjeksore të mjekimit të detyruar nuk ka marrë ende zgjidhje. Gjatë vitit 2004 institucioni i Avokatit të Popullit organizoi një inspektim në Spitalin e Burgjeve për të parë gjëndjen e të sëmurëve mendore për të cilët gjykatat kanë marrë masën mjeksore të mjekimit të detyruar dhe padrejtësisht mbahen në kushte burgimi. Nga inspektimi doli se këta persona ndonëse nuk janë të denuar, mbahen ende brënda sistemit të burgjeve. Nga hetimet e ndërmara nga ana jonë, veç të tjerash pengesë për zgjidhjen përfundimtare të këtij problemi rezultoi se ishte edhe mosplotësimi nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Ministrisë së Drejtësisë të akteve nënligjore për ruajtjen e këtyre personave. Për këtë kemi kërkuar zbatimin e rekomandimit të bërë me datën 13.05.2002 për plotësimin e kërkesave të ligjit nr.8092 dt.03.02.1996 “Për Shëndetin Mendor” për të nxjerrë rregulloren “Për masat e sigurimit të personave për të cilët gjykata ka marrë masën mjeksore të mjekimit të detyruar”, drejtuar *Ministrit të Drejtësisë, Ministrit të Shëndetësisë dhe për dijeni ish Kryeministrit të Republikës së Shqipërisë, zotit Pandeli Majko. Me urdhër të Ministrit të Drejtësisë një pjesë e Spitalit të Burgjeve është dhënë për trajtimin e të sëmurëve mendore për të cilët gjykata ka urdhëruar mjekimin e tyre të detyrueshëm. Megjithatë, kjo është një zgjidhje e përkohshme sepse ato duhet të trajtohen në përputhje me ligjin nr.8092 dt.03.02.1996 “Për Shëndetin Mendor”.*

Pra ky ligj përcakton detyrimin e Ministrit të Drejtësisë, Ministrit të Shëndetësisë dhe Ministrit të Mjedisit për të miratuar rregulloren e masave të sigurimit për personat që kanë kryer një vepër penale dhe është vendosur nga gjykata mjekimi i detyrueshëm në institucione psikiatrike. Por megjithëse kanë kaluar rreth 8 vjet nga dita kur ka hyrë në fuqi ligji “Për shëndetin mendor”, një rregullore e tillë ende nuk ka dalë. Aktualisht të gjithë të denuarit me mjekim të detyruar qëndrojnë në kundërshtim flagrant me ligjin në një pjesë të Spitalit të Burgjeve. Ky qëndrim ka sjellë moszbatimin e nenit 28 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, që përcakton se çdo person i tillë ka të drejtën e trajtimit njerëzor dhe të respektimit të dinjitetit të tij dhe ka lënë shteg për të abuzuar në drejtim të kërkesave ligjore për të drejtat e liritë e këtyre personave, duke i dëmtuar edhe më tepër nga ana mendore.

Në përgjigje të këtij rekomandimi Ministria e Shëndetësisë e ka quajtur të zgjidhur problemin me kalimin kapital që ka bërë të godinës së Spitalit të Krujës në vartësi të Ministrisë së Drejtësisë. Kurse Ministria e Drejtësisë në përgjigje të këtij rekomandimi kishte marrë angazhimin se me hapjen e Burgut të Krujës do të fillojë së funksionuari edhe rregullorja e kërkuar nga ana jonë.



Në realitet Burgu i Krujes ka filluar nga aktiviteti, por funksionon përsëri si burg dhe jo si institut mjekësor që të sistemohen personat e sipërpërmendur. Në kushtet kur ligji ndalon sistemimin e këtyre personave brenda sistemit të burgjeve nuk duhet marrë në konsideratë pretendimi i sistemimit tyre në këtë burg. Gjatë vitit 2004 zyra jonë ka insistuar pranë të dy ministrive për nxjerrjen e rregullores dhe përcaktimin e vendit ku do të shkojnë këta persona, por ende nuk është miratuar as rregullorja dhe as vendi i trajtimit tyre.

Ne mendojmë se nuk ka munguar vullneti i Qeverisë për zgjidhjen e këtij problemi. Këtë konkluzion e nxjerrim duke parë angazhimin e Kryeministrit që në muajin Qershor 2003 urdhëroi ngritjen e një grupi pune për të bërë propozimet konkrete për zgjidhjen e këtij problemi. Kohët e fundit së bashku me Ministrinë e Drejtësisë ne jemi bërë bashkëautorët e një projekti për zgjidhjen e këtij problemi duke i propozuar Kryeministrit mënyrat e zgjidhjes.

Edhe për të ardhmen sistemimi i këtyre personave, ashtu siç është përcaktuar në ligj, do të jetë një nga përparesitë e punës sonë.

### *3. Ushtrim dhune dhe shkelje të tjera nga Policia e burgjeve*

Pas miratimit nga Kuvendi të ligjit nr.9071 datë 22.05.2003”Për një ndryshim në ligjin nr.8328 datë 16.04.1998 ”Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”, Avokati i Popullit ka të drejtën për të bërë pa autorizim vizita dhe inspektime në burgje. Në zbatim të këtij ligji Avokati i Popullit organizoi një inspektim në Burgun e Sigurisë së Lartë 302 Tiranë nga dt.05.10.2004 deri me dt.06.10.2004. Ky inspektim u organizua me iniciativën e Avokatit të Popullit për shkak të të dhënave që dispononte Institucioni i ynë se në këtë burg përdorej dhunë nga ana e policisë së burgut. Pas një inspektimi të hollësishëm doli se kishte patur raste edhe për përdorim të dhunës nga ana e policisë së këtij burgu, siç ishte rasti i të denuarit E.M. Për këtë rast është mbledhur menjëherë drejtoria e burgut dhe ka dhënë “vrejte me paralajmërim për lirim nga detyra”, për tre punonjës të policisë të rolit bazë. Konstatimet tona ju bënë prezent Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve dhe Ministrit të Drejtësisë.

Ankesa për keqtrajtime nga policia e Burgjeve pranë zyrës së Avokatit të Popullit kanë bërë edhe të denuarit V. H. dhe M. Ç. nga Burgu i Burrelit. Ankesat e tyre janë verifikuar nga zyra jonë dhe ka rezultuar se ishin të pabazuara. Me miratimin e të drejtës së Avokatit të Popullit për të bërë vizita në burgje pa autorizim, si dhe për të organizuar inspektime në burgje është krijuar një mundësi shumë më efektive për mbrojtje të të drejtave dhe lirive të të dënuarve. Praktika e inspektimeve do të bëhet më e shpeshtë në të ardhmen, pavarësisht nga pengesat që po na nxirren nga ana e Ministrisë së Drejtësisë që

nuk lejon ndihmës komisionerët të futen në burgje edhe kur kanë autorizim nga Avokati i Popullit.

#### *4. Kërkesa të të burgosurve kundër vendimeve të gjykatave*

Edhe gjatë vitit 2004 në zyrën tonë kanë vazhduar të vijnë ankesa të të dënuarve kundër vendimeve të gjykatave të cilat i kanë deklaruar ata fajtorë. Në ankesat e tyre ata pretendojnë se nuk janë fajtorë për veprat për të cilat janë dënuar, sepse gjykatat nuk kanë vlerësuar drejt provat në ngarkim të tyre. Numri i këtyre ankesave për vitin 2004 është 79. Pavarësisht se Avokati i Popullit në bazë të ligjit nuk ka në juridiksion shqyrtimin e vendimeve të gjykatës, në të gjitha këto raste nga ana jonë ankuesve ju është treguar rruga që ata duhet të ndjekin për të realizuar të drejtën e pretenduar prej tyre, me kërkesë për rishikimin e vendimit pranë Gjykatës së Lartë

#### *5. Grevat e urisë*

Avokati i Popullit në disa raste që është vënë në dijeni nga media apo nga administrata e burgjeve për hyrjen në greva urie të të dënuarve, ka qenë ndermjetës midis administratës dhe të burgosurve. Në dy nga këto raste, ndërhyrja e Avokatit të Popullit ka qenë e suksesshme sepse të dënuarit kanë ndërprerë grevën e urisë, pasi ju janë plotësuar më parë ato kërkesa për të cilat kanë patur të drejtë. Ndërsa, në rastet kur ata kanë përdorur këtë mjet si presion për ndryshimin e vendimit të gjykatës, ju është bërë e qartë se ankesa nuk ishte në juridiksionin tonë dhe se çështja nuk zgjidhej me grevë urie, por duke apeluar në organet më të larta të gjyqësorit.

#### *6. Ankesa për transferime të padrejta nga një burg në tjetrin*

Në 4 raste të dënuarit janë ankuar për transferime të padrejta ose kanë kërkuar të transferohen nga njëri burg në tjetrin në zbatim të nenit 31 të Ligjit Nr.8328 dt.16.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim” ku thuhet: *“duhet të favorizohet kriteri i caktimit të të dënuarve në institucione pranë vendbanimit të familjeve të tyre.* Në të gjitha rastet që të dënuarit janë ankuar se ndaj tyre nuk është respektuar kriteri i caktimit të tyre në institucione pranë vendbanimit të familjeve të tyre, pas ndërhyrjes së zyrës tonë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve është bërë e mundur transferimi i tyre.

Nga verifikimet tona është vërtetuar se në disa raste si p.sh. që i përket të burgosurit A. G. transferimi i tyre nga një burg në tjetrin është bërë në kundërshtim me kriteret ligjore Avokati Popullit nëpërmjet rekomandimit në këto raste ka kërkuar anulimin e urdhrave të transferimit. Kërkesa jonë është

quajtur e drejtë dhe nga Drejtoria e Përgjithme e Burgjeve është vendosur transferimi i tyre në një burg afër vendbanimit të të familjeve të tyre.

#### *7. Ankesa të të dënuarve të ekstraduar nga Greqia që vuajnë dënimin në burgjet shqiptare*

Pas marrjes dijeni nëpërmjet shtypit për grevën e urisë e të gjithë të dënuarve të transferuar nga Greqia për të vuajtur dënimin në Shqipëri në vitin 2004, një grup i stafit të Avokatit të Popullit mori takim një për një me secilin të dënuar, duke dëgjuar me kujdes ankesat e paraqitura prej tyre. Takime të tilla janë bërë më të dënuarit që vuanin dënimin në Burgun e Rrogozhinës, në Burgun e Vaqarit, në Burgun e Lushnjës dhe atë të Peqinit. Vetë Avokati i Popullit bashkë me disa deputetë të Komisionit Parlamentar të të Drejtave të Njeriut ka takuar këta të burgosur në Burgun e Lushnjës.

Nga takimet ka rezultuar se këta të burgosur ndonëse i kishin kaluar të gjitha shkallët e gjyqimit në Greqi, pretendonin se ishin dënuar padrejtësisht ose se janë dënuar me masa denimi shumë të rënda për shkak se se janë shqiptarë.

Ata janë sqaruar se vendimet e gjykatës greke janë jashtë juridiksionit të zyrës sonë dhe se shqyrtimi i këtyre vendimeve nga gjykatat tona nuk mund të bëhet. Disa vendime unifikuese të Gjykatës së Lartë i ndalojnë gjykatat që të marrin në shqyrtim vendimet e dhëna nga gjykatat greke.

Ky problem është duke u ndjekur në kuadrin e hetimit të rastit që ka filluar me inisiativë zyra jonë, ku pretendohet që gruaja që është paraqitur para gjykatës greke si përkthyes nuk di fare gjuhën shqipe.

Gjithashtu, zyra jonë ka tërhequr nga burgjet të gjitha vendimet e të gjithë të dënuarve në Greqi dhe që aktualisht vuajnë dënimin në Shqipëri për shqyrtimin rast pas rasti nëse pretendimet e tyre kanë bazë ligjore. Në këtë çështje bashkëpunimi me Ministrinë e Drejtësisë dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve ka qënë shumë i mirë, por ka pengesë se nga Greqia na janë dërguar ekstrakte të vendimeve të Gjykatave të Apelit dhe jo vendime të gjykatave të shkallës së parë, nga ku mund të mësohet më shumë rreth pretendimeve të të dënuarve.

#### *8. Ankesa të familjarëve të shtetasve shqiptarë që vuajnë dënimin në burgjet e shteteve të tjera*

Për vitin 2004 ka patur 4 ankesa nga të dënuar dhe familjarë të tyre, me anën e të cilave ata kanë pretenduar se ndaj të afërmeve të tyre në burgjet në Itali dhe Greqi përdoret dhunë, se ata nuk kanë asnjë dijeni për shkaqet e burgosjes së fëmijve të tyre etj.

Duke qënë se këto ankesa janë jashtë juridiksionit tonë, 2 prej tyre, ja kemi dërguar Drejtorisë Konsullore pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës së Shqipërisë, që nëpërmjet zyrave tona konsullore në këto shtete, të japin ndihmesën e tyre në bazë të ligjit nr.8372 datë 09.07.1998 “Për ushtrimin e funksioneve konsullore nga përfaqësitë diplomatike apo konsullore”. Në një rast, atë të shtetasit Y.K i jemi drejtuar Ambasadës tonë në Bernë. Ndërsa për ankesën e shtetasit A. N pas kërkesës tonë për shpjegime drejtuar Ministrisë së Drejtësisë është bërë transferimi i tij nga burgu në Itali për të vuajtur denimin në burgjet shqiptare.

Angazhimi ynë për realizimin e një projekti për të pajisur të gjithë të burgosurit shqiptarë jashtë vëndit me një broshurë në gjuhën Shqipe, të quajtur “Akte ligjore në ndihmë të të burgosurve jashtë Shqipërisë”, tashmë është përfunduar.

Nga analiza e ankesave dhe kërkesave të të burgosurve që ndodhen në burgje dhe në dhomat e izolimit pranë komisariateve të policisë, del se gjatë vitit 2005, veprimtaria e Institucionit të Avokatit të Popullit duhet të synojë në realizimin e rekomandimeve kryesore për Qeverinë, për Ministrinë e Drejtësisë që ka në vartësi Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve dhe për Ministrinë e Rendit dhe konkretisht:

1. Shpejtimin e procedurave për marrjen në dorëzim nga Ministria e Drejtësisë të dhomave të izolimit në të gjithë vëndin.

2. Sistemimin në një institut mjekësor të personave për të cilët gjykata ka vendosur mjekimin e detyruar, ashtu siç kërkon ligji.

3. Mbi bazën e ankesave të të burgosurve, duke parë se në disa raste vetë ligji ishte bërë shkak për shkeljen e disa të drejtave të të burgosurve, mbështetur në ligjin për Avokatin e Popullit, kemi bërë edhe rekomandime për ndryshimin e akteve ligjore që lidhen me të drejtat e të burgosurve. Konkretisht të dënuarve që janë mbajtur në qelitë e paraburgimit nuk ju njihet dhe nuk ju llogaritet kjo kohë si paraburgim. Shkaku i shkeljes së të drejtës së të paraburgosurve është bërë neni 7 i ligjit nr.7941, datë 27.01.1995, “Për Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë, i cili përcakton se: “Me paraburgim do të kuptojmë ditët e qëndruara në ndalim dhe arrestim në burg. Kur arrestimi nuk është ndërprerë, periudha e paraburgimit do të konsiderohet nga dita e ndalimit, derisa vendimi i gjykatës ka marrë formën e prerë”.

Gjithashtu duke parë se një pjese të madhe të të dënuarve nuk ju sigurohet e drejta për të votuar në zgjedhjet për pushtetin vendor, Zyra jonë i ka dërguar komisionit bipartizan rekomandimin për plotesimin e Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë.

Sipas konfirmimeve verbale dhe ndryshimeve të miratuara, Komisioni bipartizan për reformën zgjedhore gjatë vitit 2004 nuk e ka marrë në konsideratë

rekomandimin tonë duke ju mohuar të drejtën për të zgjedhur të dënuarve, kur do të zhvillohen zgjedhjet vendore të radhës.

4. Gjithashtu i kemi ridërguar Ministrisë së Drejtësisë rekomandimet e mëposhtëme, për të cilat ndonëse kemi marrë përgjigje se janë pranuar si të drejta, në realitet nga ana e kësaj Ministrie nuk janë bërë hapa konkrete për vënien në zbatim të angazhimeve të marra:

- a) Rekomandim për plotësimin e kërkesave të ligjit nr.8328 dt.16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim.”

Megjithëse kanë kaluar më se 6 vjet nga dita kur ka hyrë në fuqi ligji “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”, gjithë të burgosurit që punojnë në burgje, marrin një shpërblim simbolik 90 lekë në muaj. Për çdo një muaj pune deri tani përfitonin 4 ditë burgim. Por me Urdhër të Prokurorit të Përgjithshëm me Nr.3223 Prot. të dt.08.10.2004, është urdhëruar që të gjithë të dënuarve që kanë përfituar ditë burgu nëpërmjet punës t’ju hiqen. Kjo çështje po ndiqet nga ana jonë .

- b. Rekomandim për krijimin e kushteve të nevojshme për funksionimin e Komisionit Mbikqyrës të Ekzekutimit të Vendimeve me Burgim, sipas kreut të tretë të ligjit nr.8331 datë 21.04.1998 “Për ekzekutimin e Vendimeve Penale”.

Nga shqyrtimi i çështjes prej zyrës sonë rezulton se ngritja e këtij komisioni ka përfunduar dhe se është miratuar vendimi për shpërblimin e antarëve të këtij komisioni, por Komisioni me sa jemi në dijeni nuk ka filluar të funksionojë akoma.

Institucioni i Avokatit të Popullit mbetet ne pritje të zbatimit të rekomandimeve të sipërpërmendura, të cilat sipas Ministrisë së Drejtësisë do të jenë pjesë e një pakete të re ligjore që po përgatitet të miratohet për të gjithë legjislacionin që ka të bëjë me të dënuarit.

## **b) Ankesat për Zyrat e Përmbartimit**

Edhe për vitin 2004 problemet lidhur me zvarritjet në ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, nga Zyrat e Përmbartimit në rrethe, kanë zenë një përqindje jo të vogël në ankesat e drejtuara institucionit tonë. Kështu për vitin 2004 janë regjistruar 121 ankesa nga kreditorë të ndryshëm, 30 më pak se në vitin 2003. Në totalin e përgjithshëm të të gjithë ankesave, zënë rreth 7% të tyre. Pretendimet për të drejtat e shkeluara, në shumicën dërrmuese, kanë të bëjnë me zvarritje nga Zyrat e Përmbartimit në ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Ndërsa pjesa tjetër ka si shqetësim kundërshtimet ndaj veprimeve, mosveprimeve dhe vendimeve të përmbartuesve gjyqësorë gjatë

proçesit të ekzekutimit të detyrueshëm të titujve ekzekutivë. Nga këto janë përfunduar 65 çështje, nga të cilat 12 ankime, baraz me rreth 20% të tyre, janë zgjidhur në favor të ankuesve. Ndërsa pjesa tjetër, 56 ankesa, kanë kalur për vazhdimin e shqyrtimit në viti 2005.

Gjithashtu, nga viti 2003 kanë qënë të mbartura edhe 71 çështje të të njëjtës natyrë. Nga to kanë përfunduar 67, njëra zgjidhur pozitivisht, dhe 4 janë mbartur për vitin 2005, për faktin se jemi në pritje të reagimit të debitorëve buxhetorë ndaj rekomandimeve tona për ekzekutimin e titujve ekzekutivë që nuk kanë të bëjnë me kthim shumash. Ankesat e tjera kanë rezultuar te pabazuara, për pamundësi ekzekutimi për arsye ligjore, si vendime të Gjykatës së Lartë për pezullim të ekzekutimit të titujve ekzekutivë. Shumë prej tyre kanë qënë jashtë juridiksionit, pasi kishin të bënin me ankime kundër vendimeve të pezullimit dhe pushimit të çështjes nga përmbaruesi gjyqësor. Për këto vendime ju është sugjeruar gjyqfituesve që të ankohen në gjykatën kompetente në bazë të nenit 617 të Kodit të Proçedurave Civile.

Ankesat janë thuajse për te gjitha Zyrat e Përmbarimit, por me te shumta janë për Zyrat e Përmbarimit Tiranë, Shkodër dhe Korçë, Vlorë, Durrës, Lezhë dhe Kukës. Nga keto Zyra rezulton, se me shume çështje përmbarimore pas ndërhyrjes tonë, janë përfunduar në Zyrën e Përmbarimit Tiranë. Statistikat tona tregojnë se kjo Zyrë ka edhe një pjesë tepër të madhe të praktikave të të gjithë sherbimit Përmbarimor në rang vëndi. Në marrëdhënie me Avokatin e Popullit kjo Zyrë, së bashku me atë të rrethit Lezhë, kërkesave tona ju përgjigjen brënda afateve të kërkuara dhe të shoqëruara edhe me kopjet e akteve dhe veprimeve proçeduriale përmbarimore të kryera. Më pas renditen për sa u takon çështjeve të ekzekutuara, pas kërkesave të institucionit tonë, Zyrat e Përmbarimit Tepelenë, Durrës, Sarandë, Pogradec, Përmet dhe Kolonjë. Ndërsa nga Zyra e Përmbarimit Tropojë kemi shumë pak përgjigje dhe ato me shumë vonesë.

Një pjesë e konsiderueshme e ankimeve, siç u përmend pak më lart, ka të bëjë me mos ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë nga debitorët institucione buxhetore që janë detyruar për kthim shumash monetare të caktuara. Ky problem që po mbartet nga viti në vit, thuajse me të njëjtën vlerë debiti, mendojmë se përbën shqetësimin kryesor si për Shërbimin Përmbarimor, ashtu edhe për institucionin e Avokatit të Popullit dhe veçanërisht për protagonistët kryesorë, gjyqfituesit, të cilët nuk po mund ta realizojnë të drejtën e fituar në rrugë gjyqësore. Edhe Konferenca Kombëtare me temë “Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë në mbrojtje të të drejtave të njeriut”, organizuar në 19 Dhjetor të vitit 2003, në bashkëpunim me Komitetin Shqiptar të Helsinkit, një nga qëllimet kryesore kishte edhe ndërgjegjësimin e segmenteve të administratës qëndrore dhe vendore për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formes së prerë, në zbatim të pikës 3 të nenit 142 të

Kushtetutës, siç duket ka sjellë me pak rezultat konkrete sesa pritej. Në fund të muajit Shtator 2004, në kuadrin e bashkëpunimit të institucionit tonë me organet përmbare, kemi kërkuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Përmbaremit në Ministrinë e Drejtësisë, të dhëna rreth problemeve që ndeshet ky shërbim gjatë procesit të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë me debitorët institucione buxhetorë. Nga të dhënat e dërguara nga Drejtori i Përgjithshëm i këtij Shërbimi, zotit Tedi Malaveci, për te cilën gjej rastin për ta falenderuar, rezulton se në të gjitha Zyrat e Përmbaremit në rrethe, për 6 mujorin e parë të vitit 2004, ishin të regjistruara 364 çështje përmbaremit të papërfunduara, me shumën e përgjithshme ndaj debitorëve buxhetorë prej 513.944.034 lekësh ose 4.178.407 eurosh ose 5.139.440 dollarësh. Megjithëse çdo vit shifrat e buxhetit janë rritur për këtë zë, duhet bërë e mundur që kjo çështje të zgjidhet një herë e mirë nga vetë Kuvëndi.

Treguesit janë tepër domethënës. Mendojmë se ka ardhur koha për institucionet që administrojnë financat shtetërore, që të ballafaqohen me këtë realitet, të mbajnë përgjegjësitë që ju takojnë dhe të punojnë për zbutjen e problemit me mundësitë reale financiare të disponueshme. Po ashtu i duhet kushtuar vëmendje forcimit të ndjenjës së përgjegjësisë së administratorëve shtetërore në raport me ligjin, që në veprimtarinë e tyre të përditëshme në marrëdhënie me individët, të jenë të kujdeshëm në raporte të tilla të ndjeshme, si në respektimin e pronës private, të marrëdhënieve të punës, të interesave të tjera të ligjshme të individëve, pasi cënimi i tyre pa të drejtë, çon në detyrime të larta dhe rëndime të buxhetit të shtetit.

Po ashtu, duhet të përmend faktin se në shumë raste, nëpunës të zgjedhur apo të emëruar, nuk pranojnë të ekzekutojnë vendimet gjyqësore të formës së prerë për shkak të konceptit të gabuar që kanë për këto vendime, për mangësi të formimit të tyre juridik në parametra minimalë dhe mungesa e vullnetit për ta kërkuar asistencën e duhur ligjore nga Zyrat e tyre Juridike edhe juristet që ju ka vene shteti në dispozicion. Nuk ka si shpjegohen ndryshe, përgjigje të tilla të titullarëve të institucioneve apo të organeve kolegjiale të zgjedhura, kundrejt rekomandimeve tona për t'i ekzekutuar vendimet gjyqësore të formës së prerë, si: “vendimi gjyqësor të miratohet në mbledhjen e këshillit të komunës”, apo “...nga prefekti”, ose në rastin e një vendimi për rimarrjen në punën e mëparëshme nga punëmarësi institucion buxhetor dhe pagimin e pagës për periudhën e caktuar, kreditori buxhetor përgjigjet: “...zoti X (gjyqfituesi) të bëjë kërkesë me shkrim për ripunësim për të parë nëse plotëson kriteret e vendosura” e të tjera si këto. Qëndrime të tilla ulin besimin e shtetasve ndaj organeve dhe nëpunësve të administratës, cënojnë reputacionin e shkallën e besueshmërisë të sistemit tonë të drejtësisë, brënda dhe jashtë vëndit, pjesë integrale e të cilës është edhe ekzekutimi përfundimtar i asaj të drejte që fitohet në rrugë gjyqësore.

Në raportin tonë të vitit 2003, përmendej rasti i Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, që pavarësisht rekomandimeve tona, vazhdonte të mos ekzekutonte një vendim gjyqësor të formës së prerë për rikthimin në punë të shtetasit A.B. Në vitin 2004, me insistimin tonë të vazhdueshëm, informojmë se titulli ekzekutiv u ekzekutua më në fund në favor të ankuesit. Rast tipik në argumentim të faktit të hezitimit të organeve shtetërore për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, është edhe ai për mos ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë që i ka dhene mandatin e këshilltarit për në këshillin e Qarkut Elbasan përfaqësuesit të një subjekti politik të tij. Pas disa muajsh dhe një serie kërkesash dhe përsëritje të rekomandimit u arrit që organi kolegjal i zgjedhur ta pranonte anëtarin e ri me të gjitha atributet që i jep ligji, duke larguar përfaqësuesin e subjektit tjetër politik.

Në Nëntor 2004 u gjykua nga Gjykata e të Drejtave të Njeriut në Strasburg, ankimi i parë, ngritur nga subjekti shqiptar “Qufaj Co sh.p.k.” ku objekti i shqyrtimit ishte mos ekzekutimi i një vendimi gjyqësor të formës së prerë nga Bashkia e Tiranës që nga viti 1996. Duke e vlerësuar mos ekzekutimin e titullit ekzekutiv, si shkelje të të drejtave të njeriut Gjykata Evropiane, theksoi që refuzimi i autoriteteve bashkiake të Tiranës për të paguar dëmshpërblimin prej 60 milion lekësh, në bazë të vendimit të drejtësisë shqiptare, bie ndesh me nenin 6 (1) të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Në vendimin përfundimtar të gjykatës, thuhet se ekzekutimi i një vendimi gjyqësor është pjesë integrale e drejtësisë. “Asgjë, as mungesa e fondeve nga ana e autoriteteve nuk e justifikon mosrespektimin e një vendimi gjyqësor” thuhet shprehimisht në vendimin e Gjykatës Evropiane.

Një problem tjetër që duhet prekur, është edhe niveli i ulët i cilësisë së veprimeve të përmbareshve gjyqësore, bazuar në kërkesat e kapitullit përkatës të Kodit të Proçedurës Civile. Në shumë raste, gjatë verifikimeve të ankesave me dosjet përmbareshve, rezulton se ka veprime ose mos veprime, që janë tregues të mangësive të formimit profesional, pavarësisht shkakut apo motivit konkret, si: mungesë e njohjes së legjislacionit civil dhe atij proçedural civil, keq interpretim të dispozitivit të vendimit gjyqësor, nënvleftësim, harresë, ngutje, etj. Zyra e Përmbareshve Sarandë, në praktikën përmbareshve që i takonte një debitori person juridik, e ka ekzekutuar detyrimin ndaj kreditorit, me sekuestrimin e pronës private të njerit prej bashkëpronarëve debitorë. I rekomanduam Zyrës përkatëse, të ndiqte proçedurat ligjore për heqjen e sekuestros në këtë rast, pasi ishte vepruar në keq interpretim të titullit ekzekutiv, duke cënuar pa të drejtë pronën private të një personi që nuk ishte debitor. Në shumë raste të tjera, vendimet e pezullimit të çështjes të përmbareshve gjyqësor nuk janë rrjedhim i kryerjes të të gjitha veprimeve që e justifikojnë këtë vendim. Për shëmbull, në dosje mungojnë shkresat për kërkim pasurie drejtuar organeve



të tilla që disponojnë këto të dhëna, si për pasuritë e lujtshme dhe të palujtshme; nuk janë bërë kërkime dhe nuk janë kërkuar të dhëna për vënd banimet e debitorëve, etj. Për të mos përmëndur faktin se rrallë vendosen sanksionet e parashikuara në nenin 606 të KPrC, apo të bëhet kallzim penal në organin e akuzës për personat që pengojnë ekzekutimin e titujve ekzekutivë. Kjo ka ndodhur p.sh. në çështjen që i takon kreditorës Ll. N. ku përmbaruesi gjyqësor nuk kishte marrë vendim në rastet kur debitori haptazi ka refuzuar të ekzekutojë vullnetarisht titullin ekzekutiv, që u realizua vetëm pas rekomandimit të bërë

Ka zvarritje të pamotivuara në ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë në lirimin e banesave, të tokave të zëna forcërisht dhe të dorëzimit të fëmijëve njerit prind sipas datave të vendimit gjyqësor. Tipike janë zvarritjet në ekzekutimin e një vendimi të tillë për lirim banese, nga Zyra e Përmbarimit Kukës, në favor të kreditorit A. B. Ai është një i sëmurë psiçik me kartelë, që jeton në kushtet e mjerimit dhe të mungesës së përkrahjes me nënën e tij plakë, që edhe e përfaqëson. Ndërsa ankimi tjetër i të njëjtës natyrë, për lirim objekti, që i takonte shtetasit Xh.H., me ndërhyrjen tonë u ekzekutua nga Zyra e Përmbarimit Tiranë.

Megjithatë për hir të së vërtetës duhet pranuar, se Shërbimi Përmbarimor ka arritje të dukshme nga viti në vit. Kjo edhe si rezultat i plotësimeve me akte normative në funksion të ushtrimit të veprimtarisë, por edhe të rritjes së nivelit të kontrollit nga Drejtoria e Pergjithshme dhe kriterëve të vendosura për matjen e punës së çdo përmbaruesi, gjë që ka çuar në largimin nga shërbimi të një numri jo të vogël përmbaruesisht.

Institucioni i Avokatit të Popullit edhe në të ardhmen do t'i kushtojë vëmëndjen e duhur problemeve të përmbarimit gjyqësor në rastet e konstatimeve të veprimeve apo mosveprimeve që cënojnë të drejtat dhe interesat e ligjshme të palëve në procesin gjyqësor.

### **3. Ankesat për pushtetin gjyqësor dhe administratën gjyqësore**

Institucioni i Avokatit të Popullit bashkë me gjykatat janë dy institucionet më të rëndësishme për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore. Ndihma e institucionit të Avokatit të Popullit i cili është jashtë gjyqësorit, luan një rol të rëndësishëm për rritjen e efikasitetit dhe besimit të publikut tek gjyqësori.

Pas Kushtetutës dhe ligjit “Për Avokatin e Popullit, juridiksioni i Avokatit të Popullit në lidhje me gjyqësorin është i tillë që as prek dhe as rrezikon pavarësinë e gjyqtarëve në dhënien e vendimeve gjyqësore.

Nga praktika jonë disa vjeçare del se ne kemi patur mirëkuptim me gjyqësorin. Edhe në të ardhmen marrëdhëniet tona do vazhdojnë që të jenë korrekte. Kjo sepse të gjithë jemi të interesuar që të realizohen e respektohen me përpikmëri të drejtat dhe liritë themelore të njeriut.

Avokati i Popullit me punën e tij gjatë trajtimit të ankesave dhe kërkesave ka dhënë ndihmën e duhur në punën e gjykatave, duke njoftuar Ministrin e Drejtësisë apo Inspektoriatin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë për shkelje proceduriale të konstatuara nga gjyqtarë të veçantë si dhe shkelje nga administrata e gjykatave.

Gjithashtu, Avokati i Popullit ndihmon edhe duke kërkuar që administrata shtetërore të zbatojë patjetër vendimet gjyqësore kur ato kanë marrë formë të prerë. Në këtë mënyrë ne ndihmojmë që të rritet autoriteti i pushtetit gjyqësor ndaj degës së ekzekutivit, e cila ka treguar dhe vazhdon të tregojë me qëndrimet e saj se nëvleftëson fuqinë e vendimeve gjyqësore duke i bërë në këtë mënyrë një dëm të madh moral dhe ekonomik shtetit të së drejtës.

## **1. Ankesat për gjykatat.**

Për vitin 2004 ndaj gjykatave kanë ardhur 252 ankesa, por nga këto, 181 ankesa kanë qënë kundra vendimeve gjyqësore dhe si të tilla ato janë refuzuar sepse kanë qënë jashtë juridiksionit tonë.

Por 71 ankesat e tjera, duke i analizuar sipas objektit del se kanë qënë në këto drejtime dhe për këto probleme :

- Ankohen për zvarritje pa shkaqe ligjore të gjykimit të çështjeve të ndryshme penale e civile.

- Kanë kërkuar që të përfaqësohen nga Avokati i Popullit në gjykimet në Gjykatën e Lartë, meqenëse në të dy shkallët e tjera të gjykimit kanë humbur gjyqet.

- Ankohen se nuk u jepet ndihma e nevojshme ligjore mbasi nuk kanë të ardhura për të marrë avokat privatë.

- Ankohen se u kanë kaluar afatet e ankimit ndaj vendimeve gjyqësore të marra në mungesë dhe nuk u pranohen nga gjykata ankimet ndaj vendimeve dhe kërkojnë rivendosje në afat të ankimit.

- Ankohen ndaj vendimeve gjyqësore me të cilin vendoset pezullimi i punimeve pse pezullimi i ekzekutimit të vendimeve nga zyrat e përmbarimit në rrethe.

- Ankohen për qëndrime subjektive e të njëanshme të gjyqtarëve gjatë gjykimit të çështjes dhe kërkohet përjashtimi i tyre.

- Ankohen ndaj vendimeve gjyqësore të formës së prerë dhe kërkohen ndihma ligjore për t'ju drejtuar Gjykatës Lartë me kërkesë për rishikim vendimi.

- Ankohen ndaj vendimeve gjyqësore të formës së prerë, se nuk janë respektuar të gjitha kërkesat për një proces të rregullt ligjor nga gjykatat dhe kërkohet ndihmë ligjore për dërgimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën Kushtetuese.

- Ankohen ndaj vendimeve gjyqësore të formës së prerë dhe se kanë ezauruar të gjitha mjetet e ankimit në rrugë gjyqësore në Shqipëri dhe kërkohet ndihma ligjore për t'ju drejtuar Gjykatës së Strazburgut.

- Ankohen ndaj vendimeve gjyqësore për masë të rëndë dënimi dhe kërkohet nga Avokati i Popullit që në Gjykatën e Apelit të zbatohet Amicus Curiae ( miku i gjykatës )

- Ankohen se ka zvarritje të gjata në dërgimin e dosjeve nga Gjykatat e rretheve në Gjykatën e Apelit apo në Gjykatën e Lartë dhe anasjelltas.

- Ka patur ankesa nga familjarët e viktimave se Gjykatat dhe gjyqtarë të veçantë, ndaj autorëve që kanë kryer krimin e vrasjes kanë dhënë masa dënimi të buta.

- Ankohen ndaj gjyqtarëve të veçantë të Gjykatave të rretheve dhe të Gjykatave të Apelit që ndaj tyre të fillohet procedimi disiplinor për shkelje të ndryshme në detyrë dhe për korrupsion.

Është pozitiv fakti se gjatë vitit 2004 për ankesat e ardhura ndaj Gjykatave në 37 raste ato janë zgjidhur në favor të ankuesve.

### **a) Ankesat ndaj Gjykatave të rretheve gjyqësore**

Nga 252 ankesat e ardhura gjithsej për vitin 2004, ndaj Gjykatave të Shkallës së Parë kanë ardhur 196 ankesa.

Në shumicën e rasteve rezulton se në përgjithësi ankuesit nuk kanë patur të drejtë, pasi gjyqtarët e akuzuar kanë bërë “ kujdes “ që nga ana ligjore të mos vërtetohet ndonjë shkelje e ligjeve.

Ja disa nga rastet e zgjidhura në favor gjatë këtij viti :

1. Shtetasi N.M.nga qyteti i Shkodrës është ankuar ndaj Gjykatës së Shkallës parë Tiranë, për zvarritje pa shkaqe ligjore të gjyqimit të një çështje civile me objekt shkaktim dëmi.

Nga verifikimi ynë rezultoi se gjyqtarja e çështjes ka kthyer për plotësim kërkesë padinë së bashku me dokumentat përkatëse pasi ka patur të meta në dokumentacionin e paraqitur.

Rezultoi se ndaj këtij vendimi ankuesi të ketë paraqitur ankim në shkallë të dytë ku Gjykata e Apelit Tiranë ka vendosur prishjen e vendimit të gjyqtarit të vetëm dhe kthimin e çështjes për rigjykim.

Në rastin konkret nga ana e jonë u sqarua dispozita e kodit të procedurës civile që rregullon këto çështje dhe se për rastin në fjalë nuk ka zvarritje nga gjyqtarja e çështjes.

2. Shtetasi B.U. nga qyteti i Krujës është ankuar ndaj Gjykatës së Shkallës parë Krujë për zvarritje pa shkaqe ligjore të gjykimit të çështjes penale ndaj vëllait tij Sh.U. i cili akuzohej për kryerjen e një veprë penale. Nga verifikimi ynë rezultoi se shkaqet e shtyerjes së seancave gjyqësore kanë qënë të ndryshme si mos paraqitja e dëshmitarëve e avokatit mbrojtës etj. Në përfundim gjykata ka vendosur deklarinimin e tij fajtor dhe dënimin e tij me 6 vjet burgim.

Kundra këtij vendimi i gjykuari ka bërë ankim dhe Gjykata e Apelit Tiranë pasi ka shqyrtuar çështjen në themel ka vendosur prishjen e vendimit të gjykatës faktit dhe deklarinimin e tij të pafajshëm. Ndërhyrja jonë bëri të mundur shpejtimin dhe përfundimin e këtij gjykimi.

3. Avokat V.M. nga qyteti i Vlorës është ankuar ndaj Gjykatës së Shkallës së parë Vlorë, për zvarritje pa shkaqe ligjore të gjykimit të kërkesës së të paraburgosurit E.G. me objekt, shuarjen e masës së arrestit me burgim pa afat për shkak të kalimit të afateve ligjore të paraburgimit.

Nga verifikimi ynë rezultoi se nga Gjykata e rrethit Vlorë ishin zhvilluar 8 seanca gjyqësore dhe se ato ishin shtyrë midis të tjerave se nuk shoqërohej i paraburgosuri në gjykatë nga Policia ditën dhe orën e gjykimit se ishte shtyrë me kërkesën e avokatit mbrojtës për studimin e dosjes. Në saj të ndërhyrjes tonë u bë e mundur jo vetëm shpejtimi, por edhe përfundimi i gjykimit të kësaj çështje.

4. Shtetësja Sh.T. nga qyteti i Sarandës është ankuar ndaj Gjykatës së Shkallës parë Sarandë për zvarritje pa shkaqe ligjore të dërgimit të dosjes civile nga kjo gjykatë në Gjykatën e Apelit Gjirokastrë.

Nga verifikimi rezultoi se shkak i vonesës ka qënë se nga administrata e kësaj gjykate janë bërë njoftimet dhe komunikimet e ankimit sipas ligjës dhe se mbas këtij veprimi është dërguar edhe dosja për gjykim në Gjykatën e Apelit Gjirokastrë.

5. Nga ana e jonë është shqyrtuar me inisiativë gjykimi nga Gjykata e rrethit Tiranë ndaj të akuzuarit K.M. për veprën penale, “*të nxitjes së urrejtjes ose grindjeve nëpërmjet kombësive, racave dhe feve*” në bazë të nenit 265 të K.Penal.

Nga verifikimi rezultoi se i akuzuari K.M. kishte botuar një roman në vitin 2001 dhe në këtë roman ai ka shprehur mendimet e tij të lira.

Por duke qënë se ai ka debatuar në lidhje me mendimet e personave të tjerë ndaj tij për këtë veprë penale është bërë kallëzim penal në Prokurorinë e rrethit. Në përfundim të gjykimit të çështjes në shkallë të parë, përfaqësuesi i akuzës ka kërkuar deklarinimin e tij fajtor dhe dënimin me 6 muaj burgim.

Gjykata e Shkallës parë Tiranë me vendimin Nr.602 dt.03.06.2004 ka vendosur deklarinimin të pafajshëm të K.M. për këtë vepër me arsyetimin se në rastin konkret nuk ekzistojnë elementet e kësaj vepre penale.

Ndaj këtij vendimi është bërë ankim në shkallë të dytë nga Prokurori i rrethit Tiranë dhe Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin Nr.728 dt.03.11.2004 ka vendosur lënien në fuqi të këtij vendimi.

Pra nga ana e jonë u ndoq me kujdes dhe u konstatua se ndaj tij u zhvillua një proces i rregullt duke u respektuar të drejtat e tij që u konkludua me një vendim të drejtë.

6. Shtetasi A.B. nga qyteti i Tiranës është ankuar ndaj Gjykatës së Shkallës parë Tiranë për zvarritje pa shkaqe ligjore të gjykimit të çështjes penale ndaj tij.

Nga verifikimi i ankesës, rezultoi se 10 seanca gjyqësore ishin shtyrë për mos paraqitje të Prokurorit të çështjes, ndërsa 10 seanca të tjera ishin shtyrë se nuk paraqiteshin dëshmitarët, të cilët ishin punonjës të policisë së Komisarariatit Nr.2 Tiranë.

Nga ana e jonë u ndërhy menjëherë tek Prokurori i rrethit Tiranë si dhe drejtuesit e Komisarariatit të Policisë dhe u arrit jo vetëm shpejtimi, por edhe përfundimi i gjykimit.

7. Shtetasi K.S. nga qyteti i Krujës është ankuar ndaj Gjykatës së Shkallës parë Krujë për zvarritje pa shkaqe ligjore të një çështje penale ndaj të akuzuarit H.S. i cili akuzohej për veprën penale të fallcifikimit të dokumentave zyrtare.

Nga verifikimi rezultoi se shkak i kësaj shtyerjes së gjykimit ishin mos paraqitja e dëshmitarëve e të ekspertëve etj. Pas ndërhyrjes sonë nga ana e kësaj gjykate u muarën masat e nevojshme për përfundimin e këtij gjykimi.

8. Shtetësja Xh.J. nga qyteti i Laçit është ankuar ndaj Gjykatës së Shkallës parë Kurbin për zvarritje të gjykimit të një çështje civile me objekt largim nga puna.

Nga verifikimi rezultoi se shkak i kësaj shtyerje ka qënë se Gjykata e Apelit Tiranë ka vendosur prishjen e vendimit të gjykatës rrethit Kurbin dhe dërgimin e çështjes për rigjykim përsëri në gjykatën e faktit. Por rezultoi se ndaj këtij vendimi ka ushtruar rekurs pala e paditur dhe dosja është dërguar për shqyrtim në Gjykatën e Lartë. Në përfundim mbasi edhe nga ajo Gjykatë është vendosur mos pranimi i rekursit, dosja u rigjykua nga gjykata e faktit dhe në përfundim të gjykimit është vendosur jo vetë përfundimi i gjykimit por edhe pranimi i padijes së saj.

9. Shtetasi R.G. nga qyteti i Kukësit është ankuar ndaj Gjykatës së Shkallës parë Kukës për zvarritje pa shkaqe ligjore të gjykimit të një çështje penale.

Nga verifikimi rezultoi se shkaqet e shtyerjes së gjykimit të kësaj çështje kanë qënë ndryshimi i përbërjes së trupit gjykues dhe se në këtë gjykim është kryer një ekspertim i ri me grup tjetër ekspertësh.

Pas ndërhyrjes sonë nga gjykata u muarën masat e nevojshme për përfundimin e gjykimit.

10. Shtetasi Th.K. nga qyteti i Korçës është ankuar ndaj Gjykatës së Shkallës parë Korçë për zvarritje pa shkaqe ligjore të gjykimit të një çështje civile.

Nga verifikimi rezultoi se kjo çështje ishte pushuar një herë nga Gjykata e rrethit Korçë, me dt.22.01.2004 sepse në ditën dhe orën e caktuar nuk janë paraqitur palët, megjithëse ato kanë patur dijeni të plotë për to. Më vonë paditësi, ka ngritur padi të re, e cila pasi është hedhur në short i ka rënë për gjykim gjyqtarës A.K. e cila kishte zhvilluar disa seanca gjyqësore deri në muajin maj 2004 kur ka filluar lejen e lindjes. Pas kësaj kjo çështje është rihedhur në short përsëri dhe i ka rënë për gjykim gjyqtarit G.B. i cili pas ndërhyrjes tonë mori të gjitha masat e nevojshme për ta përfunduar atë.

Shpesh herë nga ana e jonë për ata ankues ku familjarët e viktimave kanë qënë tepër të revoltuar dhe kanë shkruar për veprime korruptive të gjyqtarëve të veçantë të Gjykatave të Rrethit dhe të Gjykatave të Apelit, ankesat e tyre i janë dërguar organit kompetent si Ministrin të Drejtësisë apo Inspektoriatit të KLD-së së bashku me fotokopjen e ankesave. Në këto raste ankesat kanë patur si objekt gjykimet e zhvilluara duke pretenduar për njëanshmëri dhe mungesë objektiviteti gjatë gjykimit e është kërkuar ndihma dhe ndërhyrja e Avokatit të Popullit që t'i përfaqësojë ato në gjykimet e çështjeve para Gjykatës së Apelit.

Por shpesh ankuesit duke qënë të mërzhitur e të lodhur nga tejkëmbja e proceseve gjyqësore nga njera shkallë tek tjetra, nuk binden me përgjigjen e dhënë nga ana e jonë, sidomos me arsyetimin se vendimet gjyqësore janë jashtë juridiksionit tonë. Prandaj ankuesit këmbëngulin se institucioni ynë duhet që të bëjë patjetër vlerësimin e vendimeve gjyqësore nëse ato janë të padrejta. Ata paraqesin pranë nesh dokumenta dhe prova të ndryshme shkresore me anë të cilave kërkojnë të na bindin se kanë plotësisht të drejtë, por kjo e drejtë nuk u jepet sepse nga gjykatat ato nuk merren në konsideratë.

Këto ankesa tregojnë se në mjaft raste ankuesit kanë humbur besimin tek gjyqtarët dhe gjykatat duke i akuzuar ato direkt si njerëz dhe organe të korruptuara.

Në lidhje me problemet e zvarritjeve të gjykimit për çështjet penale, siç e kemi theksuar edhe në raportet e mëparëshme del nevoja e rishqyrtimit të dispozitave të Kodit Procedurës Penale me synim të shkurtimit të afateve të hetimit dhe të gjykimit. Kjo për arsye se me afatet ekzistuese lihet shteg për abuzim nga punonjës të veçantë si në organet e procedimit penal, ashtu edhe ato të gjykimit. Ka vend për t'u studjuar si problem, duke u caktuar afate të tjera të arsyeshme, sepse në vetvete zgjatja e tyre cënon në mënyrë të drejtëpërdrejtë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut.

Ndryshe qëndron problemi me gjykimin e çështjeve civile. Duke ju referuar dispozitave të Kodit Proçedurës Civile të cilat nuk parashikojnë afate gjykimit në shkallët e gjyimit dhe duke studjuar numërin e ankesave dhe shkaqet e zgjatjes së këtyre gjykimeve kemi mendimin se duhet të bëhen hapa konkrete me Parlamentin Shqiptar për të bërë propozime konkrete për të caktuar afate gjykimi për disa lloje gjykimesh civile.

Një shkak tjetër që ka ndikuar në zvarritjen e gjykimeve në shkallë të parë si për çështjet penale dhe civile është se në disa raste ato shqyrtohen nga trup gjykues të përbërë nga 3 gjyqtarë. Ndodh shpesh që në disa gjykata janë konsumuar gjyqtarët dhe mbi këtë bazë bëhet komandimi i gjyqtarëve nga rrethet e tjera me Vendim të Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Kjo shkakton vonesa tej afatit që mund të quhet “i arsyeshëm”, prandaj duhet që të ketë sa më tepër çështje që të gjykohen nga një gjyqtar i vetëm.

### **b) Ankesat ndaj Gjykatave të Apelit.**

Gjatë vitit 2004 ndaj Gjykatave të Apelit kanë ardhur 37 ankesa.

Numërin më të madh të këtyre ankesave 27 e zënë ato për kundërshtim të vendimeve gjyqësore për të cilat ne kemi vendosur refuzimin e tyre, pasi ato kanë qënë jashtë juridiksionit tonë.

Në 10 raste ankesa kanë qënë për shkelje të ndryshme proçedure apo se nuk u jepet kopja e vendimit gjyqësor pas përfundimit të gjyimit, se janë shkelur të drejtat e tyre gjatë gjyimit, për zvarritje të padrejta të gjykimeve, se ka vonesa të pajustificuara në dërgimin e dosjeve nga Gjykata e Shkallës së parë në Gjykatën e Apelit dhe anasjelltas etj.

1. Shtetësja A.X. nga qyteti i Tiranës është ankuar ndaj Gjykatës së Apelit Tiranë duke kërkuar shpejtimin e gjyimit të çështjes penale ndaj djalit të saj i cili është arrestuar në bazë të një vendimi penal të Gjykatës së shtetit Italian. Ankuesja ka pretenduar se kjo çështje është zvarritur për një kohë të gjatë nga gjykata e faktit dhe për këtë shkak ka kërkuar ndihmën tonë për shpejtimin e këtij gjykimi në Apel.

Pas rekomandimit tonë u analizuan këto arsye dhe u bë e mundur shpejtimi dhe përfundimi i këtij gjykimi. Po kështu është vepruar edhe në lidhje me ankesën e shtetasit G.Xh. nga Tirana.

2. Shtetasi S.B. nga qyteti i Tiranës është ankuar ndaj Gjykatës së Apelit Tiranë për zvarritje gjykimi të një çështje civile.

Nga verifikimi rezultoi se çështja e tij ndodhej për gjykim në Gjykatën e Apelit Tiranë e rregjistruar në Nr.927 dt.10.01.2004. Në fillim ankuesi u orjentua që ti drejtohej vet me një kërkesë Kryetarit të kësaj gjykate duke kërkuar shpejtimin e këtij gjykimi dhe arsyet se në rastin konkret bëhej fjalë për

një vendim me objekt “Njohje të statusit të veteranit” ndaj të cilit ishte ankuar Ministria e Mbrojtjes. Mbas kërkesës Gjykata e Apelit shqyrtoi këtë kërkesë dhe vendosi shpejtimin dhe përfundimin e këtij gjykimi.

3. Shtetësja N.H. nga qyteti i Pogradecit është ankuar ndaj Gjykatës Apelit Korçë e cila megjithse ka përfunduar gjykimine një çështje civile asaj nuk i jepet një fotokopje e vendimit me qëllim që ajo të bëjë rekurs në Gjykatën e Lartë. Nga ndërhyrja jonë u bë e mundur sigurimi i fotokopjes së vendimit gjyqësor dhe ju dha mundësia që ajo të hartojë dhe dorëzojë rekursin ndaj vendimit gjyqësor në afatin e caktuar. Po kështu është vepruar edhe për ankesën e shtetases V.C nga qyteti i Korçës.

4. Shtetasi A.C. nga qyteti i Vlorës u ankua ndaj Gjykatës së Apelit Vlorë e cila sipas tij gjatë gjykimit të një çështje civile po vepronte në kundërshtim me rregullat proceduriale të gjykimit.

Nga verifikimi rezultoi se para fillimit të shqyrtimit të gjykimit të kësaj çështje njeri nga antarët e trupit gjykues kishte kërkuar dorëheqje për shkaqe ligjore, e cila edhe i është pranuar. Me kërkesë të bërë Ministrit të Drejtësisë nga Kryetarja e Gjykatës, KLD-ja caktoi dy gjyqtarë të tjerë nga Gjykata e Apelit Durrës për gjykimin e çështjes.

Nga ana e jonë ankuesit ju bënë sqarimet e nevojshme ligjore dhe ju sugjerua që për të gjitha pretendimet e tij ai mund ti parashtronte gjatë gjykimit të çështjes vet ose nëpërmjet avokatit privat.

### **c) Ankesat ndaj Gjykatës së Lartë.**

Dihet se Gjykata e Lartë nuk ka lidhje vartësie nga Ministria e Drejtësisë, por ne e kemi radhitur në këtë kre për shkak se problemet që ngrenë shtetasit për këtë gjykatë janë pothuaj të njëjlojta me ato që ngrenë edhe gjykatat më të ulta.

Në vitin 2004 kundër Gjykatës së Lartë kanë ardhur 16 ankesa nga 30 ankesa që kanë ardhur në vitin 2003.

Në 11 raste, ankesat janë bërë kundër vendimeve gjyqësore, duke pretenduar se në shqyrtimin e çështjeve nuk janë respektuar procedurat gjyqësore.

Në rastet e tjera ankesat kanë qënë për zvarritje të gjata të gjykimit të çështjeve, për përjashtim gjyqtari se ka marrë pjesë në gjykimet e mëparëshme, kanë kërkuar që çështjen e tyre ta përfaqësojë në gjykim Avokati i Popullit, të shqyrtohet kërkesat e tyre me objekt rishikim vendimi gjyqësor, kanë kërkuar t’u jepen kopjet e vendimeve pas përfundimit të gjykimit, që të shikohet mundësia e ndërhyrjes tonë që të pranohet rekursi i tyre etj.

Ja disa raste të zgjidhjes së këtyre ankesave gjatë këtij viti.



1. Shtetasi M.S. i dënuar në burgun e Peqinit është ankuar ndaj Gjykatës së Lartë mbasi në vitin 2003 i ka dërguar një kërkesë për rishikim vendimi penal asaj gjykate së bashku me dokumentat përkatëse dhe prej saj nuk ka marrë asnjë përgjigje.

Nga verifikimi rezultoi se kërkesa e tij ndodhej e rregjistruar në Gjykatën e Lartë me numër rregjistri themeltar 24 dhe aktualisht ndodhej për studim në dhomën e këshillimit të kësaj gjykate. Nga ana e jonë u sqarua ankuesi për rrugën që duhet të ndiqte për të mësuar në lidhje me datën e orën e gjykimit duke u interesuar avokati i tij privat.

2. Shtetasi F.H. nga qyteti i Vlorës është ankuar ndaj Gjykatës së Lartë Tiranë për zvarritje pa shkaqe ligjore të gjykimit të kërkesës për rishikim vendimit të djalit tij K.H. i cili ishte gjykuar dhe dënuar në mungesë nga Gjykata Ushtarake e rrethit Tiranë.

Nga verifikimi rezultoi se kërkesa e rishikimit të vendimit të djalit tij ishte gjykuar dhe se me vendimin nr.31, dt.29.07.2004 të kolegjit penal të Gjykatës Lartë ishte vendosur mos pranimi i kërkesës për rishikim vendimi i K.H. dhe ju dha edhe një fotokopje e këtij vendimi gjyqësor.

3. Shtetasi M.G. nga qyteti i Durrësit është ankuar ndaj Gjykatës së Lartë për zvarritje pa shkaqe ligjore në gjykimin e një çështje civile me objekt detyrim civil i rrjedhur nga shkaktim dëmi, ku ai ka fituar të dy shkallët e tjera të gjykimit.

Nga verifikimi rezultoi se kjo çështje ndodhej e rregjistruar për studim në dhomën e këshillimit. Shkaku i vonesës rezultoi se ka qënë sepse ndaj vendimit ka bërë kërkesë për rivendosje në afat dhe rekurs Ministria e Transporteve Tiranë dhe nga administrata gjyqësore ishin kryer procedurat e njoftimit të palëve sipas ligjit në lidhje me rekursin.

4. Shtetasi I.R. nga qyteti i Peqinit është ankuar ndaj Gjykatës së Lartë për zvarritje të gjykimit të një çështje civile.

Nga verifikimi rezultoi se ndaj vendimit dt.16.06.2003 të Gjykatës së Apelit Tiranë ka ushtruar rekurs Ministria e Mbrojtjes dhe kjo çështje ndodhet e rregjistruar në dhomën e studimit. Nga ana e jonë ankuesi u sqarua për rrugën ligjore që duhet të ndjek për të mësuar në lidhje me datën dhe orën e gjykimit të çështjes.

5. Shtetasi I.M. nga qyteti i Tiranës është ankuar ndaj Gjykatës së Lartë se ndonëse ajo ka vendosur prishjen e vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Shkallës parë Tiranë, atij nuk i jepej kopje e vendimit për të ndjekur procedurat ligjore për gjykimin e çështjes në Gjykatën Kushtetuese dhe në Gjykatën e Strasburgut.

Nga ana jonë u bisedua me administratën e kësaj gjykate dhe në përfundim u arrit marrja dhe dorëzimi i këtij vendimi ankuesit.

Në lidhje me ankesat që janë bërë kundra vendimeve të Gjykatës së Lartë nga ana e jonë janë bërë sqarimet e nevojshme se këto ankesa janë jashtë juridiksionit tonë. Kur ankuesit kanë pretendimet në lidhje me një proces jo të rregullt ligjor, në bazë të neneve 42/2 dhe 131 germa “f” të Kushtetutës ato janë sqaruar se mund t’i drejtohen me kërkesë për gjykim Gjykatës Kushtetuese.

Edhe për ankesat e personave që kanë patur pretendime se çështja e tyre nuk është gjykuar drejtë dhe se atyre u janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore si nga organet e administratës publike shqiptare, ashtu edhe nga gjykatat, ata në çdo rast janë dëgjuar me kujdes dhe janë orjentuar se në bazë të nenit 6 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut, kanë të drejtë t’i drejtohen Gjykatës së Strasburgut, duke mbajtur gjithmonë parasysh se kjo kërkesë mund të bëhet brenda 6 muajve dhe pasi të jenë shteruar të gjitha rrugët ligjore në Shqipëri.

#### **4. Ankesa për Prokurorinë**

A. Sipas Kushtetutës sonë edhe Prokuroria nuk bën pjesë në juridiksionin e Ministrisë së Drejtësisë, por për lehtësi studimi e kemi përfshirë pas saj.

Për vitin 2004 në Institucionin tonë 280 shtetas të ndryshëm kanë paraqitur 150 ankesa apo kërkesa, të cilat kanë patur për objekt veprimtarinë e punës së organit të Prokurorisë. Mënyra e përfundimit të ankesave për vitin 2004 kanë qënë: 44 ankesa janë zgjidhur në favor ose 33 përqind, 74 ankesa kanë qënë jashtë juridiksionit apo jashtë kompetence dhe 15 ankesa kanë qënë të pabazuara. Aktualisht janë në shqyrtim 17 ankesa.

Gjatë vitit 2004 janë shqyrtuar dhe 9 ankesa të mbartura nga viti 2003 të cilat janë përfunduar dhe mënyra e zgjidhjes së tyre ka qënë: 2 ankesa janë zgjidhur në favor, 2 ankesa kanë qënë jashtë kompetence dhe 4 ankesa kanë qënë të pabazuara.

Edhe për vitin 2004 ankesat e shtetasve ndaj veprimtarisë së organit të Prokurorisë janë shqyrtuar me përparësi. Për ankesat që kanë qënë brënda kompetencës sonë, Avokati i Popullit ka bërë vlerësimet e rastit dhe ka urdhëruar kryerjen e procesit të hetimit nëpërmjet realizimit të veprimeve të nevojshme si, marrja e deklarimeve të shtetasve të ndryshëm, kqyrjes së dokumentave, kryerjes së ekspertimeve mjeko-ligjore me specialistë të fushave përkatëse, apo duke studjuar dosje hetimore për të cilat Prokuroria kishte vendosur pushimin apo pezullimin e çështjes penale.

Për mjaft ankesa është shkuar në vëndbanimin e ankuesit ose kërkuesit, apo janë kryer veprimet në vënd, duke marrë dhe shpjegimet e nevojshme në organin e Prokurorisë, ndaj të cilit shtetasi ka bërë ankimin.

Institucioni i Avokatit të Popullit ka ndjekur me precedencë dhe ankesat e shtetasve apo shoqatave që përfaqësojnë interesa të një grupi të caktuar personash, si antarë të Shoqatës së Emigrantëve Shqiptarë të Greqisë, të një grupi familjarësh nga rrethi i Dibrës, banorë nga Selenica e Vlorës etj. Ai gjithashtu ka vlerësuar dhe ndjekur me përparësi njoftimet e ardhura nga deputetë të ndryshëm të Kuvendit si në cilësinë e antarëve të komisioneve parlamentare apo dhe si përfaqësues të zonave që ata përfaqësojnë. Njoftime të rëndësishme për ankesa të shtetasve të ndryshëm ka dërguar në Institucionin e Avokatit të Popullit sidomos Z. Pjetër Arbnori në cilësinë e sekretarit të Komisionit Parlamentar për të drejtat e njeriut, minoriteteve dhe peticioneve.

Për ankesën e familjarëve dibranë të 32 viktimave të ngjarjes tragjike të ndodhur më datën 09.03.1996 në ujrat e detit Jon, Avokati i Popullit i rekomandoi rifillimin e hetimit të pezulluar Prokurorisë së rrethit gjyqësor Vlorë. Realizimi i një hetimi të gjithanshëm me anë të kryerjes së disa veprimeve hetimore merr rëndësi për faktin se jo vetëm zbardh të vërtetën e ngjarjes, identifikon autorët e veprëve penale, por edhe evidenton nëse organizatorët e ngjarjes kanë vazhduar më tej veprimtarinë kriminale dhe kanë konsumuar elementët e ndonjë veprë tjetër penale.

Gjatë shqyrtimit të ankesave për vitin 2004, vihet re se objekti i tyre është i njëjlojtë me objektin e ankesave të paraqitura edhe gjatë vitit 2003. Në mënyrë të grupuar shtetasit ankohen ndaj Prokurorisë :

#### *1. Për zvarritje në hetimin e çështjeve penale.*

Raste të tilla mund të përmëndim ankesat e shtetasve L.B. nga Tropoja, B.Gj. nga Kavaja, B.Q. nga Fushë–Arrësi i Pukës, Gj.Gj dhe P.R. nga Tirana, K.K. nga Korça, P.L. nga Lezha, etj.

Rast flagrant është hetimi i procedimit penal Nr. 201 të Prokurorisë së rrethit Lezhë në ngarkim të pandehurëve P.L. dhe Gj.L. akuzuar për veprat penale të “marrëdhënieve seksuale me dhunë me të mitura” e “shfrytëzim prostitucioni”. Pavarësisht nga veprat penale me rrezikshmëri shoqërore dhe veprimet e shumta hetimore që duhet të kryheshin, nuk ka qënë e justifikuar zvarritja e hetimeve.

Rast tjetër është edhe ai, mbi ankesën e shtetasës L.B. nga Tropoja për zvarritje në hetimin e procedimit penal në ngarkim të djalit të saj K.B. akuzuar për veprat penale të parashikuara nga nenet 140 e 25 dhe 278/2 të Kodit Penal, filluar qysh më datën 13.11.2003 dhe përfunduar në muajin shtator 2004.

Në Institucionin e Avokatit të Popullit një numur të konsiderueshëm ankuesish nga rrethe të ndryshme të vëndit ngrenë shqetësimin për zvarritje në hetimin e çështjeve penale për krime të rënda si vrasje. Si të tilla janë ankesat e

shtetasve Gj.Gj. nga Tirana, K.K. nga Korça, ankesa e shtetasit P.R. dhe çiftit A dhe J.Zhupa nga Tirana, ankesa e shtetasit B.Gj. nga Kavaja etj.

Ndonëse një nga arsyet e zvarritjeve të këtyre çështjeve ka qënë dhe ndryshimet e bëra në ligjin Nr. 9726 datë 16.09.2004 “Për disa shtesa e ndryshime në Kodin e Proçedurës Penale të Republikës së Shqipërisë” i cili bën fjalë për kompetencat e prokurorive dhe gjykatave të krimeve të rënda, zvarritjet e tejzgjatura nuk kanë qënë justifikuese.

## *2. Për moskryerje të hetimeve të gjithanshme dhe objektive.*

Të tilla janë rastet e ankesave të shtetasve Z.Ç. nga Skrapari, K.S. dhe A. R. nga Çërma e Lushnjës etj.

Kështu Prokuroria e rrethit Skrapar ka akuzuar të pandehurin A.K. për vrasjen e shtetasit D.Ç. që është dhe djali i ankuesit. Fillimisht akuza në ngarkim të pandehurit ka qënë për veprën penale të “vrasjes nga pakujdesia” dhe “mbajtjes pa lejë të armëve luftarake”. Në përfundim është pushuar akuza për “vrasje nga pakujdesia” duke e dënuar përfundimisht të pandehurin për veprën penale të armëmbajtjes me 7 muaj burgim.

Shtetasit A.R dhe K.S. nga rrethi i Lushnjës ankohen ndaj Prokurorisë së atij rrethi për moskryerje të hetimeve të gjithanshme dhe objektive, sepse prej saj në mënyrë të padrejtë janë pushuar hetimet në ngarkim të dy të pandehurëve, të cilët kanë qënë autorë në veprën penale të vrasjes me dashje mbetur në tentativë ndaj disa personave. Autorët e veprës penale për të cilët Prokuroria ka vendosur pushimin e akuzës kanë qënë problematikë në fshatin që ka ndodhur ngjarja dhe në zonën përreth.

*3. Për mosvënie në lëvizje, apo mosvlerësim të kallëzimit të shtetasve, si p.sh. ankesat e shtetasve L.L. nga Lushnja, P.P. nga Lezha, V. Ll. Nga Saranda etj.*

*4. Për mosnjoftim apo njoftim me vonesë për mënyrën e zgjidhjes së kallëzimit apo përfundimit të çështjes penale, si p.sh ankesat e shtetasve Z.R. nga Elbasani, S. Zh. nga Tirana, A. A. nga Tirana. Shtetësja F.M. nga Elbasani e cila jo vetëm nuk ka marrë dijeni për mënyrën e përfundimit të hetimit për autorët e veprës penale të trafikimit të qënieve njerëzore që kanë qënë tutorë të saj nga rrethi i K. por, dhe ka kërkuar mbrojtjen dhe rehabilitimin për t'u integruar në shoqëri; shtetësja E.S. nga Tirana për mosmarrje dijeni apo kopje të vendimit të pushimit të hetimit të çështjes penale në të cilën ajo ishte e dëmtuar etj.*

5. *Për bllokime apo sekuestrime te sendeve prove materiale sidomos per automjetet dhe kthimin e tyre me vonesë, si p.sh ankesa e shtetasit M.K. nga Kosova, njoftim i ardhur nga z. Pjetër Arbnori deputet i Kuvendit të Shqipërisë.*

6. *Për akuzë të padrejtë apo rëndim të akuzavë në ngarkim në momentin e marrjes në përgjegjësi penale.*

Raste të tillë janë ankesat e shtetases B.R., R.K. dhe N.B. nga Tirana, ankesat e shtetasit N.H. nga Vlora, ankesa e shtetasit N.L. nga Lezha, ankesa e shtetases I.M. nga Durrësi, ankesa e shtetasit A.Rr. nga Korça, ankesa e shtetasit Gj.Gj. nga Mati etj.

Kështu, në procedimin penal Nr. 1939 të vitit 2004 Prokuroria e rrethit gjyqësor Tiranë ka akuzuar të pandehurin G.B.për veprën penale të “vrasjes me dashje mbetur në tentativë”, duke kërkuar masë sigurimi “arrest në burg” e cila është vendosur dhe nga gjykata. Por gjatë hetimit është konkluduar se, ndodhemi para veprës penale të “plagosjes së lehtë me dashje” dhe meqënëse i dëmtuari ka hequr dorë nga ankimi, hetimet janë pushuar konform rregullave proceduriale.

Po ashtu në procedimin penal në ngarkim të pandehurit G.H. të Prokurorisë së rrethit gjyqësor Durrës, ndaj tij janë ngritur tre akuza dhe konkretisht ajo e falsifikimit të vulave, stampave e formulareve, favorizim në kryerjen e kontrabandës dhe shpërdorim detyre e për rrjedhojë ndaj tij është kërkuar nga prokuroria e mandej vendosur nga gjykata, masë sigurimi “arrest në burg”. Gjatë hetimeve të kryera është konkluduar se, ndodhemi vetëm para veprës penale të “shpërdorimit të detyrës”, e për rrjedhojë është ndryshuar dhe masa e sigurimit ndaj të pandehurit.

Gjatë shqyrtimit të disa ankesave është konstatuar se, organi i Prokurorisë ka vepruar në mënyrë te nxituar dhe të pabazuar në përfundim të hetimit, duke konkluduar padrejtësisht si mënyrë zgjidhje të çështjes pushimin ose pezullimin e hetimeve. Pas studimit nga ana e jonë është vënë re se pushimi i çështjes nuk ka qënë rezultat i hetimit të gjithanshëm dhe objektiv, e për rrjedhojë i është rekomanduar Prokurorit të Përgjithshëm ose Kryeprokurorëve në rrethe shfuqizimi i vendimit. Raste të tilla flagrante mund të përmëndim çështjen penale Nr. 106 të vitit 2002 hetuar nga Prokuroria e rrethit Pogradec gjatë vitit 2003 dhe 2004, për veprën penale të “shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor” me pasojë vdekjen e shtetasit Perlat Voshtina nga Tirana. Bashkëshortja e viktimës u ankua se padrejtësisht çështja penale e filluar për vdekjen e bashkëshortit të saj gjatë një aksidenti automobilistik ishte pushuar, me arsyetimin se në timon si shofer kishte qënë viktimja. Hetimet tona vërtetuan pretendimet e ankueses se shoferi i mjetit që u aksidentua kishte qënë tjetër person dhe se për faj të tij kishte ndodhur aksidenti. Pas rifillimit te hetimeve,

mbi bazën e rekomandimit tonë, çështja u dërgua për gjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec, ku si i pandehur ndodhet personi që ishte drejtues mjete. Çuditërisht nga ana e Prokurorisë së rrethit Pogradec jo vetëm që është zvarritur hetimi i procedimit penal në mënyrë të pajustificuar, por në përfundim gjatë shqyrtimit gjyqësor të çështjes janë tërhequr aktet nga prokurori dhe procedimi penal është pushuar. Mbetet të verifikohet ky veprim.

#### *7. Për shkelje proceduriale në kryerjen e veprimeve hetimore.*

- I tillë është rasti i ankesës së shtetasit D.S. nga Durrësi i cili ankohet ndaj Prokurorisë për shkelje të rregullave proceduriale në hetimin e procedimit penal Nr.261 në ngarkim të djalit të tij A.S etj, akuzuar për veprën penale të “vjedhjes me armë në bashkëpunim”. Kështu në kryerjen e paraqitjes për njohje janë bërë shkelje të tilla si, personat që do të bëhesh njohja janë njohur më parë nga të pandehurit, kushtet e paraqitjes për njohje nuk kanë qënë të përafërta konform rregullave proceduriale etj.

- Për moslejtim të familjarëve për t’u takuar me të pandehurin dhe parë gjëndjen shëndetësore të tij, mbasi ka dyshuar për ushtrim dhune nga policia, siç është rasti i ankesës së shtetasit Xh.M. nga Tirana.

- Për mosdhënie të kopjes së vendimit të pushimit të çështjes, siç janë rastet e shtetasve H.K. dhe E.S. nga Tirana etj.

**B.** Gjatë vitit 2004 në Institucionin e Avokatit të Popullit kanë paraqitur ankesa një numër i konsiderueshëm personash nga rrethe të ndryshme të vëndit, për moszbulimin dhe vënien para përgjegjësisë penale të autorëve të vrasjeve të fëmijëve apo të afërmëve të tyre, ngjarje të ndodhur kryesisht gjatë vitit 1997. Të tilla raste janë ankesa e shtetasit S.D.për vrasjen e vajzës L.S. në Korçë, ngjarje e ndodhur më datën 17.06.1997, ankesa e shtetasit D.D. po nga Korça për vjedhjen duke ushtruar dhunë, ngjarje e ndodhur datë 01.06.1997; ankesa e shtetasit M.H. nga Tropoja për vrasje të djemve dhe të afërmëve të tij në periudhën 1998-2002; ankesa e shtetasit M.N. nga Hasi për vrasjen e të afërmit të tij në makinë, ngjarje e ndodhur në Maminas të Durrësit datë 19.01.2000 etj.

Konstatohet se, për këto çështje të cilat fillojnë mbi bazën e ngjarjes dhe që jo vetëm janë me rrezikshmëri të madhe shoqërore, por dhe trondisin opinionin tek komuniteti e më gjërë, ndonëse janë kryer veprimet e para hetimore të domosdoshme, nuk është predispozicioni i duhur për kryerjen e veprimeve të gjithanshme dhe mungon bashkëpunimi mes prokurorisë dhe policisë kriminale. Për rrjedhojë, hetimet pezullohen dhe materialet e çështjes i dërgohen policisë kriminale. Nuk ka asnjë impenjim për bashkëpunim për ndjekjen në vazhdimësi të çështjes dhe analizën e tyre të herëpashershme dhe në këto kushte, ato mbeten pa veprime nga policia kriminale.

- Shqetësim i shtetasve për vitin 2004 ka qënë dhe mosndjekja e problemeve që lidhen me humbjen e të afërmeve të tyre vite më pare. Të tilla janë rastet e ankesave të shtetasve V.K. nga Korça për humbjen e vëllait të tij L.K. ngjarje e ndodhur në vitin 1991; ankesa e shtetasit D.E. nga Kukësi për humbjen e djalit të tij A.E. ngjarje e ndodhur në vitin 1990; ankesa e shtetases V.H. nga Tirana për humbjen e vajzës së mitur J.H. ngjarje e ndodhur në vitin 1992 etj.

Vërehet se nuk është bërë vlerësimi i nevojshëm si nga Prokuroria ashtu dhe policia kriminale si organe kompetente për ndjekjen e këtyre ankesave me natyrë kriminale, dhe në këto rrethana shtetasit bëjnë përpjekjet e tyre në Institucione të tjera, por pa asnjë rezultat.

Për periudhën që analizohet ka patur dhe raste kur, shtetas të ndryshëm ankohen për “mbyllje” të çështjeve për veprën penale të “shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor me pasoja të rënda”. Nga studimi dhe analiza e bërë ankesave të paraqitura në Institucionin tonë, arrijmë në përfundimin se, nga ana e Prokurorisë jo gjithmonë bëhet vlerësimi i duhur i këtyre çështjeve, të cilat fillojnë mbi bazën e ngjarjes, dhe kërkojnë kryerje të shpejta të veprimeve të para hetimore të papërsëritshme, njohuri profesionale në fushën autoteknike dhe objektivitet. Njëanshmëria, dhënia e konkluzioneve të pasakta dhe të padrejta në aktet e ekspertimit mjeko-ligjor ose autoteknik, moskryerja e veprimeve të gjithanëshme, janë pasoja të vendimeve të pabazuara të ndërmarra nga policia gjyqësore e të miratuara nga Prokuroria. Nga ana tjetër, ato sjellin zvarritje në hetimin e çështjeve penale dhe pasoja të tjera që lidhen me probleme sociale, deri në acarimin e marrëdhënieve ndërmjet autoreve të veprës me familjarët e të dëmtuarëve apo viktimave të shaktuara nga vepra penale. Veç sa sipër, këto qendrimet ndikojnë negativisht në rritjen e numërit të aksidenteve në shkallë vëndi, i cili për vite me radhë është mjaft shqetësues.

Në praktikën e punës gjatë shqyrtimit të ankesave janë ndeshur dhe raste kur, shtetas të ndryshëm duke mos njohur dispozitat proceduriale dhe Institucionet që duhet t’i drejtohen, kërkojnë ndihmën tek Institucioni i Avokati të Popullit. Kështu konstatohet se, ka raste kur tek ne dërgojnë denoncim për ndjekje penale, apo kërkojnë ndërhyrjen për vënien e drejtësisë për rastet kur të afërm të tyre janë dënuar nga gjykatat dhe vendimi penal ka marrë formë të prerë. Për këto raste, nga ana e jonë shtetasve jo vetëm ju është bërë sqarim i nevojshëm ligjor, por shpesh dhe u janë dhënë fragmente të neneve e dispozitave përkatëse si për rrugën që duhet të ndjekin për kallëzimet penale që parashikohet në nenin 283 të Kodit të Proçedurës Penale, për rishikimin e vendimeve penale që kanë marrë formë të prerë parashikuar nga nenet 449-453 të Kodit të Proçedurës Penale etj.

C. Nga shqyrtimi i ankesave të ndryshme që janë konsideruar të drejta për shkeljet e konstatuara, Avokati i Popullit i ka paraqitur Prokurorit të Përgjithshëm, apo Kryeprokurorëve në rrethe 7 rekomandime, nga të cilat 4 janë pranuar, dhe 3 rekomandime janë refuzuar.

Pra, konstatohet se rekomandimet e Avokatit të Popullit, përgjithësisht janë pranuar. Në mënyrë të grupuar rekomandimet tona drejtuar organit të Prokurorisë, paraqiten si më poshtë:

#### *I. Rekomandime per fillimin e hetimit.*

1. Rekomandim drejtuar Prokurorit të rrethit gjyqësor Tiranë “Për fillimin e hetimit për veprën penale të kryerjes të veprimeve arbitrare parashikuar nga neni 250 e Kodit Penal ndaj punonjësit të Gardës së Republikës”, i cili ka ushtruar dhunë fizike ndaj shtetases Z. K. nga Tirana për arsye se, ajo ishte pjesmarrëse në kohën që zhvillohej manifestimi i Partisë Demokratike, ngjarje e ndodhur më datën 07.02.2004. Organi i Prokurorisë ka vendosur mosfillimin e proçedimit penal bazuar në nenin 290/1 gërma”ç” dhe 291 të Kodit të Proçedurës Penale me arsyetimin se, “veprimet e punonjësit të policisë nuk janë arbitrare dhe janë drejtuar ndaj një veprimi të paligjshëm të shtetases Z. K., veprim i cili ka synuar cënimin e rendit dhe të institucioneve”.

#### *II. Rekomandime për shfuqizimin e vendimit te pushimit të çështjes penale*

1.Rekomandim drejtuar Prokurorit të Përgjithshëm për shfuqizimin e vendimit të pushimit të proçedimit penal Nr. 615 të vitit 2003 të Prokurorisë së rrethit gjyqësor Tiranë.

Rekomandimi bën fjalë për proçedimin penal të filluar mbi materialet e administruara nga Avokati i Popullit, pas ankesës të punonjsve të Fabrikës së tullave “Fabiona” Vorë, për veprat penale të “vjedhjes me anë të mashtrimit” dhe “falsifikimit të dokumenteve shëndetësore”. Organi i prokurorisë ka vendosur pushimin e proçedimit penal me arësyetimin se, “faktet e hetuara nuk përbëjnë vepër penale”, me të cilin ne nuk jemi dakort.

2. Rekomandim drejtuar Prokurorit të rrethit gjyqësor Korçë, për shfuqizimin e vendimit të pushimit të proçedimit penal Nr. 309 të vitit 2003 që bën fjalë për veprën penale të “shkatërrimit të pronës nga pakujdesia”. Rekomandimi është gjetur me vënd dhe është pranuar nga ana e organit të prokurorisë.

3. Rekomandim drejtuar Prokurorit të Përgjithshëm për shfuqizimin e vendimit të pushimit të proçedimit penal Nr. 26 të vitit 2004 të Prokurorisë së rrethit gjyqësor Kavajë. Rekomandimi është pranuar nga ana e organit të prokurorisë.



4. Rekomandim drejtuar Prokurorit të rrethit gjyqësor Vlorë për rifillimin e hetimit të pezulluar të proçedimit penal nr. 64 të vitit 1996, i cili bën fjalë për humbjen e 32 personave nga rrethi i Dibrës në ujrat e detit Jon, ngjarje e ndodhur më datën 9 mars 1996. Pas rifillimit të hetimit, Prokuroria e rrethit gjyqësor Vlorë ka vendosur pushimin e hetimit të proçedimit penal në bazë të ligjit Nr. 8202 datë 27.03.1997 “Për Amnistinë”.

Konstatohet se, ky vendim nuk është rezultat i hetimit të gjithanshëm. Kështu, autoritetet greke nuk konfirmojnë saktë ngjarjen, ndërsa nuk është marrë fare përgjigje letër porosive të autoriteteve të shtetit italian e maqedonas. Nga ana tjetër nuk janë marrë në konsideratë marrja e deklarimeve të disa personave që kanë dijeni për rrethana të dobishme për hetimin, dhe veprime të tjera hetimore cilat janë shprehur qartë në rekomandimin tonë. Mbetet të verifikohet përsëri ky veprim.

### *III. Rekomandim për ngritjen e padisë civile gjatë proçesit penal dhe vendosje sekuestro mbi pasurinë.*

1.Rekomandim drejtuar Prokurorit të rrethit gjyqësor Vlorë, me qëllim marrjen e masave për ngritjen e padisë civile në proçesin penal dhe vendosjen e sekuestros mbi pasurinë e shoqërisë franceze të minierës së bitumit Selenicë, Vlorë.

Rekomandimi lidhet me ngjarjen tragjike të ndodhur në minierën e bitumit Selenicë të Vlorës ku gjetën vdekjen 6 minatorë dhe u plagosën disa të tjerë.

Rekomandimi është pranuar pjesërisht nga organi i prokurorisë duke u ngritur dhe pranuar padia civile nga familjarët e viktimave E.M, R.T etj. Avokati i Popullit për këtë ngjarje tragjike ka gjetur dhe mirëkuptimin e Dhomës të Avokatisë Vlorë, avokatët e së cilës dhanë ndihmën ligjore falas në kryerjen e veprimeve të nevojshme për ngritjen e padisë civile në proçesin penal nga pjestarët e familjeve të viktimave.

### *IV. Rekomandim për ekzekutimin e vendimit të gjykatës.*

1.Rekomandim drejtuar Prokurorit të rrethit gjyqësor Tiranë “Për rishikimin e urdhërit të lëshuar nga prokurori” për ekzekutimin e vendimit Nr. 563 akti të datës 24.07.2001 të gjykatës së rrethit gjyqësor Tirane, në ngarkim të dënuarit B.M.

Rekomandimi është shqyrtuar nga ana e organit të prokurorisë dhe mbasi është gjetur me vënd është pranuar duke u dërguar urdhëri për ekzekutim drejtorisë së burgut ku ndodhej i dënuari.

**D.** Gjatë shqyrtimit të çështjeve që kemi paraqitur për keqtrajtime apo veprime arbitrare të organeve të policisë ndaj qytetarëve organi i prokurorisë ka filluar procedimin penal ndaj personave përgjegjës, por në përfundim ka vendosur pushimin e hetimit. Raste të tilla kanë qënë ankesa e shtetasit L.Y. nga Vlora për nipin e tij K.Y. ndaj të cilit policët e grupit të gatshëm kanë ushtruar dhunë fizike; ankesa e shtetasit F.R nga Lazarati për dëmtime të shkaktuara nga punonjësit e policisë Gjirokastër; ankesa e shtetasës D.K. nga Vlora për ushtrim dhune nga policia e Vlorës ndaj vëllait të saj G.H. etj.

Avokati i Popullit problemet kryesore i ka biseduar e zgjidhur me Prokurorin e Përgjithshëm, zotin Sollaku. Prokurorët e rretheve kanë vlerësuar më me korrektësi rekomandimet tona, por ka patur edhe raste që ngurojnë të dërgojnë informacione apo akte, s'japin për studim dosjet penale për të cilat janë pushuar hetimet prej tyre, por për të cilat ka patur ankesa nga shtetasit.

Veprimtaria e punës së Avokatit të Popullit, në shqyrtimin e ankesave të shtetasve ndaj organit të Prokurorisë ka konsistuar në zbatimin korrekt dhe objektiv të Kushtetutës, ligjit që normon punën tonë dhe ligjit procedural penal.

Qëndrimi ynë është se, duke konstatuar shkeljet reale të të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve që janë subjekte në procesin penal, si dhe duke bashkëpunuar me prokurorinë ato duhet t'i shërbejnë qëllimit të mirë për përmirësimin e punës së prokurorisë dhe ngritjen e saj në nivelet bashkëkohore.

## **5. Ministria e Rendit Publik**

Pranimi dhe shqyrtimi me përparësi dhe me rigorozitet i ankesave dhe kërkesave ndaj organeve të Ministrisë së Rendit Publik dhe të Policisë së Shtetit ka qënë dhe do të vazhdojë të mbetet një nga prioritetet tona kryesore. Kjo jo vetëm për faktin se ky organ i administratës publike përbën strukturën që përfaqëson fuqinë shtrënguese të shtetit, por edhe për vetë specifikën e Policisë Shqiptare, e cila krahas arritjeve pozitive, vazhdon të ketë në radhët e saj elementë të pakulturuar, të papërgatitur profesionalisht, të pa trajnuar me konceptet e shtetit ligjor dhe respektimit të të drejtave të Njeriut, të korrumpuar etj.

Në institucionin tonë për sektorin e policisë gjatë vitit 2004 kanë ardhur gjithsej 163 ankesa, kërkesa apo njoftime. (Në këtë numër nuk përfshihet numri i ankesave të mbartura nga viti 2003). Nga këto, 73 prej tyre janë bërë nga banorë të Tiranës, ndërsa 90 nga banorë të rretheve të ndryshme të vendit. Kanë përfunduar 144 ankesa si vijon: 34 ose rreth 24 % janë zgjidhur në favor, 33 kanë qënë jashtë juridiksionit, 75 kanë qënë të padrejta, kurse 2 ankues kanë hequr dorë. Janë mbartur për shqyrtim në vitin 2005, 19 ankesa.

Gjatë këtij viti për rastet që i kemi vërtetuar shkeljet e ligjit janë bërë 2 rekomandime për fillimin e ndjekjes penale, nga të cilat është pranuar 1, si dhe 4 rekomandime për dhënien e masave disiplinore, të cilat janë pranuar. Në bazë të rekomandimeve tona Prokuroria e Rrethit Shkodër ka filluar ndjekjen penale ndaj disa punonjësve të policisë të Komisarariatit të Policisë Shkodër dhe janë dhënë 5 masa disiplinore ndaj punonjësve të policisë që kanë bërë shkelje të ligjeve, midis të cilëve kanë qënë edhe 3 oficerë. Nga masat e dhëna mund të përmëndim, 2 pezullime nga detyra, 1 shkarkim nga detyra dhe emërim në një detyrë tjetër më të ulët dhe 2 masa të tjera disiplinore.

## **Ankesat e trajtuara ndahen sipas problemeve të mëposhtme:**

### **I. Ankesat për keqtrajtim të shtetasve.**

Këto ankesa janë vlerësuar më tepër sepse kur ato kanë rezultuar të vërteta, kanë qënë shkelje të rënda të nenit 25 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë që parashikon se: *“Askush nuk mund t’i nënshtrohet torturës, dënimit apo trajtimit mizor, çnjerëzor ose poshtërues”*. Njëkohësisht ato janë edhe dhunime të rënda të nenit 3 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Gjithashtu, ia vlen të vemë në dukje faktin se këtë vit, ato kanë qënë rreth 55 % më të pakta në krahasim me vitin e kaluar. Ndikim të konsiderueshëm në uljen e ankesave për keqtrajtime ka patur edhe puna jonë gjatë viteve të kaluara. Rekomandimet e shumta që kemi bërë për ndëshkimin e punonjësve të policisë që kanë ushtruar dhunë, për përgjithësimin e këtyre rasteve në efektivat e Policisë, si dhe bërja publike e tyre në organet e medias kanë patur efekte pozitive në radhët e Policisë.

Në institucionin tonë janë bërë 25 ankesa për keqtrajtime të shtetasve nga Policia e Shtetit, të cilat janë përfunduar të gjitha dhe mënyra e zgjidhjes së tyre është: 7 janë vlerësuar të drejta, 4 kanë qënë jashtë juridiksionit, 13 të pa bazuara dhe 1 ankues ka hequr dorë.

Për rastet kur kemi vërtetuar pretendimet e ankuesve për keqtrajtime nga punonjësit e Policisë kemi bërë rekomandime organeve përkatëse. Gjatë këtij viti, vetëm për rastet e keqtrajtmeve, i janë bërë 2 rekomandime organit të Prokurorisë për fillimin e ndjekjes penale, nga të cilat 1 është pranuar dhe është në hetim.

Si raste të vërtetimit të ankesave për keqtrajtime të shtetasve mund të përmëndim:

1. Ankesa e shtetasit B. K. banues në rrethin e Dibrës, i cili ankohej ndaj punonjësve të policisë të Komisarariatit të Policisë Dibër, Andi Marku, Nuri

Smaçi, Haxhi Hoxha etj, të cilët pas shoqërimit në polici më datë 13.05.2004, kishin kryer veprime të paligjshme ndaj tij duke ushtruar dhunë fizike e psikike.

Nga ana jonë filloi hetimi i kësaj ankese, u shkua në vënd duke bërë dhe verifikimet e nevojshme dhe nga tërësia e veprimeve të kryera rezultoi se:

Më datën 13.05.2004, rreth orës 16.00, punonjësit e policisë së Komisarariatit të Policisë Dibër, kanë shoqëruar për në polici shtetasin B. K. dhe shokun e tij A. G., mbi bazën e dyshimit për vjedhje të një aparati celular në banesën e shtetasit D. K.. Punonjësit e policisë kanë shkuar në fshatin Kabë, kanë gjetur dy personat, të cilëve pasi ju kanë vendosur prangat i kanë shoqëruar në dhomat e paraburgimit në Peshkopi veç nga njëri tjetri.

Rreth orës 20.00 punonjësit e policisë kanë çuar tek një zyrë shtetasin B. K. dhe këtu ai është marrë në pyetje nga inspektori i krimeve Andi Marku dhe inspektori i rendit Nuri Smaçi. Në këtë zyrë shtetasi B. K. është mbajtur rreth 40 minuta, ku sipas shpjegimeve të tij është rrahur në mënyrë çnjerezore. Më konkretisht Andi Marku e ka qëlluar me shkop gome disa herë në bark, shpinë dhe këmbët, bile e ka detyruar të hiqte këpucët, dhe duke qënë zbathur e qëllonte në pjesën e sipërme të këmbëve. Gjithashtu, Andi i ka kapur veshin me pincë duke ja përdredhur. Ndaj shtetasit B. K. ka ushtruar dhunë fizike dhe inspektori i rendit Nuri Smaçi i cili e ka qëlluar me shkop gome në pëllëmbët e duarve dhe i ka shkukur mjekrën me pincë.

Shtetasi B. K. ka sqaruar gjithashtu, se ai është rrahur dhe nga policët e grupit të gatshëm Haxhi Hoxha, Eduard Kaba dhe Elez Plaku, ky i fundit ka qënë civil. Kjo ka ndodhur në momentin kur ai është çuar nga punonjësit e policisë për të gjetur një thikë të tijën, të cilën e kishte hedhur në momentin kur është marrë e shoqëruar për në Komisarariat. Rrahja e tij nga punonjësit e policisë është bërë jo vetëm në automjetin e policisë, por dhe pasi e kanë nxjerë jashtë në afërsi të një përroi.

Në shpjegimet e tij shtetasi A. K. ka sqaruar se është qëlluar me pëllëmbë nga punonjësit e policisë Andi Marku dhe Nuri Smaçi kur është çuar tek një zyrë në Komisariatin e Policisë.

Pas marrjes së deklarimeve të dy shtetasve B. K. dhe A. K. ditën e nesërme më datë 14.05.2004, rreth orës 16.00, ata janë lënë të lirë.

Meqënëse shtetasi B. K. pas daljes nga dhomat e paraburgimit dhe dhunës së ushtruar ka qënë në gjëndje tepër të rëndë, në pamundësi për të lëvizur e bërë kallzim penal, në polici ka shkuar babaj i tij F. K. Por megjithë insistimin e tij nuk i është marrë kallëzimi, dhe nuk i është dhënë vendimi përkatës për vizitë tek mjeku ligjor. Në këto rrethana i dëmtuari B. K. në gjëndjen që ishte ka bërë disa fotografi, tek të cilat dukeshin qartë dëmtimet e shkaktuara nga ushtrimi dhunës.

Pas ankimit të bërë prej tij në Ministrinë e Rendit Publik, ai është ekzaminuar nga mjeku ligjor. Nga akti i ekspertimit mjeko ligjor datë 18.05.20004, rezulton se në trupin e ankuesit konstatohen dëmtime të cilat janë shkaktuar me mjet të fortë dhe që hyjnë në kategorine dëmtimeve që kanë shkaktuar paaftësi të përkohshme për punë më pak se 9 ditë.

Nga shqyrtimi i ankesës së shtetasit B. K. u konstatua se punonjësit e policisë gjatë ushtrimit të detyrës kishin kryer shkeljet ligjore të mëposhtëme:

a) Ushtrim dhune në mënyrë çnjerëzore kryesisht nga punonjësit e policisë Andi Marku, Nuri Smaçi, por edhe nga Haxhi Haxhiu, Eduard Kaba, Elez Plaku. Ky veprim i paligjëshëm vjen ndesh me nenin 27 pika 2 të ligjit Nr. 8553, datë 25.11.1999 “Për Policinë e Shtetit”, ku thuhet shprehimisht se: *“Gjatë përmbushjes së detyrës punonjësit të policisë nuk i lejohet të kryejë ndaj individëve veprime të pabazuara në ligj, ndëshkime ose trajtime çnjerëzore apo denigruese, si dhe çdo lloj torture.”*

b) Vendosja e prangave, në momentin që janë marrë si të shoqëruar, ndonëse prej të dy personave nuk ka patur kundërshtim apo rrezik për ikje.

c) Mbajtja në dhomat e paraburgimit si persona të shoqëruar mbi 10 orë, veprim i cili vjen ndesh me nenin 45, pika 2, të ligjit të sipërpërmëndur “Për Policinë e Shtetit”.

ç) Pasqyrimi jo real i të dhënave të paraqitura në librin e personave të shoqëruar, për kohën e shoqërimit dhe daljen nga policia. Nga kqyrja e librit të shoqërimit të shtetasve në polici u konstatua se shtetasit B. K. dhe A. K. janë shoqëruar në polici në orën 0.5.00 të datës 14.05.2004 dhe janë lënë të lirë në orën 12.45 të po asaj date. Ndërsa në librin e dorëzimit të raporteve të shërbimit ishte shkruar ora 16.45 e datës 13.05.2004, kur të dy shtetasit janë shoqëruar në Polici dhe ora 12.45 e datës 14.05.2004, kur ata janë lënë të lirë.

d) Kryerja e kontrollit të banesës së shtetasit B. K. nga inspektori i policisë Nuri Smaçi ishte bërë në kundërshtim me rregullat proceduriale të parashikuara në nenin 202 të Kodit të Procedurës Penale. Gjithashtu për këtë veprim procedural nuk ishte mbajtur asnjë proces verbal me qëllim pasqyrimin e veprimeve të kryera dhe rezultatit të kontrollit të ushtruar.

Veprimet e dhunës të kryera nga punonjësit e policisë Andi Marku etj, jo vetëm që përbëjnë vepër penale, për të cilën Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Dibër, më datën 28.05.2004, kishte filluar procedimin penal por, ato janë edhe shkelje flagrante e te drejtës kushtetutese të parashikuar nga neni 25 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Në përfundim të hetimit të kësaj ankese i rekomandua Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit marrjen e masës disiplinore të pezullimit nga detyra deri në përfundimin e çështjes penale, ndaj punonjësve të policisë së Komisariatit të Policisë Dibër, Andi Marku, Nuri Smaçi, Haxhi Hoxha, Eduard

Kaba dhe Elez Plaku. Rekomandimi u pranua pjesërisht vetëm për Andi Markun e Nuri Smaçin, për të cilët organi i prokurorisë kishte filluar ndjekjen penale. Në fakt duheshin marrë edhe masa të tjera administrative.

2. Ankesa e shtetasit B. S., banor i rrethit Shkodër. Ai ankohej se në datën 24 Maj, në orën 10 të darkës, i kanë shkuar në shtëpi një grup policësh prej 5 vetësh dhe i kanë bërë kontroll për armë pa patur ndonjë vendim gjyqësor, por nuk kanë gjetur asgjë të ndaluar nga ligji. Pas kontrollit ata e kanë shoqëruar atë në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Shkodër dhe e kanë keqtrajtuar në mënyrë të tmerrshme, duke i lënë shënja enjtje e hematoma sidomos në pjesët e krahëve. Ankuesi pretendonte se, ndonëse emrat e policëve që e keqtrajtuuan nuk i dinte, por ishte në gjëndje t'i identifikonte ata, në se do t'i paraqiteshin për njohje.

Nga ana jonë u bë kqyrja e ankuesit dhe meqënëse konstatuam shënja të dukshme dhune në trupin e tij, vendosëm për ekzaminimin mjeko-ligjor të tij. Instituti i Mjekësisë Ligjore bëri ekzaminimin e tij dhe na dërgoi akt dëshminë mjeko-ligjore nr. 548, datë 27.05.2004. Nga ekzaminimi i ankuesit B. S. u konkludua se në trupin e tij u konstatuan shënja dhune, të shkaktuara me mjet të fort mbretës, koha e shkaktimit të tyre nga kryerja e vizitës ishte jo më shumë se një javë (sqarojmë se ky afat përputhej me pretendimet e tij) dhe se dëmtimet e tij hynin në kategorinë e dëmtimeve që kishin shkaktuar humbje të aftësisë së përkohshme për punë në masën deri në 9 ditë.

Nga hetimet e bëra nga ana jonë dhe akt dëshmia mjeko ligjore, rezultoi se ankuesi ishte keqtrajtuar nga punonjësit e policisë dhe se atij i ishte bërë kontroll i paligjëshëm i banesës. Këto veprime përbënin shkelje të rëndë të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut të mbrojtura dhe garantuara nga neni 25 e 37 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neni 3 të Konventës Europiane për mbrojtjen e drejtave dhe lirive themelore të njeriut, si dhe neni 27, pika 2 të ligjit nr. 8553, dt. 25.11.1999 "Për Policinë e Shtetit". Me veprimet e tyre, si atë të kontrollit të paligjëshëm të banesës dhe përdorimit të dhunës fizike ndaj ankuesit, punonjësit e policisë kishin konsumuar elementët e figurës së veprës penale të kryerjes së veprimeve arbitrare të parashikuar nga neni 250 i K.Penal.

Për këto arsye, i rekomanduam Prokurorisë së Rrethit Shkodër, fillimin e ndjekjes penale në ngarkim të punonjësve të policisë të Drejtorisë së Policisë të Qarkut Shkodër të cilët kishin kryer këto veprime të kundraligjëshme. Rekomandimi u mirëprit, Prokuroria filloi ndjekjen penale dhe çështja është në hetim.

3. Ankesa e shtetasit R.Dh., i cili na shkruante se në datën 8 Janar 2004, duke udhëtuar me makinë, në afërsi të Leskovikut, ishte ndaluar nga postoblloku i policisë, i cili përbëhej nga Komandanti i Postës së Policisë Leskovik Robert Ibrahimimi dhe policët Roland Koroçi e Flamur Guda. Komandanti Robert Ibrahimimi i kishte kërkuar dokumentet, sepse ankuesi nuk

kishte vendosur rripin e sigurimit dhe për këtë e kishte gjobitur me 2000 lekë. Pas vendosjes së gjobës, meqënëse ai i kishte kërkuar sqarime për gjobën, Roberti dhe Rolandi e kishin fyer atë, nxjerë forcërisht nga makina, goditur dhe shoqëruar në Postën e Policisë Leskovik.

Për këtë veprim të kundraligjeshëm të punonjësve të policisë, ai ishte ankuar tek Shefi i Komisarariatit të Policisë Kolonjë dhe Drejtori i Policisë së Qarkut Korçë. Nga Drejtori i Policisë së Qarkut ishte vendosur përjashtimi nga Policia i Roland Koroçit, ndërsa për komandantin Robert Ibrahimimi nuk ishte marë ndonjë masë disiplinore.

Duke e vlerësuar ankesën, i kërkuam Drejtorisë së Policisë të Qarkut Korçë që të bënte verifikime të plota dhe me objektivitet rreth saj, dhe në se pretendimet e ankuesit do të vërtetoheshin, duhet të ndëshkohej me masë disiplinore edhe komandanti Robert Ibrahimimi. Drejtorja e Policisë së Qarkut Korçë na informoi, se me sugjerimin tonë, rastin e shqyrtoi dhe analizoi edhe një herë. Në përfundim të analizës ishte provuar që edhe oficeri i policisë Robert Ibrahimimi kishte përgjegjësi disiplinore dhe për këtë arsye atë e ndëshkoi me masë disiplinore “Vrejtje me paralajmërim”. Gjithashtu, ndaj tij kishte bërë edhe propozim për transferim dhe ulje në detyrë.

4. Ankesa e shtetases Z. K. nga Tirana, e cila ankohej ndaj një punonjësi të Gardës së Republikës për arsye se kishte ushtruar dhunë fizike ndaj saj, tek shkallët e hyrjes së ndërtesës së Kryeministrit, më datën 07.02.2004, në kohën që zhvillohej manifestimi i Partisë Demokratike.

Nga ana jonë filloi hetimi i kësaj ankese, duke i marë deklaratime të hollësishme të dëmtuarës, u muar vendimi për kryerjen e ekspertimit mjekoligjor të saj, si dhe u administrua si provë materiale kaseta filmike e momenteve të ngjarjes, dorëzuar në Institucionin tonë prej ankueses etj.

Nga verifikimet e bëra rezultoi se, shtetësja Z. K., ka marë pjesë në mitingun e organizuar nga Partia Demokratike në sheshin “Skëndërbej” më datën 07.02.2004. Pas foljes së oratorëve të ndryshëm, u tha që protestuesit do të shkonin përballë Kryeministrit e për rrjedhojë dhe ankuesja është nisur me protestuesit e tjerë në atë drejtim.

Në kohën kur protestuesit janë afruar para ndërtesës së Kryeministrit, shtetësja Z. K. ka qënë tek shkallët e hyrjes për tek dera kryesore me gishtat lart dhe me pamje nga protestuesit. Në këtë moment ajo është goditur fortë me qytë arme tek shpatulla e krahut të djathtë dhe pas goditjes ka humbur ndjenjat. Pas rrëzimit ajo është ndihmuar nga persona të panjohur dhe është çuar tek një lokal, ku ka marë ndihmën e nevojshme me kompresa akulli në vëndin e goditur.

Në konkluzionin e aktit të ekspertimit mjekoligjor Nr. 177 datë 12.02.2004, thuhet se “tek e dëmtuara Z. K. konstatohet një ekimozë mbi

këndin e brëndëshëm të shpatullës së djathtë me ngjyrë mavi në të gjelbër me përmasa 2x1 cm. Dëmtimi është shkaktuar me mjet të fortë mbretës dhe hyn në kategorinë e dëmtimeve që nuk kanë shkaktuar humbje të aftësisë së përkohshme për punë, pra rrahje”.

Duke analizuar në tërësi materialet e administruara, vërtetohet plotësisht se punonjësi i Gardës së Republikës ka ushtruar dhunë fizike me anë të goditjes me qytën e automatikut në trup shtetasen Z. K. Me këto veprime ai ka konsumuar elementët e veprës penale të “kryerjes së veprimeve arbitrare”, parashikuar nga neni 250 të Kodit Penal. Në këto rrethana, bazuar në nenin 63/3 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë dhe nenin 21, pika “ç”, të Ligjit Nr. 8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i rekomanduar Prokurorisë së Rrethit Tiranë fillimin e hetimit për veprën penale të “kryerjes së veprimeve arbitrare” parashikuar nga neni 250 të Kodit Penal, ndaj punonjësit të Gardës së Republikës. Rekomandimi ynë nuk u pranua prej organit të prokurorisë, e cila refuzoi fillimin e ndjekjes penale.

## **II. Ankesat për veprime të tjera të paligjshme nga policia.**

Kanë qënë 118 ankesa për veprime arbitrare të punonjësve të policisë, nga të cilat 2 për kontrole të paligjshme banese e lokali; 9 arrestime, ndalime dhe shoqërimë të paligjshme; 20 për mos evidencim apo mos ndjekje të kallzimeve apo të ankesave; dhe 87 për veprime të tjera të kundraligjshme, si për sende të sekuestruara apo bllokuara nga policia; për veprime korruptive; për gjoba të padrejta; mos lejimi i avokatëve të takohen me personat e arrestuar apo ndaluar në polici, etj. Si raste të zgjidhjes pozitive mund të përmëndim:

1. Ankesa e shtetasit të mitur E. K. përfaqësuar nga nëna e tij si kujdestare ligjore, i cili ishte nxënës në vitin e dytë të Shkollës së Mesme të Gjuhëve të Huaja “Asim Vokshi”, Tiranë. Ai na shkruante se në datën 09.02.2004, së bashku me 11 shokë të klasës së tij janë thirrur në Komisarjatit të Policisë Nr. 3, Tiranë nga oficeri i policisë gjyqësore Entiol Xhelilaj. Shkaku i thirrjes së tyre në polici ka qënë kallzimi i bërë nga një mësuese e kësaj shkolle për kanosje për shkak të detyrës. Sipas ankuesit, gjatë kohës që ai dhe shokët e tij kanë qëndruar në polici, me ta janë bërë veprime hetimore, duke ju marrë deklaratime, dorëshkrime, gjurmët e gishtave si dhe është bërë paraqitja për njohje. Të gjitha këto veprime janë realizuar pa prezencën e kujdestarëve ligjore të tyre. Gjithashtu, ai pretendonte se gjatë kësaj kohe ishte fyer, i ishte bërë presion psikologjik dhe ishte goditur me pëllëmbë nga disa punonjës policie. Gjithashtu, ai pretendonte se ishte mbajtur për rreth gjysëm ore në birucat e Komisarjatit në të njëjtin ambjent me dy të ndaluar madhorë.



Nga verifikimet e bëra nga ana jonë në shkollën “Asim Vokshi”, si pyetja e stafit pedagogjik dhe e kallzueses, si dhe në polici, rezultoi se autorë të letrës kërcënuese dërguar mësueses ishin tre nxënës të tjerë, por jo ankuesi E. K. Oficeri i policisë gjyqësore Entiol Xhelilaj nuk pranoi të kishte bërë paraqitje për njohje si dhe t’u kishte marë gjurmët atyre, por pranoi që pa prezencën e prindërit i kishte marë atij model dorëshkrimi me qëllim krahasimi. Ndërsa më pas, në prezencë të të ëmës së E. K. i ka marë deklaramë me cilësinë e personit ndaj të cilit zhvillohen hetime. Këtë deklaramë e ka marë duke u mbështetur mbi deklaramet e shokut të tij të klasës, T. O., sipas të cilit E. K. ishte një nga autorët e përpilimit të këtyre kërcënimeve ndaj mësueses E. B.. Nga pyetja e agjentëve të policisë kriminale Agim Hoxha dhe Servet Gjoshi, të cilët kishin punuar me nxënësit e thirrur në Polici dhe për të cilët ankuesi kishte pretendime, nuk u vërtetua që ankuesi të ishte futur në birucë, fyer apo keqtrajtuar.

Nga verifikimet e bëra rreth moshës së ankuesit dhe nga Çertifikata e tij e lindjes rezultoi se, ai është i datëlindjes 04.03.1988. Në vështrim të neneve 12 e 238 të K.Penal, edhe në se do të rezultonte se E. K. do të ishte autori i bërjes së letrës kërcënuese, ai nuk përgjigjet penalisht, mbasi vepra penale hyn në kategorinë e kundravajtjeve penale, e cila ka si kusht ligjor, që të konsumohet nga persona me moshë 16 vjeç e lartë. Edhe nëse ankuesi do të kishte mbushur moshën e përgjegjësisë penale, në bazë të nenit 296/1 të K.Pr.Penale, të dhënat duheshin marë në praninë e detyrueshme të mbrojtësit të tij.

Ndonëse për këto veprime të parregullta dhe në kundërshtim me kërkesat ligjore, Entiol Xhelilaj shpjegoi se i kishte kryer për shkak të pakujdesisë së rëndë që kishte treguar në trajtimin e rastit, shtuar këtu dhe mbi ngarkesën në punë që kishte patur atë ditë, ai nuk mund të përjashtohej nga përgjegjësia disiplinore.

Këto veprime të tij, përbëjnë shkelje të rëndë ligjore dhe konkretisht të pikave 1 dhe 3 të nenit 54 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet se: *“Fëmijët, të rinjtë, ... kanë të drejtën e një mbrojtje të veçantë nga shteti. Çdo fëmijë ka të drejtë të jetë i mbrojtur nga dhuna, keqtrajtimi...”* dhe të pikës 2 të nenit 27 të ligjit “Për Policinë e Shtetit”, ku thuhet se: *“Gjatë përmbushjes së detyrës punonjësit të policisë nuk i lejohet të kryejnë ndaj individëve veprime të pabazuara në ligj, ndëshkime ose trajtime çnjërzore apo denigruese si dhe çdo lloj torture”*.

Për të rivendosur në vënd dinjitetin e ankuesit dhe duke mbajtur në konsideratë edhe qëndrimin reflektues e pendues të oficerit të policisë gjyqësore Entiol Xhelilaj, i rekomanduam Drejtorit të Policisë të Qarkut Tiranë, që ndaj tij të jepte masë disiplinore, në bazë ligjit nr. 8553, dt. 25.11.1999 “Për Policinë e Shtetit”. Gjithashtu, i rekomanduam që masën disiplinore ta komunikonte në

prani të efektivit të Policisë me qëllim që të parandalohen shkelje të tilla nga punonjësit e policisë në të ardhmen. Rekomandimi u mirëprit dhe u zbatua.

2. Ankesa e shtetasit I. Ll., i cili na shkruante se nga Komisariati i Policisë Nr. 3 Tiranë, në Shtator të vitit 2000, i ishte marë e bllokuar arma e gjahut, të cilën e kishte patur me leje. Ndërsa në datën 23.05.2003, i ishin marë e bllokuar 3 telefona celularë nga Komisariati i Policisë Nr. 2 Tiranë dhe nuk i ishin kthyer megjithë kërkesat e vazhdueshme të tij.

Nga verifikimet e bëra nga ana jonë rezultoi se, arma e gjahut ankuesit i ishte bllokuar sepse në atë periudhë, djali i tij ishte akuzuar nga organi i prokurorisë për një vrasje të mbetur në tentativë. Në momentin që kishte shkuar policia për kapjen e djalit të tij, ai kishte qëlluar ndaj policisë me armë zjarri. Në këto kushte arma i ishte bllokuar sipas ligjit. Por mbajtja e saj për 4 vjet pa kryer asnjë veprim ligjor nuk ishte e drejtë dhe në përputhje me ligjin Nr. 7566, datë 25.05.1992 “Për armët” dhe me Udhëzimin e Ministrit të Rendit Publik Nr. 1288, datë 09.08.2000 “Për mënyrën e dhënies, heqjes, administrimit dhe ruajtjes së armëve e municioneve luftarake, sportive e të gjahut”. Sipas këtyre akteve normative, në se ankuesi i kishte humbur kriteret për mbajtjen e armës së gjahut, atij i duhej hequr leja e mbajtjes së armës nga komisioni përkatës, i cili është i vetmi organ kompetent për të bërë këtë veprim. Gjithashtu, sipas akteve normative të cituara më sipër, kur punonjësit e policisë bëjnë bllokimin e armëve për arësyet e përcaktuara në aktet ligjore e nënligjore, ata detyrohen që t’i dorëzojnë ato brenda 3 ditëve tek specialisti i armatimit dhe jo t’i mbajnë nëpër zyra, siç kishte ndodhur në rastin konkret. Në përfundim të shqyrtimit të kësaj ankese rezultoi që punonjësit e policisë nuk kishin zbatuar procedurat e parashikuara në aktet normative, duke i hequr padrejtësisht atij të drejtën e gëzimit të pronës private (vetjake). Për të rivendosur në vënd të drejtën e shkelur ankuesit, i rekomandua Shefit të Komisarariatit të Policisë Nr. 3 Tiranë, që arma e gjahut dhe leja e saj t’i jepeshin menjëherë pronarit dhe disponuesit të ligjshëm. Ndërsa për aparatet telefonik të bllokuara nga Komisariati i Policisë Nr. 2 Tiranë, rezultoi se ato ishin sekuestruar në kuadrin e procesit penal që ishte zhvilluar ndaj djemve të tij. Në përfundim gjykata me vendim të formës së prerë kishte vendosur kthimin e tyre, por ato për shkak të neglizhencës mbaheshin në Komisariatin e Policisë Nr. 2 Tiranë. Edhe për këto sende i rekomandua Shefit të Komisarariatit të Policisë Nr. 2 Tiranë që t’ia kthente ankuesit. Rekomandimet u mirëpritën dhe sendet e përmëndura më sipër ju dhanë ankuesit.

3. Ankesa e shtetasit E. Sh., i cili na shkruante se dispononte një mjet lundruer (gomone) me dokumente të rregullta konform kriterëve ligjore. Së bashku me ankesën ai na dërgoi edhe dokumentet e saj, si kontratën e blerjes, dëshminë e aftësisë së lundrimit, si dhe dokumente të tjera të nevojshme. Me

këtë mjet ai nuk kishte bërë asnjë lloj aktiviteti, sepse ai kishte qënë jashtë gadishmërisë teknike. Atë e mbante të parkuar në një vënd të garantuar, të cilin e kishte deklaruar në Polici. Policia e kishte miratuar vendin e parkimit dhe ndërkohë kishte ushtruar kontroll herë pas here. Sipas tij, në datën 25.11.2003, Policia Kufitare e Drejtorisë së Policisë Vlorë në kundërshtim flagrant me ligjet dhe rregullat, pa patur asnjë shkak dhe motiv ligjor, ja kishte marrë e bllokuar gomonen. Pas këtij veprimi ai ishte ankuar tek drejtuesit e Policisë së Qarkut Vlorë, por ishte sorollatur prej tyre, i ishte bërë presion për interesat e tyre të ngushta dhe nuk i ishte zgjidhur problemi.

Për zgjidhjen e kësaj ankese ne i kërkuam Drejtorisë së Policisë së Qarkut Vlorë shpjegime për shkaqet ligjore të bllokimit të këtij mjeti. Përgjigjia e saj ishte e përciptë, nuk jepeshin shpjegime për arësyet dhe bazën ligjore të bllokimit të mjetit, por justifikoheshin me faktin se pronari i tij ishte kontigjent??? kishte mangësi në dokumentacionin e mjetit, nuk kishte liçencë dhe se nuk kishte paguar detyrimet tatimore. Meqënëse përgjigjia ishte jo bindëse, përfaqësuesit tanë shkuan në Policinë e Vlorës dhe bënë verifikimet e nevojshme.

Nga verifikimet e bëra rezultoi se ankuesi gjëndjen gjyqësore e kishte të bardhë, pra nuk ishte dënuar ndonjëherë nga organet gjyqësore, dokumentacionin e mjetit e kishte të plotë dhe konform ligjit nr. 8663, datë 18.09.2000 “Për rregjistrimin, klasifikimin, mënyrën e përdorimit dhe kontrollin e mjeteve lundruese me motor me tanazh nën 20 NT”. Pretendimet e Policisë për mungesë të liçencës dhe mos pagim të detyrimeve tatimore nuk kishin bazë ligjore, sepse së pari, një kërkesë e tillë nuk ishte parashikuar në ligjin e cituar më sipër; së dyti, mjetin ai e kishte blerë për përdorim familjar dhe jo për biznes dhe së treti, kontrolli për shlyerje të detyrimeve tatimore është detyrë e Policisë Tatimore dhe jo e Policisë së Shtetit. Gjithashtu kontatuam se nga ana e punonjësve të policisë në rastin konkret nuk ishte mbajtur procesverbal për bllokimin e mjetit dhe shkaqet e bllokimit të tij. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës arritëm në konkluzionin se ankesa ishte e drejtë dhe për këtë arsye i rekomanduam Drejtorit të Policisë së Qarkut Vlorë kthimin e mjetit të bllokuar ankuesit. Rekomandimi u mirëprit dhe mjeti iu kthye pronarit të ligjeshëm. Për punonjësit e policisë që kishin kryer shkeljen e të drejtave të ankuesit nuk kërkuam masa disiplinore, sepse ata sapo ishin shkarkuar nga detyrat për shkelje të tjera ligjore.

4. Njoftimi publik i bërë nga disa organe të medias vizive dhe të shkruar, i cili bënte fjalë për faktin se në datën 06.03.2004, rreth orës 01.00, persona të pamentifikuar, i kanë shkatërruar me eksploziv makinën shtetasit Sh. A., banor i fshatit Lazarat, të parkuar në oborrin e shtëpisë së vet. Ndërkohë, nga shpërthimi i fuqishëm, i ishin dëmtuar rëndë dyert, dritaret dhe suvatimet e

shtëpisë së tij. Megjithëse prej të dëmtuarit dhe Kryetarit të Komunës Lazarat, ishin vënë në dijeni Policia për këtë akt kriminal, kjo e fundit pa shkaqe ligjore nuk shkoi në vëndin e ngjarjes. Mos vajtja e policisë e detyroi ankuesin që ngjarjen e mësipërme ta bënte publike në media.

Pas këtij njoftimi publik, përfaqësuesit tanë shkuan në fshatin Lazarat të rrethit Gjirokastrë, morën takim me të dëmtuarin, i cili bëri ankesë.

Duke u ndodhur përpara kësaj ngjarje të rëndë, si dhe pretendimeve të ankuesit ndaj Policisë Gjirokastrë, rastit i bëmë një vlerësim maksimal.

Përfaqësuesit tanë shkuan në shtëpinë e ankuesit në Lazarat dhe panë vëndin e ngjarjes si dhe dëmtimet e ndodhura. Morën takim me Kryetarin e Komunës, si dhe me inspektorin e policisë së fshatit Ilir Gërveshin dhe ndihmësin e tij Saliko Dalani. Punonjësit e policisë shpjeguan se sapo kishin shkuar në vëndin e ngjarjes, kishin njoftuar në telefon Komisariatin e Policisë për ngjarjen e ndodhur dhe kishin kërkuar ardhjen e grupit hetimor. Mirëpo ankuesi nuk pranonte grupin hetimor, sepse nuk kishte besim tek policia dhe pretendonte se do ta gjente vetë autorin. Në këto kushte punonjësit e policisë kishin njoftuar Komisariatin e Policisë se ankuesi nuk donte që të vinte grupi hetimor.

Përfaqësuesit tanë morën takim edhe me drejtuesit e Policisë Gjirokastrë, Drejtorin Nuredin Begaj, Shefin e Komisarariatit Edmond Targaj, si dhe me Shefin e Laboratorit Kriminalistik Afuz Basha, i cili është bashkëfshatar i ankuesit. Ata shpjeguan se sapo morën njoftim për ngjarjen kërkuar që atje të shkonte grupi hetimor, por ankuesi nuk kishte pranuar. Duke mbajtur parasysh marrëdhëniet e acaruar të Policisë me këtë fshat, duke marrë edhe mendimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë, për të mos acaruar këto marrëdhënie, nuk e dërguan grupin hetimor.

Gjithashtu përfaqësuesit tanë u takuan edhe me prokurorin e rrethit Gjirokastrë, të cilit pasi i shpjeguan problemin, i kërkuar që të ngrihej grupi hetimor dhe të dërgohej në vëndin e ngjarjes.

Meqënëse pretendimet e ankuesit për dërgimin e grupit hetimor ishin të ndryshme nga shpjegimet e punonjësve të policisë, u bë ballafaqim midis tyre. Ankuesi Sh. A. pranoi se duke qënë shumë i tronditur nga ngjarja e ndodhur dhe duke mos patur besim tek policia kishte thënë që të mos vinte grupi hetimor. Ndërkohë ai ra dakort që grupi hetimor të shkonte në shtëpinë e tij e të bënte veprimet përkatëse.

Në përfundim, mbi kërkesën tonë, u bë e mundur që të ngrihej grupi hetimor me pjestarë të policisë dhe të prokurorisë, të cilët shkuan në shtëpinë e ankuesit, ku në prezencë të tij, të Kryetarit të Komunës, të shumë bashkëfshatërëve të tyre dhe të përfaqësuesve tanë u bë kqyrja e vëndit të ngjarjes.

Veç sa sipër, Kryetari i Komunës Lazarat informoi përfaqësuesit tanë, se në këtë fshat kohët e fundit kishin ndodhur disa ngjarje kriminale, si vjedhja e shkollës, djegia e zyrës së tij, vjedhja e një dyqani, dëmtimi i një makine tjetër me lëndë plasëse dhe se marrëdhëniet e tij me drejtuesit e Policisë ishin jo normale. Duke e vlerësuar seriozisht këtë problem, përfaqësuesit tanë arritën të bënin të mundur komunikimin e tij me Drejtorin e Policisë dhe në prezencën e tyre ata ranë dakort që të takoheshin herë pas here dhe të bashkëpunonin për problemet shqetësuese të cënimit të rendit në këtë komunë.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese dhe në takimet e bëra me personat e lartpërmëndur, si dhe me qytetarë të ndryshëm të Komunës Lazarat, ata shprehën falenderimet e sinqerta ndaj institucionit tonë si për ndjekjen e këtij problemi, ashtu edhe të problemeve të tjera që kanë patur banorët e kësaj komune lidhur me shkeljen e të drejtave dhe lirive themelore nga organet e administratës publike.

5. Ankesa e shtetasit F.Sh. me moshë 70 vjeç, nga Tepelena, ndaj punonjësit të policisë Valter Bizhga, efektiv i Komisarariatit të Policisë Tepelenë.

Sipas ankuesit, në dt. 20.03.2004, ai ka qënë duke tregëtuar gazeta në afërsi të agjensisë Tepelenë dhe se ishte kërcënuar, shtyrë dhe rrëzuar në tokë nga punonjësi i policisë. Nga ky veprim i punonjësit të policisë, atij i ishte shkaktuar frakturë në krah dhe se ky veprim kishte indinjuar të pranishmit në ngjarje. Ankuesi pretendonte se kishte kërkuar takim me Shefin e Komisarariatit të Policisë Tepelenë, por nuk kishte mundur ta takonte. Gjithashtu, ai na shkruante se për këtë veprim të punonjësit të policisë kishte bërë disa ankesa në M.R.Publik dhe në organe të tjera, por nuk kishte marë asnjë përgjigje prej tyre.

Nga ana jonë ankesa u vlerësua seriozisht dhe për këtë nisëm shqyrtimin e saj. Nga verifikimet e bëra rezultoi, se pretendimet e ankuesit për shtyrje nga punonjësi i policisë dhe shkaktim frakture nuk qëndronin. Ndërmjet ankuesit dhe punonjësit të policisë, si dhe në prezencë të Shefit të Komisarariatit të Policisë Tepelenë u bë edhe një ballafaqim. Në përfundim të shqyrtimit të këtij rasti u provua se punonjësi i policisë nuk kishte komunikuar në mënyrë korrekte dhe etike me ankuesin dhe se për këtë sjellje nuk kishte vënë në dijeni eprorët e tij. Për të rivendosur në vënd dinjitetin e ankuesit dhe për të parandaluar veprime të tilla të punonjësve të tjerë të policisë me qytetarët, i rekomanduam Shefit të Komisarariatit të Policisë Tepelenë, që punonjësit të policisë Valter Bizhga t'i jepej masë disiplinore dhe kjo masë t'i komunikohet para efektivit. Rekomandimi u mirëprit dhe atij ju dha masë disiplinore.

6. Ankesa e disa gazetarëve, korrespondentë të Qarkut Fier. Ata pretendonin se nga ana e Drejtorisë së Policisë së Qarkut Fier nuk mbahej qëndrim korrekt lidhur me dhënien e informacionit për veprimtarinë e saj për mbrojtjen e rendit dhe të sigurisë publike. Sipas tyre, komunikimi me mediat

nga zëdhënësi nuk bëhej në ambjente e mënyra të përshtatëshme dhe se ata prisnin me orë të tëra pas derës së policisë për të marrë komunikatën. Informacioni në disa raste nuk jepej, në disa raste jepej i vakët dhe në disa raste të tjera bëhej diferencim sipas preferencave për mediat. Gjithashtu, ata pretendonin se këto probleme jua kishin bërë prezent disa herë Drejtorit të Policisë së Qarkut Fier, por ai nuk kishte bërë ndonje reagim pozitiv dhe përmirësim në mënyrën e dhënies së informacionit.

Ankesën e vlerësuam me seriozitet, sepse kishte të bënte me të drejtën e çdo shtetasi për t'u informuar për veprimtarinë e organeve të administratës publike, pjesë e të cilës është edhe Policia e Shtetit. Në të njëjtën kohë kishte të bënte edhe me mospërbushje të detyrimeve ligjore të Policisë, të parashikuara në nenin 57 të Ligjit Nr. 8553, dt. 25.11.1999 "Për Policinë e Shtetit", ku parashikohen marrëdhëniet me publikun dhe informimi rregullisht i tij për detyrat që ajo kryen.

Për këtë problem i kërkuam shpjegime Drejtorisë së Policisë së Qarkut Fier dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë. Në të njëjtën kohë, për arësyet e përshkruara më sipër, sugjeruam që problemi të analizohej me seriozitet e përgjegjësi dhe të zgjidhej sa më shpejtë. Nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë u informuam se ankesa ishte e drejtë dhe ndërkohë premtorin përmirësimin e ambjenteve dhe të mënyrës së dhënies së informacionit publikut dhe medias nga organet e Policisë. Gjithashtu na informoi se, për mangësitë e konstatuara lidhur me këtë problem, ishte shkarkuar nga detyra zëdhënësi i Drejtorisë së Policisë së Qarkut Fier.

### **III. Ankesat për largime nga puna të punonjësve të M.R.Publik dhe të Policisë së Shtetit.**

Në Institucionin tonë kanë paraqitur ankesa 33 oficerë, policë dhe punonjës të tjerë të strukturave mbështetëse të M.R.Publik për largime të padrejta nga puna. Sipas tyre, ankuesve nuk ju është komunikuar motivacioni dhe shkaqet ligjore të largimit nga puna, nuk janë thirrur e dëgjuar sipas procedurave përkatëse kur ju jepen masa disiplinore. Ndërsa në disa raste të tjera atyre ju atribuohen motivacione të pavërteta, subjektive dhe denigruese.

Gjatë vitit 2004 nga autoritetet e M.R.Publik dhe të Policisë së Shtetit është propaganduar kryerja e reformës në Polici. Mirëpo, në fakt nga krerët e tyre nuk janë publikuar kriteret ligjore të saj, nuk ka patur transparencë dhe objektivitet gjatë këtij procesi të rëndësishëm për të pastruar radhët e Policisë nga të pa aftët dhe të korruptuarit. Në emër të reformës apo luftës kundër korrupsionit, për të vendosur rend brenda rendit, figura të rëndësishme të

Policisë së Shtetit, si drejtorë apo shefa komisariati janë shkarkuar nga detyra, përjashtuar nga Policia apo kallzuar për ndjekje penale. Ky fenomen, për veç pasojave negative që ju sjell të ndëshkuarëve, duke ju ndërprerë marrëdhëniet e punës, sjellë në të njëjtën kohë edhe pasoja morale dhe humbjen e besimit të publikut ndaj këtyre organeve. Gjithashtu, ai i shkakton edhe një dëm të konsiderueshëm ekonomik buxhetit të shtetit në përgjithësi dhe buxhetit të vetë këtyre organeve në veçanti. Krerëve të M.R.Publik dhe të Policisë duhet t'ju tërheq vëmëndjen fakti, se shumë nga të akuzuarit dhe të përjashtuarit nga Policia, kanë fituar pafajësinë nga organet e drejtësisë për akuzat e bëra dhe/apo të drejtën e dëmshpërblimit në rrugë gjyqësore për përjashtim të padrejtë nga Policia. Edhe ky fakt është një tregues real, se akuzat e ngritura apo përjashtimet për shumë punonjës policie nuk kanë qënë të motivuara dhe të bazuara në ligj e në prova. Shkarkimet nga detyra të drejtuesve të Policisë pa mbushur disa muaj në vëndin e punës nuk mund të ndikojnë në rritjen e besimit publik ndaj Policisë. Edhe në se ato bëhen të drejta për shkak të shkeljeve ligjore apo të Kodit Etik, përseri ka vënd për kritika, sepse personat e tillë nuk janë studjuar mirë para emërimit në detyrë. Gjithashtu, kjo është edhe një tregues i faktit se emërimet në detyra të punonjësve të policisë nuk bëhen gjithmonë mbi bazë të kriterëve ligjore, profesionale e morale njëkohësisht, por mbi baza njohjesh personale e për interesa të ngushta.

Si shëmbuj të zgjidhjes pozitive në favor të ankuesve mund të përmëndim:

1. Ankesa e shtetasit Sokol Myrto ish inspektor i policisë kriminale në Komisariatin e Policisë nr. 4 Tiranë. Ai na shkruante se me urdhërin nr. 535, datë 04.03.2004, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit ishte përjashtuar nga Policia me motivacionin “Për shkelje të betimit dhe abuzime të rënda me atributet e policisë dhe me mirëbesimin e publikut”. Shkak për përjashtimin e tij ishte bërë një informacion i bërë nga Shefi i Komisarariatit të Policisë Nr. 4 Tiranë Bujar Laze, i cili bënte fjalë për veprime abuzive të kryera nga ankuesi në disa raste.

Nga verifikimet e bëra nga ana jonë rreth të gjitha problemeve të ngritura ndaj tij në këtë informacion, nuk rezultoi që ai të kishte kryer ndonjë shkelje ligjore për të cilat bëhej fjalë në informacionin e mësipërm. Kështu p.sh mund të përmëndim problemet e mëposhtëme të cilat i atribuoheshin atij:

a) Për vjedhjen e një makine tip “Audi” në muajin Shtator 2003, ai akuzohej se kishte kapur makinën dhe vjedhësin dhe se e ka lënë atë të lirë, duke hyrë në marrëdhënie mitmarrje.

Lidhur me këtë rast nuk na u paraqit asnjë provë apo informacion qoftë edhe konfidencial nga drejtuesit e Policisë, autorë të informacionit.

b) Për rastin e përdhunimit të një femre nga Fushë-Mëzezi në muajin Qershor 2003, atij i ishte deleguar hetimi i dosjes nga Prokuroria, por akuzohej se gjatë hetimit kishte ndërhyrë tek e dëmtuara për të tërhequr kallzimin, pasi përdhunuesi i ka dhënë një shumë të konsiderueshme lekësh dhe për pasojë çështja është pushuar dhe autori është lënë i lirë.

Në fakt, nga studimi i materialeve të çështjes penale nr. 1645 të vitit 2003, që i përket këtij rasti, rezultoi se ankuesi i ka kryer të gjitha veprimet proceduriale lidhur me hetimin e veprës penale dhe se çështja është pushuar nga prokuroria për shkak se nuk është provuar që i dyshuari A. Sh. të jetë autor i kësaj vepre penale dhe jo për shkak të tërheqjes së kallzimit nga e dëmtuara L. T., siç bëhej fjalë në informacionin e eprorëve të tij. Gjithashtu theksojmë, se e dëmtuara ishte e mitur dhe në të tilla raste çështja ndiqet kryesisht e nuk mund të pushohet me heqje dorë, siç pretendohet.

c) Për rastin e vjedhjes së makinës tip “Benz” të shtetasit D. Ç. në Janar 2004, akuzohej se i ka kthyer makinën të dëmtuarit kundrejt marjes së një shume të konsiderueshme lekësh nga autori i vjedhjes.

Nga verifikimi i rastit rezultoi se S. M. në rrugë operative ka mësuar autorin e vjedhjes dhe e ka shoqëruar atë në polici, por i dëmtuari nuk ka bërë kallzim megjithë përpjekjet e S.M. për ta bindur atë për bërjen e kallzimit. Dhe pa patur kallzimin nga i dëmtuari nuk mund të bëhej asnjë veprim procedural me të dyshuarin. Përveç kësaj nuk na u paraqit asnjë informacion apo provë për marje mite nga S. M.

ç) Për rastin e vjedhjes së banesës së shtetasit D. B. me banim në Fushë-Mëzez, ai akuzohet se gjatë hetimit të çështjes ka kontaktuar me autorin G. P. dhe ka marrë përsipër mbylljen e kësaj çështjeje kundrejt një shumë të madhe lekësh. Për këtë, ai ka shkuar në shtëpinë e të dëmtuarit i ka kthyer në lekë vlerën e sendeve të vjedhura dhe më pas i dëmtuari është dërguar tek një noter dhe ka bërë deklarime në favor të vjedhësit. Vjedhësi është kapur më pas dhe në polici ka deklaruar se e ka mbyllur çështjen pasi kishte paguar një shumë lekësh në polici dhe në prokurori dhe pasi avokati i tij ka sjellë urdhërin e lirimit ai është lënë i lirë.

Në fakt nga studimi i materialeve të procedimit penal nr. 386 të vitit 2003, i cili i përket këtij rasti, rezultoi se autori i vjedhjes G. P. është vetëdorëzuar në polici. Ai është gjykuar dhe dënuar me gjobë për vjedhjen e bërë. Nga studimi i dosjes dhe verifikimet e bëra në Prokurorinë e Rrethit Tiranë nuk rezultoi që i dëmtuari D. B. të ketë bërë kallzim për veprime të kundraligjeshme të kryera nga punonjësi i policisë. Gjithashtu nga drejtuesit e Komisarariatit të Policisë nr. 4 Tiranë nuk na u paraqit ndonjë dokument apo informacion që të kompromentonte S. M. për marje mite apo kryerje të veprimeve të tjera të paligjeshme.



d) Për rastin e vënies së gjobës nëpërmjet telefonit celular drejtorit ekzekutiv të Coca Cola-s nga shtetasi A. Sh., S. M. akuzohej se ka mbajtur në të gjitha veprimet proceduriale agjentin e tij D. Sh., i cili është kushuriri i parë i autorit. S.M-së i ishte dhënë detyra që të shkonte në Vlorë e të bënte kontrollin e banesës së autorit A. Sh., detyrë të cilën nuk e realizoi duke u justifikuar me një aksident të ndodhur gjatë rrugës në fshatin Golem të Lushnjes.

Nga përgjigjia e Prokurorisë së rrethit Tiranë e dt. 24.04.2004, rezultoi se në veprimet proceduriale që ka bërë S. M. lidhur me këtë ngjarje, ka patur të pranishëm agjentin D. Sh. vetëm në kryerjen e kqyrjes së telefonit të të dëmtuarit L. V. Ndërsa nga verifikimet e bëra nga ana jonë në Komisariatit e Policisë Lushnje, rezultoi se S. M., duke udhëtuar me makinën e tij, kishte dalë nga rruga dhe makina ishte dëmtuar dhe me të nuk mund të udhëtohej. Gjithashtu nga drejtuesit e Komisariatit të Policisë nr. 4 nuk na u paraqit asnjë dokument që të provonte lidhjen e gjakut, siç pretendohet, ndërmjet autorit A. Sh. dhe agjentit D. Sh..

Përveç sa sipër të bërë nga ana jonë, problemet e ngritura ndaj S. M., ndonëse me vonesë, janë ndjekur e verifikuar edhe nga ana SHKB-së. Nga informacioni që morëm nga ky shërbim u informuam se edhe nga ana e tyre nuk ishte provuar asnjë nga abuzimet për të cilat punonjësi i policisë S. M. ishte përjashtuar nga Policia.

Gjatë trajtimit të kësaj ankese konstatuam gjithashtu, se nga drejtuesit e Komisariatit të Policisë nr. 4 Tiranë dhe ata të Drejtorisë së Policisë së Qarkut Tiranë, në rastin e konkret janë shkelur dispozitat e ligjit nr. 8749, datë 01.03.2001, “Për Shërbimin e Kontrollit të Brendëshëm në M.R.Publik”. Në nenin 7 të këtij ligji është përcaktuar *detyrimi ligjor i çdo punonjësi të Policisë së Shtetit ose i M.R.Publik, që, kur për shkak të detyrës vihet në dijeni se, po përgatitet, po kryhet ose është kryer një vepër penale nga punonjësit e këtyre strukturave, detyrohet të njoftojë Shërbimin e Kontrollit të Brendëshëm*. Në fakt në rastin e S. M., SHKB-ja është njoftuar pasi nga organi i emërtesës së Drejtorisë së Policisë të Qarkut Tiranë ishin kryer të gjitha formalitetet për përjashtimin e tij.

Në përfundim të verifikimeve rreth kësaj ankese arritëm në përfundimin se përjashtimi nga Policia i shtetasit S. M. është i pa drejtë dhe pa mbështetur në ligj dhe në prova.

Për të bërë të mundur rivendosjen në vënd të të drejtës që i është shkelur ankuesit, i rekomanduam Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit ripranimin në Polici të shtetasit S. M. Rekomandimi është bërë kohët e fundit dhe është në shqyrtim.

2. Ankesa e shtetasit Sh. Sh. ish kuzhinjer tek Instituti M.P.Q. Policise. Në muajin Maj 2004, me urdhër të Drejtorit të këtij Instituti, ai ishte larguar nga puna me motivacionin se në të njëjtin vënd pune ishte edhe kushuriri i tij i parë.

Nga shqyrtimi i ankesës dhe verifikimet përkatëse që u bënë nga ana jonë në vëndin e punës së tij dhe në Drejtorinë e Personel Formimit dhe atë të Burimeve Njërëzore në M.R.Publik, rezultoi se largimi i tij nga puna formalisht ishte mbështetur në urdhërat e Ministrit të Rendit Publik dhe të Zv/Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë. Sipas urdhërave të mësipërme, kur në një sektor apo repart punonin persona të cilët ishin të afërt midis tyre, njëri prej tyre duhej të largohej nga detyra. Largimi do të bëhej pasi atij t'i ofrohej më parë një vënd tjetër pune, dhe në se do të kundërshtonte vajtjen në vëndin e ri të punës dhe në pamundësi të sistemimit brënda radhëve të tyre, atëhere ai mund të largohej nga detyra. Në fakt nga punëdhënësit e tij nuk ishin zbatuar dispozitat e Kodit të Punës dhe njëkohësisht edhe dy urdhërat e cituar më lartë. Konkretisht, ai nuk ishte njoftuar në afatin e parashikuar në Kodin e Punës për largimin nga puna, por në të njëjtën kohë nuk i ishte ofruar një vënd tjetër pune, para se ta largonin nga vëndi i punës ku ishte i punësuar, siç parashikohej në 2 urdhërat e cituara më sipër. Për këto arsye nga ana jonë u rekomandua strukturave përkatëse rikthimi i ankuesit në punë. Rekomandimi u mirëprit dhe ankuesi u rikthye në vëndin e punës.

#### **IV. Ankesat për mos zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë.**

Ky problem tashmë është i njohur dhe i pranishëm pothuajse në të gjitha organet e administratës publike shqiptare. Kështu për vitin 2004 ndaj Ministrisë së Rendit Publik dhe institucioneve apo organet e tjera në varësi të saj janë bërë 9 ankesa për mosekzekutim të vendimeve gjyqësore për kthimin në punë, për dëmshpërblimin për kohën e qëndrimit pa punë, si dhe për dëmshpërblimin për përjashtim të pa drejtë nga Policia. Megjithëse zbatimi i vendimeve gjyqësore është një detyrim kushtetues, përsëri ndaj tij nuk po tregohet vullneti dhe serioziteti i duhur. Si raste të zgjidhjes pozitive mund të përmëndim:

1. Ankesa e shtetasit Gj. Gj. ish punonjës policie në Repartin RENEA, i cili ishte përjashtuar nga Policia me udhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë. Ai na shkruante, se pas përjashtimit nga Policia, kishte bërë padi në gjykatë. Në përfundim të gjykimit ishte vendosuar, se përjashtimi i tij nga Policia ishte i padrejtë dhe ndërkohë detyrohej Drejtora e Përgjithshme e Policisë që të paguante në favor të tij pagën e një viti pune. Ky vendim ishte lënë në fuqi edhe nga Gjykata e Apelit Tiranë. Vendimi ishte i formës së prerë

dhe për këtë ishte lëshuar edhe Urdhëri i ekzekutimit të tij. Meqënëse vendimi nuk ishte ekzekutuar vullnetarisht nga ana e Policisë, ai i ishte drejtuar Zyrës së Përmbarrimit Tiranë, e cila megjithëse kishte bërë përpjekje për ta ekzekutuar atë, nuk kishte mundur ta bënte sepse nga ana e Policisë ishin sjellë pengesa të pajustificura nga ana ligjore. Edhe pasi Zyra e Përmbarrimit kishte bërë disa veprime dhe i kishte dërguar edhe dokumentet e kërkuara prej Policisë, përsëri vendimi gjyqësor nuk ishte ekzekutuar, duke shkelur hapur nenin 142/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet se: “*Organet e shtetit janë të detyruara të ekzekutojnë vendimet gjyqësore*”.

Të ndodhur në këto kushte dhe duke vlerësuar të drejtë ankesën, i rekomanduam Drejtorisë së Buxhet-Financës dhe asaj Juridike të M.R.Publik që të zbatonin detyrimin kushtetues dhe civil, duke ekzekutuar vendimin gjyqësor në favor të ankuesit. Rekomandimi u mirëprit dhe u vu në zbatim.

2. Ankesa e shtetasit S. B., ish oficer i M.R.Publik në Gardën e Republikës. Ai na shkruante se me urdhërin e M.R.Publik, datë 29.08.2000, ishte liruar padrejtësisht nga detyra. Pas liritimit nga detyra, ankuesi kishte bërë padi në gjykatë ndaj M.R.Publik. Në përfundim të gjykimit të çështjes, me vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, ishte vendosur anulimi i Urdhërit të Ministrit të Rendit Publik dhe detyrimi i M.R.Publik të paguajë në favor të tij pagën për kohën e qëndrimit padrejtësisht pa punë nga data 30.08.2000 deri në rifillimin e punës. Vendimi kishte marrë formë të prerë dhe për zbatimin e tij, nga Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë ishte lëshuar edhe urdhëri i ekzekutimit. Ankuesi pretendonte, se megjithëse kishte bërë përpjekje të vazhdueshme për ekzekutimin e këtij vendimi nga M.R.Publik, por ai nuk ishte zbatuar plotësisht. Ai kishte marrë pagën për qëndrimin pa punë, ndërsa në punë nuk ishte rikthyer.

Nga ana jonë pasi u bënë verifikimet përkatëse lidhur me dokumentacionin dhe pretendimet e ankuesit arritëm në konkluzionin se ankuesi kishte plotësisht të drejtë. Për të bërë të mundur rivendosjen në vënd e të drejtave të tij të shkelura nga strukturat e M.R.Publik, i rekomanduam atyre që vendimi gjyqësor i cituar më sipër të ekzekutohej plotësisht në favor të ankuesit S.B. edhe për sa i përket kthimit të tij në punë. Rekomandimi u mirëprit dhe ankuesi u rikthye në strukturat e Gardës së Republikës.

3. Ankesat e shtetasve R. T., R. Ç. dhe H. B. ish oficerë të Ministrisë së Rendit Publik dhe të Policisë së Shtetit, të cilët ishin përjashtuar nga policia. Ata pas përjashtimit nga Policia kishin bërë padi në gjykatë dhe me vendim të formës së prerë ishte vendosur rikthimi i tyre në punë dhe dëmshpërblimi për kohën e qëndrimit të papunë deri sa të riktheheshin në punë. Megjithë përpjekjet e tyre edhe nëpërmjet Zyrës së Përmbarrimit për t’u rikthyer në punë, vendimet gjyqësore në favor të tyre nuk ishin zbatuar nga M.R.Publik dhe Drejtoria e

Përgjithshme e Policisë së Shtetit. Nga ana jonë ju kërkua shpjegime M.R.Publik dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit lidhur me këto ankesa.

Në përgjigjet e tyre, ndërmjet të tjerave shprehej se:

“Ata nuk mund të meren në polici sepse nuk kanë kryer kursin e kualifikimit përkatës policor sipas ligjit “Për Policinë e Shtetit”, si dhe për shkak të motivacionit të përjashtimit.

Vendimet gjyqësore të Gjykatës së Lartë janë unifikuese dhe si të tilla janë të detyrueshme për t’u zbatuar në radhë të parë dhe mbi të gjitha nga vete gjykatat e shkallëve me të ulta, pastaj për organet e tjera shtetërore bazuar në nenin 142, pika 3 e Kushtetutës.

Prandaj sa më sipër ne zbatojme atë pjesë të vendimit gjyqësor që është në përputhje me ligjin. Nuk ka asnjë dispozitë ligjore që na detyron të zbatojmë një vendim gjyqësor që është në kundërshtim me ligjin. Nuk është përgjegjësia e jonë që Vendimet Unifikuese të Gjykatës së Lartë nuk njihen nga Gjykatat më të ulta”.

Përgjigjet e mësipërme ndonëse nga ana formale i referohen Kushtetutës dhe ligjeve, në fakt nuk janë korrekte dhe të mbështetura në ligj për arsye se:

a) Detyrimi kushtetues i Policisë (si organ i administratës publike) për të ekzekutuar vendimet gjyqësore është sanksionuar në nenin 142/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet se: “Organet e shtetit janë të detyruara të ekzekutojnë vendimet gjyqësore”. Pra, nga kjo dispozitë kushtetuese kuptohet qartë se zbatimi i vendimeve gjyqësore, qoftë edhe për rikthimin në punë, nuk varen nga vullneti i punëdhënësit, por është një detyrim kushtetues.

b) Kryerja e kursit policor është detyrim për ata persona që fillojnë punë (lidhin marrëdhëniet e punës) për herë të parë në Polici. Ndërsa në rastet konkrete që po trajtojmë nuk jemi në këto kushte, por në vazhdimin e marrëdhënieve të punës të lidhura më parë, madje para hyrjes në fuqi të ligjit “Për Policinë e Shtetit”.

c) Me vendimet gjyqësore janë rrëzuar plotësisht edhe motivacionet e përjashtimit të ankuesve nga Policia.

ç) Vendimet e Gjykatës së Lartë nuk janë të gjitha unifikuese, siç shprehet Drejtoria e Policisë në përgjigjet e saj, por të tilla, në bazë të nenit 141/2 të Kushtetutës janë, *ato që meren nga Kolegjet e Bashkuara ku shqyrtohen çështje të caktuara gjyqësore, për njësimin ose ndryshimin e praktikës gjyqësore*. Pra, Vendimet Unifikuese shërbejnë vetëm si praktikë gjyqësore për organet gjyqësore, për çështjet me objekt të njëjtë që do të gjykohen në të ardhmen prej tyre. Ato nuk kanë dhe nuk mund të kenë fuqi prapavepruese. Po kështu duhet theksuar *se ato nuk kanë fuqi juridike për*

*shfuqizimin e vendimeve gjyqësore të dhëna më parë dhe që kanë marrë formë të prerë, siç jemi në rastet konkrete (për të qënë të saktë nënvizojmë se Vendimi Unifikues i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr. 31, për të cilin është fjala, është i datës 14.04.2003, ndërsa vendimet lidhur me ankuesit janë para kësaj date).*

d) Asnjë dispozitë kushtetuese apo ligjore nuk i jep të drejtën organeve shtetërore (përfshi edhe Policinë e Shtetit”) që të bëjnë vlerësimin e vendimeve gjyqësore si të ligjëshme apo të kundërligjëshme. Këtë të drejtë ligjore e kanë vetëm organet gjyqësore më të larta. E drejta ligjore e çdo pale ndërgjyqëse, bazuar në nenin 112 të K.Pr.Civile, për të parashtruar kundërshtimet e saj ndaj vendimeve të Gjykatave të Shkallës së Parë dhe të Apelit, të cilat janë në favor të ankuesve, është akti i rekursit në Gjykatën e Lartë, i cili siç rezultoi nuk ishte shfrytëzuar nga Policia.

Për të bërë të mundur rivendosjen në vënd të të drejtës kushtetuese dhe civile që ju ishte shkelur ankuesve, i rekomandua Ministrit të Rendit Publik dhe Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit ekzekutimin e plotë të vendimeve gjyqësore në favor të ankuesve. Mirëpo edhe pas rekomandimit tonë, nuk u bë i mundur zbatimi i vendimeve gjyqësore.

Të ndodhur në këto kushte, nga ana jonë iu bë rekomandim Kryeministrit që të ushtrojë autoritetin e tij, që të urdhërojë Ministrin e Rendit Publik për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Rekomandimi është bërë kohët e fundit dhe jemi në pritje të kthimit të përgjigjes.

## **V. Ankesat për procedurat e marrjes dhe lënies së shtetësisë.**

Pranë institucionit të Avokatit të Popullit janë depozituar disa ankesa të cilat kanë të bëjnë me procedurat e shtetësisë. Në shumicën e rasteve ka rezultuar se zvarritjet më të mëdha burokratike vinin nga Policinë e Qarkut dhe nga punonjësit e këtyre Drejtorive, të cilët ishin ngarkuar të punonin, përveç procedurave të pajisjes me pasaporta edhe me procedurat që kanë të bëjnë me shtetësinë. Por nga hetimet pranë këtyre zyrave rezultoi se këta punonjës i jepnin më shumë “përparësi” procedurave të pasaportave se sa atyre që kishin të bënin me procedurat e shtetësisë. Ka mangësi në sportelet e informimit, oraret përkatëse dhe mënyra e komunikimit, shpjegimet dhe sqarimet lënë shumë për të dëshiruar, duke shkelur Udhëzimin e Ministrit të Punëve të Jashtme dhe Ministrit të Rendit Publik, të datës 27.11.2001.

Punonjësit e Policive të Qarkut që kryejnë këto detyra, rezultonte të ishin të patrajnuar për këtë detyrë. Këtë konkluzion e provon katërcipërisht fakti se nga punonjësit e policisë pranohen aplikime dhe dokumentacion me shumë mangësi. Ato pasi pranohen i dërgohen sektorit përkatës në Drejtorinë e

Përgjithshme të Policisë. Nga ky sektor në shumë raste janë konstatuar mangësi ligjore dhe për këtë arsye dokumentacioni ju rikthehet Drejtorive të Policisë së Qarqeve dhe vetë këto ja kthejnë aplikuesve për plotësim. Mirëpo kjo procedurë sjellë humbjen e kohës dhe në disa raste edhe pavlefshërinë ligjore të disa dokumenteve për shkak të skadimit të afatit kohorë, pa harruar këtu edhe dëmin financiar që ju shkaktohet aplikuesve.

Për këtë arsye në bashkëpunim me Presidencën e Republikës së Shqipërisë dhe Ministrinë e Rendit Publik gjatë vitit 2003 u realizua një seminar trajnues ku merrnin pjesë të gjithë përgjegjësit e Zyrave të Pasaportave dhe të shtetësisë në rang Republike. Në përfundim të këtij seminari institucioni i Avokatit të Popullit shpërndau dhe pajisi të gjithë pjesmarrësit me një përmbledhje aktesh ligjore për t'i ndihmuar më shumë në punën e tyre. Mirëpo shumë nga punonjësit e policisë të trajnuar në këtë fushë, kohët e fundit u lëvizën nga detyra dhe u zëvendësuan me të tjerë të patrajnuar.

## **VI. Rekomandime për parandalimin e torturës dhe formave të tjera të keqtrajtimit dhe shkeljeve të ligjit nga policia.**

Në raportet e viteve 2002 dhe 2003 kemi bërë disa rekomandime, për të cilat gjykuan se respektimi i tyre do të sillte parandalimin e torturës dhe formave të tjera të keqtrajtimit dhe të shkeljeve të ligjit nga policia. Megjithëse ato ja dërguam Ministrisë së Rendit Publik, konstatojmë se edhe pas kësaj kohe relativisht të gjatë, pjesa më e madhe e tyre nuk janë zbatuar. Kështu p.sh. mund të përmëndim:

1. Nuk janë marrë masat e nevojshme që të sigurohet e drejta e vizitës nga një mjek për personat e privuar nga liria, qysh në fillim të privimit të tyre nga liria. Kjo e drejtë duhet gjithashtu të nënkuptojë të drejtën që këta persona kanë për t'u egzaminuar nëse ata dëshirojnë nga një mjek i zgjedhur prej tyre.

Për realizimin e kësaj gjithashtu duhet që:

- Të gjitha egzaminimet mjekësore të personave të privuar nga liria e tyre prej policisë duhet të jenë larg dëgjimit, dhe vetëm nëse kundërshton mjeku. Për ndonjë rast të veçantë, larg edhe shikimit të punonjësve të policisë kur ata vizitohen nga mjeku.

- Rezultatet e çdo egzaminimi, si dhe çdo deklaratë e bërë nga personi i vizituar, duhet të shënohen nga mjeku dhe të jenë në dispozicion të personit të privuar nga liria dhe të avokatit të tij.

2. Personave të privuar nga liria prej policisë, nuk u dorëzohen formulare ku të pasqyrohen e saktësohen të drejtat e tyre. Këta formularë duhet që të jenë të disponueshëm edhe në gjuhë të huaj. Për më tepër, të interesuarit duhet të

ftohen që të firmosin një deklaratë që ata kanë qënë të informuar mbi të drejtat e tyre.

3. Nuk është nxjerë udhëzimi (kod i sjelljes) për marrjen në pyetje nga policia. Ky kod duhet ndër të tjera të trajtojë aspektet e mëposhtme; t'i tregohet sistematikisht të ndaluarit identiteti i personave të pranishëm gjatë marrjes në pyetje (emri dhe/ose matrikuli); kohëzgjatja e lejuar e një seance pyetjesh; periudhat e pushimit ndërmjet këtyre seanceve dhe pauzat gjatë marrjes në pyetje; vendi apo vendet ku mund të mbahet një seancë e tillë; nëse do t'i kërkohet të ndaluarit të qëndrojnë në këmbë gjatë marrjes në pyetje; dhe që ndalohet marrja në pyetje e personave nën ndikimin e drogës, alkoolit, ilaçeve ose nën një gjëndje tronditjeje. Ky kod duhet gjithashtu të parashikojë që të shënohet sistematikisht momenti i fillimit dhe i përfundimit të çdo marrje në pyetje, identitetin e çdo të pranishmi gjatë çdo seance pyetjeje, si dhe çdo kërkesë të formuluar nga i ndaluari gjatë kësaj seance. Situata e personave veçanërisht të pambrojtur (për shëmbull, minorenët, personat e prekur nga sëmundje ose mangësi mendore) duhet të bëhen objekt i garancive specifike.

4. Nuk zbatohen të drejtat e mësipërme edhe për personat e mbajtur nga policia për qëllime administrative. Në disa raste kemi konstatuar se “shoqërimi në polici” përdoret ndaj personave të dyshuar për një vepër penale. Pra shoqërimi përdoret për të sqaruar veprime administrative me qëllim hetimesh për vepra penale dhe mbas kohës së “shoqërimit” bëhen veprime proceduriale të ndalimit ose arrestimit. Po kështu kemi konstatuar disa raste të kryerjes së veprimeve që çojnë në kërkimin dhe mbledhjen e të dhënave në mënyrë të paligjshme, duke shkelur pikën 2 të nenit 32 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Të dhëna të tilla mund të përmëndim ato që janë marrë nën efektin e dhunës fizike.

5. Nuk është nxjerë nga autoritetet policore qarkorja që të sqarojë se koha e mbajtjes së personit, për arsye administrative ose gjyqësore duhet të llogaritet brenda afatit kohor të caktuar për paraqitjen e një personi para një gjyqtari, që, sipas nenit 28 të Kushtetutës, është jo më tepër se 48 orë. Nga verifikimi i disa ankesave ka rezultuar se koha e ndalimit ose arrestimit fillon pas asaj të shoqërimit, që në disa raste edhe ajo ka qënë tej afatit ligjor.

6. Titullarët dhe kuadrot drejtues të Policisë nuk ushtrojnë kontroll të vazhdueshëm në lidhje me librat e regjistrimit dhe të mbajtjes së personave në ambjentet e policisë, me qëllim që ato të plotësohen saktë e të mos manipulohen për të mbuluar shkeljet e ligjit. Kemi konstatuar disa raste që shënimet në këto regjistra nuk përputhen me kohën e saktë të qëndrimit të tyre në polici, ndërsa në raste të veçanta ata nuk rregjistrohen.

7. Nuk ka ndryshuar koncepti për personat e shoqëruar në polici, të cilët duhet të mbahen në dhoma shoqërimi dhe jo ndalimi, jo të prangosur ose në

dhoma të mbyllura me dryn, siç veprohet në disa raste. Po kështu nuk ka ambjente për të shoqëruarit e mitur dhe femra. Dhomat duhet të jenë me kushte të përshtatshme higjienosanitare dhe të pajisura me karrige e tavolina. Këto mangësi fatëkeqësisht janë të pranishme dhe shumë të dukëshme edhe në Komisarariatet e Policisë në Kryeqytet, ku pretendojmë dhe synojmë të kemi një Polici më të kulturuar dhe më të civilizuar.

8. Nuk janë ndryshuar e përmirësuar kushtet e mbajtjes së të ndaluarëve e të arrestuarve në dhomat e paraburgimit në ambjentet e policisë, me qëllim që:

- të respektohen në mënyrë strikte kriteret e parashikuara lidhur me çështjen e hapësirës minimale për të ndaluarin, si dhe

- të ndahen të rriturit nga minorenet dhe t'i kushtohet këtyre të fundit një vëmëndje e veçantë në planin e shëndetit dhe të edukimit.

9. Nuk u mundësua akoma kalimi i dhomave të paraburgimit dhe i personelit të tyre nga vartësia e Ministrisë së Rendit Publik në atë të Ministrisë së Drejtësisë. Megjithëse vitin e kaluar ky proces filloi me Drejtorinë e Policisë së Qarkut Vlorë, ai nuk mundi të realizohej sipas Udhëzimit të përbashkët të Ministrit të Rendit Publik dhe të Ministrit të Drejtësisë në disa Drejtori e Komisariate Policie. Kjo do të krijonte mundësinë për të vënë efektivisht në jetë të gjitha dispozitat e caktuara në “Rregulloren mbi sigurimin dhe trajtimin e të burgosurve”, të miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr.96 datë 09.03.2000.

Për veç zbatimit të rekomandimeve të mësipërme, nga organet e Policisë duhet të punohet më shumë për të zbatuar një nga detyrat kryesore institucionale të saj të përcaktuara në nenin 3 të ligjit nr. 8553, dt. 25.11.1999 “Për Policinë e Shtetit”, atë të mbrojtjes së ushtrimit të lirive dhe të drejtave të personit. Për realizimin e kësaj detyrë është e domosdoshme që:

1. T'i jepet një përparësi më e madhe edukimit dhe formimit profesional në vazhdimësi të punonjësve të policisë të të gjitha roleve dhe gradave. Në këto programe duhet të zërë një vënd të rëndësishem edukimi i tyre me ndjenjën e respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut. Niveli kulturor e profesional, njohja dhe respektimi i të drejtave të njeriut, si dhe aftësia komunikuese të jenë kriteret përcaktuese në rekrutimin, mbajtjen në punë dhe përzgjedhjen në emërimet e ngritje në detyrë të punonjësve të policisë të të gjitha roleve.

2. Duhet që autoritetet politike dhe teknike të niveleve më të larta të dalin herë pas here, më shpesh dhe më fort, me mesazhe të qarta që dënojnë rreptë keqtrajtimet nga policia. Ky veprim duhet të përsëritet me intervale të rregullta nga drejtuesit në të gjitha shkallët e Policisë. Kjo në veçanti t'u theksohet punonjësve të policisë të ngarkuar me marrjen në pyetje të personave të privuar nga liria.



3. Në të gjitha ambjentet e policisë të vendosen menjëherë posterat e përgatitura në bashkëpunim me institucionin tonë, të cilat bëjnë fjalë për respektimin e të drejtave të njeriut dhe parandalimin e dhunës nga punonjësit e policisë. Ato do të shërbejnë si një kujtesë e vazhdueshme për punonjësit e policisë dhe do t'i ndihmojë ata në zbatimin me rigorozitet të ligjit. Është konstatuar se ato që janë vënë, janë hequr pa shkak.

4. Bashkëpunimi i Ministrisë së Rendit Publik dhe i Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit me Institucionin e Avokatit të Popullit, në kuadër të punës për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, megjithëse ka qënë i mirë, duhet të rritet e përsoset më tej në të ardhmen. Mirëpo, fakti që nga ana e tyre nuk u ftuam si në vitet e mëparshme në analizat vjetore të punës së tyre për vitin 2004, është tregues jo pozitiv i mirëkuptimit që ato duhet të kenë ndaj rekomandimeve dhe kritikave tona për mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, duke përfshirë edhe ato të punonjësve të policisë.

## **VII. Rekomandime dhe propozime në fushën legislative.**

Gjatë shqyrtimit të disa ankesave të ndryshme ne konstatuam se disa akte normative nënligjore ishin nxjerë në kundërshtim me dispozitat kushtetuese dhe shkelnin në mënyrë masive të drejtat e punonjësve të administratës publike dhe në veçanti të punonjësve të Policisë së Shtetit. Ndërsa disa të tjera nuk zbatoheshin në favor të punonjësve të policisë.

Kështu p.sh. mund të përmëndim:

1. Rekomandimi drejtuar Kryeministrit për të shfuqizuar Urdhërin e Ministrit të Rendit Publik nr. 1661, dt. 08.04.2002 “Për komunikimin me mediat”. Gjatë shqyrtimit të ankesës së ish punonjësit të Policisë së Shtetit, Q. H., efektiv i Komisarariatit të Policisë Nr. 3 Tiranë, bërë vitin e kaluar, i cili i përjashtua nga policia për shkelje të Urdhërit të Ministrit të Rendit Publik “Për komunikimin me mediat”, konstatuam se: Urdhëri i Ministrit të Rendit Publik nr. 1661, dt. 08.04.2002, ishte bërë shkak për shkeljen e të drejtave të punonjësve të policisë për arsye se:

a) Ai kufizonte një nga liritë themelore të njeriut të garantuar nga neni 22, pika 1 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet se: “*Liria e shprehjes është e garantuar*”. Çdo person ka të drejtë në çdo kohë të shfaqë e të shprehë mendimin e tij të lirë për çështje që çënojnë jo vetëm interesat e tij, por edhe ato publike. Në rastin konkret ankuesi kishte bërë publike një ankesë që nuk kishte lidhje me probleme të detyrës së tij si polic, por çështje që lidhen me statusin dhe pagën e tij.

b) Akti administrativ i mësipërm, i cili kufizon lirinë themelore të shprehjes, është nxjerrë në kapërcim të kompetencave ligjore të Ministrit, sepse në bazë të nenit 17 të Kushtetutës, *“Kufizime të të drejtave dhe lirive të parashikuara në këtë Kushtetutë mund të vendosen vetëm me ligj për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Kufizimi duhet të jetë në përpjestim me gjëndjen që e ka diktuar atë. Këto kufizime nuk mund të çenojnë thelbin e lirive dhe të të drejtave dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut”*.

c) Përmbajtja e urdhërit nr.1661, dt. 08.04.2002, nuk përputhet me bazën ligjore në të cilën ai është mbështetur si dhe në qëllimin për të cilin është nxjerrë *“në interes të rritjes së transparencës të M.R.Publik me median dhe me publikun”*, sepse: *Së pari*, në asnjë dispozitë të akteve normative në të cilat është mbështetur urdhëri, nuk kufizohet e drejta e punonjësve të policisë të komunikojnë me mediat dhe për problemet (ankesat) personale dhe *së dyti*, ky urdhër nuk i shërben rritjes së transparencës së M.R.Publik me median dhe me publikun, por të kundërtës.

Për të rivendosur në vend të drejtën kushtetuese të shprehjes, i propozuam Ministrit të Rendit Publik të përmirësonte (ndryshonte) Urdhërin nr. 1661, dt. 08.04.2002 *“Për komunikimin me mediat”*, me qëllim që dispozitat e tij të mos çenojnë liritë dhe të drejtat themelore të njeriut. Mirëpo edhe pas revokimit të Urdhërit me të njëjtin objekt të Kryeministrit, pranimi i rekomandimit tonë ishte vetëm një akt formal, Ministri i Rendit Publik nuk e zbatoi rekomandimin tonë. Çuditërisht ai mbajti të njëjtin qëndrim edhe pas shkresës së dytë që i dërguam.

Në bazë të nenit 115, gërma “a” dhe 116, gërma “b” të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 *“Kodi i Proçedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”*, Urdhëri i Ministrit të Rendit Publik nr. 1661, datë 08.04.2002 *“Për komunikimin me mediat”* është akt administrativ absolutisht i pavlefshëm. Duke qënë i tillë, në bazë të nenit 117, pika 1 të *“Kodit të Proçedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”*, ai nuk prodhon pasoja ligjore, pavarësisht nga fakti nëse është deklaruar ose jo si i tillë.

Të ndodhur në këto kushte, kur ky urdhër antikushtetues dhe cënues i të drejtave themelore të njeriut është në fuqi, në bazë të nenit 63, pika 3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 24, gërma “b” të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit, i propozuam Kryeministrit, që në bazë të nenit 124/1 të Kodit të Proçedurave Administrative, ku përcaktohet se: “Me përjashtim të rasteve kur me ligj parashikohet ndryshe, e drejta për të revokuar aktin i takon organit që e ka nxjerre atë, ndërsa shfuqizimi i aktit është prerogativë e organit epror”*, të reagoje duke shfuqizuar Urdhërin e Ministrit të Rendit Publik nr. 1661, dt. 08.04.2002 *“Për komunikimin me mediat”*. Rekomandimi është në shqyrtim dhe jemi në pritje të reagimit pozitiv.

2. Propozimi i përsëritur drejtuar Qeverisë për të përmirësuar V.K.M. nr. 552, datë 27.11.1999, “Për trajtimin ekonomik e financiar të familjarëve të punonjësve të policisë të vrarë e plagosur për shkak të detyrës”. Qëllimi i këtij rekomandimi ishte që V.K.M të shtrinte fuqinë vepruese edhe para vitit 1999 dhe prej tij të përfitojnë edhe punonjësit e policisë të vrarë apo plagosur gjatë viteve 1991-1998. Për këtë problem edhe më parë ne kemi bërë rekomandimet përkatëse, të cilat i kemi pasqyruar edhe në raportet vjetore. Fillimisht pati një reagim pozitiv nga Qeveria, e cila i kërkoi M.R.Publik që të studionte problemin dhe të bënte propozimin përkatës. Mbi këtë bazë M.R.Publik përgatiti propozimin për përmirësimin e V.K.M dhe nga ish ministri Rama u premtua në Parlament se nga Qeveria do të përmirësohej së shpejti Vendimi. Por veç premtimit problemi nuk pati ndonjë avancim e konkretizim të tij, megjithëse ne kemi qënë në ndjekje të vazhdueshme të tij. Meqënëse Qeveria për vitin 2004 e shtoi buxhetin e M.R.Publik dhe të Policisë edhe 10 % më shumë se në vitin 2003, shpresuam që ky problem të gjente zgjidhje përfundimtare. Shpresat tona i bazuam edhe në faktin se kohët e fundit Qeveria ka krijuar mundësi për kompesimin e disa shtresave të popullsisë. Mirëpo rekomandimi ynë megjithëse i argumentuar dhe i mbështetur në ligj nuk është realizuar akoma.

3. Ankesa e 70 punonjësve të policisë të Qendrës së Furnizimit Materialo-Teknik të M.R.Publik. Ata na shkruanin se gjatë vitit 2003, u dhanë gradat e reja në Policinë e Shtetit dhe efektivit i oficerëve të kësaj qendre i mori ato, ndërsa efektivit trup i rolit bazë nuk i mori. Gjithashtu, ankuesit na bënë të ditur edhe faktin, se në këtë Repart disa kolegë të tyre, të cilët kishin ardhur aty me transferim, i kishin marrë gradat e reja. Për këtë padrejtësi, mohim i të drejtave ligjore dhe diferencim ligjor të bërë atyre, ata ishin ankuar në instancat eprore në rrugë administrative, por nuk ju ishin dhënë të drejtat që ju takonin.

Për t’u informuar lidhur me këtë problem, nga ana jone ju kërkuan shpjegime Drejtorisë së Përgjithshëm të Policisë, e cila na informoi se: “Qendra e Furnizimit Materialo Teknik në M.R.Publik është në limitin e përgjithshëm të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, por në varësi administrative të Ministrisë së Rendit Publik. Si e tillë punonjësve të këtij reparti nuk u janë dhënë gradat policore nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë pasi aktualisht ata nuk janë në varësi të tij. Nëse ky repart do të kalojë në varësi të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë, për rrjedhojë ata do të gëzojnë edhe të drejtën e mbajtjes së gradës policore”.

Nga shqyrtimi i ankesës rezulton se punonjësit e policisë të Qendrës së Furnizimit Materialo-Teknik të M.R.Publik, duke përfshirë edhe ankuesit, janë pjesë e Policisë së Shtetit. Ndërsa nga studimi i akteve ligjore e nënligjore si: Ligji Nr. 8643, datë 20.07.2000 “Për Gradat në Policinë e Shtetit”; Vendimit të

Këshillit të Ministrave Nr. 64, datë 02.02.2001 “Për inkuadrimin e Gradave Ushtarake, në Gradat e Policisë së Shtetit dhe për përcaktimin e funksioneve që do të ushtrohen sipas tyre”; Urdhërit të Ministrit të Rendit Publik, Nr. 1484, datë 18.06.2001 “Për krijimin e Komisioneve të Gradimeve”; Urdhërit të Ministrit të Rendit Publik Nr. 1833, datë 27.03.2003 “Për Inkuadrimin e Gradave Ushtarake, në Gradat e Policisë së Shtetit dhe për përcaktimin e funksioneve që do të ushtrohen sipas tyre”; Urdhër-Shërbimit Nr. 1172, datë 04.04.2003, nxjerë nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit “Për përbërjen dhe procedurat e Komisionit të Gradimeve të rolit bazë”, rezulton që punonjësve të policisë të këtij reparti ju duheshin dhënë gradat e reja dhe rrjedhimisht edhe të drejtat financiare që burojnë prej tyre. Pra edhe me këtë efektiv të rolit bazë duhej të ishte bërë inkuadrimi i Gradave Ushtarake në Gradat e Policisë së Shtetit, ashtu sikurse ishte bërë edhe me punonjësit e policisë të roleve më të larta të këtij reparti si dhe me disa kolegë të tyre. Për të bërë të mundur zgjidhjen e kësaj ankese dhe dhënien e të drejtave ligjore ankuesve, i rekomanduam Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit marjen e masave të nevojshme për inkuadrimin e gradave ushtarake në gradat e Policisë së Shtetit punonjësve të policisë të rolit bazë, efektiv të Qendrës së Furnizimit Materialo-Teknik të M.R.Publik. Rekomandimi u mirëprit dhe u pranua menjëherë.

## **6. Ministria e Mbrojtjes**

Per vitin 2004 ndaj strukturave të Ministrisë së Mbrojtjes janë bërë 249 kërkesa e ankesa nga subjekte ushtarakë apo ish ushtarakë nëpërmjet 71 letrave që i kanë dërguar zyrës sonë. Nga këto 10 kërkesa apo ankesa janë të mbartura nga viti 2003, që janë përfunduar. Për vitin 2004 janë përfunduar ankesat e paraqitura nga 243 ushtarakë apo ish ushtarakë, që kanë aplikuar nëpërmjet 62 letrave dërguar zyrës sonë. Janë në shqyrtim 9 ankesa të mbartura që i përkasin kryesisht muajit dhjetor 2004.

Nga ankesat e përfunduara gjatë vitit 2004, rezulton se 20 ankesa ose 32 përqind e tyre kanë gjetur zgjidhje pozitive. Ky është një tregues mjaft i kënaqshëm që tregon efikasitetin e punës sonë si dhe bashkëpunimin e frytshëm me Ministrinë e Mbrojtjes. Ndërsa 19 ankesa ose 31. përqind kanë qënë jashtë kompetencës tonë dhe 23 ose 37 përqind kanë qënë ankesa të pabazuara.

Duke analizuar në tërësinë e tyre ankesat e ardhura në Institucionin tonë për vitin 2004 konstatohet se ato janë bërë kryesisht nga oficerë, më pak nënoficerë, nga punonjës civilë dhe ushtarë. Ashtu siç ishim angazhuar vitin e kaluar, nga ana e jonë u organizuan ditët e hapura duke organizuar një takim me

ushtarë të distriktit detar të Vlorës. Nga takimi me ta rezultoi se ushtarët kishin ankesa për kushtet e jetesës në repart. Paraqitja e ankesave në takimin e hapur me ekspertët e zyrës sonë vuri në lëvizje komandën e repartit e cila brenda një kohe shumë të shkurtër bëri përmirësimin e disa prej kushteve të pretenduara prej tyre. Një takim i kësaj natyre u organizua edhe me oficerët dhe nënoficerët e ketij reparti, të cilët pasi paraqitën ankesat e tyre me gojë, ju rekomandua t'i paraqisnin ato me shkrim duke i pajisur me formularët përkatës. Në vitin 2005 do të organizojmë më shumë dhe më mirë takime të hapura me ushtarët, për të verifikuar në vënd nëse ka shkelje të drejtave dhe lirive të tyre si dhe kushtet e jetesës. Kjo sepse vihet re që ankesat nga kjo kategori ushtarakësh janë ende shumë të rralla. Ne e ndiejmë për detyrë të verifikojmë se ndoshta mungesa e ankesave nga ushtarët vjen nga ngurrimi apo frika mos komandat e reparteve hakmerren ndaj tyre.

Pas shqyrtimit të problemeve kryesore të cilat na janë bërë prezent nëpërmjet ankesave të subjekteve ushtarake del përsëri në pah që, ankesat e ushtarakëve apo ish ushtarakëve që ndërpresin karrierën, apo e kanë ndërprerë atë, kohë më parë ne kuadrin e reformës në Forcat e Armatosura qysh nga viti 1992 e në vazhdim, zenë një vënd të konsiderueshëm.

Këta persona ankohen se, jo vetëm që masa e pensionit të tyre është më e ulët se pensioni i kolegeve të tyre që kanë dalë në pension pas vitit 1993, edhe pse kanë qënë të barazvlefshëm në detyrë, por dhe për mosnjohjen e pagës shtesë mbi pensionin e pleqërisë për vitet e shërbimit në ushtri, në një kohë kur ushtarakët e dalë në pension pas vitit 1993 e përfitojnë këtë të drejtë ligjore.

Kërkesa apo ankesa të kësaj natyre kanë paraqitur jo vetëm individë të caktuar, por edhe shoqata e grupime të tjera ish ushtarakësh.

Duke i konsideruar të drejta këto ankesa, Avokati i Popullit qysh më datën 29.11.2003 i ka drejtuar Kryeministrit z. Fatos Nano, rekomandimin në lidhje me shqyrtimin dhe kalimin në Kuvend të projektligjit "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin Nr. 8087, datë 13.03.1996", "Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, Ministrisë së Rendit Publik dhe Shërbimit Informativ Kombëtar në Republikën e Shqipërisë". Me daljen e ligjit për Statusin e Ushtarakut në Republikën e Shqipërisë dhe nxjerrjen e akteve zbatuese të tij, ky problem mund të konsiderohet i zgjidhur.

Është për t'u përmëndur fakti se pak nga këta subjekte kundërshtojnë daljen në rezervë pasi, për një gjë të tillë, në përkrahje të reformave në Forcat e Armatosura, ata janë ndërgjegjësuar. Por ankesat e tyre kanë të bëjnë me mospërfitimet e të drejtave që ju siguron atyre ligji nr. 8087 datë 13.03.1996 dhe ndryshimet përkatëse të mëvonshme të këtij ligji. Jo gjithmonë nga strukturat e Ministrisë së Mbrojtjes dhe disa komanda ushtarake është vepruar

me korrektesë, drejt dhe në kohë, në mënyrë që këta ushtarakë, pas ndërprerjes së karrierës, të përfitojnë atë ç'ka ju takon me ligj.

Nga përgjithësimi i këtyre rasteve, ne kemi arritur në konkluzionin se gjatë zbatimit të reformës, në mënyrën se si është vepruar ka patur shkelje të të drejtave të tyre. Ankesat e tyre janë bërë prezent tek ne gjatë vitit 2004 dhe kanë përbërë një pjesë të rëndësishme të punës sonë.

Konkretisht, pas hetimit tonë për këto ankesa doli se Ministria e Mbrojtjes pas përcaktimit të kriterëve të reformës si mosha, profesionalizmi dhe përkushtimi në detyrë, ka filluar në vazhdimësi procedurat e ndërprerjes së marrëdhënieve të karrierës së oficerëve aktivë të planifikuar për t'u larguar.

Por këto procedura, nuk u kryen gjithmonë konform ligjit dhe akteve nënligjore, por u veprua në mënyrë të tillë, që solli hapur shkeljen e të drejtave e tyre, sepse ushtarakët e sipërpërmëndur u lanë "ushtarakë aktivë" por papagesë e në dispozicion për muaj të tërë. Kështu në Institucionin e Avokatit të Popullit ka bërë ankesë efektivë i Brigadës së reagimit të shpejtë Tiranë z.Sh. B. Ankuesi ka pretenduar se në bazë të urdhërit të Komandantit të Forcave Tokësore ka ndërprerë marrëdhëniet financiare më 01.08.2003, tre muaj përpara daljes së urdhërit të Ministrit të Mbrojtjes, që e ka nxjerrë në lirim më datë 01.11.2003. Në këtë mënyrë është shkelur e drejta e tij, për t'u trajtuar me pagë për një periudhë tre mujore. Për këtë nga ana jonë u ndërmor një proces verifikimi dhe pasi konkludua se ankuesi ka të drejtë dërguam rekomandimin e datës 25.05.2004, me anën e të cilit kërkonim, trajtimin e tij me pagë për periudhën që ka qëndruar në dispozicion. Mbi bazën e këtij rekomandimi i sipërpermenduri mori trajtimin financiar të kërkuar.

Për vitin 2004, në Institucionin tonë kanë vazhduar ankesat nga ushtarakët në lidhje me mosprivatizimin e objekteve të dhëna nga Ministria e Mbrojtjes për strehimin e tyre. Nga ana e jonë është ndjekur në vazhdimësi realizimi i projekt vendimit që do t'i paraqitet Këshillit të Ministrave, lidhur me ndryshimet në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 379 datë 26.06.1995 që bën fjalë "Për kthimin në banesa të objekteve që mbeten të lira nga ristrukturimi i ushtrisë dhe Ministrisë së Rendit Publik". Ka qënë rekomandimi i ynë drejtuar Ministrisë së Mbrojtjes për domosdoshmërinë e disa ndryshimeve të vendimit të mësipërm, me qëllim lehtësimin e procedurave të privatizimit të objekteve në fjalë, duke mos parashikuar nevojën e marrjes më parë të vendimit të Bashkive për kthimin e tyre në fond banese, siç është vepruar në praktikë. Me kënaqësi mund të shprehemi se Ministria e Mbrojtjes jo vetëm që pranoi rekomandimin tonë, por përgatiti me kujdes projektvendimin përkatës me ndryshimet e nevojshme të cilin e dërgoi për miratim në Këshillin e Ministrave. Por ky projekt nuk u pranua me arsyetimin e ndërhyrjes në autonominë e pushtetit vendor. Pavarësisht nga kjo, në kuadrin e hyrjes në fuqi të ligjit "Për Statusin e

Ushtarakut” po punohet për hartimin e një drafti të ri për Qeverinë i cili mendohet se do të mundësojë zgjidhjen e problemeve të strehimit të ushtarakëve. Në këtë drejtim ka përpjekje serioze nga Ministria e Mbrojtjes dhe Qeveria për të lehtësuar vështirësitë e strehimit të ushtarakëve. Në këtë kuadër ka dalë V.K.Ministrave nr.524 datë 30.07.2004 “Për masën dhe mënyrën e kompesimit të qirasë së banesës dhe të ushqimit të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”

Veç problemeve të sipërpërmendura, për vitin 2004 në Institucionin tonë oficerë të ndryshëm kanë paraqitur ankesa të tjera të cilat në mënyrë të grupuar paraqiten si më poshtë:

- Për nxjerrjen në lirim apo largime të padrejta nga puna. Kështu N.B. mjek në Spitalin Ushtarak është ankuar se ka dalë në rezervë pa asnjë motivacion. Nga verifikimet tona doli se ka dalë në rezervë nga reforma e cila ka përfshirë edhe spitalin ushtarak.

N.C, R. B, P. M., etj punonjës të distriktit detar Durrës të cilës janë nxjerrë në rezervë për ngjarjen e Bishtit të Pallës. Ankesa e tyre më parë i ishte drejtuar Gjykatës. Për këtë ata u sqaruan se duhet të presin vendimin e saj si një nga nga mjetet më efikase që ligjvënësi ka vënë në dispozicion të tyre për vënien në vënd të të drejtës që ata mendojnë se ju është shkëlur padrejtësisht.

- Ankesa të punonjësve civilë, të cilët janë larguar nga puna për arsye të reformës, ose kur objekti i punës ka kaluar në varësinë e nje Ministrie tjetër, kryesisht në Ministrinë e Pushtetit Lokal, si p.sh. ankesat e ish punonjësve të Tipografisë Ushtarake; ankesa e një grupi punonjës civilë të shtëpisë së ushtarakëve Pogradec, Durrës, apo të Spitalit Ushtarak në Tiranë.

Ministria e Mbrojtjes për të minimizuar pasojat sociale dhe ekonomike që vijnë nga dalja e papunë e këtyre punonjësve, ka paraqitur projektligjet apo projektvendimet përkatëse. Mbi këtë bazë Qeveria ka nxjerrë Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 678, datë 16.10.2003 “Për trajtimin e punonjësve që dalin të papunë nga reforma në Spitalin Ushtarak Qëndror Universitar”.

Gjithashtu Ministria e Mbrojtjes ka paraqitur në Komisionet Parlamentare dhe projektligjin “Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në disa ndërmarje të industrisë ushtarake”. Ky projekt ligj u miratua nga Parlamenti me Ligjin nr.9779, datë 29.01.2004 “Për një Trajtim të Veçantë të Punonjësve, që kanë punuar në disa ndërmarje të industrisë ushtarake”. Vlen për tu përmendur se me daljen e ligjit, në bazë dhe në zbatim të tij doli edhe V.K.Ministrave nr. 161 datë 18.03.2004.

83 punonjës të uzinës së Poliçanit janë ankuar se pas mbylljes së aktivitetit të këtij objekti kanë mbetur në mëshirën e fatit. Me daljen e Ligjit “Për trajtimin e veçantë të punonjësve të këtyre uzinave”, u bë e mundur të

lehtësohen problemet sociale të shkaktuara nga mbyllja e aktivitetit të uzinave ushtarake.

Nga numri i përgjithshëm i ankesave të ardhura për vitin 2004, 18 ankesa ose rreth 21 përqind janë për statusin e veteranit të luftës, nga të cilat 10 ankesa janë zgjidhur në favor, 5 ankesa kanë qënë jashtë kompetence, kerse 3 ankesa të pabazuara. Objekti i ankesave të paraqitura ka qënë për përfitimin e statusit të veteranit, për statusin e dëshmorit, apo dhe për përfitime shtesë që rrjedhin nga Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr.190 datë 03.05.1995, për veteranët të cilët gjatë luftës kanë qënë në burgjet nazifashiste brënda apo jashtë vëndit.

Qysh në fillim konstatojmë se Ministria e Mbrojtjes ka bërë vlerësimin e veteranëve duke paraqitur projektet e nevojshme dhe Qeveria ka nxjerrë Vendimet përkatëse, “Për rritjen e masës së shpërblimit të veteranëve të LANÇ-it të popullit shqiptar” etj..

Nga shqyrtimi i disa ankesave për këtë kategori personash, (veteranët e luftës) doli se dokumentat e paraqitura prej tyre pranë Komisionit Qëndror të Statusit të Veteranit, janë paraqitur jashtë afatit ose paraqitja e dokumentave me vonesë është bërë mbi bazën e një vendimi të gjykatës për rivendosjen e afatit.

Në këto rrethana për ta zgjidhur këtë situatë u bashkëpunua dhe me Departamentin e Veteranëve në Ministrinë e Mbrojtjes ku gjetëm mirëkuptim dhe predispozicionin e duhur. Nga bashkëpunimi rezultoi se pranë atij Departamenti, numri i veteranëve që kishin paraqitur ankesa ishte dhe më i madh se sa i janë drejtuar Institucionit tonë. Konkretisht janë rreth 450 persona në shkallë vendi duke pritur shqyrtimin e dokumentave si dhe mjaft të tjerë që pretendojnë të marrin Statusin e Veteranit të Luftës.

Personat e mësipërm i kishin paraqitur dokumentat e mësipërme jashtë afatit të përcaktuar pas datës 30 Korrik 2002.

Me qëllimin e mirë për të vënë në vënd të drejtën e kësaj kategorie personash të cilët janë me moshë mbi 70 vjeç, me kushte jetese e mundësi të pakta financiare për të përballuar jetesën, dhe për t’ju dhënë një satisfaksion moral dhe material, Avokati i Popullit i rekomandoi Ministrit të Mbrojtjes, ndërmarjen e inisiativës për hartimin e projektvendimit të Qeverisë, për caktimin e një afati të ri për paraqitjen e dokumentave pranë Komisionit Qëndror të Statusit të Veteranit të Luftës. Ndonëse Ministria e Mbrojtjes ishte dakort me këtë dhe e paraqiti draftin e shtyrjes së këtij afati, nuk u pranua nga Ministria e Financave. Ministria e Mbrojtjes është angazhuar për ta paraqitur përsëri draftin për shtyrjen e afatit të shqyrtimit të dokumentave të veteranëve, duke e argumentuar bindësisht domosdoshmërinë e marrjes së një vendimi të tillë nga Qeveria. Për këtë zyra jonë në bashkëpunim me Ministrinë e Mbrojtjes do të vazhdojë përpjekjet për të realizuar këtë angazhim.



Ka disa ankesa për ndërprerjen e pagës së grave të oficerave (pagë për papunësi). Kështu D. K. ankohet se i është ndërprerë paga për papunësi. Për këtë zyra jonë ka hyrë në një dialog konstruktiv me Drejtorinë e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore e cila ka marrë angazhimin për të hartuar sa më parë draftin që do të përcaktojë shpërblimin për pagë papunësie të grave të oficerave ashtu siç urdhëron ligja për statusin e ushtarakut. Në këtë kuadër Avokati i Popullit i ka dërguar Ministrisë së Mbrojtjes rekomandimin për shpejtimin e procedurave për nxjerrjen sa më parë të akteve zbatuese të ligjit Për Statusin e Ushtarakut. Në përgjigje të këtij rekomandimi njoftohemi se ai është konsideruar i drejtë. Me vendimin nr.854 datë 17.12.2004, Qeveria ka miratuar vendimin , “Për kriteret dhe masën e përfitimit të pagesës së papunësisë për bashkëshortin/en e ushtarakut aktiv të Forcave të Armatosura”. Kështu ankesat e kësaj kategorie përfundimisht janë zgjidhur në favor të ushtarakëve që janë ankuar pranë zyrës sonë si dhe shumë ushtarakëve të tjerë , të cilëve ju ishte mohuar kjo e drejtë.

Ka patur ankesa për moszbatim të vendimeve të Komisionit të Shërbimit Civil. Kështu në Institucionin tonë është administruar ankesa e bërë nga shtetasi M. Sh. ish përgjegjës i sektorit të protokollit në Drejtorinë e Marrëdhënieve me Jashtë dhe të Integritetit në Ministrinë e Mbrojtjes, i cili është ankuar se ka më shumë se tetë muaj, që Ministria e Mbrojtjes i ka ndërprerë marrëdhëniet financiare, ndonëse Komisioni i Shërbimit Civil me vendimin nr. 53, datë 31.03.2003 ka vendosur pranimin e pjesës së ankesës së tij, duke e detyruar Ministrinë e Mbrojtjes t’i japë pagën për një periudhë një vjeçare. Institucioni i Avokatit të Popullit në mbështetje të nenit 8 pika 3 të ligjit nr. 8549 datë 11.11.1999 “Statusi i Nëpunësit Civil” që përcakton se “Vendimet e Komisionit të Shërbimit Civil marrë në përputhje me pikën 1, shkronja “a” janë të detyrueshme për institucionet e administratës publike qëndrore dhe vendore”, bëri rekomandimin e datës 09.02.2004 me anën e të cilit rekomandonte dhënien e pagesës së shtetasit M. Sh. në përputhje të vendimit të Komisionit të Shërbimit Civil. Në përfundim rekomandimi ynë u quajt i drejtë dhe ankuesi mori pagën që i takonte.

Një prioritet i rëndësishëm i punës së Avokatit të Popullit, që nga viti 2000, ka qënë zgjidhja e ankesave të ushtarakëve aktiv në lidhje me trajtimin e tyre financiar, për shkak të natyrës së vështirë të punës apo punës me orar dhe pa orar etj. Për këtë siç del nga raportet e mëparshme Avokati i Popullit ka rekomanduar nevojën e trajtimit financiar më të mirë të ushtarakëve aktiv apo për çeljen e fondeve për trajtimin financiar edhe të ushtarakëve të dalë në rezervë apo lirim. Lidhur me këtë mund të raportojmë me kënaqësi se me V.K.Ministrave nr.791, datë 26.11.2004 “Për disa shtesa dhe ndryshime në

vendimin nr.839. datë 11.12.2003 të Këshillit të Ministrave “Për pagat e ushtarakëve aktiv të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, janë bërë shtesa në pagë për punë të vështira të ushtarakëve aktiv; shtesa për kushte të veçanta pune dhe shërbimi; shtesa në pagë sipas gradës dhe viteve të shërbimit si dhe shtesa për punë të vështira dhe të dëmshme për shëndetin. Këtë ne e vlerësojmë si një arritje të suksesshme për realizimin e objektivave tona në mbrojtje të të drejtave të ligjshme të njeriut, në sajë të një bashkëpunimi të ngushtë me Ministrinë e Mbrojtjes.

Duke shqyrtuar shifrat e mësipërme mund të pohojmë se puna me ankesat që lidhen me Ministrinë e Mbrojtjes ka qënë e suksesshme. Por këtë konkluzion nuk e nxjerrim vetëm nga shifrat. Është kënaqësi të raportojmë se Ministria e Mbrojtjes është një nga dikasteret e Administratës sonë Publike ku ne gjithmonë, qysh në fillim të veprimtarisë sonë në vitin 2000, kemi gjetur partnerë të gatshëm për të bashkëpunuar në mënyrë institucionale, me qëllimin e mirë dhe të vetëm për zgjidhjen e drejtë të problemeve dhe shqetësimeve të ushtarakëve.

Bashkëpunimi i mirë me Ministrinë e Mbrojtjes është realizuar në kontaktet direkte me drejtues dhe specialistë të Drejtorive përkatëse, të ngarkuara për problemet dhe shqetësimet e ankesave të ushtarakëve si, me Drejtorinë e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, Departamentin e Veteranëve, me Drejtorinë Juridike etj, duke rritur në këtë mënyrë dhe përgjegjësinë e të gjitha strukturave të Ministrisë së Mbrojtjes, për të trajtuar më me kujdes problemet dhe për të respektuar të drejtat e ligjshme të ushtarakëve.

Ky mirëkuptim dhe bashkëpunim me Ministrinë e Mbrojtjes shikohet nga ana jonë si arritje e suksesshme në realizimin e objektivave tona në mbrojtje të të drejtave të ligjshme të njeriut, duke synuar që këtë eksperiencë të mirë ta shtrijmë edhe me dikastere të tjera. Ai ka konsistuar dhe në mirëpritjen, vlerësimin e pranimit e rekomandimeve të bëra nga Avokati i Popullit

Në prioritetet e punës së Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2005 do të jenë organizimi i ditëve të hapura me grup ekspertësh në reparte të ndryshme që lidhen me Komandat e Forcave Tokësore, Ajrore dhe Detare, me qëllim tërheqjen e ankesave dhe nga nënoficerë dhe ushtarë të Forcave të Armatosura, bashkëpunimi më i ngushtë me drejtoritë e ndryshme në Ministrinë e Mbrojtjes dhe strukturat e tjera ushtarake për zbatimin korrekt të ligjit dhe zgjidhjen e drejtë të ankesave të ushtarakëve

Si konkluzion, e gjithë kjo pjesë e punës sonë me këto subjekte ka shërbyer mjaft pozitivisht për realizimin e objektivit kryesor të punës së Institucionit tonë, për të mbrojtur të drejtat e njeriut, duke ndikuar në këtë mënyrë në mirëadministrimin e pushtetit dhe mirëqeverisjen edhe në Forcat e Armatosura.

## **7. Ministria e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit**

Për vitin 2004 Institucioni ynë ka ndjekur 35 ankesa me këtë Ministri, nga të cilat 12 prej tyre janë mbartur nga viti 2003. Nga ky numër ankesash, 26 prej tyre kanë përfunduar dhe 10 ankesa janë ende në shqyrtim e sipër. Nga 26 ankesat që kanë përfunduar, 8 prej tyre kanë qenë jashtë juridiksionit, 10 ankesa janë të pa bazuara, 6 janë zgjidhur në favor të ankuesve dhe 2 ankesa kanë përfunduar me orientime juridike, nëpërmjet të cilave ankuesit kanë gjetur rrugën e zgjidhjes së problemit. Gjatë këtij viti, sikurse edhe në vitin e mëparshëm, janë trajtuar edhe ankesa të cilat lidhen me shërbimin e Zyrave të Gjendjes Civile, shërbim i cili aktualisht është në varësi të këtij Dikasteri.

Problematika e ankesave ka qënë e njëjtë me atë të prezantuar edhe në Raportet e mëparshme, kryesisht mos përfitimi i ndihmës nga shteti në raste fatkeqësish që kanë ndodhur nga forcat madhore, si zjarre, shpërthime eksplozivi apo nga përmbytjet, shembje banesash nga rrëshqitjet e tokave, dëmet e shkaktuara nga tërmeti. Ky pasqyrim i njëjtë buron nga fakti se mungesa e deritanishme e fondeve me destinacion të tillë, ka sjellë mbartjen e ankesave me të njëjtën objekt nga viti në vit dhe për pasojë dhe mos zgjidhjen e tyre në favor të ankuesve.

Në ankesat e tyre pretenduesit e shkeljes së të drejtave, kërkojnë zbatimin e Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.206 datë 26.03.1998 “Për kriteret e pjesëmarrjes së shtetit në përballimin e dëmeve në raste fatkeqësish” dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.708 datë 21.12.2000 “Për disa ndryshime në Vendimin Nr.206 datë 26.03.1998 të Këshillit të Ministrave, “Për kriteret e pjesëmarrjes së shtetit në përballimin e dëmeve, në raste fatkeqësish”. Nga shqyrtimi i ankesave ka rezultuar se kërkimet e shtetasve, pjesërisht janë të drejta dhe burojnë nga vetë aktet ligjore dhe nënligjore. Por zgjidhja e tyre në favor të ankuesve paraqitet e pamundur për pamundësi financiare të mbulimit nga buxheti i shtetit.

Nga Ministria e Pushtetit Vendor, në vijimësi të ndjekjes së ankesave, jemi informuar se ka vështirësi në sigurimin e fondeve me destinacion të tillë dhe për këtë arsye numri i ankesave sa vjen dhe shtohet. Duke qënë se fondet për ndihmë jepen nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave, me vendime të veçanta të qeverisë janë akorduar disa herë fonde, kur problemi ka qënë masiv dhe kur fatkeqësitë natyrore kanë prekur zona dhe shtresa të gjera të popullsisë, sikurse është dhe akordimi i fondeve për zonat e përmbytura nga Hidrocentrali i Fierzës, apo zonat ku ka patur rrëshqitje masive të tokës dhe si rezultat janë shkatërruar shumë banesa.

Në këtë kontekst mendojmë se për ankesat që grumbullojnë kjo Ministri, duhet të përcaktohen prioritete, sikundër janë rastet kur fatkeqësitë natyrore kanë qenë me pasoja tepër të rënda për një jetesë normale. Veçojmë në këtë grup, ankesën e paraqitur nga Kryesia e Fshatit Nimçe, Komuna Topojan, Kukës, e cila na bën të ditur shqetësimin madhor, që ka ardhur si rezultat i rrëshqitjeve masive të tokës në këtë zonë, fakt i cili ka sjellë vështirësi të shumta për një jetesë normale, pasi ka ndërperë vijimin e nxënësve në shkollë, rrezikon shembjen e shtëpive dhe ka ndërprerë komunikimin me zonën, si dhe rrugën kryesore. Për këtë gjendje të krijuar ata dhe në vijimësi edhe Institucioni ynë, ka kërkuar ndihmë dhe mbështetje nga shteti dhe strukturat e tij, duke i bërë thirrje për një sensibilizim dhe nxitje në zgjidhje të problemit, por problemi është ende pa zgjidhje.

Për rastet e veçanta të fatkeqësive natyrore, fondet duhet të sigurohen pjesërisht nga mirëmenaxhimi i burimeve financiare të vetë organeve të pushtetit vendor, si dhe nga përpjekjet e këtyre të fundit, për të cilat janë vërejtur dhe zvarritje administrative dhe neglizhenca të theksuara, për t'ia bërë prezent dhe ndjekur problemin në strukturat qendrore, që delegojnë të tilla fonde.

Lidhur me organet e pushtetit vendor, duhet të vihet në dukje mungesa e transparencës dhe informimit të publikut, për veprimet dhe procedurat që ndërmarrin për këto raste, sikurse është rasti i shtetasit A.G. nga Komuna Bytyç e rrethit Tropojë, për të cilën nga Ministria ankuesi informohet se fondet janë akorduar. Ndërsa nga ana e Komunës nuk disponohet asnjë përgjigje, për pamundësinë e trajtimit të këtij rasti. Gjithashtu do të përmendim këtu dhe mungesën e plotë të informimit për ekzistencën e tregut të sigurimeve, të cilat nëse do të operojnë intensivisht sipas objektit të veprimtarisë, mbulojnë financiarisht një pjesë të madhe të fatkeqësive natyrore. Detyrimi ynë ligjor dhe institucional, është të nxisim dhe sensibilizojmë organet qendrore që çdo vit të programojnë fonde me destinacione të tilla, si dhe pranë organeve të pushtetit vendor, të cilat nga ana e tyre, duhet të menaxhojnë mirë burimet financiare, në favor të zgjidhjes së shqetësimeve jetike të komunitetit. Në këtë drejtim do të vazhdojmë të synojmë, në mënyrë që të garantojmë rritjen e besimit për zgjidhjen e ankesave të shtetasve.

Gjatë vitit 2004 me këtë Ministri, veçojmë ankesën e një grupi punonjësish të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit, të cilët pretendojnë se nga ana e Ministrisë së Pushtetit Vendor nuk janë përmbushur disa kërkesa të Ligjit Nr.8766 datë 5.04.2001 “Për mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpëtimin” në trajtimin e efektivave të kësaj strukture. Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, pasi konstatoam se kërkimet e tyre ishin të drejta, paraqitëm Rekomandimin tonë, nëpërmjet të cilës kërkuam përsheptimin e procedurave

për zbatimin e plotë të detyrimeve ligjore e nënligjore, ndaj trajtimit të këtyre efektivave, duke i konsideruar këto masa një prioritet të veprimtarisë së kësaj Ministrie. Në përgjigjen e dërguar nga Ministri vërejmë se Rekomandimi është mirëpritur dhe vënë në rrugën e zgjidhjes në favor të ankuesve, pasi paraprakisht është ngritur grupi i punës dhe po punohet në këtë drejtim.

Gjithashtu për këtë Ministri nënvizojmë ankesën e prezantuar nga një grup përfaqësuesish të kryetarëve të Degëve të Kordinimit Ekonomik, të Institucionit të Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave të Shtetit, të cilët ankoheshin lidhur me miratimin e shtesës për vështirësi pune (30 %) nga ana e Institucionit tuaj, në bazë të parashikimeve të bëra në VKM nr.726 datë 21.12.2000 “Për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore”.

Sikundër ata shkruajnë, kërkesa e tyre për të përfituar këtë shtesë bazohet në funksionimin si buxhetor të Institucionit të Rezervave të Shtetit dhe në rregulloren e brendshme të degëve të këtij institucioni.

Ne kemi gjykuar se zgjidhja e mundshme është dhënë në vetë VKM-në Nr.726 datë 21.12.2000, në paragrafin e gjashtë të pikës 7 të tij, ku thuhet shprehimisht se: “Kur punonjësit i takon të marrë dy a më shumë shtesa për vështirësi a dëmshmëri, ai do të marrë nga një vështirësi për çdo shkallë”.

Nga gjithë trajtimi dhe analiza e këtij rasti, pavarësisht se VKM-ja Nr.726 datë 21.12.2000, përcakton si kriter kryesor emërtesën për çdo funksion ose vend pune, rasti konkret nxjerr në pah anën tjetër të problemit, që lidhet me ngarkesën reale të punëve që kryen çdo emertesë në Institucione të ndryshëm, sikurse edhe në Drejtorinë e Përgjithshme të Rezervave të Shtetit.

Çështja në fjalë konstaton një dyzim faktik punësh që i përkasin dy emërtesave të ndryshme, por që në fund personi që i kryen, merr vetëm një pagë dhe vetëm një pagesë për vështirësi në procesin e punës.

Si një nga shkaqet për mosdhënien e kësaj pagese për vështirësi në trajtimin e mësipërm, citohet përfundimi i strukturave të reja dhe ndryshimit të emërtesave.

Por emërtesa e dhënë nga struktura e re, zgjidh pagesën për atë person që do të gëzojë këtë emërtesë në këtë institucion (ky fakt përjashton detyrimisht kryetarët e degëve ekonomike) dhe se nuk i jep pagesën kryetarëve të degëve që kanë bërë faktikisht punën e inspektorëve, deri në momentin kur ligjërohet emërtesa e re. Nisur nga trajtimi ligjor i çështjes Institucioni ynë i paraqiti Rekomandim Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave të Shtetit, duke kërkuar pagimin e shtesës mbi pagë, për Kryetarët e Degëve Ekonomike në degët e Rezervave të Shtetit, sipas Lidhjes II-A, pika 1, të VKM-së nr.726 datë 21.12.2000 “Për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore”. Kjo çështje është ende në shqyrtim, sepse nuk na është dërguar një qëndrim zyrtar për zgjidhjen e problemit.

Pjesën më të madhe të ankesave për zyrat e Gjendjes Civile, e zënë ato me objekt zvarritjen e procedurave dhe mosveprim nga ana e nëpunësve të tyre gjatë trajtimit të kerkesave të shtetasve. Gjithashtu nuk mungojnë dhe rastet kur ankuesit nuk informohen nga zyrat e gjendjes civile për kërkesat e tyre.

Përmendim këtu ankesën e shtetasës F.P, banuese në Tiranë, e cila kishte një periudhë rreth 2 vjet që nuk arrinte të merrte një certifikatë vdekjeje të bashkëshortit të saj me mbiemrin e saktë. Kjo vetëm për neglizhencë të nëpunësit të gjendjes civile Korçë për të gjetur rregjistrin përkatës. Gjithashtu shtetasi Dh.C. banues në Korçë, u ankua pasi kishte rreth dy muaj që nuk i plotësohej kërkesa për ndryshimin e mbiemrit në zbatim të ligjit “Për gjendjen civile”. Me ndërhyrjen e Institucionit tonë zyra e gjendjes civile u vu në lëvizje dhe ankuesi realizoi të drejtën e tij.

Ndërsa për çështjet që janë ende në trajtim ekziston problemi i moskthimit të përgjigjes në afatin e parashikuar në ligj, ndaj kërkesave tona për shpjegime. Përmendim këtu Zyrën e Gjendjes Civile të Njësisë bashkiake Nr.7 Tiranë dhe Zyrën e Gjendjes Civile, Sukth.

Pavarësisht numrit të vogël të ankesave të ardhura, nga trajtimi i tyre arrijmë në konkluzionin se nëpunësit e gjendjes civile nuk i trajtojnë me etikën e duhur qytetarët. Vërejmë këtu se ka mjaftuar ndërhyrja jonë pranë këtyre zyrave dhe çështja është zgjidhur. Rezulton që nuk ka patur shkaqe objektive për moszgjidhjen e problemeve, por kanë ekzistuar vetëm shkaqe subjektive, zvarritje pa shkak dhe trajtim në mënyrë jo të barabartë të shtetasve nga vetë nëpunësit e gjendjes civile.

### **Ankesat për organet e pushtetit vendor (Komunat, Bashkitë, dhe Prefekturat)**

Gjatë vitit 2004 kemi patur 369 ankesa, problematika e të cilave është e larmishme dhe natyrisht jo e panjohur, pasi është prezantuar edhe në Raportet e mëparëshme.

#### **a. Ankesa për komunat**

Nga 64 ankesa që kemi shqyrtuar me Komunat, 18 prej tyre janë të mbartuara nga viti 2003. Nga këto, 16 çështje janë ende në shqyrtim dhe 48 janë përfunduar, nga të cilat 10 janë në favor, 21 jashtë juridiksionit dhe 17 konsiderohen ankesa të pa bazuara. Objekti i ankesave të paraqitura gjatë këtij viti, ka qenë i ndryshëm, duke filluar që nga konfliktet e pronësisë në procedurat e ndjekura gjatë ndarjes së tokave nga Komisionet e Ndarjes së

Tokave, të cilat trajtohen në një zë të veçantë më poshtë dhe deri tek problemet jetike të komunitetit, si ndotjet e ambientit dhe zhurmat e shkaktuara në dëm të shëndetit, mos informim për procedurat administrative, apo ndërprerje e padrejtë e ndihmës ekonomike, mos përfitim i përkrahjes sociale, apo largime nga puna të pamotivuara, etj.

Fenomenet e shfaqura, si dhe problemet ekzistuese, janë më të dukshme në këto organe, sepse dhe niveli profesional nuk është në standartet që kërkon koha. Kjo sjell që vlerësimet dhe qëndrimet e tyre në raport me shkeljet e konstatuara, të mos gjejnë në kohën e duhur zgjidhjen ligjore të domosdoshme. Shpesh nga mos njohja e akteve ligjore dhe nënligjore, komunat jo vetëm që nuk shqyrtojnë dhe zgjidhin probleme, por nuk kthejnë as përgjigje ankuesve për sa kërkojnë. Sikurse e kemi konstatuar dhe prezantuar edhe vitin e mëparshëm, Kodi i Procedurave Administrative, e cila është bibla e Administratës, në shumë raste nuk njihet, por edhe kur njihet ose nuk zbatohet ose keqpërdoret për interesa të caktuara dhe shkaqe të pajustificuara.

Në grupin e ankesave të ndjekura me Komunat, gjatë këtij viti mund të veçojmë ankesën e shtetastit M.G. nga fshati Sovjan, Komuna Pirc Korçë, i cili ngrinte shqetësimin, në lidhje me ndotjen dhe zhurmat që i krijoheshin nga një objekt sharrë-zdrukthtari. Ankuesi pasi ia bëri prezent problemin Komunës Pirc, kjo e fundit nuk merrte masat ligjore për zgjidhjen e këtij problemi, me pretendimin se është e pa qartë, lidhur me kompetencat që duhet të ushtrojë në këtë rast. Në këto kushte, për t'i ardhur në ndihmë kësaj paqartësie, pas ndërhyrjes tonë, nga ana e Drejtorit të Planifikimit Urban në Këshillin e Qarkut Korçë u udhëzua Komuna Pirc, që të ushtrojë detyrat e saj funksionale për të zhvendosur objektin sharrë-zdrukthtari në një vend më të përshtatshëm, duke ruajtur një distancë optimale me zonat e banuara. Megjithë udhëzimin e lartpërmendur, sërisht Komuna nuk ka bërë të mundur zgjidhjen e këtij shqetësimi.

Avokati i Popullit, duke parë situatën e krijuar në të cilën neglizhenca dhe apatia për të zbatuar ligjin nga organet shtetërore sillte si pasojë lindjen e një konflikti të mprehtë social në Fshatin Sovjan, gjykoi se përgjegjësia kryesore për zgjidhjen sa më të shpejtë të kësaj çështje i përkiste vetëm Komunës Pirc dhe Inspektoratit Rajonal të Mjedisit.

Në këtë këndvështrim, Avokati i Popullit mendon se prononcimi i Kryetarit të Komunës Pirc, sipas të cilit kjo komunë në rastin konkret nuk mund të kryejë asnjë veprim, anashkalon tërësisht kompetencat funksionale të këtij organi duke e bërë atë inekzistent. Ky qëndrim në kundërshtim të hapur me detyrimet ligjore komunale ngarkon me përgjegjësi të madhe Kryetarin e Komunës, i cili në situatën e krijuar i ka të gjitha mundësitë të zgjidhë këtë problem, konform prerogativave të tij të parashikuar në dispozitat ligjore.

Mosveprimi ndaj fenomeneve të tilla të cilat përbëjnë kundravajtje administrative (zhurma, ndotja etj) është një qëndrim që cënon rëndë imazhin e organeve përfaqësuese vendore. Ndaj u kërkua që kjo gjendje paligjshmërie duhet të pushojë së ekzistuari, për ti hapur rrugë funksionimit normal të Komunës në shërbim të komunitetit që e ka votuar atë. Mosveprimi i organeve të qeverisjes vendore për zgjidhjen e problemeve dhe shqetësimeve të shtetasve, si në këtë rast, por edhe në shumë raste të tjera, si dhe mungesa e bashkëpunimit midis organeve, krijon një imazh negativ të mirëqeverisjes, si dhe shfaq një ndikim të drejtëpërsëdrejti në komunitet, duke u bërë në ndonjë rast dhe burim konflikti. Në të tilla raste, ku shfaqet dukshëm mosveprimi i organeve vendore, Avokati i Popullit ka ndërhyrë që të gjenden mënyrat propocionalisht të pranueshme të zgjidhjes, midis interesave të ligjshme të banorëve dhe garantimit të plotë të zbatimit të ligjshmërisë.

Gjatë shqyrtimit të ankesave me Komunat, është vërejtur se në disa raste në këto struktura, aktet administrative apo shkallët e ankimit administrativ, nuk njihen ose ndërmerren veprime nga kryetarët e komunave që kapërcejnë kompetencat e tyre. Gjithashtu janë shfaqur dhe zvarritje e neglizhenca në trajtimin e problemeve, mos angazhim për zgjidhjen e fenomeneve, sidomos në zonat rurale. Kjo dhe për faktin se duke qenë të veshur me mandat politik zgjedhor, Kryetarët e Komunave e konsiderojnë veten të pacënueshëm edhe në rastet kur shkelin ligjin në mënyrë sistematike, me dashje apo për qëllime abuzive.

Nga gama e gjerë e ankesave me Komunat mund të veçojmë dhe ankesën e paraqitur nga L.K, ish mësues në shkollën Qesarat të Komunës Dajt, i cili na prezantonte problemin në lidhje me mosdhënien e pagës së 13 –të në përpjestim me kohën e punës. Duke e konsideruar të drejtë dhe ligjore kërkesën e mësipërme, Institucioni ynë ndërhyri pranë kësaj Komune, duke bërë të mundur përfitimin e kësaj të drejte në favor të ankuesit. Po kështu edhe shtetasi N.N. ankohej se nga Komuna Fan-Klos, i kishte mbajtur pa të drejtë dhe nuk i kishte paguar pensionin e invaliditetit të të atit “të verbër”. Pas verifikimit të çështjes dhe ndërmjetësimit tonë pranë Komunës, u arrit që të rivendoset në vend e drejta e shkelur kundrejt ankuesit.

Vlen të përmendim dhe ankesën e paraqitur nga grup shoferësh, të cilët shfrytëzojnë rrugën Gose-Vil Boshtovë, Kavajë, të cilët ngrinin shqetësimin, përse i përket vendosjes së një takse nga ana e autoriteteve vendore për kalimin në këtë rrugë.

Duke e konsideruar të padrejtë dhe të kundraligjshme vendosjen e një trau dhe taksës përkatëse, nga ana jonë u ndërmjetësua pranë Komunës Gosë dhe Këshillit të Komunës Gosë dhe së fundmi u arrit që çështja të zgjidhet pozitivisht.



Pra në shqyrtimin e këtyre ankesave, ka rezultuar se nga Komunitat apo Këshillat e Komunave, vërehen mosveprime, apo veprime të kundraligjshme dhe tej kompetencave të përcaktuara në Ligjin Nr.8652 datë 31.07.2000 “Për Organizimin dhe funksionimin e Qeverisjes Vendore”. Sikurse është rasti tipik i ankesës së paraqitur nga shtetasi V.S, banues në fshatin Libonik, i cili ankohej për mos veprim të Komunës, për faktin se me një vendim të KKK të Pronave, i ishte njohur dhe kthyer fizikisht një sipërfaqe toke e lirë brenda vijave kufizuese të fshatit Libonik. Ankuesi pretendonte se megjithëse kërkonte nga Komuna t’i dorëzohen pronat e paluajtshme me proces-verbal të rregullt, nuk gjente mirëkuptimin e duhur. Duke parë se me këto mos-veprime cënoheshin rëndë të drejtat e tij legjitime, si pronar i ligjshëm, u ndërhy nga Institucioni ynë, për të mundësuar rivendosjen në vend të kësaj të drejte të parashikuar në Nenin 41 të Kushtetutës, si dhe pikën 10 të Udhëzimit të Këshillit të Ministrave nr.13, datë 18.10.1993 “Për zbatimin e Ligjit nr.7698, datë 15.4.1993 dhe ndryshime në Udhëzimin nr.3 datë 21.6.1993” në të cilën parashikohet se: “Vendimet e Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave në rrethe ose bashki janë të detyrueshme për ekzekutim nga organet shtetërore përkatëse (organet e pushtetit lokal dhe policia)”. Pas kësaj ndërhyrje institucionale nga ana jonë, çështja u zgjidh pozitivisht dhe ankuesi rivendosi në vend të drejtën e tij legjitime.

## **b. Ankesat për bashkitë**

Gjatë vitit 2004 në Institucionin e Avokatit të Popullit kanë mbërritur 211 ankesa kundrejt Bashkive. Gjithashtu kemi shqyrtuar edhe 76 ankesa të mbartura nga viti 2003, gjithsej 287. Nga këto janë përfunduar 206 dhe janë ende në shqyrtim 81 ankesa. Nga totali i ankesave të përfunduara kanë rezultuar 31 ankesa në favor të ankuesve, 83 prej tyre jashtë juridiksionit dhe 92 ankesa të pa bazuara. Problematika e çështjeve është e ndryshme dhe e shumëllojshme, sepse dhe vetë veprimtaria dhe aktiviteti i këtij organi, është e tillë që përballet çdo ditë me problemet dhe shqetësimet e komunitetit për çështje nga më jetiket dhe deri tek problemet më madhore. Natyrisht edhe këtë vit prezantohen probleme dhe fenomene, të cilat nuk janë të panjohura dhe të paditura, porse zgjidhja e tyre është ende larg pasi kërkon kohë, investime, burime njerëzore dhe financiare dhe për më tepër projekte dhe strategji të qarta afat gjata dhe afat shkurtëra, duke përcaktuar më parë prioritetet dhe alternativa zgjidhje. Shumica e objektivit të ankesave të mbërritura gjatë këtij viti ka patur në qendër të vëmendjes, çështjen e strehimit si një problem madhor, i prekshëm, jetik, por praktikisht ende i pazgjidhshëm. Megjithëse për këtë vit vlen të përmendet zgjidhja e 54 familjeve në Tirane, të pastreha nga rënia e skemave piramidale, të cilat u strehuan në pallatet e ndërtruara posaçërisht për këtë kategori. Ky

natyrisht është një hap i madh përpara për t'u përshëndetur, që rrit besimin dhe shpresën në materializimin e politikave të zgjidhjes së këtij problemi. Megjithatë ende ka shumë për të bërë në këtë drejtim. Duke shpresuar se aktet e fundit ligjore dhe nënligjore që kanë dalë nga Qeveria për zgjidhjen e strehimit do të zgjidhin hap pas hapi këtë problem kombëtar dhe madhor, besojmë se dhe kategoritë e tjera të pastreha do të përfitojnë nga këto politika sociale të shtetit. Megjithatë gjatë trajtimit të këtyre ankesave ka patur pretendime nga ankuesit, se mungon transparenca në përzgjedhjen e kategorive apo në vendimarrjet për zgjidhjen e këtyre çështjeve dhe sidomos në vendimet që marrin këshillat bashkiake, për të cilat pretendohet se asnjëherë nuk dihen kriteret vlerësuese, radha e trajtimit të shtetasve. Mungon informimi publik për ditën e mbledhjeve, apo dhe rendin e ditës të mbledhjeve të këshillave bashkiake, të cilat duhet të jenë publike dhe të njohura, me qëllim që personat e interesuar të jenë pjesë e kësaj procedure, për të cilët janë direkt të interesuar dhe për të cilat duhet të vihen në dijeni, qoftë dhe se kur praktikisht mund të zgjidhen shqetësimet e tyre. Në këtë drejtim është e nevojshme të rritet transparenca nga organet e pushtetit vendor, për t'i bërë të njohur taksapaguesve dhe zgjedhësve të tyre punën dhe arritjet për zgjidhjen e këtij problemi madhor, si dhe strategjitë përkatëse, pasi shpesh shtetasit nuk informohen në kohë për kuadrin ligjor ekzistues dhe në këtë mënyrë humbasin dhe afatet ligjore për mbrojtjen e interesave të tyre të ligjshme. Këto organe, duke qenë se ushtrojnë veprimtarinë mbi bazën e parimit të autonomisë dhe vetëqeverisjes, duhet që të rritin bashkëpunimin me komunitetin për tërheqjen e mendimit të tyre, për alternativat dhe kohën e zgjidhjes. Për gjithë kuadrin ligjor që trajton strehimin, shtetasit janë krejtësisht të pa informuar, pasi shpesh nuk dinë se ku duhet t'i kërkojnë të drejtat e tyre.

Sikurse edhe vitin e kaluar janë konstatuar mjaft raste kur Bashkitë nuk shfrytëzojnë mjetet ligjore për zgjidhjen e ankesave të shtetasve, nuk shfrytëzojnë kompetencat që u jep Ligji Nr.8652 datë 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e organeve të qeverisjes vendore", duke hezitur në nxjerrjen e urdhërave administrative, duke i treguar qytetarëve rrugën gjyqësore. Ndërkohë që sipas Kodit të Procedurave Administrative dhe ligjit të sipërcituar, ato kanë të drejtë të ndërmarrin procedime të tilla, duke marrë në shqyrtim dhe vendosur edhe për ankimet administrative. Ndërsa në mjaft raste të tjera i tejkalojnë këto kompetenca, duke marrë përsipër detyra funksionale të cilat nuk i takojnë.

Një nga parimet bazë të funksionimit të organeve të njësisve vendore është vazhdimësia e tyre, e përcaktuar qartë në pikën 5 të nenit 4 të Ligjit Nr.8652 datë 31.07.2000 "Për Organizimin dhe funksionimin e Qeverisjes Vendore". Por ndryshimi i Kryetarëve të Bashkive dhe i Këshillave Bashkiake, pas zgjedhjeve

të Tetorit 2003, në disa raste kanë sjellë mos funksionim në rregull dhe në vazhdimësi të veprimtarive të këtyre njësive. Kështu mos konstituimi i këshillave bashkiake në kohën e duhur, paralizoi zgjidhjen e shumë problemeve akute të komuniteteve, duke vështirësuar zgjidhjen e mëtejshme, rriti kaosin dhe pasigurinë në administratën e këtyre organeve.

Në grupin e atyre ankesave, në të cilat shfaqet dukshëm tejkalimi i kompetencave apo dhe atribucioni i kompetencave që nuk u takojnë, vlen të përmendim një rast tipik të prezantuar nga shtetasi K.K. nga Tirana, i cili në ankesën e tij evidentonte paligjshmërinë e një vendimi të marrë nga një Komision i quajtur i vlerësimit pranë Bashkisë Himarë, duke kërkuar konstatimin absolutisht të pavlefshëm të tij në bazë të Kodit të Procedurave Administrative.

Shtetasi u ankua pranë Zyrës tonë për këtë akt administrativ të dalë nga një organ i pidentifikuar pranë Bashkisë Himarë. Konkretivisht Bashkia Himarë me një vendim të Komisionit të Vlerësimit (!?), duke parë në vend punimet e kryera nga një shtetas M.S. për ndërtimin e shtëpisë që i është dhënë me leje nga ish Këshilli Popullor i qytetit të Himarës, kishte vendosur që K.K. t'i paguante shtetasit M.S. vlerën prej 435 mijë lekë sipas preventivit të paraqitur nga Komisioni i Vlerësimit dhe në rast të mos shlyerjes së këtij detyrimi, trualli tjetërsohej në favor të ashtuquajturit kreditor, M.S.

Komisione të tilla që vlerësojnë dëme materiale shkaktuar midis personave privat dhe për më tepër që marrin edhe vendime, janë krejtësisht në kundërshtim me Kushtetutën dhe me Ligjin nr. 8652, datë 31.7.2000 "Për organizimin e funksionimit të qeverisjes vendore". Është pikërisht ky ligj, që përcakton mënyrën e organizimit dhe funksionimit të njësive të qeverisjes vendore, misionin, parimet themelore mbi të cilat veprojnë këto njësive, organet përbërëse qofshin kolegjiale apo monokratike si dhe detyrat dhe të drejtat e tyre.

Komisioni i lart përmendur nuk është nga ato komisione të njohura nga ky ligj. Është e vërtetë se në pikën 1/d të nenit 8 që trajton të drejtat e njësive të qeverisjes vendore, parashikohet ngritja e komiteteve, bordeve apo komisioneve për kryerjen e funksioneve të veçanta sa herë që paraqitet nevoja. Është krejt normale që në funksion të ushtrimit të qeverisjes dhe brenda kuadrit të kompetencave, për një problem të caktuar mund të ngrihet një komision, i cili bën vetëm parashtrime para organit që i ka krijuar, për sa ka vrojtuar e konkluduar, por nuk mund t'i japë vetes të drejtën e vendim-marrjes. Të drejtën e marrjes së vendimit, pas relativitetit të këtyre komisioneve, e kanë organet e përcaktuara në ligj, si Këshillat e Komunave, Bashkive apo Qarqeve, Kryetari i Komunës, Bashkisë apo Qarkut. Për më tepër, nuk mund të ngrihen komisione që të marrin atributet e pushtetit gjyqësor, duke përcaktuar dëmin e shkaktuar në konfliktet midis personave privatë, përcaktimin e fajësisë dhe mënyrën e

zgjidhjes. Këto veprime diletanteske janë hapur në kundërshtim me nenin 7 të Kushtetutës që parashikon se sistemi i qeverisjes në Republikën e Shqipërisë bazohet në ndarjen dhe balancimin ndërmjet pushteteve ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor. Zgjidhja e konflikteve midis personave fizikë është e drejtë ekskluzive vetëm e pushtetit gjyqësor që vihet në lëvizje me kërkesën e të dëmtuarit nga veprimet ose mos veprimet e një personi që pretendohet se e ka dëmtuar, është gjykata, që nëpërmjet ekspertëve të caktuar prej saj, vlerëson dëmin efektiv, fajësinë ose pafajësinë rast pas rasti dhe mënyrën e zgjidhjes në themel të çështjes nëpërmjet vendimit që merr dhe shpall në përfundim të gjykimit. Në rastin konkret “Komisioni i Vlerësimit” ka marrë të gjitha atributet e pushtetit gjyqësor. Në vendimin e komisionit ka edhe diçka “të re”, vendoset një mënyrë e re e fitimit të pronësisë, ajo që nëse nuk paguhet detyrimi monetar, toka tjetërsohet. Në pikën 2 të Nenit 41 të Kushtetutës në mënyrë taksative është sanksionuar: ***“Prona fitohet me dhurim, me trashëgim, me blerje dhe me çdo mënyrë tjetër të parashikuar në Kodin Civil”***.

Organe të sajuara në këto mënyra dhe vendime të tilla që marrin, si nga padija, ashtu edhe nga mungesa e ndjenjës së përgjegjësisë, jo vetëm kompetencat e Këshillit Bashkiak, si organ vendimarrës, por edhe juridiksionin e gjykatave, janë në kundërvënje me tërë legjislacionin tonë. Vendime të tilla janë haptazi në kundërshtim me frymën e ligjit dhe janë burim konfliktesh midis personave për të cilët dalin “akte” të tilla.

Këto janë veprime dhe akte absolutisht të pavlefshme dhe si të tilla nuk krijojnë asnjë pasojë ligjore, aq më tepër që në Bashkinë e Himarës raste të tilla ishin të përsëritura. Për këtë arsye, Zyra jonë paraqiti Rekomandimin nëpërmjet të cilës synonte që në bazë të Nenit 17 të Kodit të Proçedurave Administrative, Këshilli i Bashkisë Himarë të konstatonte pavlefshmërinë absolute të vendimit të Komisionit të Vlerësimit, me qëllim që palët në konflikt t’i adresohen Gjykatës për zgjidhjen e pretendimeve. Nga ana tjetër të prezantohen para këshilltarëve raste të tilla që nuk i shërbejnë konsolidimit të Administratës Publike dhe shërbimit ndaj komunitetit mbi parimet e ligjshmërisë, paanësisë dhe respektimit të ligjit.

Ky Rekomandim u mirëprit nga Bashkia Himarë, e cila mori masat e duhura ligjore për rivendosjen në vend të kësaj të drejte, duke zgjidhur pozitivisht çështjen.

Gjithashtu për Bashkinë e Tiranës, mund të veçojmë dhe ankesën e prezantuar nga përfaqësues të Sindikatës së Pavarur të Transportit Urban, të cilët në objektin e kësaj ankese ngrinin problemin se futja e operatorëve privatë në transportin publik të qytetit të Tiranës është bërë në kundërshtim me aktet ligjore dhe nënligjore përkatëse.

Sipas një vendimi të Drejtorisë së Transportit pranë Drejtorisë së Përgjithshme Ekonomike të Bashkisë Tiranë, Bashkia kishte kontraktuar me subjektet private që operojnë në fushën e transportit mbështetur në një Vendim të Këshillit Bashkiak të qytetit.

Bazuar në vendimin e sipërcituar, transporti qytetas në territorin e qytetit të Tiranës përbëhet nga 9 linja urbane. Në bazë të pikës 2 të këtij vendimi, Parku i Transportit Urban të udhëtarëve Tirane do të jetë përgjegjës për mbulimin e linjës 1, 2A dhe 3, ndërkohë që për mbulimin e linjave të tjera do të jenë përgjegjëse Shoqëritë Private të Transportit pas liçencimit të tyre sipas procedurave ligjore.

Pra, në Vendimin e Këshillit Bashkiak është përcaktuar se për cilat linja Bashkia e Tiranës duhet të kontraktojë me operatorët privatë. Ka rezultuar, gjithmonë nga shkresa e ardhur nga Drejtoria e Transportit pranë Bashkisë Tiranë, se operatorët janë “Tirana lines” dhe “Tirana Urban Trans”, ndërkohë që linjat e tjera duhet të mbulohen nga ana e Parkut të Transportit Urban, i cili është ndërmarrje publike që ka varësi administrative nga Bashkia Tiranë.

Por faktikisht rezulton se nga ana e Parkut të Transportit Urban mbulohet vetëm një pjesë e linjës 1. Pra dhe linjat e tjera, të cilat në vendimin e Këshillit Bashkiak i janë lënë Parkut, në fakt i kanë kaluar operatorëve privatë.

Kjo ndodhi pikërisht pas organizimit të grevës nga ana e Sindikatës së Pavarur të Transportit Urban, pra pas datës 21.03.2004. Me futjen e operatorit tjetër privat nga ana e Këshillit Drejtues, paralelisht u mor dhe vendimi për largimin nga puna të 80 punonjësve të tjerë të Parkut.

Nga verifikimi i çështjes, sipas akteve ligjore në këtë fushë, futja e operatorëve privatë në shërbimin urban duhet të bëhet detyrimisht në ato linja të cilat janë përcaktuar me Vendim të Këshillit Bashkiak, pasi ligji dhe aktet nënligjore nuk lënë klauzolë tjetër.

Parku i Transportit të Udhëtarëve Tiranë është ndërmarrje publike, që ushtron veprimtarinë ekonomike në kushtet e konkurrencës së lirë e të ligjshme, bazuar në Ligjin Nr.7582 datë 13.07.1992 “Për ndërmarrjet shtetërore” me ndryshimet përkatëse.

Gjithashtu ai është në varësi administrative nga Bashkia Tiranë dhe është një nga operatorët që kryen shërbimin e transportit urban.

Pra është e pabazuar në ligj dhe në aktet nënligjore nënkontraktimi i realizuar nga vetë Parku, pasi në rolin e organit që ka të drejtë të vendosë lidhur me transportin qytetas urban është Këshilli Bashkiak. Për zgjidhjen e kësaj situate, Institucioni ynë i rekomandoi Bashkisë Tiranë, rregullimin në përputhje me Ligjin të shërbimit urban në qytetin e Tiranës dhe marrjen e masave për përgjegjësit e shkeljes ligjore të konstatuar si dhe paralel i dërgoi rekomandim

Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe Inspektoriatit Shtetëror të Punës. Përgjigje zyrtare për zgjidhjen e kësaj çështje ende nuk kemi marrë.

Veçojme ndër rastet e trajtuara me Bashkitë dhe ankesën e paraqitur nga shtetasi L.B. nga Pogradeci, i cili parashtronte shqetësimin e tij, për një vendim të K.R.R.T-Bashkisë Pogradec, i cili kishte vendosur të nxirren të paligjshme dhe të prishen edhe dy objekte të ankuesit L. B.

Nga verifikimi i pretendimeve të paraqitura rezultoi se ankuesit i është dhënë leja e ndërtimit, pra ai presupozohet se ka vepruar konformë ligjit dhe se ai ndodhet në kushtet e mirëbesimit, kusht i cili e përjashton nga çdo lloj përgjegjësie. Ai ka të drejtë të gëzojë lirisht pronën e tij dhe askush nuk mund ta cënojë e për më tepër t'i shkaktojë dëm interesave të tij ekonomike. Askush nuk mund të mbajë përgjegjësi për veprimet e parregullta të kryera nga punonjësit e Administratës Shtetërore. Veprimet e mësipërme vijnë në kundërshtim me Nenin 3/b të Ligjit nr. 88510 datë 15.7.1999 *“Për përgjegjësinë jashtëkontraktore të organeve të Administratës Shtetërore”* ku thuhet se: *“organet e Administratës Shtetërore përgjigjen për dëmet që u shkaktojnë personave fizikë a juridikë privat kur kryejnë veprime a mosveprime të ligjshme, por që sjellin dëmtimin e interesave të ligjshme të personave fizikë a juridikë privat”*.

Në rastin konkret normalisht që ankuesi nuk mund të përgjigjet e dëmtohet ekonomikisht, mbasi ai disponon lejen e ndërtimit të dhënë nga organi kompetent. Në një situatë të tillë në rast se ndërtimi i ligjshëm i bërë nga ankuesi pengon realizimin e studimit të zonës apo planin e përgjithshëm urbanistik, nga ana e Bashkisë për interesin publik duhej të bëhej shpronësimi real i pronës së ankuesit. E drejta që secili ka për të gëzuar e poseduar lirisht pronën është një e drejtë universale që rrjedh nga e drejta e pronësisë. Në këtë kuadër veprimet e K.R.R.T. vinë në kundërshtim edhe me Nenin 44 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku thuhet se: *“kushdo ka të drejtë të rehabilitohet ose zhdëmtohet në përputhje me ligjin në rast se është dëmtuar për shkak të një akti, veprimi ose mosveprimi të paligjshëm të organeve shtetërore.”*

Veç sa më sipër u konstatua se ishte shkelur edhe Neni 41 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut Neni 1/1 i Protokollit shtesë Nr. 1 ku thuhet se: *“Çdo person ka të drejtë për respektimin e pasurisë së tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, veçse për arsye të dobisë publike dhe në kushtet e parashikuara në ligj dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare”*. Nisur nga këto argumente ligjore Institucioni ynë i rekomandoi Bashkisë Pogradec që të fillonte procedimin administrativ dhe në bazë të legjislacionit të sipërpërmendur të kryhet zhdëmtimi real për dëmin që ka pësuar ankuesi L.B. Kjo çështje është ende në shqyrtim nga Zyra jonë.

Një rast tjetër që vlen të përmendet dhe që bën fjalë për veprime të parregullta të Bashkisë është ankesa e shtetasit A.A, i cili prezantonte shqetësimin në lidhje me mospezullimin nga ana e Drejtorisë së Politikave Urbane në Bashkinë Tiranë, të procedurave administrative të inicuar nga kërkesa e shtetasit V. Ai, për dhënien e një leje ndërtimi në një sipërfaqe trualli, e cila është bërë objekt shqyrtimi gjyqësor përse i përket përcaktimit të titullit të pronësisë të saj dhe përveç kësaj kishte filluar dhe procedim penal ndaj këtij të fundit për veprën penale të fallsifikimit të dokumentave. Ndërsa Bashkia Tiranë megjithëse kishte shkaqe të arsyeshme për të pezulluar këtë procedurë, përsëri nuk vepronte duke rrezikuar pozitën e ankuesit A.A.

Gjatë këtij procedimi për vetë rëndësinë e sqarimit të përkatësisë së titullit të pronësisë, është e domosdoshme të pezullohet procedimi i mëtejshëm deri në marrjen e vendimit përfundimtar nga ana e gjykatës.

Për më tepër konfliktet e pronësisë sikurse në këtë rast, në mënyrë të padiskutueshme janë kompetencë e gjykatës dhe e asnjë organi tjetër.

Nga sa më sipër u rekomandua pezullimi i menjëhershëm i procedurës së nisur për dhënien e lejes së ndërtimit (për më tepër kur ka filluar edhe një procedim penal), deri në dhënien e vendimit përfundimtar të formës së prerë nga ana e gjykatës. Pas kësaj ndërhyrje kjo çështje u zgjidh në favor të ankuesit.

Një tjetër ankesë që mund të relatojmë dhe që shfaq dukshëm veprimet e parregullta të Bashkisë Tiranë, kundrejt interesave të ligjshme të shtetasve, është ajo e shtetasit T.B, në të cilën sipas pretendimeve të ankuesit përgjithësohet një praktikë e gabuar dhe e padrejtë që ndiqej nga Drejtoria e Legalizim-Shpronësimeve, pranë Bashkisë Tiranë.

Shtetasi T.B. me një vendim të Komisionit të Kthimit e Kompesimit të Pronave Tiranë, kishte rregjistruar midis të tjerash në Zyrën e Rregjistrimit të Pasurive të Paluajtshme një sipërfaqe trualli, e cila sipas hartës treguese shtrihej në Bulevardin “Bajram Curri” (*buzë rrugës, në anën e kundërt të skarpatit të Lanës*). Ky segment rrugor gjatë vitit 2003 i është nënshtruar rikonstruksionit dhe zgjerimit nga ana e Bashkisë Tiranë, duke mos u marrë parasysh, sipas ankuesit, pronësia e tyre apo shpronësimi për interes publik sipas ligjit.

Duke analizuar në tërësi çështjen, Zyra jonë gjykoi se procedurat e ndjekura për punimet në këtë segment rrugor urban, në raport me të drejtat legjitime të pronarëve të trojeve janë kryer në kundërshtim të hapur me Ligjin Nr.8561, datë 22.12.1999 “*Për Shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik*”.

Në ligjin e sipërcituar parapraakisht caktohet rradha e punëve dhe etapave që duhen përmbushur deri në fillimin e punimeve. Së pari fillohet me ngritjen e Komisionit të Shpronësimit, më tej vazhdohet me evidentimin e sipërfaqeve që preken nga projekti, me vlerën e drejtë që duhet të akordohet ndaj pronarëve,

me nënshkrimin e marrëveshjes me pronarët për shpronësim dhe së fundi me procedurat e miratimit të fondeve. Pas realizimit të këtyre fazave, subjektit të interesuar (*në këtë rast Bashkisë Tiranë*) i lind e drejta të fillojë planin zbatues të punimeve në terren. Ne vlerësuam se për sa kohë nuk janë përmbushur kriteret e ligjit të mësipërm në favor të pronarëve legjitim, për aq kohë këto punime dhe vepra me vlerë urbane do të konsiderohen cënim pronësie private, në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.

Të njohësh dhe të trajtosh pronarët sipas të drejtave të tyre është së pari një detyrim që buron nga Protokollin I Neni 1 i Konventës Europiane e të Drejtave të Njeriut dhe Kushtetuta e Shqipërisë.

Avokati i Popullit, mendon se vlerat publike që përfaqësojnë punët e Bashkisë Tiranë duhet të ecin paralelisht me zbatimin korrekt të ligjit në mbrojtje të të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshme të individëve. Çdo përpjekje për të anashkaluar legjislacionin në fuqi dhe për të cënuar të drejtat e pronësisë është një veprim, i cili dëmton forcimin e shtetit të së drejtës.

Gjithashtu, Avokati i Popullit shpreson që mungesa e pasqyrimit të veprimtarisë shpronësuese në Buletinin Vjetor 2003 të Bashkisë Tiranë, është thjesht një harresë botimi dhe nuk përbën një veprim të ndërgjegjshëm për realitetin antiligjor që ushtrohet në dëm të individëve.

Në këtë situatë të re, ku niveli i shkeljeve të të drejtave dhe lirive themelore po shihet si barometër për etiketimin dhe standartizimin në planet integruese, Avokati i Popullit apelon për më shumë kujdes dhe profesionalizëm në marrëdhënie me individët dhe me të drejtat që ata gëzojnë karshi organeve të Administratës Publike Qendrore apo Vendore.

Duke e konsideruar të kundraligjshme praktikën e lartpërmendur, si shkelje të të drejtave dhe interesave të ligjshme të individit, rekomanduam eliminimin e praktikave të padrejta që ndiqen për pronarët që duhet të shpronësohen për interes publik. Në lidhje me këtë konstatim, kemi marrë konfirmime verbale se çështja është mirëkuptuar dhe do të merren masat e nevojshme ligjore për rregullimin e gjendjes.

Gjatë shqyrtimit të ankesave me Bashkitë, vlen të theksojmë shembullin pozitiv të punës në Bashkinë e Tiranës, në të cilën është konstatuar se po bëhen përpjekje për një model qeverisës, me elementët bazë të standarteve mirëadministruese ndaj publikut. Ky opinion argumentohet nga një sërë masash, ku një vend të veçantë zë riorganizimi i pritjes së popullit, garantimi i të drejtës së informimit për dokumentat zyrtare, respektimi i afateve administrative për paraqitjen e dokumentacionit të kërkuar etj. Kjo veprimtari pozitive ka lënë një shije të mirë në opinionin publik, duke gjetur përkrahje të hapur dhe mbështetje serioze nga një sërë institucionesh që synojnë rritjen e përgjegjshmërisë administrative ndaj publikut. Gjithësesi këto përpjekje konformë kësaj fryme



kanë nevojë për një oponentë konstruktive të vazhdueshme, e cila në rastet që kemi ndjekur me këtë organ, jemi munduar t'ia servirim me profesionalizëm e objektivitet nga Zyra jonë.

Konkretisht në këtë kuadër, mund të ndalemi në një çështje, e cila për vetë specifikat e saj, përgjithëson një praktikë të gabuar ligjore që ndiqet nga Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore, pranë Bashkisë Tiranë. Ky proces u iniciua nga ankesa e T.D. nga Tirana, i cili pasi sqaronte pozitën e tij si pronar i ligjshëm në zonën përballë Institutit të Lartë Bujqësor Kamëz, ku është hapur dhe funksionon një treg, ka ngritur shqetësimin se nëpunës të Bashkisë Tiranë, e konkretisht të Drejtorisë së Tregje-Taksave vjelin çdo muaj “*Taksën e Vendit*” ndaj biznesmenëve të atjeshëm, duke shkelur të drejtën e pronarit për të përfituar në bazë të lëgjislacionit në fuqi. Pronësia në fjalë e ka burimin nga një titull i hershëm i njohur dhe kthyer me anë të Vendimit të Komisionit të Kthimit e Kompesimit të Pronave, Tiranë dhe rregjistruar në Zyrën e Rregjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë.

Zyra jonë, duke vlerësuar në tërësi problematikën që shfaqte përmbajtja e kësaj ankese, shqyrtoi praktikën e ndjekur nga Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore, duke patur si qëllim të evidentonte qëndrimin e këtij organi ndaj të drejtave të pronarit të truallit ku vlej taksa vendore për zënie hapësire publike.

Sipas Drejtorisë së Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore në zbatim të dispozitave të Ligjit Nr.8982 dt.12.12.2002 “*Për Sistemin e Taksave Vendore*” dhe Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr.7 dt.07.03.2001 “*Për Sistemin e Taksave dhe Tarifave Vendore në Qytetin e Tiranës*”, taksa vendore për zënien e hapësirave publike, aplikohet për të gjithë subjektet, të cilët shfrytëzojnë hapësirat publike për të kryer aktivitetet tregëtar dhe baza e kësaj takse është sipërfaqja në metër katror që vihet në shfrytëzim prej tyre. Në një kuadër të përgjithshëm vërehet lehtësisht se veprimtaria e Drejtorisë së Përgjithshme të Taksave dhe Tarifave pranë Bashkisë Tiranë, mundohet të vihet në funksionim konformë dispozitave ligjore dhe akteve të tjera administrative. Por nga një analizë më e thellë dhe e detajuar e praktikës që ndiqej nga ky organ, për të identifikuar dhe trajtuar ligjërisht pronarët e trojeve ku vilen taksa për zënien e hapësirave publike, rezultoi se brendia e këtyre procedurave ka elementë të parregullsive administrative që derivojnë në shkelje të të drejtave dhe interesave të ligjshme të qytetarëve. Kjo sepse procesi i caktimit të zonave apo hapësirave publike ku ushtrohet veprimtari tregtare për efekt të aplikimit dhe vjeljes së taksave duhet të kryhet nëpërmjet një verifikimi paraprak nga Bashkia e Tiranës dhe nga organet në varësi të saj. Konkretisht ky verifikim paraprak duhet të konsistojë në evidentimin e mundshëm nëpërmjet Zyrës së Rregjistrimit të Pasurive të Paluajtshme të të gjithë pronarëve të truallit brenda zonës ku

ushtrohet aktivitet tregtar. Ky verifikim duhet të konsiderohet si pjesë e pandarë e detyrimit pozitiv të organeve publike për të mos cënuar të drejtat e pronësisë mbi qytetarë të ndryshëm. Në çështjen e T.D, i cili njihet si pronar i ligjshëm i truallit që nga viti 1996, mundet që Bashkia e Tiranës të pësojë humbje gjyqësore të të ardhurave të saj, si pasojë e vjeljes së taksave në kundërshtim me ligjin. Kjo për arsyen e thjeshtë se Ligji Nr.8982 dt.12.12.2002 “Për Sistemin e Taksave Vendore” shprehet në mënyrë eksplicite për hapësira publike ku aplikohen taksat vendore. Si rrjedhim askush, qoftë edhe me autoritet shtetëror, nuk mund të vjelë taksa pa patur pronësinë territoriale, si dhe pa e verifikuar më parë këtë atribut ligjor me dokumentacionet përkatës. Kjo analizë vlen për të shkukur nga mendja e ndonjë burokrati mentalitetin se çdo hapësirë apo truall në dukje i lirë dhe i pa rrethuar është në pronësi apo juridiksion fiskal të Bashkisë Tiranë.

Ky konstatim nga ana e Zyrës tonë, konkludoi i drejtë sepse Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave, pranoi se jo vetëm tregu përballë Universitetit Bujqësor të Kamzës nuk ndodhet në hapësira publike, por ai në të njëjtën kohë ka qenë edhe i pamiruar si zonë për aktivitet tregtar.

Këto procedura dhe praktika të gabuara, të cilat mund të ndodhin edhe në organet e tjera vendore kemi mendimin se jo vetëm cënojnë hapur interesat e ligjshme të pronarëve, por nganjëherë formojnë mendimin se Bashkitë, me qëllim mbushjen e arkës së tyre po motivohen në veprime të paligjshme, për të përfituar sa më shumë në këtë kuadër.

Problematika të cilat janë hasur gjatë trajtimit të ankesave me Bashkitë, janë dhe ato që lidhen me mos zbatimin e Ligjit Nr.8549 datë 11.11.1999 “Statusi i Nënpunësit Civil” në veçanti, si dhe mos ekzekutimi i vendimeve gjyqësore në përgjithësi.

Në këtë drejtim përmendim rastin tipik të A.C. nga Ballshi, të cilit me një akt administrativ të Kryetarit të Bashkisë, iu ndërpre në marrëdhëniet financiare. Duke qenë me status të nëpunësit civil ankuesi, iu drejtua Komisionit të Shërbimit Civil, i cili pas shqyrtimit të çështjes anuloi këtë akt duke i rikthyer A.C. të gjitha të drejtat e tij. Vendimin e Komisionit, Kryetari i Bashkisë Ballsh pa të drejtë e konsideron absolutisht të pavlefshëm dhe refuzon t’u zbatojë, duke marrë përsipër attribute të pushtetit gjyqësor. Zyra jonë, duke e vlerësuar si absolutisht të padrejtë qëndrimin e këtij Kryetari, i sqaroi pozicionin e tij kundërshtues ligjit Nr.8549 datë 11.11.1999. Ju shpjegua se vendimet administrative të Komisionit të Shërbimit Civil duhet të zbatohen ose të kundërshtohen në rrugë gjyqësore, dhe jo të interpretohen sikurse ndodhi në këtë rast. Për këtë çështje, Zyra jonë paraqiti Rekomandimin për ekzekutimin e vendimit të Komisionit të Shërbimit Civil, i cili është pranuar nga Bashkia Ballsh. Rast analog me këtë është dhe ankesa e paraqitur nga shtetasi E.M. punonjësi i

Bashkisë Tiranë, i cili megjithëse ka fituar të gjitha të drejtat si nëpunës civil me vendim të Komisionit të Shërbimit Civil dhe në të gjitha shkallët gjyqësore, përsëri Kryetari i Bashkisë Tiranë refuzon të bëjë ekzekutimin e këtyre vendimeve, duke arsyetuar mosveprimet me ndryshimet strukturore organizative të Bashkisë.

Mos zbatimi i vendimeve të Komisionit të Shërbimit Civil është një praktikë e kundraligjshme, e cila është vërejtur në pothuajse të gjitha organet administrative të nivelit qendror dhe vendor. Ky qëndrim duhet të eliminohet, për faktin se jo vetëm që çënon dhe ul besueshmërinë dhe autoritetin e një institucioni të pavarur, por në përgjithësi çënon autoritetin e shtetit dhe të qeverisjes, krijon pasoja sociale dhe ekonomike, por njëkohësisht shkel të drejtat e ligjshme të nëpunësve të shërbimit civil.

### **c. Ankesat për prefekturat**

Gjithësej kemi trajtuar 17 ankesa me prefekturat për këtë vit, nga të cilat 11 janë të mbartura nga viti 2003. Nga këto 14 janë përfunduar dhe 2 janë ende në shqyrtim për këtë vit. Nga ankesat të cilat kanë përfunduar, 2 janë në favor të ankesuesve, 6 janë jashtë juridiksionit dhe 4 ankesa janë të pabazuara.

Nga shqyrtimi i ankesave me Prefekturat vërehet se kryesisht shkeljet e të drejtave kanë ardhur si rezultat i moszbatimit të procedurave administrative në procedimet e ndryshme që ndërmarin këto organe për zgjidhjen e problemeve te ndryshme me komunitetin.

Prefekti duke qenë një hallkë e posaçme ndërmjetëse midis pushtetit qendror dhe vendor, duhet të bashkrendojë punën dhe veprimtarinë me këto institucione dhe në këtë këndvështrim janë konstatuar raste të zvarritjeve të procedurave administrative, mungesë transparence, apo dhe mos informim për veprimet apo mosveprimet e këtij organi.

Theksojmë me Prefekturat ankesat për mos ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, problem i cili është evident në të gjitha organet, në nivel qendror dhe vendor dhe natyrisht i pasqyruar në vijimësi në të gjitha Raportet e Zyrës tonë. Në shumicën e rasteve mos ekzekutimi, justifikohet me mungesë fondesh dhe në disa raste me ndryshimet strukturore të organikës që i bëhen këtij organi, sidomos në rastet e ndërrimit të titullarëve. Përmendim rastin e shtetases B.K. nga qyteti i Kavajës, punonjëse e Prefekturës së Qarkut Tiranë, e cila pasi u njoftua për shkurtim të vendit të punës me ndryshimin e organikës, iu drejtua Komisionit të Shërbimit Civil. Më pas ezauroi edhe të gjitha shkallët e gjyqësorit. Megjithëse ajo përfitoi të gjitha të drejtat si nëpunëse civile, përsëri Prefekti nuk ekzekutoi këtë vendim, duke pretenduar se ka ndryshuar struktura dhe vendi i saj i punës është shkurtuar dhe nuk ekziston në strukturën e re të

Prefekturës. Gjithashtu dhe ankesa e paraqitur nga N.A., i cili kishte fituar të drejtat me vendim gjyqësor por, që Prefektura e Qarkut Vlorë nuk ndërmerre veprimet e nevojshme ligjore për të bërë të mundur ekzekutimin e këtij vendimi, duke e justifikuar këtë qëndrim me mungesë fondesh. Në të njëjtën situatë është dhe ankesa e shtetasit A.L. nga qyteti i Korçës, i prezantuar edhe në Raportin e vitit të shkuar, të cilit përsëri nuk i është ekzekutuar vendimi gjyqësor nga Prefektura Korçë, për mungesë fondesh.

Në ankesat për Prefekturat, shfaqet mungesa e bashkërendimit të punës midis Institucioneve qendrore dhe vendore. Veçojmë ankesën e shtetases B.S. nga qytetit i Beratit, e cila ankohet se ka zvarritje në procedurat administrative që duhet të kryejë Prefektura e Qarkut Berat, për të bërë të mundur sigurimin e një fondi që duhet t'i akordohet ankueses, si rezultat i përfitimit të një dëmshpërblimi me vendim të Këshillit Bashkiak. Ndërsa Prefektura nga ana e saj e justifikon këtë mos veprim edhe pas konfirmimit që i ka bërë ligjshmërisë së vendimit të sipërcituar, me mungesë dokumentacioni. Çështja është në ndjekje nga Zyra jonë, e cila ka ndërhyrë pranë Prefekturës së Qarkut Berat, për të qartësuar pozicionin e saj kundrejt ankesës.

Në ankesat për Prefekturat, mund të përmendim rastet kur dispozitat e Kodit të Proçedurës Administrative ose nuk zbatohen, ose shkelen pa shkaqe të arsyeshme. Shtetasi SH.B. nga Tirana, paraqiti një ankesë në të cilën na informonte për mos zbatimin e një urdhëri, i cili bën fjalë për emërimin e tij në detyrë polic zjarrfikësi, në Rinas. Ky urdhër jo vetëm që nuk u zbatua dhe në vijimësi nuk kemi dijeni të jetë anuluar, por ankuesi asnjëherë nuk u informua për këtë proçedurë administrative të ndjekur nga Prefektura. Ai direkt është palë e interesuar, nuk informohet as për ekzistencën e shkaqeve të mos zbatimit dhe as për shkaqet se përse ky urdhër nuk ishte anuluar. Kjo çështje është në shqyrtim e sipër nga Zyra jonë. Të njëjtin qëndrim e konstatoam edhe në rastin e ankesës së shtetases N.P., e cila ishte informuar për një urdhër të nxjerrë nga Prefekti i Qarkut Vlorë, që e emëronte ankuesen në një post drejtues. Por më pas nuk ishte informuar për procedurat e mëtejshme që kishin ndodhur, pasi një urdhër i dytë që kishte dalë, kishte anuluar të parin. Pra në këtë rast ishin shkelur dispozitat e Ligjit Nr.8503 datë 30.06.1999 “Për të drejtën e informimit për dokumentat zyrtare”, si dhe dispozitat e Kodit të Proçedurës Administrative.

Nga gjithë sa parashtruam më lart, konkludojmë se Prefekturat në zbatim të Ligjit Nr.8927 datë 25.07.2002 “Për Prefektin”, duhet të rrisin rolin e tyre kontrollues mbi administrimin dhe veprimtarinë e organeve të pushtetit vendor në të gjitha hallkat e tij, si dhe kontrollin e bazueshmërisë ligjore të të gjitha akteve që nxjerrin këto organe, për t'u prerë rrugën veprimeve të kundraligjishme dhe abuzive që në fillim, me qëllim që situata të mos derivojë dhe të sjellë pasoja të pariparueshme sociale dhe ligjore për shtetasit.

## **8. Ministria e Punës dhe e Çështjeve Sociale**

Numri i ankesave të shqyrtuara nga Institucioni ynë lidhur me Ministrinë e Punës dhe Çështjeve Sociale, si dhe të institucioneve në varësi të saj, Institutin e Sigurimeve Shoqërore Shtetërore, Shërbimin Social Shtetëror dhe filialet e tyre në rrethe ka qenë 184. Nga këto 9 çështje kanë qenë për vetë Ministrinë. Ndërsa ankesa dhe kërkesa të mbartura nga viti 2003 e që janë shqyrtuar në vitin 2004 kanë qenë 58. Problematika e ankesave të trajtuara ka qenë thuajse e njëjtë me ato të viteve të mëparshme.

Po përmendim ankesën e shtetases K.M ndaj kësaj ministrie, që ka përfunduar me zgjidhje pozitive. Ankuesja ishte shpallur fituese pas konkurrimit për vendin e lirë të punës, shefe e sektorit në Drejtorinë e Kontrollit Financiar në këtë Ministri. Por nga eprori direkt nuk ishte realizuar detyrimi i përcjelljes në DAP, e cila më pas do të publikonte fituesin në media, duke bllokuar tërësisht këtë procedim. Nga ky mosveprim rezultonte shkelja e të drejtave të saj të fituara ligjërisht, në një proces tërësisht transparent. Pas ndërhyrjes sonë pranë Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale, u ndërmorën të gjitha veprimet ligjore dhe ankuesja filloi rregullisht marrëdhëniet e punës dhe ato financiare për vendin e punës, në të cilin konkurroi.

Ajo që konstatohet dhe që vazhdimisht vihet theksi nga zyra jonë gjatë trajtimit të ankesave lidhur me shërbimin social, është se mundësitë e vendit për të siguruar shëndetin dhe mirëqënien e popullsisë janë kompromentuar nga infrastruktura e dobët dhe lëvizjet e mëdha demografike. Edhe një herë vëmë në dukje se ristrukturimi dhe reformimi i shërbimeve sociale bazë është një element prioritar në uljen e varfërisë

Ritmet e rritjes së punësimit, do të sillnin ndryshime dhe ulje të nivelit të varfërisë, duke patur parasysh që me punësimin janë të lidhura dhe përfitimet ose mospërfitimi i ndihmës ekonomike ose uljet apo rritjet në kontributet e sigurimeve shoqërore. Vetë Ministria e Punës në mbështetje të Vendimeve përkatëse të Qeverisë në vitin 2004, ka nxjerrë dhe Udhëzimet nr.73, 74, 75 e 76 për nxitjen e punësimit.

### **a) Instituti i Sigurimeve Shoqërore Shtetërore**

Gjatë vitit 2004 ankesa të drejtuara ndaj Institutit të Sigurimeve Shoqërore kanë qenë 151. Nga këto ankesa janë përfunduar 114 dhe kemi akoma në proces shqyrtimi 37 prej tyre. Nga ankesat e përfunduara kanë rezultuar 34 të pabazuara, 63 jashtë juridiksioni, 14 të zgjidhura në favor të ankuesve dhe 3 kërkesa të sqaruara.

Konstatohet se problematika e tyre është thuajse e njëjtë me vitet paraardhëse 2000-2003. Kështu qytetarët ankohen për masën e përfitimit të pensionit të pleqërisë, për masën e përfitimit të pensionit të invaliditetit, të masës së pensionit familjar, mospërfitimin e statusit të invalidit, mospërfitim të shtesave mbi pension, mospranim dokumentacioni, zvarritje të procedurave nga organet kompetente, etj.

Këtë vit nuk u bë indeksim i pensioneve, por nga ISSH na është konfirmuar se rritja e pensioneve që u realizua në Korrik 2004, ishte më e madhe se sa inflacioni.

Kjo nuk ka kaluar pa reagime të publikut, të cilat janë përcjellë dhe në ankesat që i janë drejtuar Institucionit tonë. Por, gjithsesi kemi të bëjmë me politika që vetë shteti ndjek në këtë fushë dhe ato dalin jashtë juridiksionit të veprimtarisë sonë.

Mendojmë se ndjehet e nevojshme që gjithnjë e më shumë ky legjislacion të përmirësohet.

Ashtu si dhe në vitin e kaluar, vëmë në dukje problematikat e këtij legjislacioni, ku midis shumë ankesave të llojeve të ndryshme janë paraqitur ankesa, ku ngrihen një sërë problemesh të cilat kanë të bëjnë me përmbajtjen e Ligjit Nr.7703 datë 11. 05. 1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, si dhe aktet nënligjore të cilat janë nxjerrë kohë pas kohe në zbatim të tij.

Në këto ankesa janë evidentuar çështje të cilat në thelb përfaqësojnë përmbajtjen e legjislacionit për Sigurimet Shoqërore, që shpesh shfaqet kontradiktor, si dhe jepen mendime për përmirësimin e këtij legjislacioni. Kjo problematikë është trajtuar në vija të përgjithshme edhe në vitet e mëparshme.

1-Problemi i parë që ngrihet në këto ankesa, është përmbajtja e nenit 59, të Ligjit Nr.7703 datë 11. 05. 1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë” me ndryshimet përkatëse dhe parashikimit të bërë në Udhëzimin nr.1 datë 24.12.2002 “Për llogaritjen dhe indeksimin e bazës së vlerësuar për efekt pensioni”.

Neni 59 i Ligjit për Sigurimet Shoqërore përcakton se: “... pas vitit 1996, baza e vlerësueshme do të llogaritet mbi pagat për të cilat është derdhur kontributi që nga viti 1994 e deri në vitin e fundit të lënies së punës”, ndërkohë që Udhëzimi nr.1 datë 24.12.2002, në pikën 1 të tij parashikon se:“Për personat që e drejta për pension u ka lindur para datës 1.1.1997 e në vazhdim, baza mesatare e vlerësuar do të llogaritet mbi pagat për të cilat është derdhur kontribut që nga janari 1994 e deri në vitin e fundit të lënies së punës. Këto paga do të indeksohen me koefiçentët e miratuar çdo vit me vendime të Këshillit të Ministrave”

Në lidhje me këtë çështje nga ana jonë është evidentuar fakti se Ligji “Për Sigurimet Shoqërore”, parashikon shprehimisht se “...pas vitit 1996, baza e vlerësueshme do të llogaritet mbi pagat për të cilat është derdhur kontributi që nga viti 1994 e deri në vitin e fundit të lënies së punës”.

Kemi arritur në konkluzionin se nuk mund të ekzistojë marrëdhënia juridike me Institutin e Sigurimeve Shoqërore, për periudhat që nuk janë periudha sigurimi (koha gjatë së cilës nuk derdhet kontribut) dhe për më tepër, të prodhohen efekte për këto lloj periudhash, të cilat ndikojnë direkt në llogaritjen e masës së pensionit.

Ligji është shprehur në mënyrë të qartë se “baza e vlerësueshme” dhe jo “baza mesatare e vlerësueshme”, do të llogaritet mbi pagat për të cilat është derdhur kontribut pra, duke përjashtuar periudhat e tjera të cilat nuk janë periudha sigurimi.

Si konkluzion mund të thuhet se përmbajtja e këtij udhëzimi sikurse dhe udhëzime të tjera që tashmë janë shfuqizuar, vjen në kundërshtim me vetë përmbajtjen e Ligjit Nr.7703 datë 11. 05. 1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”.

2-Problemi tjetër që ngrihet lidhet me faktin se në udhëzim nuk pasqyrohet kërkesa e nenit 59 të Ligjit Nr.7703 datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, ku thuhet shprehimisht se: “*Baza e vlerësuar për të gjitha të ardhurat do të jenë pagat sipas të cilave janë paguar kontributet për 3 vjet rresht në 10 vjetëshin e fundit të punës*”.

Nga kontakti i marrë me specialistë të Sigurimeve Shoqërore në lidhje me këtë problem, është nxjerrë përfundimi nga vetë opinioni i dhënë prej tyre se meqënëse vetë ligji e parashikon këtë gjë, nuk është nevoja të parashikohet shprehimisht edhe në udhëzim, për të mos krijuar keqkuptime apo keqinterpretime.

3-Krahas këtyre problemeve, duke ju referuar neneve 72, 73 dhe 74, të Ligjit Nr.7703 datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, vërejmë se ky ligj nuk parashikon shprehimisht që Këshilli Administrativ të ketë kompetencë për nxjerrjen e udhëzimeve për zbatimin e këtij ligji. Zyra jonë ka arritur në konkluzionin, që Këshilli Administrativ nuk ka kompetencë ligjore nxjerrjen e akteve të tilla si udhëzimet.

Strategjitë e formuluar nga ana e ISSH-së, mund të tentojnë në zbutjen e këtyre problemeve, por mendojmë që duhen zgjidhur në mënyrë imediate dhe më konkrete për publikun çështjet e mprehta, të cilat lidhen me kuptimin dhe zbatimin e Ligjit “Për Sigurimet Shoqërore”.

Për sa më sipër bazuar në rolin dhe kompetencat që Institucionit të Avokatit të Popullit i jepen prej Ligjit nr.8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, në funksion të mirëfunksionimit të administratës publike, si dhe të

zbatimit rigoroz të ligjit apo dhe të mundësive të përmirësimeve të tij, këto çështje i janë ngritur zyrtarisht Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale, me rekomandimin për përmirësimin e legjislacionit përkatës, sikurse është vënë gjithashtu në dijeni edhe Këshilli i Ministrave. Në lidhje me këtë çështje, vitin e kaluar i kemi rekomanduar Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale, marrjen e masave për rregullimin e duhur ligjor.

Nga kjo ministri rekomandimi ynë është gjetur me vend dhe është pritur pozitivisht, duke na informuar se është ngritur një grup pune nën drejtimin e Zv/ministrit, për shqyrtimin në tërësi të legjislacionit të sigurimeve shoqërore dhe përgatitjen e propozimeve përkatëse për përmirësimin e tij. Në këtë kuadër është përgatitur një projektligj i cili parashikon të zgjidhë kryesisht problemet që lidhen me nenin 59 për llogaritjen e bazës së vlerësueshme, nenin 61 me indeksimin e pensioneve, me nenin 88 për të drejtat e përfituara etj. Nga informacioni që kemi marrë nga kjo Ministri, projektligji është përfunduar dhe tashmë është në fazë shqyrtimi nga Kuvendi. Në këtë projektligj janë patur parasysh disa nga rekomandimet tona.

Në vijim po paraqesim disa çështje të përfunduara gjatë vitit 2004, të cilat kanë rezultuar të zgjidhura pozitivisht.

1. Qytetari F.D, banues në qytetin e Bulqizës, ankohej për mospërfitim të shtesave të pensionit që nga Dhjetori 2003, në bazë të VKM nr.787 datë 26.11.2003, si dhe të kompensimit të energjisë elektrike.

Pas interesimit tonë pranë DRSSH Dibër, janë bërë rillogaritjet e pensionit dhe ankuesi përfitoi shtesat e pretenduara të pensionit. Ndërsa u sqarua, se kompensimin e energjisë elektrike e ka përfituar që nga data kur ka paraqitur dokumentacionin e plotë të kërkuar.

Në këtë mënyrë ankesa, ka marrë zgjidhjen pozitive, pas ndërhyrjes së Zyrës sonë, si dhe është realizuar informimi i plotë i ankuesit me përcaktimet ligjore që rregullojnë problemin e përfitimit të pensionit dhe të shtesave përkatëse në bazë të Vendimeve të Qeverisë.

2. Qytetari B.K nga Tirana, u ankua ndaj DRSSH Tiranë, për moslidhjen e pensionit të pleqërisë.

Për zgjidhjen e problemit të relatuar, i kërkuam shpjegime shkresore DRSSH Tiranë. Nga ana e këtij organi, pasi u bënë verifikimet e duhura për kategorinë dhe vjetërsinë në punë të ankuesit, problemi u zgjidh.

Në këtë mënyrë në bazë të ndërmjetësimit dhe interesimit tonë të vazhdueshëm, ankuesit iu njoh e drejta ligjore e përfitimit të pensionit të pleqërisë, pas ndërhyrjes së Zyrës sonë.



3. Qytetarja Q. J, nga qyteti i Përmetit, na paraqiti ankesën e saj, ndaj DRSSH Gjirokastër, për mospërfitimin e shtesave në pensionin e pjesshëm të invaliditetit të të birit.

Pas marrjes në shqyrtim të kësaj çështjeje, kemi marrë shpjegime të hollësishme nga ana e DRSSH Gjirokastër, të cilat qartësojnë edhe bazën ligjore të trajtimit të djalit të ankueses, invalid i pjesshëm.

Ajo që vlen të theksojmë është fakti që me Ligjin nr.9143 datë 16.10.2003 “Për disa ndryshime në Ligjin nr.7889 datë 14.12.1994 Për Statusin e Invalidëve”, është ndryshuar neni 7, dhe mbi këtë bazë përfitojnë shtesë mujore mbi pensionin e invaliditetit, edhe invalidët e aksidentuar gjatë shërbimit të detyrueshëm ushtarak.

Ndaj na është konfirmuar se do të rillogaritet pensioni i invaliditetit dhe ankuesi do të përfitojë shtesën përkatëse.

Pra nga trajtimi i kësaj ankese, është arritur sqarimi ligjor i problemit dhe ka rezultuar zgjidhja në favor e ankuesës.

Bashkëpunimi me administratën lokale e qendrore të sigurimeve shoqërore ka qenë rezultativ, duke vërejtur një përgjegjshmëri në rritje të saj, si kundrejt qytetarit dhe kundrejt Institucionit të Avokatit të Popullit.

## **b) Ndhma dhe Përkujdesi Shoqëror**

Ankesa të lidhura me këtë fushë të paraqitura në Institucionin e Avokatit të Popullit për vitin 2004 rezultojnë 24. Nga këto janë përfunduar 19 prej tyre, nga të cilat 9 kanë rezultuar të pabazuara, 6 jashtë juridiksionit, 4 ankesa në favor të ankuesve dhe janë akoma në proces shqyrtimi 5 të tjera.

Kryesisht këto ankesa kanë konsistuar në pretendime për masën e përfitimit të ndihmës ekonomike, ndërprerjen e ndihmës ekonomike, mospërfitim nga e drejta e kujdestarisë.

Në vijimësi, po paraqesim disa nga ankesat tipike të trajtuara në këtë fushë:

1. Ankuesi K. M, banues në Komunën Gostinë, Elbasan, paraqiste shqetësimin për mospërfitimin e ndihmës ekonomike, shumë të nevojshme për mbijetesën e familjes së tij.

Pas shqyrtimit të kryer nga ana jonë kësaj ankese, dhe kërkesës përkatëse për shpjegime pranë Zyrës së Ndhmës Ekonomike dhe Përkrahjes Sociale të Komunës Gostinë, kjo familje u sistemua në skemën e ndihmës ekonomike, dhe kjo pagesë i filloi që nga muaji Mars 2004.

2. Shtetasi I.L, banues në Komunën Babrru, Tiranë, në një ankesë drejtuar Zyrës sonë ka paraqitur shqetësimin lidhur me zvarritjen e procedurave dhe mosdhënien e informacionit për fatin e të bijës, 16 vjeçare. Kjo pasi vajza ishte

larguar bashkë me të fejuarin në Korrik të vitit 2003, në drejtim të Kosovës. Atje është bërë ndalimi i tyre për arsye se nuk kanë pasur dokumenta të rregullta, por të fallsifikuara.

Nga kontaktet e tij me punonjës të UNMIK-ut, i është komunikuar që tërheqja e vajzës mund të bëhet vetëm pasi shteti shqiptar të kryejë të gjitha procedurat ligjore. Por megjithë përpjekjet pranë Shërbimit Social Shtetëror, ankuesi nuk ka arritur të informohet për dokumentacionin e nevojshëm e as për procedurat që duhen ndjekur për sjelljen e vajzës në Shqipëri.

Pas ndërhyrjes së Zyrës sonë pranë Drejtorisë së Shërbimit Social Shtetëror u informuam se nga ana e këtij organi, janë kryer me përpikmëri procedurat, por ankuesi nuk është vënë në dijeni, për shkak të vetë natyrës së procesit si mjaft i rezervuar. Në përfundim të këtij procesi shtetasi u informua se janë mbajtur kontakte me Ministrinë e Punës dhe Mbrojtjes Sociale të Kosovës, si dhe me Zyrën Kundër Dhunës në Familje, Trafikimit dhe Krimeve Seksuale, duke kaluar të gjitha etapat e hetimit si rast, këshillimin me organizmat ndërkombëtare që veprojnë në Kosovë, si dhe me partnerin kryesor IOM, të cilët kanë bërë të mundur, kthimin e vajzës në Shqipëri pranë familjes së saj.

3. Qytetarja N.B, banuese në Berat paraqiti ankesën e saj për ndërprerjen pa të drejtë të ndihmës ekonomike dhe përkrahjes sociale.

Pas shqyrtimit që Zyra jonë i bëri objektit të kësaj ankese në Bashkinë e Beratit, rezultoi se:

Kjo familje në gjendje mjaft të rënduar ekonomike është ndihmuar jashtë kriterëve të përcaktuara, pasi kishte dy vjet që jetonte në Tiranë, megjithëse në lejen e banimit figuronte në Berat.

Në VKM nr.113, datë 31.3.2003 janë përcaktuar qartë kriteret e përfitimit të ndihmës ekonomike, për të gjithë shtetasit në bazë të vendbanimit të tyre. Kjo familje ishte nxjerrë nga skema e përfitimit të kësaj ndihme pasi për tre muaj rresht nuk ishte paraqitur për të tërhequr shumën përkatëse. Por me rikthimin në qytetin e Beratit në muajin qershor 2004 është hartuar relacioni i posaçëm, që do t'i parashtrohej Këshillit Bashkiak për miratimin e rifutjes së kësaj familjeje në skemën e ndihmës ekonomike.

Në një numër të konsiderueshëm ankesash apo kërkesash, ndihma e Avokatit të Popullit ka rezultuar në orientimin dhe informimin e qytetarëve për të drejtat e tyre, si dhe rrugët për t'i kërkuar këto të fundit.

Gjatë raportit të vitit 2002 e 2003, duke ju referuar legjislacionit për ndihmën dhe përkujdesin shoqëror, nga ana jonë është arritur në konkluzionin se përfitimi i kujdestarisë nuk duhej dhe s'kishte pse të lidhej me skemën e ndihmës ekonomike. Për këtë qëllim në vitin 2002, i kemi rekomanduar Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme të Ndihmës dhe Shërbimeve

Sociale, shfuqizimin e pikës 9-të, të Urdhërit Nr.2132, dt 23. 09.1998, të Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme të Ndihmës dhe Shërbimeve Sociale, sepse është në kundërshtim me ligjin në zbatim të të cilit ajo ka dalë.

Rekomandimi i bërë nga ne është konsideruar i drejtë dhe ligjor, ndërkohë që sipas konfirmimeve nga Ministria e Punëve dhe Çështjeve Sociale, nga kjo e fundit është përgatitur një projektligj që në vitin 2002, i cili reflektonte ndryshimet e mësipërme.

Pas interesimit tonë të vazhdueshëm, ky projektligj, nga procesi i shqyrtimit nga ana e Ministrisë përkatëse, është shqyrtuar dhe miratuar nga ana e Qeverisë dhe ende megjithëse ka kaluar një kohë e konsiderueshme, ndodhet në pritje të miratimit të tij nga ana e Parlamentit.

Nga kjo analizë del qartë se shumica e reformave të ndërmarra kanë karakter legjislativ, ndërkohë zbatimi me korrektesë dhe kompetencë të ligjeve progreson me ngadalë, përfshirë dhe legjislacionin e ndihmës dhe përkrahjes ekonomike.

## **9. Ministria e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit**

### **a) Ankesa të ndryshme për Ministrinë**

Për vetë Ministrinë e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit, institucioni i Avokatit të Popullit gjate vitit 2004 ka shqyrtuar 22 ankesa, nga te cilat 4 jane mbartuar nga viti 2003. Nga keto 2 janë zgjidhur në favor të ankuesve, 6 kanë qënë të pabazuara, 7 jashte kompetence dhe 7 janë ende në shqyrtim.

Nisur nga problematika e ankesave, mund te themi se nuk ka ndyshime te dukshme nga fenomenet e verejtura dhe te pasqyruara ne raportet e meparshme. Kryesisht përmendim çeshjet qe lidhen me strehimin, pasi kjo Ministri akordon dhe delegon fondet perkatese organeve te pushtetit vendor, te cilat nga ana e tyre ne bashkepunim me Entin e Banesave, kane te drejten e vendimarrjes per trajtimin e te pastreheve, sipas kategorive respektive.

Ne kete vit sikurse edhe vitin e kaluar ka patur dhe ankesa të cilat lidhen me procedurat e privatizimit të banesave nga ana e Entit Kombëtar të Banesave dhe degëve në rrethe. Ne lidhje me kete grup ankesash, pretendimet e shtetasve, lidhen kryesisht me menyren e vleresimit te siperfaqeve perfituese, duke pretenduar se meqenese kane statusin e te pastrehit nuk duhet te paguajne asnje vlere tjeter monetare. Keto ankesa pas verifikimeve paralele ne disa organe, jane klasifikuar si te pabazuara.

Gjate shqyrtimit te ankesave qe lidhen me kete Ministri, jane verejtur raste që lidhen me mos zbatimin e ligjit Nr.8503, date 30.06.1999 “Për të drejtën e informimit për dokumentat zyrtare”. Kjo sepse pretendohet, se

shtetasit nuk jane te informuar lidhur me akordimin e fondeve të cilat u delegohen organeve vendore, per mbulimin e nevojave te ndryshme te komunitetit. Nga ana e tyre edhe keto te fundit, nuk kane transparencen e duhur kundrejt komunitetin, ne sherbim te te cileve jepen keto fonde, duke lene shteg per abuzime dhe vleresime ndoshta dhe te gabuara ndaj funksionareve, apo personave te veshur me pushteti publik.

Ne grupin e ankesave qe kemi ndjekur me Ministrine e Turizmit, veçojme edhe ate te perfaqesuesve te fshatit Nivice, te Komunes Lukove te Rrethit Sarande, sipas pretendimit te te cileve nga Ministria e Turizmit, i eshte dhene leja per veprimtari te stimuluar subjekteve "Riviera" sh.p.k. dhe "Mediterraneo Grup" per ndertimin e fshatit turistik ne gjirin e Kakomes. Gjithmonë sipas tyre, zona e Kakomes bën pjesë në pronësinë e fshatit Nivice të Komunës Lukovë, për të cilën ata gëzojnë të drejtën e pronësisë, secili sipas sipërfaqes që i takon me vendim të Komisionit të Ndarjes Tokës. I gjithë dokumentacioni për regjistrimin e kësaj pasurie ndodhet pranë Zyrës së Kadastrës Sarandë. Ata pretendojnë se dhënia e lejes për veprimtari turistike subjekteve të sipërpërmendur, ka cënuar rëndë të drejtën e pronësisë të banorëve të kësaj zone. Për këtë çështje e cila tashmë është e njohur nga media, nga ana jonë me objektivitet u verifikua procedura e ndjekur dhe rezultoi se nga ana ligjore nuk kishte shkelje.

Ndersa lidhur me ankesen e shtetasve, që lidhet me moszbatimin e VKM-së Nr.85, datë 2.03.1994 “Për vënien në dispozicion të zonave të banimit për familjet që shpërngulen nga Ujëmbledhësi i Bovillës dhe ato që kanë ndërtuar pa leje, përreth qytetit të Tiranës”, si dhe të nenit 142/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, çështje e cila u be prezent edhe raportin e vjetshem, mund te informojme se pas rekomandimeve te zyres tone, eshte ende ne ndjekje nga kjo Ministri, e cila per mungese fondesh nuk ka bere te mundur kompensimin monetar dhe fizik te ketyre banoreve, ndonese grupi i punes eshte ngritur dhe funksionon prane kesaj Ministrie. Duke besuar se angazhimi institucional do te bejë te mundur zgjidhjen e kesaj çështje, sa te drejte aq dhe te ligjshme te shpresojme se ne te ardhmen te mund te kemi nje zgjidhje pozitive.

Duke qene se problemi i strehimit eshte i mbartur ne vite, fakt i cili shton dhe veshtiresine e zgjidhjes, ne Institucionin tone adresohen shume ankesa me objekt te tille. Ne kete konteks eshte per t'u pergezuar miratimi i Ligjit Nr.9232 date 13.05.2004 “Per programet sociale per strehimin e zonave urbane”, ne te cilen percaktohen rregulla dhe procedurat administrative, per menytrat e sigurimit dhe shperndarjes se fondeve, ne te cilen parashikohen dhe shume alternativa zgjidhje per kategorine e te pastreheve, si dhe shume akte te tjera nenligjore te cilat bejne te mundur zbutjen e ketij problemi madhor kombetar. Keshtu vlen te permendim VKM Nr.814 date 3.12.2004 “Per percaktimin e

normave të strehimit”, si dhe nisma për hartimin e një projekt vendimi “Për dokumentat dhe procedurat që duhet të ndjekin perfituesit nga ky ligj”. Gjithashtu nga verifikimet tona në ndjekje të ankesave me objekt strehimit, jemi informuar se është miratuar Vendimi për perberjen, organizimin dhe funksionimin e Komitetit Kombëtar të Strehimit, së bashku me rregulloren për funksionimin e këtij Komiteti. Pra nismat e ndërmara tregojnë se ky problem është në rrugën e drejtë të zgjidhjes, për të cilën deri vjet vërehet një boshllëk ligjor, si dhe mundësi të strukturave që bëjnë të mundur hartimin e politikave dhe strategjive për zgjidhjen e strehimit.

### **b) Ankesat për ndërtimet pa leje**

Zhvillimet e fundit, në lidhje me ekzistencën e ndërtimeve pa leje në të gjithë territorin e vendit, si një eksperiencë negative në kuadrin e zhvillimit urban, tashmë kanë zhvendosur fokusin në këto çështje, duke i parë ato jo vetëm si probleme sociale, urbanistike dhe të cilësisë së jetesës, por si probleme që janë shtruar për zgjidhje definitive.

Organet apo institucionet të cilat me ligj janë ngarkuar për trajtimin e zgjidhjen e këtyre çështjeve, nuk mund të ngelen më tani vetëm në funksione konstatuese, por detyrimisht ato përfshihen së bashku me individët kundravajtës në një proces real dhe funksional, atë të legalizimit të këtyre ndërtimeve pa leje.

Këto risi në konceptimin e problemit dhe të kryerjes së punës të administratës publike, që ushtron aktivitetin në këtë fushë, janë mundësuar së fundmi nga një bazë e re ligjore, e cila kishte dalë si kërkesë urgjente që me lindjen e fenomenit në fjalë e si rrjedhojë e trajtimit të problemeve të njëjta nga vendet e tjera me eksperiencë në këtë fushë.

Dy janë ligjet e miratuara nga ana e Kuvendit të Shqipërisë dhe që kanë hyrë në fuqi gjatë vitit 2004, të cilat synojnë zgjidhjen e çështjes të ndërtimeve pa leje, Ligji Nr.9209 datë 23.03.2004 “Për legalizimin e shtesave në ndërtime” dhe Ligji Nr.9304 datë 28.10.2004 “Për legalizimin dhe urbanizimin e zonave informale”.

Objekti i rregullimit të ligjit të parë të sipërcituar, është legalizimi i ndërtimeve, tërësisht ose karabina, me sipërfaqe më të madhe se projekti i miratuar me vendim të KRRT-ve të njësisë të qeverisjes vendore.

Ndërkohë objekti i rregullimit të ligjit të dytë, është legalizimi i ndërtimeve pa leje në zonat informale, të përcaktuara sipas procedurave të këtij ligji dhe urbanizimi i zonave të zëna nga ndërtimet e banesave pa leje, të emëtuara “Informale”, për integrimin e tyre në zhvillimin territorial e infrastrukturor të vendit dhe përmirësimin e kushteve të jetesës në to.

Kemi dhënë shpjegimet e mësipërmë për të evidentuar se problemi i ngritur në raportet tona të mëparshme vjetore, ai i mosrespektimit të projekteve të miratuara në lejet e ndërtimit, nga ana e ndërtuesve, gjen rregullim në këtë bazë ligjore të re.

Megjithatë për shkak të një sërë problemesh, sot e kësaj dite evidentohet me lehtësi fakti se, zbatimi i Ligjit “Për legalizimin e shtesave në ndërtime” nuk po ecën dhe realisht ai është kthyer në një ligj të pazbatueshëm.

Ky problem është ngritur si nga ana e Shoqatës të Ndërtuesve të Shqipërisë, ashtu siç edhe ne vetë e kemi evidentuar nga një shqyrtim paraprak që i kemi bërë këtij problemi.

Nga informacioni i marrë në Drejtorinë e Përgjithshme të Urbanistikës në Bashkinë Tiranë, rezulton se aktualisht janë në proces legalizimi vetëm dy firma ndërtimi. Pra vetëm për këto dy firma do të përfundohet procedura e legalizimit, ndërkohë që për dhjetra firma të tjera që i kanë paraqitur kërkesat jashtë afatit 3 muhor, pas datës 25.08.2004, nuk do të kryhet legalizimi i ndërtimeve të ngritura prej tyre.

Pra faktikisht ligji që doli për të zgjidhur këtë problem të madh për komunitetin dhe territorin, mbeti që në Tiranë të zbatohet vetëm për 2 objekte. Ndërkohë dhjetra objekte të tjera ngelen pa filluar procedurat nga organet e qeverisjes vendore, megjithëse neni 6 ka caktuar edhe një afat tjetër 1 vjeçar, i cili duhet interpretuar në favor të subjekteve ndërtuese, që të vazhdojnë t’i paraqesin kërkesat për legalizim.

Realisht procesi i legalizimit, konsiderohet i bllokuar për shkak të kalimit të afatit 3 muhor të përcaktuar në ligj.

Zgjidhja e mundshme në këtë rast, lidhet me ripërcaktimin e një afati të ri për mundësinë e depozitimit të kërkesave për legalizim, pranë njësive përkatëse të qeverisjes vendore (pika 1, neni 6, i Ligjit “Për legalizimin e shtesave në ndërtim”), sepse afati 3 muhor që përcakton ligji, ka qenë i shkurtër dhe faktikisht është bërë pengesë kryesore në këtë proces. Njëkohësisht si vështirësi dhe pengesë nga ana e ndërtuesve, janë vlerësuar procedurat dhe dokumentacioni i kërkuar në këtë proces legalizimi.

Kjo zgjidhje duhet të realizohet nëpërmjet amendimeve në Ligjin “Për legalizimin e shtesave në ndërtime”, të cilat do t’i propozohen nga ana jonë si ndërmarrje insiative legjislative Ministrisë përkatëse dhe Kuvendit të Shqipërisë, lidhur me dy momente kryesore:

1. Ripërcaktimi i një afati të ri për mundësinë e depozitimit të kërkesave për legalizim.

2. Thjeshtimi i procedurave dhe dokumentacionit përkatës të nevojshëm për legalizim.

Një dukuri që është vërejtur në punën e Policisë të Ndërtimit, në disa nga çështjet më të fundit që janë trajtuar nga ana jonë, është fakti se për ndërhyrje të kërkuara ndaj ndërtimeve të paligjshme, mbahet qëndrimi se nuk mund të ndërhyhet nga ana e tyre pasi rastet përkatëse do të gjejnë rregullim nga Ligji “Për legalizimin dhe urbanizimin e zonave informale”.

Veçojmë këtë fakt pasi është e nevojshme të sqarohet paraprakisht një dukuri që mund të shfaqet në vazhdim, në punën e këtij organi gjatë vitit 2005. Në Ligjin “Për legalizimin dhe urbanizimin e zonave informale”, jepet në mënyrë shumë të qartë në nenin 3/1 kuptimi i termit ligjor “Zonë informale”, ndërkohë që të gjithë individëve të cilët kanë ngritur ndërtime pa leje të ndodhura në këto “Zona Informale”, ju jepet mundësia që brenda 3 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të fillojnë procedurën e legalizimit të ndërtimeve të tyre. Po kështu, konstatimi nga ana e organit të Policisë të Ndërtimit, të ndërtimeve apo volumit të ndërtimeve, jashtë projektit të miratuar me vendime të KRRT-ve të njësisve vendore, gjen rregullim sipas kushteve dhe për aq sa është parashikuar në Ligjin “Për legalizimin e shtesave në ndërtime”.

Megjithatë kjo marrëdhënie e re ligjore e krijuar tashmë, nuk nxjerr jashtë loje veprimtarinë e organit të Policisë të Ndërtimit, apo edhe të KRRT-ve të njësisve vendore.

Ky konkluzion del shumë i qartë për faktin se në radhë të parë bëhet fjalë për ndërtime pa leje brenda territorit të zonës informale, të përfunduara në çastin e hyrjes në fuqi të Ligjit “Për legalizimin dhe urbanizimin e zonave informale”, gjithmonë duke mos rënë ndesh me studimet e miratuara të zonës përkatëse. Në këtë kuptim për të gjitha ndërtimet e tjera të paligjshme që ngrihen pas kësaj kohe, në mënyrë direkte është kompetente për veprim Policia e Ndërtimit. Po kështu nuk përjashtohen nga kjo kompetencë, ndërtimet tashmë të ngritura në zonat me studime të miratuara urbanistike në fuqi. Përsëri në përputhje me parashikimet e nenit 77 të Ligjit “Për urbanistikën”, në këto raste nuk shmanget kompetenca e trajtimit dhe vendim-marrjes nga ana e KRRT-së të njësisve vendore.

Në këtë llogjikë të ndjekur nga legjislacioni i ri në fuqi, mbetet me rëndësi sqarimi i ekzekutimit të vendimeve të mëparshme të marra nga ana e Policisë të Ndërtimit, për prishjen e ndërtimeve pa leje. Në pamje të parë, parashikimet e Ligjit “Për legalizimin dhe urbanizimin e zonave informale”, duket sikur krijojnë një përplasje mes kompetences tanimë të ushtruar në vendimet e marra paraprakisht për ndërtime të ngritura në zonat informale, nga ana e organit të Policisë të Ndërtimit dhe që me hyrjen në fuqi të këtij ligji, rezultojnë të paekzekutuara. Zgjidhja e kompetencës në këtë rast, megjithëse nuk është përcaktuar shprehimisht në ligjin e sipërcituar, jepet në nenin 23 të Kodit të Procedurave Administrative. Efektivisht, vendimi i organit të Policisë

të Ndërtimit duhet të pezullohet në ekzekutim, derisa të merret një vendim përfundimtar nga ana e organit të ngarkuar me ligj për shqyrtimin e mundësisë së legalizimit apo jo, të ndërtimit të sanksionuar. Legalizimi i ndërtimeve pa leje në këtë kuptim zgjidh njëkohësisht edhe pronësinë mbi parcelën ndërtimore, ose të sipërfaqes së truallit të zënë nga ndërtimi, në harmonizim me Ligjin Nr.9235 datë 29.07.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”.

Gjatë vitit 2004, për këtë problematikë që lidhet me veprimtarinë në tërësi të organit të Policisë të Ndërtimit, rezulton të jenë marrë në shqyrtim 117 ankesa. Në specifikë të ankesave të paraqitura në institucionin tonë, me objekt ndërtimet pa leje, rezulton të jenë marrë në shqyrtim 109 ankesa, nga të cilat 99 lidhen me veprimtarinë e organit të Policisë të Ndërtimit, 8 me veprimtarinë e strukturave përkatesë të Bashkive apo të KRRT-ve pranë tyre, si dhe me veprimtarinë e komunave dhe organeve ekzekutive të tyre.

Nga ankesat të cilat lidhen me problematikën e ndërtimeve pa leje, deri në fund të vitit 2004, rezultojnë të përfunduara 79 ankesa dhe akoma në shqyrtim janë 30 ankesa.

Përsa i përket çështjeve të përfunduara, ka rezultuar se janë zgjidhur në favor 4 çështje, të pabazuara 13 çështje, jashtë juridiksionit dhe kompetencës 46 çështje, ndërsa për 16 prej tyre jemi në kushtet e braktisjes së procedimit administrativ të filluar nga ana jonë për shqyrtimin e tyre nga vetë ankuesit, pra jemi në kushtet e heqjes dore të ankuesve nga ndjekja e mëtejshme e çështjeve prej nesh.

Moment i rievidentuar në rastet e shqyrtuara në këtë vit ngelet ai që lidhet me mbartjen e problemeve që kanë të bëjnë me ndërtimet pa leje nga ana e organit të Policisë të Ndërtimit, vit pas viti, duke bërë që ngarkesa e punës të mos jetë më racionale, por të krijojë probleme të funksionimit të këtij organi që shpesh mund të vlerësohen si jo të mirëqena dhe fiktive.

Mosveprimi i plotë, neglizhenca apo nganjëherë një zvarritje krejtësisht e pajustificuar, si dhe veprimi i pjesshëm në lidhje me sanksionimin apo ekzekutimin e ndërtimeve pa leje, është edhe një ndër shkaqet që megjithëse vërehet se ka një rënie të dukshme të ngritjes të ndërtimeve pa leje, sidomos nga individët, ndikon në përsëritjen e problematikës të çështjeve që paraqiten në zyrën tonë, por edhe efikasitetin e organit të Policisë të Ndërtimit.

Kjo anë negative e veprimtarisë së Policisë të Ndërtimit, ka efekte direkte në vetë vazhdimin e shkeljeve ligjore, apo cënimin e mundshëm të të drejtave të individëve të tjerë, nga ana e individëve apo subjekteve kundravajtës, por edhe në besueshmërinë që ka ky organ në sytë e publikut.

Veçori e këtij viti, është ajo e mosekzekutimit të vendimeve përkatëse të marra për ndërtimet e paligjshme.



Kështu megjithëse ndërtimet e paligjshme evidentohen dhe ndaj tyre zhvillohet procedura përkatëse ligjore, deri në marrjen e vendimit për prishjen e tyre, puna në shume raste ngec deri ketu, duke passjellë pakënaqësinë e qytetarëve.

Vërejmë gjithashtu se megjithë ndërhyrjen tonë për rregullimin e fenomenit që ka të bëjë me përcaktimin e një afati vlefshmërie të përcaktuar zyrtarisht nga vetë Policia e Ndërtimit, në lidhje me vendimet që ajo merrte dhe ka marrë, me objekt prishje ndërtimesh të kundraligjshme, përsëri në raste të caktuara, ka qëndrime nga ana e degëve të Policisë të Ndërtimit, ku rishfaqet ky qëndrim joligjor. I tillë ka qenë një rast i paraqitur në ankesën e qytetares F.C në qytetin e Durrësit, ku evidentohet mosveprimi i Policisë të Ndërtimit, dega Durrës, për ekzekutimin e një vendimi të marrë nga KRRT-ja pranë Bashkisë Durrës, për prishjen e një ndërtimi të kundraligjshëm. Megjithëse rasti në fjalë ka rezultuar jashtë kompetencës së trajtimit tonë për shkak të kalimit të shqyrtimit të tij në gjykatë, përsëri nga ana jonë është mbajtur qëndrim ndaj prononcimit jo korrekt të degës së Policisë të Ndërtimit, Durrës për sa më lart, pasur kjo edhe me konfirmimin pozitiv nga ana e Drejtorisë të Përgjithshme të Policisë të Ndërtimit, në mbështetje të qëndrimit tonë.

Ky qëndrim pozitiv i Drejtorisë së Policisë të Ndërtimit, ka ardhur si pasojë e pranimit të sugjerimit të bërë nga ana jonë vitin e kaluar, në funksion të mirëfunksionimit të organit të Policisë të Ndërtimit, për ndërprerjen e praktikës së referimit të gabuar për vlefshmërinë e ekzekutimit të vendimeve të KRRT-ve dhe të vetë organit të Policisë të Ndërtimit, sipas afatit 1 vjeçar të përcaktuar në nenin 23, të Ligjit “Për kundërvajtjet administrative”, si dhe zbatimin e përcaktimit të shpenzimeve të prishjes që i ngarkohen kundërvajtësit, në bazë të nenit 84 të Ligjit Nr.8405 datë 17.09.1998 ”Për Urbanistikën”.

Problemi real që evidentohet dhe që nuk është trajtuar në praktikën që ne kemi shqyrtuar deri tani, është përcaktimi i shpenzimeve të prishjes dhe ngarkimi i tyre për pagesë kundërvajtësit, dënim administrativ që nuk është aplikuar nga Policia e Ndërtimit.

Një nga veçantitë e problematikës së shqyrtuar në këtë fushë, lidhur me çështjet e ndjekura paraprakisht nga zyra jonë, është se për disa çështje të ndjekura në vitin 2003, të cilat kishin përfunduar si shqyrtim se ishin jashtë kompetence, është se me veprimin e metëjshëm të pritshëm të organit të Policisë të Ndërtimit, kanë përfunduar pozitivisht. Të tilla janë p.sh ankesa e P.B ndaj mosveprimit të Policisë të Ndërtimit, dega Durrës, apo ankesat e shtetasve S.H dhe P.K ndaj mosveprimit të Policisë të Ndërtimit, dega Tiranë, çështje të cilat gjatë vitit 2004 janë zgjidhur pozitivisht, të konfirmuara si të tilla ndaj zyrës tonë nga ana e vetë ankuesve dhe organit të Policisë të Ndërtimit.

Mbetet problem shqetësues, mosrespektimi i afateve ligjore në kthimin e përgjigjeve për kërkesat tona për shpjegime drejtuar organit të Policisë të Ndërtimit. Për më tepër ngandonjëherë, moskorrespondimi i përgjigjeve të dhëna për të njëjtën çështje, nga ana e Drejtorisë së Policisë të Ndërtimit, me përgjigjen e dhënë prej degëve të saj përkatesë. Po kështu shpesh sqarimet e dhëna janë të pjesshme, jo të qarta dhe të pamjaftueshme, ose edhe të pakuptueshme.

Për nga numri i çështjeve të marra në shqyrtim vazhdojnë të ngelen problematike, Degët e Policisë të Ndërtimit, Tiranë, Durrës, Vlorë, Elbasan, por edhe vetë Drejtoria e Përgjithshme e Policisë të Ndërtimit.

Ndërthurja e kompetencave në trajtimin e rasteve të ekzistencës së ndërtimeve të kundraligjshme, rishfaq lojën e shkresave ndërmjet Policisë të Ndërtimit dhe KRRT-ve në Bashkitë përkatesë, lojë e cila nuk çon asnjëherë në vendim-marrje përfundimtare, por vetëm në zvarritje të problemeve. Kjo gjë ka bërë që të vazhdohet të ndërhyhet nga ana jonë me rekomandime për shpjegimin e përkatësisë të procesit të vendim-marrjes, rekomandime të cilat synojnë zgjidhjen përfundimtare të çështjeve dhe vënien në vend të së drejtës së shkelur të individit.

Nga nje eksperiencë disa vjeçare pune, e cila ka nxjerrë në pah anët pozitive dhe negative të veprimtarisë së organeve dhe institucioneve kompetente për trajtimin e çështjeve që lidhen me ndërtimet pa leje, theksojmë se është nevojë e kohës dhe e zhvillimeve pozitive në kuadrin ligjor, reformimi dhe ristrukturimi i organit të Policisë të Ndërtimit. Ky konkluzion arrihet për faktin se mungesa e personelit, mungesa e mjeteve, ndërrimi i kohë pas kohshëm i personelit ekzistues, si drejtues ashtu edhe ndihmës, mbetet problematik në kuadër të një veprimtarie normale të organit të Policisë të Ndërtimit.

Nuk ka se si të shpjegohet mosdhënia e kopjeve të dokumentave zyrtare nga ana e organit të Policisë të Ndërtimit, sikurse edhe nga ana e sekretarive të KRRT-ve, në përputhje me parashikimet e ligjit “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”, përveçse me qëndrime përfitimi dhe abuzuese të punonjësve të këtyre organeve. Theksojmë se në një shumicë të konsiderueshme rastesh, thelbi i shkeljes së të drejtave të individit vjen nga mosinformimi, veprim i cili ndeshet shpesh edhe në këto ankesa.

Nga shqyrtimi i disa çështjeve në vitin 2004, është evidentuar mosushtrimi i kompetencës, që neni 6 i Ligjit “Për Policinë e Ndërtimit”, i jep organit të Policisë të Ndërtimit, në lidhje me pezullimin dhe njoftimin e KRRT-ve për vendimet e marra nga Këshilli i Rregullimit të Territorit, kur vëren shkelje të ligjit në vendimet e tyre.

Duhet theksuar se edhe këtë vit, një rëndësi e veçantë i është kushtuar ndërmjetësimit direkt për zgjidhjen e çështjeve që i adresohen këtij grupimi, pa pasur nevojë për rekomandim apo propozim me shkrim nga ana jonë.

Nevoja e reformimit të plotë të sektorit të urbanistikës, nëpërmjet përgatitjes sa më parë të një ligji të ri për urbanistikën, është një moment tjetër i cili megjithëse ka qenë nënvizuar si prioritar në analizen vjetore të punës së Qeverisë për vitin 2003, përsëri nuk ka gjetur zbatim gjatë vitit 2004.

Në konkretizim të problematikave të mësipërme, po paraqesim disa nga rastet e shqyrtuara nga ana e zyrës sonë:

1. Ankesa e shtetasit B.N nga qyteti i Tiranës.

Në letrën drejtuar Avokatit të Popullit, ankuesi së bashku me një grup banorësh të bllokut “Vasil Shanto”, ka paraqitur një ankesë lidhur me mosveprimin nga ana e Policisë të Ndërtimit, dega Tiranë, përse i përket disa ndërtimeve (garazhe) pa leje, të ndodhura pranë pallatit ku ata banojnë.

Këto ndërtime të paligjshme ishin bërë problem për ndotjen që ato krijojnë, duke u bërë edhe burim sëmundjesh me mbeturinat që grumbullojnë rreth tyre, si dhe duke zënë rrugën e kalimit. Për këtë çështje, banorët ankues i ishin drejtuar disa herë organit të Policisë të Ndërtimit për të vepruar, por sikurse rezultonte nuk ishte ndërmarrë asnjë veprim.

Me marrjen në shqyrtim të kësaj çështje nga ana jonë, i jemi drejtuar me kërkesë për shpjegime, nëpërmjet një procesi ndërmjetësimi aktiv, Policisë të Ndërtimit, dega Tiranë. Kështu në përgjigjen e kthyer nga ana e Policisë të Ndërtimit, dega Tiranë, jemi vënë në dijeni të faktit se për ndërtimet pa leje të ndodhura pranë pallatit të Gardës, në bllokun “Vasil Shanto”, është realizuar prishja e tyre më datë 12.01.2004, duke iu dhënë zgjidhje pozitive kësaj çështje.

2. Ankesa e shtetases N.D. nga qyteti i Tiranës.

Në letrën drejtuar Avokatit të Popullit, ankuesja si pronare e një objekti (bar-restorant “Gent-Drin”), i ndodhur në rrugën “Muhamet Gjollesha”, Tiranë, ka paraqitur një ankesë lidhur me nxjerrjen e vendimeve të herë pas hershme nga ana e Policisë të Ndërtimit, dega Tiranë, për prishjen e këtij të fundit.

Objekti në fjalë është ndërtuar prej saj në mënyrë të ligjshme, bazuar në lejen e ndërtimit, ndërkohë që me anë të kontratës së shitjes, Bashkia Tiranë i ka shitur sipërfaqen e truallit mbi të cilën ngrihet ky objekt, prej 150 m<sup>2</sup>.

Kjo pronësi është e regjistruar në Zyrën përkatëse të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

Pavarësisht kësaj, ankesa bëhej se në mënyrë të përsëritur nga ana e degës të Policisë të Ndërtimit, ishin dërguar vendime të ndryshme për prishjen e këtij objekti, duke e konsideruar atë të kundraligjshëm.

Vetë Drejtoria e Përgjithshme e këtij organi, me anë të një vendimi, kishte vendosur shfuqizimin e vendimit për prishje objekti, duke e quajtur atë si vendim të kundraligjshëm.

Në vazhdim përsëri nga ana e Policisë të Ndërtimit, dega Tiranë, është marrë vendimi tjetër me nr.139 date 7.03.2003 për prishjen e objektit në fjalë, duke e konsideruar atë si të kundraligjshëm. Ky vendim është shfuqizuar edhe me anë të vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, me nr.1498 date 9.04.2003.

Megjithatë dega e sipërcituar e Policisë të Ndërtimit, me anë të një shkrese të datës 15.07.2003, ka rinjoftuar ankuesen përsëri për prishjen e objektit “Bar-Kafe, Gent-Drin”. Ajo i referohet vendimit nr.341 datë 25.06.2003, të KRRT-së pranë Bashkisë Tiranë, ku behët fjalë për prishjen e objekteve të kundraligjshme në segmentin rrugor ku ndodhet objekti i saj.

Me marrjen në shqyrtim të kësaj çështje, janë kërkuar shpjegime nga ana e Policisë të Ndërtimit, dega Tiranë.

Nëpërmjet një procesi aktiv ndërmjetësimi, ka dalë përfundimi se njoftimi që është bërë nga ana e Policisë të Ndërtimit, dega Tiranë, nuk ka qenë i bazuar në dokumentacionin përkatës tekniko-ligjor. Pra çështja në këtë rast ka gjetur zgjidhje pozitive.

### 3. Ankesa e shtetasit N.Sh nga qyteti i Tiranës

Në letrën drejtuar Avokatit të Popullit, ankuesi si përfaqësues i 18 familjeve që jetojnë pranë Bregut të Lanës, ka paraqitur një ankesë në lidhje me mosinformimin e tyre, nga ana e Policisë të Ndërtimit, dega Tiranë, përse i përket një vendimi që është marrë nga ana e këtij organi, për prishjen e barakave ku këto familje jetonin.

Ankuesi shprehej se kishte paraqitur ankesat e tij së bashku me përfaqësuesit e tjerë të familjeve në fjalë, si në degën e Tiranës, ashtu edhe në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë të Ndërtimit, por në asnjë rast nuk i ishte kthyer përgjigje.

Në këto kushte ankuesi i është drejtuar organit të sipërcituar, duke kërkuar një kopje të vendimit në bazë të të cilit i është thënë se do t’ju prishen barakat, por gjithçka ka ngelur në heshtje.

Me marrjen në shqyrtim të kësaj çështje, janë kërkuar shpjegime lidhur me trajtimin e saj, nga ana e Policisë të Ndërtimit, dega Tiranë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë të Ndërtimit.

Në shpjegimet e dhëna nga ky organ është sqaruar se në bazë të ankesës të shtetas M. B, mbi zënien arbitrare të pronës së saj nga disa familje rome, Policia e Ndërtimit, dega Tiranë ka filluar procedurat përkatëse ligjore. Mbas verifikimit në vend të situatës janë konstatuar disa baraka dhe disa rrethime të ndërtuara nga disa familje të komunitetit Rom, ndaj të cilave janë mbajtur

procedurat ligjore, deri në marrjen e vendimit për prishje nr.331, numer serie 012331, datë 19.06.2004.

Në përfundim të këtij shqyrtimi, në përgjigjen e dhënë ankuesit kemi bashkangjitur një kopje të vendimit të sipërcituar dhe një kopje të përgjigjes së dhënë nga ana e Policisë të Ndërtimit, dega Tiranë, duke i dhënë mundësinë ankuesve për shfrytëzimin e mjeteve të tjera të mundshme të ankimit, për zgjidhjen e kësaj çështje.

#### 4. Ankesa e shtetasit K.P nga qyteti i Tiranës.

Në ankesën e shtetasit K.P, që në vitin 2001 është shprehur shqetësimi i tij në lidhje me mosveprimin e Policisë të Ndërtimit, dega Tiranë, përse i përket dëmtimeve që ka pësuar banesa e tij nga ndërtimi i bërë prej shtetasit Z.A, si dhe për pjesën e ndërtimit që është bërë jashtë lejes së ndërtimit në këtë rast.

Ankuesi shkruan se edhe pse nga ana e organit të Policisë të Ndërtimit, është konstatuar dëmtimi, gjithçka ka ngelur në kuadrin e konstatimit dhe asgjë më tepër.

Po kështu edhe në përgjigjen e Policisë të Ndërtimit, dega Tiranë, drejtuar Institucionit tonë për këtë çështje, pohoj se ndërtimi i garazhit sipas lejes në fjalë është pezulluar. Por kjo gjë nuk rezultonte si e tillë, sipas ankesës së paraqitur nga K.P.

Nëse do të shqyrtohet dosja e kësaj çështje, do të shihet në mënyrë të dukshme zvarritja dhe neglizhenca e shfaqur nga ana e organit të Policisë të Ndërtimit, për dhënien e shpjegimeve lidhur me këtë çështje.

Theksojme këtë fakt, pasi janë dërguar një sërë shkresash për dhënien e shpjegimeve dhe përgjigjeve në lidhje me këtë problem, janë zhvilluar një sërë takimesh me përfaqësues të degës të Policisë të Ndërtimit Tiranë, apo edhe të Drejtorisë të Policisë të Ndërtimit, por përsëri problemi ka ngelur për një kohë shumë të gjatë pa përgjigje.

Në këto takime janë përcaktuar shpesh herë detyra, janë përcaktuar shpesh herë afate dhe si përfundim, asnjëherë nuk është respektuar kjo marrëdhënie.

Dosja e trajtimit të kësaj çështje është shumë e ngarkuar me shkresa dhe korrespondenca zyrtare, me të cilat ankuesi na ka njohur dhe na i ka vënë në dispozicion kohë pas kohe.

Në vazhdim mund të përmenden një sërë shkresash të tjera që Drejtoria e Urbanistikës Ligjore dhe Kontrollit mbi Territorin në Bashkinë Tiranë, i ka drejtuar si njoftime për këtë problem, Policisë së Ndërtimit, dega Tiranë.

Nga ana e Ministrisë së Rregullimit të Territorit dhe Turizmit, është dërguar shkresa ku konfirmoj se ka shkelje në zbatimin e lejes së ndërtimit nga Z.A dhe se ka ndërtim pa leje. Në këtë shkresë nuk diskutohej me ky fakt, por nxirreshin arsyet përse nuk ishte bërë e mundur prishja e ndërtimit pa leje.

Pas kontaktimeve të shpeshta me degën e Policisë të Ndërtimit Tiranë dhe Drejtorisë të Përgjithshme të Policisë të Ndërtimit, së fundmi jemi vënë në dijeni nga ana e Drejtorisë të Përgjithshme të Policisë të Ndërtimit se:

Problemi i paraqitur nga ana e ankuesit është trajtuar disa herë nga ky organ dhe se në bazë të verifikimeve të kryera ne vend, informacioneve të Drejtorisë së Urbanistikës Ligjore në Bashkinë Tiranë, ka rezultuar se ndërtimi i bërë nga shtetasi Z.A, nuk është bërë konform Planimetrisë së sheshit të ndërtimit dhe lejes së ndërtimit.

Ndërtimi i garazhit është pezulluar, kurse pjesa e shtesës anësore objekt konflikti, e cila është realizuar jashtë planimetrisë së sheshit të miratuar, është konstatuar si kundravajtje, por teknikisht ka patur vështirësi për prishje.

Në këto kushte, duke patur parasysh ankesat e vazhdueshme për t'i dhënë zgjidhje përfundimtare kësaj çështje, nga ana e kësaj Drejtorie, jemi informuar se ka urdhëruar degën e Tiranës, *të marrë masa të menjëhershme për prishjen e këtij ndërtimi, si dhe ngritjen e një grupi pune, për të përcaktuar mënyrën dhe mjetet që duhen për prishjen e ndërtimit të kundraligjshëm.*

Bazuar në këtë përgjigje, i jemi ridrejtuar edhe një herë degës së Tiranës, duke i kërkuar shpjegime për trajtimin e mëtejshëm të çështjes, referuar edhe faktit sipas të cilit vetë ankuesi, ka shprehur gatishmërinë për të siguruar dhe vënë në dispozicion të saj punëtorë dhe personel të nevojshëm, për kryerjen e prishjeve dhe ndërhyrjeve të mundshme.

Çuditërisht, dërgohet një përgjigje nga ana e degës së Tiranës, ku citohet shprehimisht se:

*“Sipas dokumentacionit të paraqitur del se me vendimin nr.747 datë 29.09.2000 të KRRT-së së Bashkisë Tiranë, është miratuar rikonstrukcion për objekt ekzistues jashtë kësaj leje, objekt i cili është ngjitur me objektin 2 kat të K.P. Kjo provohet edhe nëpërmjet shkresës dt.28.09.2001 të Drejtorisë së Urbanistikës Ligjore në Bashkinë Tiranë.*

*Pëderisa objekti megjithëse është rikonstruktuar pa leje ka qenë ekzistues, Policia e Ndërtimit nuk mund të veprojë për prishje.*

*Për çdo pretendim për dëmin që mund t'i jetë shkaktuar banesës së tij, K. P, mund t'i drejtohet vetëm Gjykatës.”*

Me këtë përgjigje, jo vetëm që transformohet plotësisht ajo çfarë neve si institucion na është konfirmuar në shkresën e Drejtorisë të Përgjithshme të Policisë të Ndërtimit për këtë problem, por çështja futet në interpretime të tjera. Me sa duket dega e Tiranës nuk ka patur mundësinë dhe kohën t'i japë për katër vjet rresht.

Nga këto shkresa zyrtare të krijohet përshtypja se për trajtimin e kësaj çështje, janë shprehur dy organe të ndryshme të pavarura nga njëri-tjetri dhe jo i njëjti organ, i cili ka shkallën e tij hierarkike të organizimit administrativ.

Prandaj i kemi drejtuar një rekomandim Drejtorisë të Përgjithshme të Policisë të Ndërtimit dhe degës së saj të Tiranës, për veprimin sa më të shpejtë nga ana e tyre në lidhje me këtë problem, në bazë të kompetencave që iu jepen nga Ligji Nr.8408 datë 25.09.1998 “Për Policinë e Ndërtimit”, për të marrë vendimin përkatës për prishjen e ndërtimit të paligjshëm.

Gjithashtu kemi tërhequr njëkohësisht vëmendjen, për një rakordim më të mirë të përgjigjeve të dhëna nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë të Ndërtimit dhe degëve të saj, për çështje të njëjta, pasi kemi vërejtur se sikurse në këtë rast, nuk mbahet i njëjti qëndrim.

Kjo çështje është ende në shqyrtim nga ana jonë, pasi ndaj këtij rekomandimi, nuk është dhënë akoma qëndrimi zyrtar i organit të Policisë të Ndërtimit.

### **c) Ankesat per Ujësjetllës Kanalizimet**

Gjatë vitit 2004, janë shqyrtuar 3 ankesa, që kanë patur të bëjnë me ujësjetllësin dhe kanalizimet. Nga këto tre ankesa 1 është zgjidhur në favor dhe 2 kanë qënë të pabazuara.

Ankesën e zgjidhur pozitivisht po e trajtojmë si një rast që ilustron problematikën që haset në shërbimet publike që ofrojnë këto organe.

Pranë Institucionit të Avokatit të Popullit është paraqitur ankesa e shtetasit M. A nga Kavaja me anën e së cilës ngrihet shqetësimi se faturimi qe bëhet ndaj tij në lidhje me konsumin e ujit në banesë është fiktiv dhe nuk përmban vlerat reale të shënuara në matësin përkatës.

Konkretisht, ndërta matësi punon dhe shënon në dt.01.01.2004 (641m<sup>3</sup>), dt.01.02.2004 (645m<sup>3</sup>), 01.03.2004 (649m<sup>3</sup>), dt.01.04.2004 (654m<sup>3</sup>), dt.01.05.2004 (658m<sup>3</sup>), dhe dt.01.06.2004 (661m<sup>3</sup>) faturimi per 6 mujorin e pare te këtij viti nga Ujesjetlles Sh.a shenon vlerat e konsumit në masën 30m<sup>3</sup> gjithsej (pra 10m<sup>3</sup> me shume). Ne keto kushte, pasi ankuesi ka paraqitur ankese me shkrim pranë Ndërmarrjes së Ujësjetllës-Kanalizimeve Kavaje dhe nuk ka marrë përgjigje është drejtuar tek Avokati i Popullit dhe ka kërkuar ndërhyrjen e tij në eliminimin e abuzimeve të mëtejshme të faturuesve.

Avokati i Popullit, pasi u njoh me këtë ankesë, kërkoi të informohej hollësisht nga ana e Drejtorisë së Ujësjetllës Kanalizimeve për faturimet ndaj ankuesit dhe për veprimet që kishin ndërmarre për të verifikuar pretendimet e tij.

Nga ana e Ndërmarrjes së Ujësjetllës-Kanalizimeve Kavajë jemi informuar se para 7 vjetësh janë vendosur matësa uji (donacion gjerman) per te gjithë abonentet e qytetit te Kavajës. Por per shkak të mungesës së ujit, shumica e tyre kane dale jashtë përdorimit dhe nuk funksionojnë. Prandaj bazuar edhe ne

eksperiencën e vendeve të tjera, ndaj abonentëve është aplikuar një vlerë standarte faturimi duke u mbeshtetur në normativa që përcaktohen nga numri i pjesëtarëve në familje.

Avokati i Popullit konstatoi se matësi i furnizimit me ujë të ankuesit funksiononte normalisht dhe ndaj tij nuk është përpiluar ndonjë proces verbal nga Ndërmarrja e Ujësjetllës-Kanalizimeve për prishje të kësaj aparature. Prandaj kemi paraqitur rekomandim, duke kërkuar një faturim të rregullt ndaj ankuesit. Në këtë rekomandim është kërkuar që çdo abonent, i cili ka kontaktor në gjendje të rregullt pune, duhet të jetë subjekt i kontrollit dhe leximit periodik nga faturuesit. Ndërsa në raste të tjera kur kontaktoret nuk funksionojnë dhe vërtetohen si të tillë, duke njohur edhe konsumatorin për këtë fakt, faturimi të behet perkohesisht konform normatives për frymë, deri në pajisjen me matësa të rinj.

Në çështjen konkrete, Avokati i Popullit me qëllim ndreqjen e një praktike të gabuar që ndiqet nga Ndërmarrja e Ujësjetllës-Kanalizimeve në dëm të interesave të ligjshme të shtetasve, sugjeroi se rakordimi paraprak i shumave që paraqiten në kontaktor në raport me të dhenat në fatura, është një veprim mëse i domosdoshëm, i cili do të normalizojë në të ardhmen leximin dhe faturimin e rregullt ndaj tij. Në kontaktet e mevonshme me këtë Ndërmarrje është bërë i njohur fakti se ndaj një sërë individesh ka filluar të aplikohet një faturim real konform matësive, pasi këta të fundit janë konstatuar të rregullt.

Avokati i Popullit i vetëdijshëm për këtë periudhë tranzitore të reformimit teknik të rrjetit të ujit, mendon së trajtimi i diferencuar i dy grupeve të abonentëve të sipercituar, hap rrugën e evitimit të mosmarrëveshjeve dhe rrit besueshmerine e publikut për shërbimin që i ofrohet.

## **10. Ministria e Ekonomisë**

Për vitin 2004 ka patur vetëm 3 ankesa ndaj Ministrisë së Ekonomisë, ku 2 prej tyre pas shqyrtimit kanë rezultuar të pabazuara, ndërsa ankesa e tretë vazhdon të mbetet në shqyrtim. Rëndësia e kësaj ankese qëndron në nevojën e përmirësimit të legjislacionit përkatës dhe të metodës së punës së organeve të administratës shtetërore, për mbrojtjen e interesave të ligjshme të shtetasve shqiptare.

Kështu përfaqesuesi i shoqërisë tregtare “Infosoft Systems” sh.a, ka paraqitur ankesë, lidhur me ndryshimet më të fundit të bëra në Udhëzimin e Këshillit të Ministrave nr.1 date 1.01.1996 “Për prokurimin publik”, ku midis të



tjerave në pjesën e përgjithshme të dokumentave të tenderit, është shtuar edhe formulari “Autorizimi i Prodhuesit”.

Sikundër shprehet në ankesë, ky formular nuk pasqyron formën aktuale të marrëdhënieve tregtare ndërkombëtare, pasi duke ju referuar përmbajtjes së paragrafit të tretë të këtij formulari, kërkohet që firmat ndërkombëtare të autorizojnë vetëm një kompani lokale për të ofruar dhe lidhur kontrate, për mallrat e prodhuara prej tyre.

Një kërkesë e tillë, siç shprehet më tej në ankesë, vjen në kundërshtim me ligjin “Për konkurrencën”, me parimet e tregtisë së lirë dhe praktikën ndërkombëtare të biznesit dhe si e tillë, ajo nuk mund të pranohet nga firmat ndërkombëtare prodhuese, të cilat në një vend të caktuar kanë të autorizuar disa kompani lokale dhe jo vetëm një.

Lidhur me sqarimin e trajtimit që i është bërë kësaj çështje, nga ana jonë janë kërkuar paraprakisht sqarime prej Ministrisë së Ekonomisë dhe Agjencisë së Prokurimit Publik.

Në përgjigjen e dhënë nga Agjencia e Prokurimit Publik në bazë të një ankese të mëparshme që “Infosoft Systems” sh.a, ka paraqitur tek kjo e fundit në lidhje me problemin e ndeshur me Formularin e Autorizimit të Prodhuesit, si pjesë e dokumentave standarte të tenderit, sqaron se;

Modulet e dokumentave standarte të tenderit, të cilat do t’i vijne në ndihmë enteve prokurorese që do të kryejnë prokurimet publike në përputhje me ligjin e prokurimit publik dhe aktet nënligjore të tij, janë miratuar nga Këshilli i Ministrave, me Udhëzimin e Këshillit të Ministrave nr.3, date 10.07.2003 “Për disa ndryshime ne UKM nr.1 datë 1.01.1996 “Për prokurimin publik”.

Këto akte nënligjore, si edhe dokumentat standarte në këtë rast, janë fryt i bashkepunimit në grupe punë ndërdikasteriale, të cilat sipas përgjigjes, futen në fuqi pas miratimit që i bëhet nga Këshilli i Ministrave.

Kështu në kuadër të projektit të Bankës Botërore “Për reformën në Administratën Publike”, është firmosur kontrata me firmën konsulente ILI për hartimin e dokumentave standarte të tenderit, të cilat pasi janë rishikuar nga kjo firmë, janë diskutuar gjerësisht në grupin e punës të ngritur me përbërjen e specialistëve të Agjencisë së Prokurimit Publik dhe të enteve qendrore prokurorese.

Në vazhdim në përgjigjen e Ministrisë së Ekonomisë për këtë problem, në pak fjalë thuhet se me kërkesën e autorizimit të prodhuesit si kërkesë e dokumentave standarte të tenderit, kjo ministri ka zbatuar aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, të cilat kanë të bëjnë me procedurat e prokurimit publik.

Veç argumentimit procedural për nxjerrjen e Udhëzimit të Këshillit të Ministrave përkatës, konstatohet fakti se në të dy përgjigjet e dhëna për këtë

problem, nuk ka argumentim ligjor për bazueshmerinë e Formularit të Autorizimit të Prodhuesit.

Ajo çfarë të bën përshtypje nga ky formular, është pikërisht paragrafi i 5-te i tij, në të cilin thuhet shprehimisht se: *“Asnjë firmë ose kompani tjetër përveç (emri dhe adresa e ofertuesit) nuk autorizohet të ofroje, negocioje dhe lidhe kontrate për mallrat tona”*.

Ky deklaram duhet të vijë nga prodhuesi direkt i mallit, mall i cili kërkohet që të ofertohej në procedurën përkatëse të tenderimit.

Për nga menyra e formulimit të këtij paragrafi, të krijohet idea se ligjvënësi ka dashur të paraqesë dhe afrojë përfaqesuesin eskuziv të përfaqesimit të një kompanie apo firme prodhuese, në një procedure tenderimi.

Në rastin konkret nëpërmjet formularit të autorizimit të prodhuesit, ndodhemi përpara faktit të një kërkesë apo propozimi për lidhjen e një kontrate të mundshme të mëvonshme, e cila i përgjigjet lëvrimit të një malli që në kuptimin e gjetjes së tij në treg, është i zëvendësueshem për atë që ofrohet nga disa subjekte në treg dhe jo vetëm nga një.

Nga ana tjetër, kemi gjykuar se deklarimi i origjinës së mallit nuk ka asgjë të keqe në një procedure tenderimi, përkundrazi krijon kushtet për prokurimin e një malli me cilësor dhe më të kontrolluar, si dhe forcon kontrollueshmerinë në marrëdhëniet e kontraktimit mes palëve. Sikurse është përcaktuar në nenin 7, të pjesës së Dokumentave Standarte të Tenderit, (origjina e mallrave), nuk ka kufizime në procedurat e tenderimeve në këtë aspekt veç atyre të përcaktuara me ndonjë Rezolutë të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.

Në rastin konkret ka një rezonancë mes përcaktimeve për deklarimin e origjinës dhe faktit se kemi një kërkesë për autorizim të nënshkrimit të kontratës, për lëvrimin e një malli që do të prokurohet në një treg tjetër lokal, mes pjesmarrësit në tender dhe prodhuesit fillestar të mallit.

E kemi thënë këtë pasi jo vetëm në ligjin aktual në fuqi “Për prokurimin publik”, por edhe në ligjin “Për konkurrencën”, nuk ka përcaktime të cilat e ndalojnë një konkurrencë sa më të madhe në treg dhe në kushtet e respektimit të rregullave të konkurrencës.

Fakti që në autorizimin e prodhuesit jepet një përcaktim sikurse në paragrafin e pestë të tij, nuk do të thotë gjë tjetër veçse një kufizim që i behët pjesmarrjes sa më të gjërë, nëpërmjet një autorizimi nominal shumë strikt, që në fund të fundit kushtëzon edhe vetë prodhuesin në marrëdhëniet e tij kontraktore me të tretët.

Zyra jonë konkludoi se ankuesi me të drejtë e sheh ekzistencën e këtij formulari në rastin konkret për tregtinë e mallrave kompjuterike, si kërkesë që vjen në kundërshtim me parimet e ligjit për konkurrencën dhe praktikën

ndërkombëtare të biznesit, pasi autorizimi vetëm ndaj një firme që operon në tregun lokal nga ana e prodhuesit, jo vetëm që përbën kufizim ndaj këtij të fundit, por edhe përbën limitim dhe reduktim të konkurrencës në një treg të caktuar, sikurse edhe tregu yne. Pikërisht për këtë arsye i kemi sugjeruar Këshillit të Ministrave revokimin e paragrafit që parashikon formularin e "Autorizimit të Prodhuesit", në kapitullin e tretë të UKM nr.1 date 1.01.1996 "Për prokurimin publik", ndryshuar me UKM nr.3 datë 10.07.2003 "Për disa ndryshime në UKM nr.1 datë 1.01.1996 "Për prokurimin publik".

Për këtë rekomandim nuk kemi marrë ende një përgjigje, megjithë përpjekjet dhe përsëritjet e vazhdueshme të kërkesës tonë edhe gjatë këtij viti, për rishikimin në tërësi të akteve nënligjore që rregullojnë këto procedura tenderimi.

Në këtë çështje është konstatuar një zvarritje e dukshme burokratike e organeve të administratës publike për të përmiresuar legjislacionin në fuqi, ku të bie në sy një hezitim dhe apati administrative e organeve si Ministria e Ekonomisë apo Agjensia e Prokurimeve Publike për të iniciuar një ndryshim akti nënligjor. Avokati i Popullit do të vazhdojë të këmbengulë edhe në të ardhmen në lidhje me këtë çështje, pasi ekziston plotësisht bindja se në rastin e sipërpermendur ka mangësi dhe parregullsi administrative që çënojnë rëndë interesat e ligjshme ekonomike të subjekteve private. Për aq kohë sa këto interesa do të jenë objekt i veprimtarisë mbrojtëse të këtij institucioni, aq kohë nuk do të rreshtin edhe përpjekjet tona për të ndryshuar akte të tilla nëpërmjet ndërhyrjeve të vazhdueshme.

## **11. Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit**

Gjatë vitit 2004 për Ministrinë e Bujqësisë dhe Ushqimit si dhe për institucionet e tjera qendrore apo lokale në vartësi të saj, janë regjistruar 63 ankesa ndaj 58 të tillave për vitin 2003. Në favor të shtetasve janë zgjidhur 4 ankesa apo kërkesa.

Për vetë Ministrinë e Bujqësisë dhe Ushqimit ka një ankesë . Ka të bëjë me mos dhënien nga kjo Ministri, të aktit të miratimit si person juridik të "Shoqatës së Operatorëve të Fekondimit Artificial të Kafshëve" qëllimi i të cilës është sjellja nga jashtë e materialik gjenetik cilësor. Duke e vlerësuar si të bazuar ankimin, i kemi dërguar rekomandim Ministrisë për zbatimin e procedurave administrative në rastin kur plotësohen kriteret e vendosura.

#### **a) Ankesa për peshkimin dhe akuakulturën.**

Janë vetëm dy ankesa. Njëra e trajtuar dhe zgjidhur pozitivisht në vitin 2003, që i takonte Shoqërisë “Miqte e Ramsarit” me qendër në Divjakë të Lushnjës, gjatë të cilit ju mundësua dhënia e liçensës së kërkuar nga Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit, por që tani, në vitin 2004, kërkonte zgjerimin e aktivitetit të saj në të gjithë detin Adriatik: në ushtrimin e veprimtarisë së peshkimit profesional dhe të ruajtjes, zhvillimit dhe shfrytëzimit të eko-sistemit përkatës. U vlerësua, pas verifikimeve dhe kontakteve me përfaqësuesit e Ministrisë, si e pabazuar në ligj dhe në konkurrencën e ndershme. Ankesa tjetër, e cila si objekt të ankimit kishte mos dhënien e liçensës po për ushtrimin e veprimtarisë së peshkimit profesional, rezultoi e pabazur, pasi Drejtoria përkatëse në Ministrinë e Bujqësisë dhe Ushqimit, e kishte njoftuar edhe më parë ankuesin se nuk plotësonte kërkesat e ligjit për dhënien e saj. Plotësimi i tyre do të sillte edhe zgjidhjen në favor të tij të shqetësimit të paraqitur.

#### **b) Ankesa për çështje të Ligjit “Për Tokën”**

Ankesat që kanë të bëjnë me zbatimin e Ligjit nr.7501, datë 19.7.1991 “Për Tokën” dhe kontestimet e ish pronarëve të tokave bujqësore lidhur me të, janë si sasi, thuajse në të njëjtin nivel me ato të vitit të kaluar.. Kështu nga 49 ankesa të tilla për vitin 2003, për vitin 2004 ishin 53, 5 nga të cilat të mbartura nga viti 2003. Janë përfunduar 39 ankesa, nga të cilat 4 janë zgjidhur në favor të ankuesve duke u pajisur, në bazë të Ligjit nr.7501, datë 19.7.1991 “Për tokën” dhe akteve nënligjore dalë në zbatim të tij, me tokë bujqësore në pronësi nga Komisionet e tokave të fshatrave Kryemëdhenj-Kavajë e Mjull Bathore Tiranë, të Bashkive Bulqizë, dhe Kamëz, dhe 14 të tjera janë në shqyrtim. Edhe këto kanë të përbashkët faktin, se ankuesit pretendojnë se nuk janë pajisur plotësisht apo pjesërisht me tokë bujqësore sipas normave për frymë.

Konstatimi ynë për vitin 2004 është se ka lëvizuar diçka më mirë në krahasim me dy vitet e kaluara, në drejtim të përfundimit të procesit të ndarjes së tokave bujqësore, ka një rritje të interesimit dhe përkushtimit të një pjese të mirë të Komisioneve të Tokave, sidomos në Komuna, ku duam të veçojmë Komunën Farkë, Tiranë, me të cilin kemi patur marrëdhënie që mund të vlerësohen si nga më të mirat. Pavarësisht nga këto, objekti i ankimit dhe problemet e ndarjes së tokës bujqësore në zbatim të Ligjit nr.7501, datë 19.7.1991, “Për Tokën”, mbeten të njëjta. Komisionet e Tokave në shumë fshatra dhe Komuna vazhdojnë të mos funksionojnë, pavarësisht se janë të ngritura formalisht. Një pjesë e tyre nuk kanë vullnetin e duhur për zgjidhjen e

ankesave të shtetasve. për dhënien e tokës bujqësore në pronësi Me gjithë ndërhyrjet tona sidomos pranë Komisioneve të Tokave në Qarqe, që për faktin e mungesës së tokës për t'u plotësuar familjet bujqësore me të dhe në zbatim të kompetencave që ju jep VKM. Nr 230, datë 22.7.1991 "Për krijimin e komisioneve të tokave" me ndryshimet e bëra, të bëjnë ndërhyrje dhe propozime pranë Komisionit Qeveritar të Tokës për dhënien e rrugë-zgjidhjeve konkrete, nuk shikohet ndonjë reagim konkret. Nuk kuptohet siç duket, se këto organe janë organe të mirëfillta të administratës publike, qëllimi i ngritjes dhe funksionimit të tyre, është jo vetëm të zbatojnë në praktikë dhënien e tokës bujqësore në pronësi subjekteve që e përfitojnë atë; por edhe për të qënë në shërbim të tyre duke u udhëhequr nga parimet, normat dhe praktikat e ndjekura nga e gjithë administrata publike, të tilla si transparenca, paaënësia në veprimtarinë vendim-marrëse, korrektesa, fleksibiliteti, ndershmëria, profesionalizmi, etj. Ka vonesa të theksuara në dërgimin e sqarimeve të kërkuara për çdo pretendim të familjeve bujqësore për mos dhënie të tokës në pronësi ose mos plotësim me të sipas normës së caktuar për çdo fshat. Por edhe në rastet kur na i përcjellin, kanë vetëm justifikime të natyrës "që nuk ka më tokë për t'u ndarë", "s'jemi në dijeni të një ankimi të tillë", "ja kemi dërguar Komisionit të Tokës së Qarkut për ta zgjidhur", etj. Të gjitha këto janë tregues të mos njohjes në përgjithësi dhe mos zbatimit të etikës dhe korrektesës që duhet të karakterizojë administratën publike, jo vetëm në relacion me organet e tjera por edhe me individët Ndërsa njohja dhe zbatimi i të drejtës së informimit, si një e drejtë e ligjeshme e shtetasve për të marrë informacionin e duhur nga Komisionet e Tokave të të gjithë niveleve, për shqetësimet e tyre të ligjeshme, dhe shkalla e njohjes së kërkesave të Kodit të Proçedurës Administrative, bëhet fjalë gjithmonë për Komisionet e Tokave, është ende në parametra tepër të ulët. Kjo rezulton nga fakti, se një pjesë e ankimeve për problemet që kanë lindur me ndarjen e tokës bujqësore, kërkojnë ndërhyrjen e Avokatit të Popullit pranë Komisioneve të Tokave, veçanërisht atyre pranë Komunave, për t'ju dhënë përgjigje apo sqarim për informacionin që kërkojnë.

Kanë vazhduar edhe për këtë vit vonesat dhe mos veprimet e pamotivuara për shumë kohë të Komisioneve të Tokave në Qarkun e Elbasanit, në Komunitet e Rrashbullit dhe të Katundit të Ri në Durrës, për zgjidhjen e ankesave të shtetasve D.Gj, H.D, E.Sh, e të tjerë., dhe sidomos në Qarkun e Shkodrës, të Komunës Guri i Zi dhe të fshatrave Boriç i Madh dhe Boriç i Vogël. Këto komisione, herë premtojnë një trajtim të shpejtë të ankesave dhe herë heshtin për këto premtime.

Ankesat që kishin të bënin me tokat e ish Ndermarjeve Bujqësore. në rrethet e Korçës, Vlorës dhe Elbasanit, deri në vitin 2003 të pezulluara pjesërisht ose tërësisht, këtë vit konstatojmë se pas verifikimeve të bëra dhe

realizimit të detyrave të lena nga kontrollet e Prefektuarave dhe Departamentit të Kontrollit të Brëndeshëm Administrativ në Këshillin e Ministrave, kanë filluar të shqyrtohen për t'u dhënë zgjidhjen përfundimtare

Për këtë tablo të gjëndjes faktike për ankesat e shtetasve që pretendojnë se ju janë shkelur të drejtat dhe interesat e tyre të ligjshme në fushën e zbatimit të Ligjit "Për tokën", mendojmë se përpjekjet tona me ato mjete ligjore që na ka dhënë vetë ligji, nuk kanë dhënë rezultatet e pritura, megjithëse siç u nënvizua më lart ka një lëvizje pozitive të punës të një numri Komisionesh të Tokave.

Për vitin në vazhdim, insistimi dhe ndërhyrjet tona për ankimet e kësaj natyre, do të jenë më të mëdha për të dhënë ndihmesën brënda kuadrit ligjor, që ky proces të përfundojë pasi ka lidhje direkte me fillimin e kompensimit të ish pronarëve të pasurive të palujtshme në formën e trojeve dhe tokave bujqësore.

### **c) Ankesa për pasurinë e ish kooperativave bujqësore**

Ka 2 ankesë të tillë, një prej të cilave është në fazën e verifikimit të ankimit ndërsa tjetra, pasi rezultoi e bazuar dhe pasi morëm konfirmimin nga Drejtoria e Buxhetit në Ministrinë e Financave që shuma e kontributeve prej afro 50 milion lekësh e depozitur në Bankën e Kursimeve, pas privatizimit të saj nga Raiffaisen Bank, ka kalur në buxhetin e shtetit, i kemi sugjeruar ankueses rrugën gjyqësore për tërheqjen e këtij kontributi në vlerë si ish anëtar i ish kooperativës bujqësore.

### **ç) Probleme për pyjet**

Për Drejtorinë e Shërbimit Pyjor në rrethe ka patur 4 ankesa. Dy kanë qënë ankime për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës, për të cilat ankuesve ju sugjerua në bazë të Kodit të Punës, ankimi në gjykatën kompetente. Njera me objekt dorëzimin e një fondi pyjor, kthyer ish pronarëve në natyrë me vendim të KKK të Pronave. Është në shqyrtim dhe ndjekje pasi deri tani Drejtoria e Shërbimit Pyjor Fier nuk pranon të beje dorëzimin e kesaj sipërfaqe me aresyetimin se është zone e mbrojtur dhe Komisioni përkatës ka gabuar në kalimin e saj në prone private. Se shpejti do t'japim zgjidhjen e duhur ligjore këtij problemi në baze të dispozitave përkatëse në fuqi. Ndërsa e fundit kishte të bente me një shqyrtim të një shtetasi për masakrimin e pyjeve në Komunën e tij nga individë të papërgjeshmë për interesa të ngushtë përfitimi. Për kompetencë ju dergua Drejtorisë së Shërbimit Pyjor në rrethin përkatës, të cilët në përgjigjen e tyre e konsideruan ankimin si pjesërisht të drejtë duke na vënë në dijeni edhe për gjokat e vendosura për kundravajtje dhe kallzimet për procedim penal për persona konkrete.

#### **d) Probleme për cilësinë e ushqimeve**

Nuk ka patur asnjë ankesë për cilësinë e produkteve ushqimore

#### **e) Ankesa për Drejtoritë e Bujqësisë dhe Ushqimit në rrethe.**

Për këto drejtori kemi patur 3 ankesa për vitin 2004. Dy kishin të bënin me ndërprerjen e marrëdhënieve të pënes, për të cilat ankuesve ju bë e ditur se kushtet e rregullimit të këtyre marrëdhënieve me kontrata pune në bazë të Kodit të Punës, ata duhet t'i drejtoheshin rrugës gjyqësore. Ndërsa ankesa tjetër është në ndjekje pasi është rregjistruar në fundin e vitit.

## **12. Ministria e Financave**

Numri i ankesave, kërkesave dhe njoftimeve drejtuar Avokatit të Popullit nga shtetas dhe subjekte tregtare për shkeljen e të drejtave dhe interesave të ligjshme të tyre nga administrata financiare, ku përfshihen Ministria e Financave, organet doganore, tatim-taksat dhe Agjensia Kombëtare e Privatizimit për vitin 2004 është 30. Nga ky numër, rezulton se 8 ankesa janë ende në shqyrtim, 8 janë gjetur të pabazuara, 5 janë shpallur jashtë juridiksionit, 3 janë konsideruar me mungesë kompetence, 2 ankesa janë zgjidhur në favor që në fazën e parë të ndërhyrjes dhe verifikimit të tyre dhe 3 ankesa janë zgjidhur në favor pas paraqitjes së rekomandimeve përkatse nga Avokati i Popullit.

Në lidhje me ankesat në fushën financiare, do të trajtojmë disa prej tyre, të cilat paraqesin problematika të mprehta apo që janë zgjidhur në mënyre pozitive.

1. Pranë Institucionit të Avokatit të Popullit, shtetasi S. B. paraqiti një ankesë e cila kishte të bënte me mosëkzekutimin e një vendimi gjyqësor të Gjykatës së Shkallës së parë Tiranë nga ana e Ministrisë së Financave. Në atë vendim ishte percaktuar detyrimi i Ministrisë së Financave si palë e paditur që t'i paguante paditesit S.B shumën prej 375.000 lekë, për kohën e mbajtur padrejtësisht në burg. Zyra e Permbarimit Tiranë për përmbushjen e këtij detyrimi kishte dërguar lajmerimin për ekzekutim vullnetar në Ministrinë e Financave. Por që nga ajo datë kjo Ministri nuk kishte bërë të mundur të ekzekutonte vendimin gjyqësor, duke e zvarritur këtë procedurë. Pasi u komunikua me Ministrinë e Financave dhe ju dërgua edhe rekomandimi

përkatës, është bërë e mundur që konform rregullave të kryhej ekzekutimi i plotë i vendimit gjyqësor në favor të ankuesit.

2. Në letrën drejtuar Avokatit të Popullit, përfaqësuesit e një grupi punonjësish të Degës së Tatim Taksave, Tiranë janë ankuar lidhur me marrjen e disa masave administrative, nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve. Të gjithë këta persona kanë pretenduar se duke qenë anetarë të komisioneve të hartimit të dokumentave dhe të vleresimit të ofertave, në një procedurë prokurimi, i kanë kursyer shtetit shumën prej 16 milione lekë. Por në këtë kuader, ju janë dukur të padrejta masat administrative të vendosura mbi bazën e një kontrolli të Ministrisë së Financave (Drejtoria e Përgjithshme e Kontrollit të Brendshëm), kur për këtë procedurë prokurimi paraprakisht ishte shprehur vetë Agjencia e Prokurimit Publik.

Pasi Avokati i Popullit u njoh me këtë ankesë, kërkoi menjëherë shpjegimet paraprake nga Dega e Tatim Taksave Tiranë dhe nga Drejtoria e Përgjithshme e Kontrollit të Brendshëm në Ministrinë e Financave.

Në mungesë të vazhdueshme të përgjigjeve nga këto organe, janë marrë takime dhe është këmbëngulur, duke kërkuar shpjegime të përsëritura nga ana e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Administratës, në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve.

Së fundmi, Avokati i Popullit është vënë në dijeni se masat administrative që ishin marre ndaj grupit të ankuesve, mbi bazën e kontrollit të Ministrisë së Financave, janë ndryshuar, duke u nisur nga motivet dhe argumentat e paraqitura.

3. Në letrën drejtuar Avokatit të Popullit, shtetasi Ç.H shprehte shqetësimin lidhur me transferimin dhe uljen në detyrë që i ishte bërë nga drejtoresha e mëpareshme e doganave, brenda një harku kohor prej 5 ditësh, duke e konsideruar këtë si një masë të padrejtë administrative. Avokati i Popullit, pasi u njoh me këtë ankesë dhe kreu verifikimet përkatëse, kërkoi një informacion të hollësishëm nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave. Në përgjigje, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave shpjegoi se kalimi nga doganier i kontrollit fizik në doganier rregjimesh është bërë në kuadrin e hyrjes në fuqi të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.612, datë 11.9.2003 “Për strukturën dhe organikën analitike të administratës doganore”. Gjithsesi pas ndërmjetësimit tonë të përsëritur, u bë e mundur që shtetasi Ç.H të kthehej në detyrën e mëparshme.

4. Shtetasit V.DH dhe B.Ç ish punonjës të Drejtorisë së Doganës dega Durrës, kanë paraqitur ankesë tek Avokati i Popullit, pasi Drejtoria e Përgjithshme e Doganave nuk ka pranuar të ekzekutojë në favor të tyre vendimet e Komisionit të Shërbimit Civil. Këto vendime në përmbajtjen e tyre kanë konstatuar të paligjshme vendimet për largimin nga detyra të ankuesve dhe



kanë vendosur për rikthimin e tyre në detyrën e mëparshme dhe pagimin e pagës për kohën e qëndrimit pa pune.

Avokati i Popullit, pasi u njoh me këto ankesa, kërkoi menjëherë shpjegime të hollësishme për procedurat që po ndiqte për rikthimin në punë Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, si dhe paraqiti pranë këtij organi edhe rekomandimet përkatse për zbatimin e vendimeve të Komisionit të Shërbimit Civil. Në përgjigjen e ardhur nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave është bërë e ditur se propozimet e paraqitura janë marrë në konsideratë dhe personat e interesuar janë vënë në listë pritje për tu trajtuar sipas mundësive që do të krijohen për vende vakant.

5. Pranë Institucionit të Avokatit të Popullit, shtetasi R.R ka paraqitur një ankesë me anë të së cilës ngre shqetësimin se ekzekutimi i vendimeve gjyqësore që kanë si debitor Ministrinë e Financave kryhet me parregullsi të dukshme. Konkretisht me anë të Vendimit Nr.509 dt.10.02.2004 të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë është ngarkuar Ministria e Financave (*pala e paditur*) që të kompesoje për burgim të padrejtë ankuesin në shumën 4.130.600 lekë. Gjithashtu Ministrisë së Financave i janë ngarkuar edhe shpenzimet gjyqësore në shumën 73.493 lekë. Pasi ky vendim ka marrë formë të prerë dhe janë kryer të gjitha formalitetet e duhura, shtetasi ka terhequr si kreditor pranë Bankës së Kursimeve Tirane 3.717.540 lekë si detyrim të lëvruar nga Ministria e Financës në zbatim të vendimit gjyqësor të mësipërm. Pasi ka ardhur në dijeni të kësaj vlere, ankuesi ka pretenduar se nga shuma e caktuar me vendimin gjyqësor Nr.509 dt.10.02.2004, Ministria e Financave nuk ka rimbursuar shpenzimet gjyqësore të parapaguara nga ky shtetas. Avokati i Popullit, pasi u njoh me këtë ankesë, kërkoi të informohej nga ana e Ministrisë së Financave, lidhur me vërtetësinë e pretendimeve të këtij shtetasi dhe arsyet e mbajtjes së shumave përkatse.

Në përgjigjen e Zv.Ministres së Financave është sqaruar se rimbursimi i shpenzimeve gjyqësore të parashikuara në vendimet përkatse nuk është i mundur të realizohet, pasi në fondin e buxhetit të shtetit për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore nuk janë parashikuar shpenzimet gjyqësore. Nisur nga ky qëndrim antiligjor që mban Ministria e Financave në zbatimin e plotë të vendimeve gjyqësore, Avokati i Popullit ka paraqitur një rekomandim pranë Ministrisë së Financave, duke kërkuar rimbursimin e ankuesit me shpenzimet gjyqësore që kanë parapaguar dhe përmirësimin e praktikave të gabuara që aplikohen gjatë zbatimit të vendimeve gjyqësore.

Megjithese kjo çështje është ende në shqyrtim dhe pritet përgjigje nga Ministri i Financave, Avokati i Popullit gjykon se mos dhënia e shumave për shpenzimet gjyqësore të parapaguara nga shtetasit, përbën një shkelje të hapur të ligjit, e cila duhet të korrigjohet menjëherë. Ministria e Financave nuk mund

të anashkalojë këtë detyrim kushtetues me justifikimin se nuk ka përfshirë në buxhetin vjetor zërin “Shpenzime Gjyqësore” pasi kjo është e panevojshme për atë kohë sa shpenzimet gjyqësore janë pjesë përbërëse e dispozitivit të vendimit gjyqësor. Avokati i Popullit do të këmbëngulë në këtë çështje edhe në të ardhmen deri në zgjidhjen e plotë të saj, pasi çmon se qëndrimi i Ministrisë së Financave ka cënuar rëndë të drejtat dhe interesat e ligjshme të individëve.

Në disa prej ankesave objekt ka qenë neni 29, prg.3 i Ligjit nr.8438, date 28.12.1998, “Për Tatimin mbi të ardhurat”, i cili përcakton mënyrën se si një parapagim i bërë nga individit organeve tatimore, duhet të njihet si i tillë dhe t’i rikthehet individit në një nga format e përcaktuara në këtë dispozite, pra ose t’i njihet individit për shlyerjen e detyrimeve tatimore të prapambetura, ose për pagesën e detyrimeve tatimore të ardhshme ose t’i rikthehet tatimpaguesit me kërkesën e tij. Me keqardhje kemi konstatuar se ky detyrim ligjor shpesh herë nuk zbatohet nga organet tatimore dhe si i tillë përbën objekt ankimi për tatim paguesin si pranë zyrës sonë , po ashtu dhe në gjykate si objekt konflikti gjyqësor.

Edhe një herë për sa i përket konkluzioneve të arritura nga ne për punën e Ministrisë së Financave nuk mund të lëmë pa përmendur se shkak që çështjet janë në shqyrtim është se administrata doganore ose tatimore, në kundërshtim me dispozitat ligjore dhe në neglizhencë të plotë, nuk kthen përgjigje ndaj kërkesave për shpjegime të dërguara nga Avokati i Popullit, duke shkaktuar probleme serioze në hetimin dhe përfundimin e ankesave brenda një afati të arsyeshëm.

Në këtë kuadër gjatë vitit 2004 janë propozuar masa disiplinore pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve për disa nëpunës përgjegjës që me dashje apo nga paaftësia zvarritin vazhdimisht korrespondencat me Institucionin e Avokatit të Popullit. Ndër shkaqe të tjera për këtë gjëndje jo të mirë në administratën publike të sektorit të Financës mendojmë se janë mosnjohja e Kushtetutës, Kodit të Punës, Ligjit “Per Statusin e Nëpunësit Civil”, ku vendosen rregulla për detyrimin e administratës në njohjen e mjaft të drejtave ndaj individëve.

Si konkluzion mund të themi se megjithëse numri i ankesave të individëve kundër organeve të administratës financiare është i pakët, kjo nuk do të thotë se shkeljet e kryera nga kjo e fundit janë të pakta. Si një nga shkaqet kryesorë të mospasjes së shumtë të këtij tipi ankesash, mund të veçojmë mosbesimin e individëve në zgjidhjen e tyre, mosbesim ky i ardhur dhe i krijuar ndër vite nga marrëdhëniet organe tatimore-tatimpagues. Vlen të përmendim dhe vetë legjislacionin tatimor si një shkak tjetër, zbatimi i të cilit në vetvete sjell probleme për tatimpaguesin, po ashtu dhe qëndrimin e organeve tatimore sikundër e përmendëm me lart.

## **a) Agjensia Kombëtare e Privatizimit**

Për vitin 2004 ka patur 3 ankesa ndaj Agjensisë Kombëtare të Privatizimit, të cilat janë përfunduar duke u konsideruar si të pabazuara dhe jashtë juridiksionit. Krahas këtyre ankesave gjatë vitit 2004 janë përfunduar edhe 5 ankesa të mbartura nga viti 2003, tek të cilat nuk janë konstatuar shkelje të të drejtave dhe interesave të ligjshme të individëve të kryera nga Agjensia Kombëtare e Privatizimit. Për ankesat që kanë rezultuar të pabazuara ose jashtë juridiksionit të Avokatit të Popullit, ankuesve ju janë sqaruar dispozitat përkatëse ligjore dhe rruga nepermjet së cilës do të realizojnë të drejtat dhe interesat e tyre të ligjshme. Shqetësimi i evidentuar nga ankesat e këtij viti kishte të bënte me privatizimin e disa objekteve të fermentimit të ish Fabrikës së Cigareve Durrës. Në ankesat drejtuar Avokatit të Popullit qytetarët (ish pronarë) kanë shprehur shqetësimin, lidhur me abuzimet që janë kryer gjatë ankandit që ka zhvilluar AKP-ja, ku parregullsitë më të mëdha janë konstatuar në fazën e njoftimit.

Lidhur me verifikimin dhe transparencën e këtij privatizimi, Avokati i Popullit ka kërkuar dy herë shpjegime pranë Agjensisë Kombëtare të Privatizimit. Përgjigjet e paraqitura nga ky organ, krahas sqarimeve dhe verifikimeve të tjera të nevojshme ligjore, ju janë vënë në dispozicion ankuesve.

Konkretisht Agjensia Kombëtare e Privatizimit ka sqaruar se: Objekti “dy godina të fermentimit” dhe miratimi i privatizimit të saj është kryer me një shkresë të Ministrisë së Ekonomisë drejtuar Ministrisë së Bujqësisë, në të cilën është përcaktuar vlera e objektit prej 105985504 leke, me sipërfaqe 6660 m<sup>2</sup> dhe nën objekt 4937 m<sup>2</sup>.

Sa më sipër rezulton se AKP-ja ka zbatuar me përpikmëri të gjitha detyrimet e saj ligjore lidhur me kontrollin e dosjes, procedurat e publikimit, procedurat e shitjes me ankand, në përputhje me ligjin nr.7512, date 10.8.1991, VKM nr.159, date 13.3.2003 dhe VKM nr.169, date 13.3.2003.

Përsa i përket të drejtës së ish pronarit me të drejtën e parablerjes së objektit, bazuar në VKM nr.159, date 13.3.2003, kap.III, pika 2 thuhet se: “Ish pronarët e truallit në zbatim të ligjit “Për kthimin dhe kompesimin e pronave ish pronarëve” kanë të drejtën e parablerjes së objektit me vlerë fillestare. Në rastet kur nuk ka pronar truall apo nuk janë paraqitur dokumentat e pronësive deri në datën e zhvillimit të ankandit, objekti i nënshtrohet ankandit. Vlera e truallit i kompesohet pronarit sipas dispozitave në fuqi”.

Te drejtat e ish pronarëve të truallit me të drejtën e parablerjes së objektit përcaktohen shume qartë në VKM nr.159, date 13.3.2003, kap.III, neni 8 dhe 10.

AKP ka sqaruar se pretendentët për të drejtën e parablerjes si ish pronar trualli jo vetëm që nuk janë paraqitur ditën e ankandit, por nuk kane shprehur interesim ne AKP edhe pas vendosjes se afishimeve në mjediset e objektit, ndërmarjes, si dhe te publikimit ne gazetat “Shekulli”, “ZP” dhe “RD”.

Ndodhur përpara kësaj situate, ku per objektet e mësipërme tashme jane lidhur kontratat përkatse të shitblerjes, roli i Avokatit te Popullit është i padobishem për të rikthyer procedurat në gjendjen e mëparshme. Në këto kushte, për pretendimet e mundshme të ankuesve ish pronare që kërkojne pavlefshmerine e privatizimit, ju është sugjeruar që brenda afateve ligjore të paraqisnin kërkesë padi në organet gjyqësore.

Gjatë verifikimit të ankesave të lartëpërmendura, Avokati i Popullit ka ardhur në dijeni për parregullsi që kanë të bëjnë me njoftimet e palëve të interesuara në ankand. Ky veprim procedural i ankandit, nga vetë ankesat e paraqitura lë mjaft për të dëshiruar dhe duhet përmirësuar ndjeshëm. Në këto kushte, Avokati i Popullit çmon se një konceptim i ri i shpalljes dhe publikimit të ankandeve që të ruaje standarte të mjaftueshme transparence, do të jetë rrugëzgjdhja e eliminimit të ankesave për punën e Agjensisë Kombëtare të Privatizimit.

Avokati i Popullit edhe në të ardhmen do të synojë të evidentojë dhe ndërhyjë për fenomene që vihen re në keqadministrimin e organeve të administratës publike financiare në raport me të drejtat dhe liritë themelore të individit si dhe të ketë në vëmendje përmirësimin e mëtejshme qoftë të kuadrit ligjor finnciar, ashtu dhe të punës së nëpunësve të administratës financiare, nëpërmjet rekomandimeve dhe kontakteve të vazhdueshme me ta.

### **13. Ministria e Arsimit dhe Shkencës**

Gjatë vitit 2004 rezultojnë 48 ankesa apo kërkesa të ardhura ndaj Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe institucioneve në vartësi të saj. Janë në fazën e shqyrtimit pranë Zyrës sonë 13 ankesa. Në favor janë zgjidhur 8 ankesa apo kërkesa, kanë qenë jashtë juridiksionit dhe kompetence 14 ankesa, të pabazuara kanë qenë 10 ankesa. Ndërsa nga viti 2003 janë mbartur për shqyrtim 16 ankesa, nga të cilat 4 janë zgjidhur në favor, 6 jashtë juridiksionit dhe kompetencës, 4 të pabazuara.

Një numër i konsiderueshëm ankesash kanë patur si objekt problemet e largimeve nga puna të mësuesve apo transferimeve nga një vend pune në një tjetër. Këtë vit kjo problematikë ka qënë mbizotëruese në ankesat e paraqitura dhe për faktin e riorganizimit të Drejtorive Arsimore në gjithë vendin.

Gjithashtu ka patur ankesa në të cilat janë kontestuar procedurat e zhvillimit të konkurseve të zhvilluara për drejtuesit e zyrave Arsimore.

Nga shqyrtimi i ankesave, është konstatuar se në disa raste vendimet e largimit nga puna dhe ato të transferimit janë të paarsyetuara.

Arsyetimi i akteve administrative është një ndër tiparet më themelore të shtetit të së drejtës për dy arsye kryesore: Së pari, dhënia e arsyeve informon personat e interesuar për shkaqet që qëndrojnë pas vendimeve të administratës të cilat ndikojnë negativisht mbi të drejtat dhe liritë e tyre, dhe, së dyti, arsyetimi që i bëhet një akti lehtëson së tepërmi kontrollin gjyqësor dhe hierarkik administrativ. Për këto arsye, çdo akt administrativ i shprehur ose i konfirmuar me shkrim duhet të përmbajë dhe arsyet e tij. Në këtë mënyrë, krahas qëllimit dhe formës që duhet të ketë akti administrativ, arsyetimi i tij është një tjetër element i rëndësishëm

Në këto vendime është shpjeguar ana ligjore, ndërkohë që ana faktike, me fjale të tjera faktet esenciale të cilat e kanë detyruar organin të nxjerrë vendimin nuk janë të pasqyruara në ato vendime.

Ky fakt përbën shkelje të dispozitave të Kodit të Procedurave Administrative dhe cënon në të njëjten kohë gjithë procesin e vendimmarrjes.

Gjithashtu ka patur dhe ankesa ku mësuesve të larguar nga puna ju mohohet e drejta për t'u informuar për vendimin e marrë. Shpesh njoftimi verbal konsiderohet nga organi vendimmarrës si e vetmja mënyrë njoftimi.

Duke analizuar respektimin e dispozitave procedurale nga organi vendimmarrës, konstatojmë se në asnjë rast personit të dëmtuar nuk i është dhënë mundësia të dëgjohet para marrjes së vendimit të largimit apo të transferimit, për t'i dhënë këtij të fundit mundësinë për të shprehur argumentat e tij.

Nisur nga këto konstatime, jemi të mendimit se ka shumë për të bërë në drejtim të respektimit të procedurave ligjore nga ana e këtyre organeve, kryesisht në njohjen dhe zbatimin e dispozitave të Kodit të Procedurave Administrative.

Nga ankesat e trajtuara përmendim:

1. Shtetasi P.T. u ankua për faktin që nga ana e Rektorit të Universitetit Politeknik nuk ju bë e mundur pajisja me diplomë.

Ky i fundit, në mënyrë verbale, i sqaronte ankuesit se nuk pranonte të vendoste në diplomë fotografinë, ku ankuesi kishte dalë me mjeker si praktikant i fesë myslimane, duke përmendur si argument të vetëm faktin se shkolla është laike.

Për zgjidhjen e kësaj çështjeje i jemi drejtuar Rektorit të Universitetit Politeknik, në veprimet e të cilit ishin konstatuar disa shkelje administrative.

Kështu, nisur nga fakti se një organ administrativ shprehet nëpërmjet akteve administrative, në rastin konkret vendimeve, Rektorit ju shpjegua se edhe kur ato janë verbale nevojiten të arsyetohen nga organi që i nxjerr ato. Pra, dhënia e arsyeve për nxjerrjen e një akti administrativ përbën një detyrim ligjor, bazuar në nenin 108/a të Kodit të Proçedurave Administrative.

Në të njëjtën kohë, nxjerrja e një vendimi të arsyetuar nga ana e organit administrativ, i jep mundësi ankuesit, të parashtojë më mirë ankimin e tij, në organin më të lartë në shkallë hirarkie, në Ministrinë e Arsimit. Dhe në përfundim i jepet mundësia e kontrollit gjyqësor të veprimtarisë administrative. Pra referuar nenit 18 të Kodit të Proçedurës Administrative, në mënyrë që të mbrohen të drejtat kushtetuese e ligjore të individit, ky i fundit duhet të pajiset me aktin konkret të nxjerrë nga vetë organi në lidhje me këtë çështje. Pra shprehja “Shkolla është laike” në rastin konkret nuk mund të konsiderohej si arsyetim i një akti administrativ.

Pas rekomandimit të drejtuar Rektorit të Universitetit Politeknik, çështja mori zgjidhje pozitive dhe ankuesi u pajis me diplomë duke ju pranuar fotografia ku kishte dalë me mjekër.

2. Të njëjtën problematikë ka paraqitur dhe ankesa e shtetasit E. M., të cilit nuk i bëhej e mundur regjistrimi në shkollën e mesme “Kostandin Kristoforidhi” për faktin se ai mbante mjekër. Nga ana e Drejtorit të shkollës, ky fakt konsiderohej në kundërshtim me normat e bashkëjetesës në shkollë dhe si paraqitje e tepruar estetike.

Në rastin konkret, refuzimi i konstatuar krijonte premisa për shkeljen e disa të drejtave, si të drejtës për të shprehur e praktikuar besimin fetar dhe në të njëjtën kohë e drejta e ankuesit për t’u arsimuar. Situata bëhej më e ndjeshme dhe për faktin tjetër se ankuesi ishte i mitur.

Sa më sipër Drejtorit të shkollës se mesme “Kostandin Kristoforidhi” i është drejtuar një rekomandim duke argumentuar se:

Në rastin konkret ka shkelje të nenit 18 dhe 26 të Kushtetutës tonë. Në vijim, nenit 7 pika 1 dhe 2 i Ligjit Nr.7952 date 21.06.1995, “Për sistemin arsimor parauniversitar” që nenkupton se shkolla konsiderohet laike në rast se ajo nuk do të financohet nga fonde të ardhura prej organizatave fetare, nuk bën propagandë fetare dhe nuk diskriminon në pranimin e nxënësve duke u bazuar në afilacionet fetare. Laicizmi normalisht nënkupton laicizmin e institucionit dhe jo të individeve si dhe laicizëm në përmbajtje dhe jo në formë.

Pra Kushtetuta, Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut dhe ligjet organike, nuk kufizojnë lirinë e fesë dhe praktikave fetare dhe, si pasojë, nuk mund të diskriminohet një individ vetëm se ai praktikon një besim të caktuar.

Liria e shfaqjes së besimit ose të bindjeve nuk mund të bëhet objekt i kufizimeve të tjera, vec atyre që parashikohen me ligj dhe që janë të

domosdoshme në një shoqëri demokratike, për interesa të sigurimit publik, të ruajtjes së rendit, të shëndetit dhe të moralit publik ose *të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të tjerëve*.

Në të njëjtën kohë mbajtja e mjekrës nuk mund të konsiderohet në kundërshtim me normat e bashkejetesës në shkollë dhe paraqitje e tepruar estetike, pasi nuk pengon procesin mësimor si dhe nuk çënon aspak bashkejetesën.

Duke qënë se në rastin konkret trajtohet ankesa e një të mituri, referuar Konventës “Mbi të Drejtat e Fëmijës”, konkretisht të neneve 28 dhe 29, mosregjistrimi çënon gjithashtu të drejtën e ankuesit për t’u arsimuar.

Ky rekomandim është pranuar nga ana e Drejtorit të shkollës dhe rezultoi që ankuesi është regjistruar dhe vazhdon shkollën në sistemin e korrespondencës.

3. Shtetësja L.Ç. është ankuar për mosekzekutimin e vendimit Gjyqësor nga ana e Ministrisë së Arsimit, në të cilën është vendosur anulimi i pikës 3 të pjesës urdhëruese të aktit administrativ “Konkluzionet e kontrollit”, të Drejtorisë së Kontrollit Financiar të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës. Ky vendim i jepte të drejtë ankueses që të paguhej sipas kualifikimit të saj, në kundërshtim me rezultatet e akt kontrollit.

Nga ana e Institucionit tonë i është drejtuar një rekomandim Ministrisë së Arsimit dhe Shtëpisë Botuese të Librit Universitar, duke ju argumentuar se mosekzekutimi i një vendimi gjyqësor të formës së prerë përbën shkelje të nenit 142 pika 3 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku thuhet se “Organet e shtetit janë të detyruara të ekzekutojnë vendimet gjyqësore”.

Këtij rekomandimi, Shtëpia botuese e Librit Universitar ju përgjigj pozitivisht dhe ankuesja mori shtesën në pagë që i takonte për shkak të kualifikimit.

4. Shtetasi A. B. u ankuar për largim pa të drejtë nga puna si pedagog i Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike në Universitetin Politeknik me vendimin e ish rektores së Universitetit Politeknik.

Nga shqyrtimi i çështjes rezultoi se vendimi i largimit nga detyra të shtetasit A. B. ishte marrë individualisht nga ana e ish Rektores, pa e bërë objekt diskutimi të strukturave të Fakultetit.

Pavarësisht se në bazë të nenit 11 të Statutit të Universitetit Politeknik, Rektori ka kompetencën të emërojë personelin akademik të brëndshëm, nëpërmjet një procedure konkurimi dhe vendimi i largimit nga puna, duhet të jetë objekt diskutimi nga këto struktura dhe në fund të kësaj procedure është Rektori organi që ka kompetencën të vendosë .

Në të njëjtën kohë nisur nga specifika e marëdhënieve të punës të pedagogëve, rezultoi se në rastin konkret kemi shkelje të procedurave të parashikuara në Kodin e Punës.

Si pasojë një akt administrativ i nxjerrë në kundërshtim me procedurat e kërkuara nga ligji, referuar Kodit të Procedurave Administrative konsiderohet absolutisht i pavlefshëm.

Në këto kushte, me ndërhyrjen e Institucionit tonë, mjaftoi konstatimi i faktit të pavlefshmerisë absolute të vendimit të largimit nga puna nga ana e Rektorit, dhe ankuesi u rikthye në detyrën e tij të mëparshme.

5. Shtetasi M. S. pedagog në Akademinë e Edukimit Fizik dhe Sporteve, është ankuar për zvarritje në mënyrë të kundërligjshme të procedurave për dhënien e titullit “Profesor i Asociuar”.

Nga shqyrtimi i çështjes ka rezultuar se, në shqyrtimin e kërkesës së shtetasit për marrjen e titullit “Profesor i Asociuar” ka vonesa të pajustificuara dhe subjektivizëm në trajtimin e saj.

Rezultoi se nga momenti i rifillimit të procedurës për kërkimin e titullit shkencor “Profesor i Asociuar” ka kaluar më shumë se një vit dhe nga ana e strukturave të Akademisë në mënyrë të kundërligjshme dhe të qëllimshme, nuk është paraqitur dosja për miratim në senatin e Akademisë së Edukimit Fizik dhe Sporteve, pavarësisht se procesi vendimmarrës i këtij organi ka vazhduar për raste të tjera.

Sa më sipër, nga ana jonë i është rekomanduar organit kompetent vendimmarrës studimi i dosjes për dhënien e titullit shkencor “Profesor i Asociuar” shtetasit M.S. bazuar në kriteret ligjore të parashikuara.

Nga ana e Rektoratit nuk kemi ende përgjigje për këtë rekomandim.

## **14. Ministria e Shëndetësisë**

Gjatë vitit 2004 për Ministrinë e Shëndetësisë dhe institucionet në vartësi të saj janë shqyrtuar gjithsej 33 ankesa. Nga këto 8 kanë qënë të mbartura nga viti 2003. Janë përfunduar 25 ankesa, 11 janë zgjidhur në favor, 4 kanë rezultuar të pabazuara dhe 7 kanë qënë jashtë juridiksionit dhe kompetencës. Janë mbartur 8 ankesa për shqyrtim në vitin 2005.

Problematika e çështjeve që kanë të bëjnë me këtë ministri ka qënë kryesisht lidhur me vendimet e lëvizjes në detyrë, transferime, mosrimbursim të ilaçeve, mosrespektim të procedurave të pranimit në punë, mungesë transparence lidhur me vendimet e marra nga ana e Drejtorisë së Qendrës Spitalore “ Nënë Tereza”, etj.



Nga ankesat e përfunduara përmendim;

1. Shtetësja Sh. B. është ankuar lidhur me procedurat e konkurimit për vendet vakante, në emërimin e mjekëve të përgjithshëm dhe të familjes të zhvilluar nga ana e Autoritetit Shëndetësor Rajonal, Tiranë.

Kështu është bërë prezent çështja e parregullsive të konstatuara gjatë dy konkurseve të zhvilluara nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve të Kujdesit Shëndetsor.

Nga hetimi i çështjes rezultoi se pretendimet e ankueses ishin të bazuara. Konkretisht rezultuan gabime në vlerësimin e konkuresve, gabime të cilat kanë çenuar drejtpërdrejt te drejtat e ankuesve.

Me ndërhyrjen dhe sugjerimet e dhëna nga ana jonë u rivendos në vënd e drejta e shkelur.

2. Shtetasi A.M. është ankuar pasi nuk përfitonte falas medikamentin “Mestion” (Piridostigmine Bronkeri) pasi ky medikament ka ndryshuar origjinën e importit duke ardhur nga Italia.

Problemi qëndronte në futjen në listën e medikamenteve të rimbursuara të prodhimit të ri farmaceutik.

Në përfundim të korespondencës zyrtare me Drejtorinë Farmaceutike pranë Ministrisë së Shëndetësisë, ankuesi u informua se në zëvendësim të medikamentit të mëparshëm, tashmë lista e rimbursimeve parashikon 3 alternativa te tjera ilaçesh që importohen nga Italia, Franca dhe Gjermania. Për këto medikamente të reja që rimbursohen furnizimi ka qënë i rregullt dhe është shpërndarë plotësisht.

3. Shoqata e Farmacistëve të Rrethit Dibër, ka paraqitur shqetësimin se në qytetin e Peshkopisë janë hapur dhe funksionojnë farmaci pa drejtues teknik të diplomuar si farmacist.

Problematika e kësaj ankese është prezantuar dhe në raportin e vitit të kaluar.

Rezulton se pas rekomandimit tonë, Qendra e Kontrollit të Barnave konfirmoi veprimtarinë e saj për përfundimin e procedurës së mbylljes së farmacieve në bashkëpunim me Policinë Tatimore të Rrethit Dibër.

4. Ankesa e shtetases V.D. për ekzekutim të një vendimi gjyqësor që i jep të drejtë ankueses të rivendosë të drejtat e saj, si Drejtoreshë e Autoritetit Rajonal Shëndetësor.

Pas rekomandimit drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë ankuesja është sistemuar në punë.

5. Shtetësja M.K. u ankua për vendimin e padrejtë të pezullimit dhe propozimit për largim nga puna.

Duke e konsideruar ankesën të drejtë, nga ana jonë, ju drejtua një rekomandim Kryetarit të Bordit Drejtues të ARSH-së, rekomandim i cili u

konsiderua dhe u vlerësua nga ana e Bordit. Ankuesja u rikthye sërish në vendin e saj të punës.

Nga ankesat të cilat janë ende në shqyrtim vlen të përmëndim:

1. Ankesën e Konfederatës së Sindikatave të Shqipërisë lidhur me Urdhrin e brëndshëm Nr.179 datë 12.11.2004 të Drejtorit të Qendrës Spitalore, “Për mbylljen e klinikës së sëmundjeve profesionale”, dhe ankesën e Sindikatës Autonome të Shërbimit Shëndetësor të Shqipërisë lidhur me vendimin e Drejtorisë-së Q.S.U.T-së në të cilin janë pezulluar nga puna 105 punonjës, për shkak të reformës në shëndetësi.

Lidhur me këtë proces ankuesit referojnë se i janë drejtuar strukturave drejtuese të Qendrës Spitalore por ende nuk janë informuar lidhur me kriteret e vendosura për zbatimin e kësaj reforme.

2. Ankesën e shtetasit A.Sh. lidhur me konkurimin e zhvilluar nga ana e Qendrës Spitalore “Nënë Tereza” për okulist pranë kësaj qendre.

Gjatë trajtimit të këtyre çështjeve, dhe të tjera që kanë të bëjnë me Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, kemi konstatuar se ka vonesa në kthimin e pergjigjeve, gjë që ka ndikuar drejtpërdrejtë në mospërfundimin në kohë të këtyre ankesave.

## **15. Ministria e Punëve të Jashtme**

Gjatë vitit 2004 për Ministrinë e Punëve të Jashtme, ambasadat dhe konsullatat jashtë vendit janë shqyrtuar gjithsej 13 ankesa, nga të cilat 2 janë çështje të mbartuar nga viti 2003. Nga 13 ankesat 6 çështje janë në shqyrtim, 4 rezultojnë të jenë jashtë kompetencës së Avokatit të Popullit, kurse 3 ankesa janë zgjidhur në favor. Pjesën më të madhe të ankesave që lidhen me këtë Ministri, e përbëjnë ankesat për përfaqësitë e huaja në Shqipëri. Kur kanë qenë jashtë kompetencës apo juridiksionit, qytetarëve ju është treguar rruga që duhej të ndiqnin në secilin rast. Shpesh këto çështje i janë kaluar për kompetencë Drejtorisë Konsullore pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme, me të cilën bashkëpunimi është shumë i mirë.

Nga ankesat e trajtuara nënvizojmë se ndërhyrja Institucionale e Avokatit të Popullit dhe një proces ndërmjetesimi aktiv, ka bërë të mundur realizimin e të drejtës për t’u informuar dhe vënien në rrugën e zgjidhjes të problemeve. Përmendim këtu kërkesën e Kryetarit të Shoqatës Shqiptare të Emigrantëve në Kanada, për nevojën e hapjes së një Konsullatë të Përgjithshme të Shqipërisë në Toronto. Kërkesa kishte më shumë se dhjetë muaj që ishte bërë dhe nga ana e

Ministrisë së Punëve të Jashtme nuk informohej kërkuesi lidhur me qëndrimin e mbajtur për kërkesën e tyre.

Nga ankesat që janë në shqyrtim përmendim:

1. Ankesën e zotit Nafiz Bezhani i cili pretendon zënien në mënyrë arbitrare të një sipërfaqe toke në pronësi të tij pa asnjë kontratë, autorizim, apo marrëveshje me ankuesin duke ju shkelur e drejta e pronësisë, nga ana e Drejtorisë së Shërbimit të Trupit Diplomatik, e cila ka improvizuar një parking.

Ky fakt është bërë prezent strukturave përkatëse të Ministrisë së Punëve të Jashtme. Por rezulton se ende nuk është ndërmarë asnjë veprim për të pushuar cënimin në të drejtën e pronësisë.

Të ndodhur para një situatë mosveprimi nga ana e Drejtorisë së Shërbimit të Trupit Diplomatik, nga ana jonë i është dërguar një rekomandim Ministrisë së Punëve të Jashtme për lirimin e menjëhershëm të truallit të zënë arbitrarisht nga Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomatik. Akoma vazhdon ky veprim arbitrar dhe i pajustificuar që cënon marrëdhëniet tona me administratën publike dhe krijon një imazh negativ në funksionimin e saj.

Praktika të tilla pune cënojnë rëndë tagrat e pronarit të ligjshëm.. Këto veprime, cënojnë të drejtën për të disponuar, poseduar dhe gëzuar pronën dhe janë në kundërshtim me Konventën Europiane të të Drejtave të Njeriut, me paragrafin e parë, të nenit 1, të Protokollit shtesë të saj dhe nenin 41 të Kushtetutës.

Në funksion të realizimit të funksioneve tona kushtetuese e ligjore, veprimtaria jonë nuk është fokusuar vetëm në trajtimin e rasteve konkrete. Veprimtaria jonë, ndërhyrjet dhe konkluzionet e nxjerra kanë qënë pjesë e procesit të raportimit në organizmat e O.K.B.-së .

Tashmë bashkëpunimi me grupin e punës të ngritur pranë kësaj Ministrie, për hartimin e raporteve për zbatimin e Konventave në të cilat vendi ynë ka aderuar ka rezultuar i frytshëm. Përmendim këtu kontributin e dhënë nga Institucioni ynë në mbrojtjen e Raportit Kombëtar për zbatimin e Paktit Ndërkombëtar për të drejtat civile e politike, në muajin tetor 2004 në Komitetin përkatës të O.K.B.-së në Gjenevë.

## **16. Ministria e Transportit dhe Telekomunikacioneve**

### **a) Ankesa për vetë Ministrinë**

Gjatë vitit 2004 ka patur 31 ankesa për Ministrinë e Transportit dhe Telekomunikacioneve dhe organeve në varësi të saj, nga të cilat 8 ankesa janë drejtuar për vetë këtë organ. Nga këto 5 ankesa kanë qenë të pabazuara, 2 ankesa kanë qenë jashtë kompetencës dhe juridiksionit dhe 1 ankesë është zgjidhur në favor të ankuesit.

Ankesa e zgjidhur pozitivisht i përket shtetasit D.M me banim në Tiranë, i cili ishte student i vitit të II në Fakultetin Ekonomik. Ky person në kuadrin e një seminari që zhvillonte Fakulteti, ka kërkuar të njihet dhe të sigurojë dokumentacionin nga Drejtoria e Përgjithshme e Aviacionit Civil, në lidhje me dhënien me konçesion të Aeroportit Ndërkombëtar “Nënë Tereza” Rinas. Ky dokumentacion, sipas pretendimeve të ankuesit, kërkohej për trajtimin e një teme akademike me objekt “Dhënia në konçesion si mjet efektiv i zhvillimit ekonomik”. Gjatë përpjekjeve të këtij studenti për të marrë dhe studjuar një praktikë konkrete konçesionare, Drejtoria e Përgjithshme e Aviacionit Civil, megjithë kërkesën e ankuesit, nuk kishte bërë të mundur dhënien e këtij informacioni të nevojshëm.

Avokati i Popullit, pasi u njoh me këtë ankesë, bazuar në rrethanat konkrete të çështjes, ka përshpejtuar të gjitha procedurat në zbatim të rolit të tij si “kujdestar” i zbatimit korrekt të Ligjit Nr. 8503 dt.30.06.1999 “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentat Zyrtare”.

Duke vlerësuar në tërësi ankesën e studentit, është formuar bindja se praktika konçesionare e kërkuar prej tij nuk përbën atë lloj dokumentacioni, dhënia apo publikimi i të cilit ka pengesa ligjore. Gjithashtu vënia në dispozicion e një kopje të kësaj praktike është një detyrim ligjor në favor të individit sa herë që ai e kërkon këtë. Kjo gjë duhet bërë për të respektuar të drejtën e informimit, parashikuar në nenin 23, pika 2 të Kushtetutës, ku thuhet se:

*“Kushdo ka të drejtë, në përputhje me ligjin, të marrë informacion për veprimtarinë e organeve shtetërore, si dhe të personave që ushtrojnë funksione shtetërore”*

Prandaj, Avokati i Popullit, bazuar në nenin 23/2 të Kushtetutës si dhe në ligjin Nr.8503 dt.30.06.1999 “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentat Zyrtarë” parashitroi një rekomandim pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Aviacionit Civil, ku propozohej të beheshin të gjitha procedurat administrative

për vënien në dispozicion të një kopje të dokumentacionit konçesionar të Aeroportit “Nënë Tereza” Rinas, në favor të studentit D.M. Ky veprim u kërkua të kryhej brenda rregullave të përcaktuara në ligjin e mësipërm dhe konform nevojës së shpejtë të sigurimit të dokumentacionit nga ana e ankuesit. Gjithashtu Avokati i Popullit, ashtu si edhe herë të tjera, shprehu gadishmërine të jepte asistencën e tij për një zbatim sa më korrekt të ligjit Nr.8503 dt.30.06.1999, duke mos e përjashtuar këtë kontribut edhe gjatë përpilimit të një rregullore për të drejtën e informimit ndaj individëve nga ana e Drejtorisë së Pergjithshme të Aviacionit Civil.

Në përgjigjen e paraqitur nga Drejtoria e Pergjithshme e Aviacionit Civil, është konfirmuar dhënia e dokumentacionit të duhur në favor të studentit D.M. dhe është siguruar zbatimi i vazhdueshëm i ligjit Nr.8503 dt.30.06.1999 “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentat Zyrtare” në shërbim të qytetarëve.

Kjo ankesë është një provë për të ilustruar mangësitë që paraqesin organet në varësi të Ministrisë së Transporteve dhe Telekomunikacioneve, në lidhje me njohjen e të drejtave të ligjshme të qytetarëve dhe garantimin e tyre me korrektësi. Ky detyrim që rrjedh nga Kushtetuta apo ligji dhe që shërben për të garantuar interesat e ligjshme të qytetarëve, përbën një element të rëndësishëm edhe gjatë veprimtarive të tjera që përmbush Ministria e Transporteve të Telekomunikacioneve. Konkretisht pranë Zyrës së Avokatit të Popullit, vazhdojnë të paraqiten ankesa për parregullsitë që hasen gjatë fazës së shpronësimit për interes publik të qytetarëve. Këta të fundit shpesh herë nuk arrijnë të kenë informacionin e duhur për njoftimet, paraqitjen e dokumentacionit, shpalljet e vlerësimeve të trojeve apo tokave bujqësore që do të shpronësohen etj. Duke qenë se mjaft individë ndodhen me banim në zona të thella rurale, ku mbërritja e informacionit është e kufizuar, i takon Ministrisë së Transportit dhe Telekomunikacionit që në bashkëpunim me organet vendore të organizojnë punën për njoftime dhe sqarime të sakta tek personat, pronat e të cilëve do të shpronësohen për interes publik. Madje në mjaft raste Avokati i Popullit vëren se përmiresimit të kësaj procedure mund t'i vinte në ndihmë një rol më i madh dhe aktiv i strukturave të administratës së transportit. Kjo vlen për të lehtësuar përpjekjet e qytetarëve, të cilët në shumicën e rasteve kanë barrën të enden për të tërhequr dokumentacionin e nevojshëm në Zyrat e Rregjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe ta paraqesin atë brenda afateve në organet vendore apo në Komisionin e Posaçëm të Shpronësimit pranë Ministrisë së Transporteve dhe Telekomunikacionit. Kjo procedure ka vend të zgjidhet plotësisht nga strukturat e Ministrisë së Transporteve dhe Telekomunikacioneve, të cilat në të ardhmen duhet të kenë një raport më aktiv me qytetarin.

## **b) Ankesa për Telekomin**

Gjatë vitit 2004 pranë nesh janë shqyrtuar 23 ankesa për Drejtorinë e Përgjithshme të Telekom sh.a dhe filialet e tij nëpër rrethe. Nga keto 4 ankesa janë ende në shqyrtim, 9 ankesa kanë qene te pabazuara, 2 kanë rezultuar jashtë juridiksionit dhe kompetencave dhe 8 ankesa janë zgjidhur në favor të ankuesve. Ketu nuk llogaritet peticioni prej 10.000 firmash te qytetarëve që Zyra per Mbrojtjen e Qytetarëve na dergoi per t'u ankuar per rritjen e çmimeve te energjise elektrike dhe telefonisë fikse në fund të vitit 2003. Dihet se në 15 Dhjetor 2003 Albtelekom sha, pas miratimit nga Enti Rregullator i Telekomunikacioneve, vuri në veprim tarifa pagese për telefoninë fikse që ishin deri 6-7 here me te larta. Pati një shqetësim të madh të konsumatorëve dhe zyra jonë ngriti një grup ekspertësh te përbërë nga profesore të Akademisë së Shkencave dhe Universitetit të Tiranës. Grupi i ekspertëve arriti në përfundimin se rritja e bërë ishte tepër e madhe dhe e pa motivuar plotësisht në kushtet e nivelit mesatar të konsumatorit shqiptar. Si rrjedhojë e disa takimeve dhe ballafaqimeve te grupit tonë të ekspertëve me ekspertët e Albtelekom sha dhe ERT-së, si dhe te vetë Avokatit te Popullit me Ministrin e Transportit dhe Telekomunikacioneve, këta të fundit u bindën se tarifat e vëna në veprim ishin tepër të larta. Si rrjedhojë u bë një kompromis që ato tarifa te uleshin rreth 50%. Kjo u zyrtarizua me një vendim të ri te ERT-se qe filloi nga veprimi me 1 Prill 2005. Kjo është një çështje, ku institucioni yne punoi shume me palët dhe zgjidhja pozitive u arrit faktikisht pa qënë nevoja te bëhej ndonjë rekomandim me shkrim , por vetëm me ane të një akt ekspertimi të kryer nga ekspertët e caktuar nga ne.

Disa nga ankesat e tjera të zgjidhura pozitivisht dhe problematikat qe hasen ne këtë ent publik, jane parashtruar si më poshtë:

1. Pranë Institucionit të Avokatit te Popullit shtetasi H.C depozitoi një ankesë ne lidhje me procedurat jo korrekte që ndiqte Albtelekom zona 2 Tiranë për riparimin e difektit të linjës telefonike te tij. Avokati i Popullit, duke parë se vonesa e këtij riparimi ishte bërë shkak i shumë ankesave nga banoret e asaj zone, ka ndërhyre prane strukturave përkatse teknike te Albtelekom zona 2 dhe difekti është arritur të riparohet në një kohe te shpejtë. Në këtë rast vlen te theksohet se nëpunësit qe merreshin me ndreqjen e difekteve në rrjet kanë patur neglizhencë të plotë për të riparuar në kohë linjen dhe kanë reaguar me shpejtësi vetëm pasi është urdhëruar nga strukturat eprore të tyre.

2. Shtetasi S.K kishte bërë kërkesë për transferimin e linjes se telefonit nga një lagje ne një adresë të re. Duke parë se strukturat e Albetelekom po e zvarrisnin realizimin e ketij transferimi, ai është drejtuar me një ankese konkrete pranë Avokatit te Popullit. Pasi është nderhyrë pranë ketij organi për të

shpejtuar transferimin e linjes si nje detyrim ndaj shërbimeve qe ofrohen në kontrate, kërkesa është marrë në konsiderate. Si rrjedhim në zbatim të një projekti te ri te instalimit të linjave telefonike te zonës është përfunduar instalimi i linjes në favor te ankuesit.

3. Prane Avokatit te Popullit, shtetasja E.B. është ankuar se megjithese kishte permbushur të gjitha detyrimet e prapambetura kundrejt Albtelekom sh.a zona 1 Tirane, nuk është bërë faturimi për impulset paraardhese dhe linja vazhdonte te ishte e ndërprerë pa patur një njoftim sqarues. Me qellimin e zbardhjes se pretendimeve së ankueses, Institucioni i Avokatit te Popullit kërkoi nga Albtelekomi të jepeshin shpjegime dhe informacion për zgjidhjen e këtij problemi. Krahas kësaj Avokati i Popullit ngarkoi edhe nje ekspert për të kryer verifikimet dhe ndërhyrjet e nevojshme në vend, konform kompetencave që percakton ligji “Per Avokatin e Popullit”. Ne perfundim me anë te një procedure të përshpejtuar të ndikuar drejtperdrejt nga Avokati i Popullit, u arrit që strktrurat teknike te Albtelekomit te rilidhnin linjen telefonike në favor të ankueses.

4. Në letrën drejtuar Avokatit te Popullit, shtetasja H.B shprehte shqetesimin, ne lidhje me mos plotesimin e kërkesës së saj nga Filiali i Albtelekomit Tirane për tu pajisur me linje telefonike. Kështu ajo shpjegonte se kushtet e saj sociale e bënin të domosdoshem pajisjen me linjë telefonike (pasi jetonte e vetme), por kërkesat e saj të vazhdueshme nuk po gjenin zgjidhje nga ana e Albtelekom Tirane.

Nga ana e Avokatit te Popullit, kjo çështje është parë edhe në kuadrin e ndihmës që duhet tu jepet personave në nevojë, ndaj edhe menjëherë është realizuar nje takim me Drejtorin e filialit, i cili u angazhua seriozisht për ta zgjidhur këtë problem. Mbas verifikimeve përkatëse rezultoi se problemi ishte zgjidhur pozitivisht.

Si konkluzion përfundimtar është konstatuar që ky Ent publik, edhe pse ka rritur ndjeshëm tarifat e tij, shërbimi që ofron le shumë për të dëshiruar. Për shembull ende nga ana e Albtelekom sh.a nuk pajisen abonentët me faturat analitike për të patur kështu më shumë transparencë dhe për të plotësuar një nga të drejtat më elementare të konsumatorit atë të informacionit të detajuar për telefonatat e kryera, kohëzgjatjen e tyre si dhe vlerën përkatëse. Për më tepër kjo duhet bërë sepse Albtelekom, ndryshe nga KESH dhe Ujësjiellës aparaturat e matjes i ka në administrim pranë Entit të tij dhe jo pranë apo nën kontroll të abonentëve.

Kjo bën të mundur edhe shmangjen e abuzimeve në dëm të konsumatorëve për të cilat ka mjaft ankesa. Gjithashtu shërbimet e instalimeve, transferimeve apo rilidhjeve te linjave telefonike vazhdojne te jene nje proces

teper i veshtire per tu realizuar shpejt nga strukturat teknike te Albtelekom dhe shpesh eshte aluduar per fenomene korruptive per te bere shpejtimin e tyre.

Si arritje për bashkëpunimin e Institucionit me Albtelekom sh.a ishte hartimi dhe futja në fuqi e kontratës së re që ju ofrua konsumatorit shqiptar të telefonisë fikse. Kjo kontratë mund të cilësohet një kontratë bashkëkohore ku sanksionohen qartë ne barazi të drejtat dhe detyrimet e te dy paleve. Por nje sfide e re qe ka lindur eshte venia ne zbatim e saj. Ne kete kuader, Avokati i Popullit do te vazhdoje te ndikoje qe sherbimet qe ofron Albtelekomi te jene konform standarteve dhe kushteve te parashikuar ne legjislacionin dhe kontratat përkatëse.

Ngelen problem tarifat e larta të telefonisë celulare që zbatohen nga AMC dhe Vodafone. Enti Rregullator i Telekomunikacioneve vazhdon te merret me probleme të tjera të vogla të operatorëve rurale, duke lënë pas dore metodologjine e hartimit të tarifave të telefonisë celulare që do detyrojnë keto dy kompani të ulin çmimet.

## **17. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve**

Për Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve për vitin 2004 kanë ardhur gjithsej 4 ankesa, kurse 6 ankesa i përkasin vitit 2003. Janë të përfunduara 7 ankesa, 3 janë zgjidhur në favor, 2 të pabazuara 2 kanë qënë jashtë juridiksionit. Ka mbetur në shqyrtim për vitin 2005 3 ankesa.

Problematika e ankesave që kanë patur të bëjnë me këtë Ministri ka qënë në lidhje me mosekzekutimin e vendimeve të gjykatës, shkelje të së drejtës së informimit, apo për largime nga puna.

Përsa i përket çështjeve të trajtuara mund të përmendim, se në 3 ankesat të cilat janë zgjidhur pozitivisht konstatohet se individët nuk informohen në lidhje me përmbajtjen e vendimit të largimit nga puna nga autoritetet përkatëse dhe nuk pajisen me kopje të këtyre vendimeve; nuk informohen lidhur me arsyet e marrjes së vendimeve apo mosdhënie informacioni rreth ecurisë së procedurave konkrete, të cilat çënojnë drejtpërdrejt të drejtat e tyre duke shkelur dispozitat e Ligjit Nr.8503 datë 30.06.1999 “Për të drejtën e informimit për dokumentat zyrtare”.

Nga ankesat e trajtuara vlen të përmendim:

1. Ankesën e 24 punonjësve të “Alba Film Studios” të cilëve u janë ndërprere pagat dhe ndërkohë nuk u paguhen sigurimet shoqërore, ankesë e cila është prezantuar dhe vitin e kaluar.



Në përfundim të hetimit të kësaj çështjeje u konkludua në nxjerrjen e një rekomandimi drejtuar Ministrit të Kulturës Rinisë dhe Sporteve për inicimin e kërkesës për çelje fondesh për mbulimin e pagave, sigurimeve shoqërore, e shpenzimeve të tjera për shoqërinë “Alba film Studio”. Për fat të keq akoma nuk kemi përgjigje zyrtare për këtë rekomandim.

Nga ankesat që janë në shqyrtim përmendim: ankesën e një grupi banorësh të fshatit Borovë të Rrethit Kolonjë, të cilët ngrenë shqetësimin për restaurimin e memorialit të ngritur në fshatin e tyre në përkujtim të viktimave të masakrës të ushtrisë gjermane në 6 korrik të vitit 1943. Ata pretendojnë se edhe pse këtë shqetësim e kanë bërë gjithmonë prezent në Organet e Pushtetit Vendor dhe në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve duke kërkuar fonde për riparimin e këtij monumenti, asnjë përgjigje dhe rezultat konkret nuk ka patur.

## **18. Ministria e Mjedisit**

Gjatë vitit 2004 kemi patur vetëm 4 ankesa të drejtuara ndaj Ministrisë së Mjedisit dhe kryesisht me problematikën e ndotjes së mjedisit. Njëra ka rezultuar jashtë juridiksionit të Zyrës sonë, 2 jashtë kompetence ndërsa ankesa tjetër është në fazën e shqyrtimit. Ndonëse numri nuk është i konsiderueshëm, objekti i ankesave tregon se publiku shqiptar po ndërjegjësohet për nevojën e një ambjenti të shëndetshëm dhe për menaxhimin më të mirë të tij.

Duke qenë se janë vetëm 4 ankesa po i përmendim shkurtimisht së bashku me problematikën në vazhdimësi;

1- Ankuesja P.G. u ankua se pranë pallatit të saj në vijë ajrore 3 metra ishte ndërtuar një qendër rritje dhe mbarështrimi shpendësh dhe thundrakësh. Kjo qendër me ndotjen e madhe që paraqiste për zonën përreth kishte shkaktuar formimin e një mjedisi të papërshtatshëm jetese dhe banimi.

Institucioni i Avokatit të Popullit e sqaroi ankuesen se në bazë të nenit 60 të Ligjit Nr.8934, datë 5. 9.2002 “Për Mbrojtjen e Mjedisit” kontrolli për gjendjen e mjedisit është detyrë e Inspektoratit të Mjedisit, e punonjësve të caktuar nga Ministri i Mjedisit dhe e agjencive rajonale të mjedisit. Detyra e Inspektorëve, krahas të tjerës, është të evidentojnë dhe të marrin masa parandaluese për ndotjen e mjedisit, duke bashkërenduar veprimet e tyre në raste të caktuara me strukturat e Policisë së Shtetit dhe Policisë Ndërtimore.

Keshtu që qytetarja u orientua t’i drejtohet Inspektoratit të Mjedisit, si organ i specializuar kontrolli për mjedisin, i cili gëzon kompetenca të gjëra veprimi në terren.

**2-** Kryetari i Komunes Helmas, Kavajë u ankua se prej disa vitesh hedhja e mbeturinave të qytetit të Kavajës bëhej në vendin e quajtur “Xhixha” të Komunës Helmas, që është një burim i madh infeksionesh e ndotjesh të ambientit si dhe rrezik për shëndetin e banorëve të rreth 5 fshatrave përfaqë.

Nga verifikimi rezultoi se nga takimet dypalëshe ndërmjet Bashkisë dhe Komunës, që janë organizuar nga Ministrinë e ndryshme është vendosur se deri në ndertimin e impiantit të perpunimit të mbeturinave të ngurta urbane të qyteteve Tirane, Durrës, Kavajë, Bashkia Kavajë duhet të marrë masa për funksionimin normal të sheshit ekzistues.

Nga kjo bashki si administratore e drejtpërdrejtë e venddepozitimit të mbetjeve urbane, u pranua se problemi qëndronte, por se nuk ka fonde të mjaftueshme për një zgjidhje përfundimtare të vendit të hedhjes së mbetjeve urbane.

Pavaresisht se nga zyra jonë u kërkuan një sërë shpjegimesh dhe informacionesh dhe iu bë e qarte Bashkisë Kavajë detyra e saj për rregullimin e kësaj gjendje, pikërisht për argumentin e paraqitur nga kjo bashki për mungesën e fondeve, çështja u konsiderua e mbyllur.

**3-** Një përfaqësues i banorëve të Bashkisë Kamëz ngriti shqetësimin për sa i përket shoqërisë “SIAP”, e cila nëpërmjet veprimtarisë së saj, kishte ndotur ambientin mjedisor, duke prishur qetësinë e banorëve përreth si dhe duke ndikuar në shëndetin e njerëzve.

Zyra jonë i kërkoi informacione Inspektoriatit të Mjedisit pranë Ministrisë së Mjedisit për situatën në fjalë.

Kjo ministri u vu në lëvizje duke kërkuar verifikimin e gjendjes nga disa organe kompetente të çështjes. Pas një kontrolli të ushtruar nga Inspektoriatit i Mjedisit, me konstatimin e kundravajtjes administrative për personin juridik “SIAP” ishte vendosur sanksioni administrativ i dënimit me gjobë në vlerën përkatëse, shumë të cilën e kishte likuiduar.

Ankuesi u informua për sa më lart dhe iu bë e ditur se nga kjo ministri ishin kryer të gjitha veprimet ligjore për çështjen në fjalë.

**4-** Shoqata Shqiptaro- Kanadeze dhe Shoqata Rinia Shqiptare Kanadeze, të dyja me seli në Toronto u ankuan për projektin lidhur me ngritjen e një impianti për përpunimin e plehrave në Shqipëri.

Zyra jonë i kërkoi shpjegime Ministrisë së Ndërtimit dhe Turizmit dhe Ministrisë së Mjedisit.

Akoma nuk kemi asnjë përgjigje zyrtare nga këto organe.

## **19. Ministria e Industrisë dhe Energjistikës**

### **a) Ankesa për vetë Ministrinë.**

Ankesa të vitit 2004 që kanë lidhje direkte me objektin e punës së kësaj Ministrie rezultojnë gjithsej 16 ankesa, nga të cilat 5 prej tyre kanë rezultuar jashtë juridiksionit, 1 e zgjidhur në favor, 5 ankesa të pabazuar, ndërsa 5 ankesa janë në proces shqyrtimi.

Ankesa e zgjidhur pozitivisht me ndërhyrjen e Avokatit të Popullit ishte paraqitur nga shtetasi Y.A. (në emër të 13 punonjësve) të Policisë Elektrike Tiranë gjate vitit 2003, ku shprehej shqetësimi për disa veprime antiligjore të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë Elektrike, që është në varësi të Ministrisë së Industrisë dhe Energjistikës. Këta ankues pretendojnë se janë larguar nga puna në mënyrë të paligjëshme, për arsye se kanë ngritur probleme të abuzimeve dhe korrupsionit.

Largimi i tyre i padrejtë nga puna është shqyrtuar dhe gjyqësisht. Në vendimet përkatëse gjyqësore theksohet se largimet e menjëhershme të këtyre punonjësve nga puna, janë bërë pa u marrë më përpara masa disiplinore dhe se nuk ka pasur vërejtje për punën e tyre. Por këto vendime Gjyqësore nuk janë zbatuar nga Drejtoria e Policisë Elektrike, Tiranë. Ndaj nisur nga fakti se lufta kundër korrupsionit është detyrë parësore për të gjitha organet dhe institucionet e administratës sonë publike, i kemi rekomanduar Ministrit të Industrisë dhe Energjistikës verifikimin e akuzave për korrupsion që ankuesit kanë paraqitur ndaj Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë Elektrike.

Ne lidhje me këtë rekomandim nga ana e Ministrit të Industrisë dhe Energjistikës është konfirmuar se pas ngritjes së nje grupi kontrolli dhe verifikimit të të dhënave të servitura nga Avokati i Popullit, janë konstatuar parregullsi dhe abuzime në detyrë të kryera nga Drejtori i Policisë Elektrike të Tiranës dhe nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë Elektrike. Në këto kushte këta funksionarë janë liruar nga detyra me urdhër të Ministrit të Industrisë dhe Energjistikës. Krahas këtyre masave administrative, Kontrolli i Lartë i Shtetit po vazhdon punën për të evidentuar shkeljet financiare të kryera nga këta nëpunës me qellim dokumentimin dhe nxjerrjen e përgjegjësive penale dhe administrative të mëtejshme.

Me perfundimin pozitiv të kësaj ankese, Avokati i Popullit vlereson si të nevojshme në të ardhmen një vëmendje të vazhdueshme të Ministrisë së Industrisë dhe Energjistikës lidhur me fenomenet e korrupsionit, abuzimit me detyrën dhe anomali të tjera që krijohen gjate ushtrimit të detyrës së funksionarëve të saj.

Krahas detyrave të tjera, Ministrisë së Industrisë dhe Energjitikës, i mbetet një përgjegjesi e madhe për mirëadministrimin dhe funksionimin normal të organeve në varësi të saj. Në këtë kuadër, forcimi i rregullit, mbështetja e iniciativave të reja në mbrojtje të të drejtave të individit, eliminimi i praktikave të paligjshme duhet të jenë prioritete të qëndrueshme të këtij dikasteri.

Në mjaft raste është e papranueshme qëndrimi pasiv i Ministrisë së Industrisë dhe Energjitikës kur i është kërkuar ndihmë në lidhje me furnizimin me energji elektrike të disa zonave urbane dhe ndërrurbane. Rast për tu përmendur është lagja “Bregalumas” Laprakë Tiranë ku megjithëse është instaluar linja 20Kë gjatë vitit 2003 shumica e banorëve të saj edhe sot nuk furnizohen me energji elektrike apo nuk ju është lidhur një kontratë e rregullt furnizimi. Kjo çështje i është bërë e njohur disa herë Ministrisë së Industrisë dhe Energjitikës. Por veprimet dhe mbështetja që ajo po jep për eliminimin e një problemi kaq të mprehtë të komunitetit nuk ka të dhëna që të tregojnë për zgjidhje të tij.

Avokati i Popullit ka konstatuar në mjaft raste se nxjerrja e përgjegjësive administrative dhe ndëshikimi i nëpunësve të strukturave në varësi të ministrive ka sjelle përmirësim të punës dhe të shërbimeve publike që i ofrohen komunitetit. Rast për tu përmendur është ndëshikimi me masa administrative të drejtuesve të lartë të Policisë Elektrike. Por këto veprime duhet të çohen përpara dhe të vihen më shumë në qendër të vëmendjes strukturat e KESH-sha. Nga problematika e vënë në vëmendje të kësaj ministrie nga Avokati i Popullit është pritur që mjaft gjëra të shikohen me syrin kritik për këtë korporatë dhe të merren masa konkrete. Gjithsesi çdo përpjekje në të ardhmen e Ministrisë së Industrisë dhe Energjitikës për të përmirësuar imazhin dhe standartet e shërbimeve që i ofrohen individëve nga organet në varësi të saj, do të jetë një hap pozitiv që do të gjejë mbështetjen dhe inkurajimin e Avokatit të Popullit.

#### **b) Ankesat për Korporatën Elektroenergjitike (KESH) Sh.A.**

Gjatë vitit 2004 Avokati i Popullit ka trajtuar 47 ankesa dhe kërkesa kundër KESH-it, nga të cilat 10 kanë qenë të mbartura nga viti 2003 dhe 37 janë bërë prezente gjatë vitit 2004. Ankesat e mbartura nga viti 2003 janë përfunduar plotësisht, ndërsa nga 37 ankesat e paraqitura gjatë vitit 2004, 2 janë zgjidhur pozitivisht, 15 prej tyre mbas verifikimit kanë rezultuar të pabazuara, 4 kanë qenë janë juridiksionit dhe kompetencave, 16 ankesa vazhdojnë të jenë ende në shqyrtim.

Konkretisht mjaft shtetas ankohen se megjithëse kanë paguar rregullisht faturat e energjisë elektrike, ata nuk marrin energji elektrike për shkak se

ndërpritet energjia që në kabinat apo fidrat përkatës të zonave apo lagjeve për arsyen se disa nga fqinjët e tyre nuk paguajnë energjinë e konsumuar.

Institucioni i Avokatit të Popullit ka vazhduar të këmbëngule pranë Kesh-it se askush nuk mund të ndëshkohet për shkak se fqinjët e tij nuk kanë zbatuar kontratën apo shkelin ligjet. Në çdo rast ky problem duhet të zgjidhet duke i shkëputur energjinë elektrike individit që nuk paguan dhe në asnjë rast klientit të rregullt. Zbatimi i ligjit nuk sigurohet me arbitraritete, por veçse me kërkesë për zbatim të ligjit nga çdo individ që shkel ligjet. Në vitin 2002 me rekomandimin tonë Kesh-i ndryshoi pikat 1 dhe 6 të Urdhrit të tij nr.32, dt.2.02.2001 i cili legjitimonte dënimet kolektive. Por faktikisht ky urdhër vepron verbalisht përderisa vazhdojnë ankesat me këtë objekt. Gjithashtu janë paraqitur ankesa të shumta në lidhje me faturat afrofe që perlllogariten nga Kesh sh.a për konsumatorët. Krahas faturimeve të larta që janë bërë ndaj familjeve të varfëra që nuk disponojnë pajisje të konsumit të lartë të energjisë, këtë vit është konstatuar edhe faturimi afrofe ndaj konsumatoreve që kanë matësa të rregullt të instaluar në bokset përkatës. Ky fenomen kryhet nga faturistet, pasi se pari ato neglizhojnë të punojnë me korrektesë dhe së dyti shfrytëzojnë këtë element procedural të faturimit për të kërkuar rryshfete nga konsumatorët. Avokati i Popullit po punon për të çuar deri në fund dokumentimin e veprimtarisë së disa prej tyre, të cilët me tej do të perballen me ligjin dhe organet kompetente. Kjo punë po kryhet individualisht nga ana jone si organ, pavarësisht çfare bëjnë strukturat përgjegjëse të KESH-sha, të njoftuara për parregullsi të faturimit. Në qoftë se nuk veprojnë për verifikimin e tyre, i lënë rrugë të lire abuzimit në vazhdimësi. Në lidhje me këtë vazhdon të mbetet një problem i madh zbatimi i detyrimit ligjor për t`ju përgjigjur në kohë Avokatit të Popullit për informacionet që ai kërkon. Në mjaft raste janë vërejtur vonesa të mëdha në kthimin e përgjigjeve zyrtare nga ana e strukturave të Kesh sha. Këto vonesa janë mosnjohje e detyrimeve ligjore nga administrata e Korporatës.

Megjithatë KESH sh.a kishte marrë angazhim se brenda vitit 2004 me ndihmën edhe të një granti të akorduar nga Banka Botërore do të pajiste të gjithë konsumatorët shqiptarë me matësa duke filluar kjo me përparësi në zonat si Shkodra, Vlora, Kukësi etj, në zyrën e Avokatit të Popullit vazhdojnë të paraqiten ankesa nga zona të ndryshme veriore ( siç është rasti i disa komunave në zonën e Dibrës dhe Malësisë së Madhe) të cilët kërkojnë instalimin e menjëhershëm të matesave për të eliminuar faturimin aforfe. Kjo vertetohet se angazhimi i KESH-sha për të kryer në kohë instalimin e matesave në të gjitha zonat që nuk i disponojnë nuk është realizuar në kohë. Ky konstatim bazohet nga "Informacioni mbi investimet në sistemin matës për vitin 2004" të paraqitur nga Drejtori i Përgjithshëm i KESH-sha Z.Andis Harasani, ku midis të tjerash, krahas angazhimeve për vitin 2005 jepen konkluzionet për vitin 2004 si me

poshtë vijon:

“Si konkluzion për gjithë vitin 2004 janë sistemuar 254.529 abonente familjar. Kjo përbën 92.71% të sasise së matësive që duhen në rang republike që ky proces të stabilizohet (sasia totale e planifikuar është 274.529 abonente). Instalimi i matësive sipas KESH-sha në përgjithësi është realizuar sipas planifikimit dhe mbyllur brenda vitit për pjesën kryesore të kredive me përjashtim të Cooperazione Italiana, kredi e cila është në vazhdim në vitin 2005 për 20.000 abonente. Arsytet e mos instalimit në kohë të matësive sipas KESH-sha ka qenë ardhja e tyre me vonesë (jashtë kohës së planifikuar nga kontrata). Gjithsesi KESH-sha ka marrë angazhimin që gjatë vitit 2005 do të montohen 20.000 cope matësia nga kredia Italiane dhe 30.000 matësia që nevojiten për abonentet që lindin nga lidhjet e reja të vitit, të cilët do të sistemohen me fondet e KESH-sha”.

Me qëllim rritjen e cilësisë së shërbimeve në mbrojtje të interesave të ligjshme të qytetarëve, Avokati i Popullit do të vazhdojë të monitorojë ecurinë e procesit të instalimit të matësive, si një detyrë e domosdoshme për ti thënë “Ndal” abuzimit me faturimin aforfe.

Në vazhdim të konstatimeve tona, mund të përmendim faktin se strukturat e KESH-sha në mjaft raste kanë zvarritur kërkesat për të ndrequr brenda një afati të arsyeshëm matësat e prishur të konsumatoreve, duke shkelur kështu kontratat e reja që e garantojnë një shërbim të tillë. Njëkohësisht Institucioni i Avokatit të Popullit ka kërkuar që qytetarët të plotësojnë detyrimet për pagesën e energjisë elektrike dhe si detyrë kryesore ka qenë zbatimi me korrektësi dhe paanshmeri i kontratës së re tip nga të dy palët, nga konsumatorët dhe nga Kesh sh.a.

Kesh sh.a që nga fillimi i vitit 2004 po punon me tarifa të reja për konsumatorin shqiptar. Për këtë arsye, Zyra për Mbrojtjen e Qytetarëve (organizatë jo fitimprurëse) na përcolli për shqyrtim ankesat e 10.000 qytetarëve shqiptarë kundër rritjes së tarifave të pagesës së energjisë elektrike. Për këtë rast nga ana e Institucionit tone u ngrit një grup ekspertësh me përfaqësues të Akademisë së Shkencave dhe Universitetit Politeknik të Tiranës për të bërë mundur një opionencë sa më efektive për rritjen e këtyre tarifave. Në përfundim Avokati i Popullit bazuar në raportin përfundimtar të grupit të eksperteve ka kërkuar me anë të një rekomandimi rishikimit dhe uljen e tarifave të energjisë elektrike të miratuara me anë të Vendimit Nr.22 dt.30.12.2003 të Entit Rregullator të Energjisë. Ky rekomandim përveç organit të mësipërm ju përcoll për dijeni edhe Kryetarit të Kuvendit Z.Servet Pellumbi dhe Kryeministrit Z.Fatos Nano.

Në mendojmë se ERE-ja duhet të zbatonte nenin 29 të Ligjit Nr.9072 dt.22.05.2003 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”. Duke patur parasysh se

KESH sh.a. ka akoma konsumatorë pa matësa elektrikë, të cilat pretendoi se do t'i vendosë përfundimisht deri në fund të vitit 2004, se shërbimi në cilësi (voltazh më i ulët ose më i lartë se 220 ëolt), dhe në sasi (ka ndërprerje për mungesë energjie me orë të tëra) lë shumë për të dëshiuar, të mos bënte rritje çmimesh të mëdha, por t'i vinte detyrë Kesh-it që më parë të plotësonte detyrimet e mësipërme para konsumatorëve.

Megjithë paraqitjen në kohë të këtij rekomandimi, gjatë vitit 2004 KESH-sha dhe ERT-ja kanë vazhduar të lënë në fuqi dhe aplikojnë tarifën e reja të energjisë, duke e nënvlerësuar jo vetëm qëndrimin e Avokatit të Popullit, por edhe mendimin e ekspertëve teknikë, të cilët përfaqësojnë grupin më të mirë të shkencetarëve, akademikëve dhe intelektualëve në fushën e energjitikës në vend. Madje për ironi të kësaj përpjekje tepër serioze dhe ligjore, KESH sha i propozoi gjatë vitit 2004 Entit Rregullator të Energjisë një tjetër rritje të tarifave të energjisë për vitin 2005. Edhe në këtë rast qëndrimi i Avokatit të Popullit ka qenë kundërshtues dhe do të jetë i tillë për aq kohë sa çënohen hapur të drejtat ekonomike dhe interesat e ligjshme të konsumatorit shqiptar.

## **20. Ankesat për Shërbimet Sekrete**

Gjatë vitit 2004 pranë Institucionit të Avokatit të Popullit kanë ardhur 12 ankesa, kundër veprimeve apo mosveprimeve të organeve të Shërbimit Informativ Shtetëror, Shërbimit Informativ Ushtarak dhe Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm të Ministrisë së Rendit Publik. Për shkak të natyrës së këtyre shërbimeve, ankesat dhe kërkesat ndaj tyre janë parë me përparësi dhe kujdes të posaçëm, duke i verifikuar në mënyrë të hollësishme. Si rrjedhojë, pas shqyrtimit dhe verifikimit të tyre, ka rezultuar se 5 ankesa kanë qenë të pabazuara, 4 ankesa të drejta janë në shqyrtim gjyqësor, 2 ankesa janë nxjerrë jashtë juridiksionit dhe 1 ankesë është në shqyrtim.

Po përmendim disa ankesa:

1. Shtetasit M.SH. dhe M.S. janë ankuar për largim të padrejtë nga detyra si oficerë të Shërbimit Informativ Ushtarak, me rastin e ngjarjes së Bishtit të Pallës. Nga verifikimi i zyrës sonë, bazuar në fakte dhe dokumente, u arrit në konkluzionin se dy ankuesit nuk kishin përgjegjësi për këtë ngjarje dhe nuk duhej të shkarkoheshin nga detyra. Nga ana jonë ju dërgua rekomandim Ministrisë së Mbrojtjes, për kthimin e tyre në punë, por u refuzua nga kjo Ministri. Çështja po shqyrtohet në rrugë gjyqësore.

2. Shtetasi F.O. është ankuar se largimi i tij nga puna në Shërbimin Informativ Shtetëror ka qenë i padrejtë. Këtij ankuesi brenda 17 ditëve i janë

dhënë dy masa disiplinore për të njëjtën shkelje dhe nuk është vënë në dijeni për masën e dhënë më parë. Nga analiza e urdhërave ku ishin pasqyruar masat e dhëna ndaj ankuesit, vërehet se në formulimin e tyre kishte përzierje, ku përfshiheshin 6 masa disiplinore.

Nga verifikimi i zyrës tonë, doli se kjo masë i është dhënë ankuesit për të shfajësuar drejtuesit e tij, të cilët kanë prodhuar dokumente sekrete në kundërshtim me aktet normative të veprimtarisë së këtij shërbimi. Kjo ankesë është në ndjekje.

3. Shtetasi R.S. është ankuar se e kanë larguar padrejtësisht nga detyra. Nga verifikimi i bërë nga zyra jonë rezultoi se ndaj këtij drejtuesi kryesor të Shërbimit Informativ Shtetëror të një Qarku nuk ishte marrë asnjë masë disiplinore më parë, por menjëherë pas një analize i jepet motivacioni “i papërshtatshëm për të punuar ne SHISH”. Kjo masë nuk parashikohet në Rregulloren e Shërbimit. Çështja është në gjykim.

5. Shtetasi F.Y. është ankuar për moszbatim të një vendimi gjyqësor, që e detyronte Shërbimin Informativ Shtetëror t’i paguante atij pagën e 1 viti. Me ndërhyrjen tonë pranë këtij shërbimi u pranua shkelja për zbatimin e këtij vendimi gjyqësor. Por ka kaluar një kohë e gjatë dhe akoma ky vendim nuk është zbatuar.

5. Shtetasi I.G. në ankesën e tij ka kërkuar të dijë për një masë që i është dhënë kur ka qenë në Degën e Sigurimit të Ushtrisë. Nga ana jonë janë bërë verifikime për të gjetur dosjen e tij. Ajo ndodhet në Kartotekën e Drejtorisë së Organizim – Kompletimit pranë Ministrisë së Mbrojtjes, sipas njoftimit dërguar zyres tonë nga Shërbimi Informativ Ushtarak, që bëri verifikimin përkatës. Por në mënyrë të papërgjegjshme Drejtoria e Organizim - Kompletimit e Ministrisë së Mbrojtjes, përgjigjet me shkrim se kjo dosje mund të jetë transferuar në Ministrinë e Rendit Publik. Nga ana jonë ishin bërë të gjitha verifikimet më parë dhe kjo dosje nuk ndodhej në Ministrinë e Rendit Publik.

Këto veprime administrative jo ligjore, çënojnë liritë dhe të drejtat themelore të njeriut për t’u informuar dhe për të ditur se si ishte trajtuar problemi i ankuesit, me rëndësi për karrierën e tij personale.

Kemi patur vërejtje ndaj Shërbimit Informativ Shtetëror, për zbatimin e rregullores për masat që merren ndaj punonjësve të këtij shërbimi, sepse disa herë masat e dhëna disiplinore apo largimet nga puna, nuk përputhen me përkufizimin që ka Rregullorja aktuale për masat disiplinore. Po kështu nga zyra jonë është bërë vërejtje, që të gjithë ankuesve që u jepen masa disiplinore apo largohen nga puna t’u jepet urdhëri përkatës me shkrim. Kjo për arsye se në këtë Shërbim vazhdon akoma mosdhënia e këtij dokumenti, gjë që çënon të drejtën e ankuesit për të ndjekur problemin në mënyrë ligjore.



## **21. Konkluzione që dalin nga ankesat për punën e administratës publike shqiptare**

Pa pretenduar se konstatimet dhe konkluzionet që kemi nxjerrë gjatë raportit të punës për vitin 2004 për ankesat dhe kërkesat e shqyrtuara për çdo ministri më vete dhe këto që do evidentojmë më poshtë janë përfundimtare dhe të pakritikueshme, mendojmë të theksojmë se:

Në veprimtarinë e Administratës Publike Shqiptare ka mjaft raste të shkeljeve të të drejtave të njeriut. Këto shkelje paraqiten si shkelje të afateve të përcaktuara për zgjidhjen në rrugë administrative të çështjeve në fusha të caktuara; ka mosvlerësim, mosshqyrtim dhe mospërgjigje ndaj ankesave të qytetarëve, refuzim për pranimin e kërkesave, ankesave e aplikimeve të tyre, mohim të së drejtës për të marrë pjesë në procedurat administrative. Të gjitha këto janë mohim të së drejtës për t'u mbrojtur apo për të marrë informacion apo për t'u njohur me dokumentet zyrtare.

Dihet se një pjesë e madhe e shërbimeve të Administratës Publike bëhet kundrejt pagesës së qytetarëve dhe shpesh këto tarifa janë jo të vogla në raport me pagat dhe nivelin e jetesës në Shqipëri. Ndonëse ka mjaft përmirësime në krahasim me dy apo më tepër vite më parë, akoma ka rradhë dhe humbje kohe për të kryer shërbimet për të cilin vetë administrata është e interesuar që klientët t'i kryejnë këto shërbime publike ose pagesa si p.sh. në zyrat e rregjistrimit të pasurive të paluajtshme, pagesat për KESH, Telekom etj. Evitimi i rradhëve të pritjeve apo cfilitjeve të qytetarëve bën që qytetarët t'a ndjejnë veten të respektuar, kursen kohën e tyre të çmuar, etj. Por mbi të gjitha do të evitonin edhe shfaqjet e korrupsionit "të vogël" që jo rrallë herë shoqëron këto situata. Duhet t'a themi se shpesh kemi vënë re qëndrime të drejta dhe nivel të pranueshëm të vet korigjimit të shkeljeve, sidomos nga Administrata Publike e nivelit të lartë në ministritë, në drejtoritë qendrore, apo prefektura. Por kjo nuk ka ndodhur gjithmonë me bashkitë dhe sidomos me komunat apo autoritetet publike të nivelit të ulët, sidomos me degët e Policisë Ndërtimore në rrethe.

Përballë sfidave që ka përpara vetes, përveç përmirësimit të efektivitetit dhe kompletimit të sistemit të ri ligjor e administrativ brenda procesit të integritit me Europën e Bashkuar, mendojmë se detyrat kryesore për të gjithë Administratën tonë Publike janë:

1- Të rritet kontrolli në të gjitha fushat e veprimtarisë konkrete të hallkave të administratës. Të mos kontrollohet vetëm aspekti financiar, siç ndodh shpesh, por vetë veprimtaria dhe funksioni përshkrues i punës së çdo nëpunësi. Për këtë duhet forcuar si kontrolli i brendshëm, ashtu edhe ai i

jashtëm mbi administratën. Mund të krijohen të reja dhe atje ku ekzistojnë, duhen forcuar hallkat kontrolluese. Roli i Kontrollit të Lartë të Shtetit është i pazëvendësueshëm, veçse rekomandimet e tij duhen zbatuar pa hezitim.

2- Duhet të zbatohen pa hezitim dispozitat e Ligjit “Për Kodin e Proedurave Administrative” dhe të Ligjit “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”, në të gjitha fushat dhe nivelet e Administratës Publike. Ndaj, çdo zyrtari apo nëpunësi civil që me dashje apo pakujdesi shkel këto ligje, në të ardhmen duhen zbatuar masa disiplinore në vartësi të shkallës së përgjegjësisë. Këto ligje kanë mbi 5 vjet që kanë hyrë në fuqi dhe askush nuk mund të shfajësohet me pakujdesi apo paditurinë e tyre.

3- Ligji “Për statusin e nëpunësit civil” duhet të zbatohet për çdo vend pune të Administratës Publike. Kudo duhet të ketë një përshkrim të saktë të të drejtave dhe detyrave që ka personi që punon në çdo vend pune (job description).

4- Të koordinohen më mirë punët brenda ministrive, midis ministrive me njëra-tjetrën e në veçanti marrëdhëniet e reja të decentralizimit dhe autonomisë me pushtetin vendor duhet të pranohen e saktësohen në praktika pozitivisht.

5- Forcimi i punës së drejtorive apo sektorëve juridikë në dikastere dhe respektimi i sugjerimeve të tyre nga titullarët, si dhe plotësimi me juristë i organeve më të ulta, veçanërisht në pushtetin vendor. Kjo ka ndikuar në nivelin e vendimeve të këtyre organeve, përfshirë këtu edhe raste të marrjes së vendimeve të kundërligjshme apo të parregullta, sepse në mjaft komuna, por edhe nëpër bashki nuk ka juristë, apo janë juristë që kanë diploma, por janë të paaftë.

6- Administrata Publike e të gjitha niveleve duhet ta bëjë normë të punës që të njohë nivelin e saj qeverisë. Kjo realizohet duke organizuar herë pas here sondazhe në publik për punën dhe zyrtarët e saj, por duhet edhe të zhvillojë më tepër veprimtari propagandistike për veprimtaritë e saj dhe për çfarë shërbimesh ajo i ofron publikut.

7- Njohja dhe zbatimi i Kodit Etik të Administratës Publike të miratuar me Ligjin Nr.9131 datë 08.09.2003 nga të gjithë funksionarët dhe nëpunësit publikë gjatë kryerjes së detyrave të tyre, bashkë me ligjin “Për konfliktin e interesave” që besojmë se do miratohet këtë vit, do të luajnë një rol të rëndësishëm në përmirësimin e punës së Administratës Publike Shqiptare.

Ne nuk mund të pretendojmë se kjo është një listë e plotë me rekomandime, të cilat do t’ a bëjnë punën e Administratës Shqiptare më të mirë ose do të përmirësojnë rrënjësisht menjëherë cilësinë e saj. Qëllimi ynë është modest: mbi bazën e trajtimit të ankesave të paraqitura pranë nesh lidhur me punën e administratës, të japim shkurtimisht vëzhgimet dhe gjetjet tona, pra disa rekomandime që të vlejné.

Ne e dijmë se Kuvendi është institucion politik, prandaj jemi modestë dhe për të qenë të ekuilibruar, duhet të themi se duke patur parasysh rastet e ankesave dhe kërkesave që kanë ardhur në Institucionin tonë dhe veprimtarinë e Administratës Publike Shqiptare, nuk është e mundur që të japësh një gjykim të prerë pozitiv, pa patur kontestime të bazuara për të kundërtën e këtij gjykimi.

Ne kemi thënë dhe e përsëritim se puna jonë konkrete me organet e Administratës Publike ka si objekt kryesor: të merremi me rastet, ku ka dhunim të të drejtave të njeriut ose parregullsi të tjera që çojnë në shkeljen e këtyre të drejtave dhe të ndihmojmë qytetarët.

## KREU IV

### **1. Në ndjekje të rasteve të prezantuara në Raportet Vjetore 2000, 2001, 2002 dhe 2003.**

Disa nga rastet (*ankesa, kërkesa apo rekomandime*) që janë prezantuar në Raportet e viteve 2000, 2001, 2002 dhe 2003 kanë përfunduar dhe gjatë këtij raporti janë pasqyruar në pjesët përkatëse ku trajtohet problematika e tyre. Prandaj në këtë Kre të këtij Raporti do të paraqesim shkurtimisht, disa nga rastet të cilat janë akoma në ndjekje edhe për vitin 2005.

1. Plotësimi i ligjit “Për të Drejtat e të Dënuarve” me aktet nënligjore për shpërblimin e punës së të dënuarve dhe ndryshime të rregullores së policisë së burgjeve. Brenda vitit 2003 duhej të hartohej drafti nga Ministria e Drejtësisë. Meqënëse një gjë e tillë nuk u realizua në vitin 2003, plotësimi me akte nënligjore i ligjit të sipërcituar u fut në programin e vitit 2004. Nga verifikimet tona rezulton se edhe në vitin 2004 nuk është bërë gjë nga Ministria e Drejtësisë.

2. Rekomandim drejtuar Kuvendit të Shqipërisë “Për përgatitjen sa më shpejt të projekteve për plotësimin e legjislacionit për mbrojtjen e shëndetit të njerëzve dhe të ambientit nga rrezatimet jo jonizuese të telefonisë celulare”. Rekomandime me të njëjtën përmbajtje, i kemi drejtuar Kryeministrit, Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Shëndetësisë, Ministrisë së Mjedisit dhe Ministrisë të Transporteve. Deri tani kemi përgjigje vetëm nga Ministria e Shëndetësisë e cila shprehet dakort lidhur me faktet e parashtruara në Rekomandimin tonë dhe konfirmon krijimin e një grupi pune, i cili nuk ka arritur në një konkluzion përfundimtar për shkak të mendimeve të kundërta rreth vendosjes së njesisë rregulluese. Kurse Ministria e Drejtësisë përgjigjet se po përgatitet projektligji për sa më sipër.

3. Rekomandim drejtuar Këshillit të Ministrave, që në mbrojtje të të drejtës kushtetuese të lirisë fetare të sanksionuar në nenin 24 të Kushtetutës, Këshilli i Ministrave duhet të respektojë detyrimin kushtetues të parashikuar në pikën 5 të nenit 10, në të cilin parashikohet se: “Marrëdhëniet ndërmjet shtetit dhe bashkësive fetare të rregullohen mbi bazën e marrëveshjeve të lidhura ndërmjet

përfaqësuesve të tyre dhe Këshillit të Ministrave. Këto marrëveshje ratifikohen në Kuvend”. Ky rekomandim është përsëritur disa herë dhe ende ky detyrim kushtetues nuk është realizuar.

4. Rekomandim për ndryshim të legjislacionit në fushën e ndihmës dhe përkrahjes sociale, në lidhje me ndarjen e përfitimit të pagesës së kujdestarisë nga qënia në skemën e ndihmës ekonomike, si dhe plotësim të ligjit “Për ndihmën dhe përkrahjen sociale”, përsa i përket rrugës së ankimit administrativ ndaj vendimeve që merren shkallë pas shkalle. Lidhur me këtë rekomandim nuk kemi një përgjigje zyrtare, por është në proces ndryshimi i ligjit.

5. Propozimi drejtuar Kryeministrit të Republikës së Shqipërisë për ndryshimin dhe përmirësimin e Vendimit të K.M. nr.552 datë 27.11.1999 “Për trajtimin ekonomik e financiar të familjeve të punonjësve të policisë të vrarë apo plagosur për shkak të detyrës”, për t’i shtrirë efektet e zbatimit të tij nga 01 janari 1991. Megjithëse nga ish Ministri i Rendit Publik z. Luan Rama u premtua para parlamentit se vendimi do të ndryshohej, në fakt ai nuk u bë. Ne e kemi përsëritur këtë rekomandim, por nuk kemi marrë përgjigje.

## **2. Çështje të filluara me iniciativën e Avokatit të Popullit**

Sipas nenit 13 të Ligjit nr.8454, dt.4.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, “Avokati i Popullit fillon procedurën e shqyrtimit të çështjes kur vëren ose dyshon se ka ndodhur një shkelje e së drejtës, në bazë të ankesës apo të kërkesës së personit të interesuar ose të dëmtuar, si dhe me nismën e vet, për raste të veçanta të bëra publike, por me pëlqimin e të interesuarit ose të dëmtuarit”.

- Në total çështje të filluara me iniciativë gjatë vitit 2004 janë:	9
- Ankesa të drejta ose zgjidhur në favor	4
- Jashtë kompetence ose juriksionit	0
- Të refuzuara për shkak se nuk u bënë ankesa individuale sipas ligjit, ose gjatë shqyrtimit u tërhoqën, ose në përfundim doli se ankesa ishte e padrejtë apo e pavërtetë	5
- Në shqyrtim	0

## **ANEKSE**

### **1. Letra falenderimi nga qytetaret**

Letër falenderimi

**Drejtuar Avokatit të Popullit  
Ermir Dobjani**

Ju falenderoj nga zemra për kontributin që keni dhënë si institucion i popullit, duke kontribuar në respektimin e ligjeve të shtetit shqiptar për djalin tim Sokol Manjani, vjeç 26, lindur dhe banues në fshatin Gjoricë e P. Komuna Gjoricë – Bulqizë.

Sokoli u sëmur emigrant në Itali me dokumenta të rregullta në marrëdhënie me shtetin italian. I morën në dhomë 8 milion lireta dhe dokumentat komplet. Kaloj në sëmundje psiqike. E mora në Shqipëri se nuk kishte mjet jetese në pamundësi për të jetuar në Itali ku shteti italian e pajisi me Riçevutë. U sëmur për vitin e ri 2003 dhe u largua nga shtëpia për të cilën kërkova ndihmë nga organet e rendit, nuk m'u dha. Djali djeg ca lecka në teqen e Bllacës. E plagosin, e fusin në burg, e bëjnë terrorist me akuzë të rreme. Edhe sot pas një viti, ku djalit e kurova në spitalin e Tiranës në repartin e Tiranës kur më kërkoi pafajësinë, nxjerrin vendime për kurim mjekësor në Krujë, duan t'a izolojnë gjithë jetën se nuk është realizuar korrupsioni i tyre.

**07.05.2004**

**Besim Manjani**

Letër mirënjohje

**Drejtuar: Avokatit të Popullit  
Z.Ermir Dobjani**

**TIRANË**

I jam mirënjohës Institucionit të Avokatit të Popullit për ndjekjen juridike që i bëri ankesës time Nr.K1/H18-9 Prot, Nr.dok. 2003001607/9, në adresë të INSIG sh.a. Tiranë.

Më 15 janar 2002 u transferova nga dega e INSIG-Kosovë në Drejtorinë e Përgjithshme të INSIG-ut në Tiranë, ku punova deri në korrik 2003 që më nxorrën në reformë.

Më 20 korrik 2003 u paraqita për të tërhequr 9 pagat e reformës, por:

- Më njoftuan gojarisht për një borxh me rrudhje krahësh e ngritje supesh, borxh pa emër, pa burim, në shumën 429 Euro, për kohën që kisha punuar në Kosovë.

- Nga 15 janari 2002 e deri më 30 korrik 2003, unë kisha marrë plot 37 pesëmbëdhjetëditësha të plotë page pa më prekur asnjë qindarkë.

- Deri më sot nuk ka urdhër të lëshuar për ndalimin e atyre parave.

U ankova disa herë te drejtorët e përgjithshëm të INSIG-ut, por pa përgjigje.

Në këto kushte iu drejtova Institucionit të Avokatit të Popullit. Më takoi z.Artur Lazebeu dhe më dëgjoi me shumë kujdes për të gjitha argumentat e mia të shkruara që, sipas meje, flisnin për padrejtësinë dhe fajësinë e INSIG-ut dhe shkeljen e të drejtave të mia nga ana e tij. Me këto veprime INSIG-u bënë mirë, pasi nuk i kërkohet llogari.

Për disa muaj rradhazi e ndoqi z.Alket Jaupi, deri sa përfundoi me REKOMANDIMIN e Avokatit të Popullit, të dt.02.06.'04 drejtuar INSIG-ut.

Këmbëngulja e këtyre specialistëve, në luftë me shkelësit e mospërfillësit e ligjeve më ngjalli shpresë për drejtësinë ligjore.

Falenderimet që ia shpreha me gojë z.Alket Jaupi po ua dërgoj me shkrim dhe më duken pak.

U jam mirënjohës për deri tani për luftën që bëni në kërkesë për zbatimin e ligjeve.

***Tiranë, 21.06.'04***

**Me respekt  
Halil Elezi**

**Avokatit të Popullit  
Z.Ermir Dobjani**

**TIRANË**

Faleminderit shumë dhe u jam tepër mirënjohës për ngushëllimet e bëra me tuajën Nr.K2/F59-3 datë 17.12.2003 Nr.Dokumentit 200301837/3 për humbjen e vajzës time Elsa Hasa dhe për demarshet që bëtë pranë Ombudsmanit Grek në Athinë.

Variantin që shtroni me tuajën Nr.K2/F59-5 datë 25.03.2004. Nr.Dok. 200301837/5, për arsye tepër të rënda ekonomike nuk mund të bëjmë asgjë, sepse vetë jam plak i vetmuar lindur më 02.05.1920, në pension e me sëmundje të pleqerisë (tension-zemër) dhe siç e dini, vetëm për të marrë vizë në

Ambasadën Greke, veç të njohurve që s'kemi, duhet një shumë e madhe lekësh. Që të shkosh në Greqi duhen lekë për hotel -ushqim dhe udhëtim. Pastaj për Avokatin e Gjykatën shpenzime të papëballueshme.

Prandaj ju faleminderit shumë dhe na falni që ju bezdisim. Por do t'u lutesha shumë, mendoni për ndonjë klauzolë tjetër si p.sh: Të bëjmë një Prokurë për ndonjë punonjës të Ambasadës tonë në Athinë për t'a ndjekur problemin, pasi ky problem është i zbuluar nga Autoritetet Greke, dihet emri e mbiemri i shoferit për gabimet që ka bërë duke shkelur vetë ligjet e shtetit grek.

Kam bindjen se ky problem nuk zgjidhet asnjëherë po qe se nuk prihet nga ana juaj me të drejtat që u jep Kushtetuta Neni 8 paragrafi 2, ose ndonjë ligj apo dispozitë tjetër që mund të ketë Ambasada jonë për mbrojtjen e të drejtave për shtetasit e saj, të zhdukur ose të vrarë.

Që nga fjalët në letër, e di predispozicionin Tuaj.  
Vetëm më falni shumë për shqetësimin.

Nderimet dhe respektet

**28.07.2004**

**Fadil Hasa**

## **Organizatat e Veteranëve të LANÇ**

### **Komiteti Kombëtar**

#### **Letër falenderimi**

**Drejtuar: Institucionit të Avokatit të Popullit  
Z.Ermir Dobjani**

Kryesia e Komitetit Kombëtar të Organizatës së Veteranëve të LANÇ të Popullit Shqiptar, në emër të të gjithë veteranëve të LANÇ të popullit shqiptar, Ju falenderon për respektin dhe konsideratën e lartë që keni treguar dhe vazhdoni të tregoni për ish partizanët e LANÇ, që përbëjnë plejadën e tërë atyre që luftuan e sakrifikuan për çlirimin e atdheut.

Tek personi Juaj i respektuar, me funksionin e lartë e të nderuar të Avokatit të Popullit, ne, si përfaqësues të veteranëve të LANÇ kemi parë funksionarin korrekt të Drejtësisë që ka pasur respektin e veçantë për të na pritur e për të na dëgjuar me shumë vëmendje. Ishte edhe interesimi Juaj i drejtëpërdrejtë që bëri të mundur pranimin e dokumenteve të mjaft prej atyre veteranëve të LANÇ, që, për shkaqe objektive, nuk mundën t'i dorëzonin në kohë. Kemi besim, se dhe në të ardhmen do t'a kemi mbështetjen Tuaj për kërkesën që i kemi paraqitur Këshillit të Ministrave për caktimin e një afati të ri



kohor për të grumbulluar dokumentet e atyre veteranëve të LANÇ që nuk i patën dorëzuar.

Gjithmonë në mbështetje të mundësive që mund të krijohen nga shfrytëzimi i hapësirave ligjore, kemi besim se do të mund të ndihmoni edhe për rritjen e arsyeshme të pensioneve të veteranëve të LANÇ., të pjestarëve të kësaj plejade aq shumë të sakrifikuar gjatë LANÇ, por edhe në dekadat e pasçlirimit.

Me ndihmën Tuaj u bë i mundur miratimi i të drejtave ligjore të veteranëve ushtarakë, të cilët deri tani nuk kanë përfituar asnjë shpërblim financiar për shërbimin e kryer për rreth 40 vjet radhazi. Tani kur është çasti, që Këshilli i Ministrave do të nxjerrë aktet nënligjore, prej të cilave do të mund të bëhet i mundur përcaktimi konkret i masës së shpërblimeve, kemi besim se ndihma Juaj nuk do të mungojë.

Për të gjitha vlerësimet e qëndrimet që keni mbajtur ndaj kërkesave të drejta të paraqitura nga ana e Kryesisë së Komitetit Kombëtar të Organizatës së Veteranëve të LANÇ, edhe një herë Ju shprehim mirënjohjen e thellë dhe nderimin e veçantë.

Me konsideratën më të lartë

**Për Kryesinë e Komitetit Kombëtar të Veteranëve të LANÇ**

**Sekretari i Përgjithshëm  
Qamil Poda**

**Kryetari  
Adnan Qatipi**

**Tiranë, më 08.10.2004**

**Z.Ermir Dobjani**

**Avokat i Popullit i Republikës së Shqipërisë**

Po Ju shkruaj këtë letër në shenjë falenderimi dhe mirënjohje të thellë për gjithçka që Ju dhe Institucioni që Ju drejtoni keni bërë për mua, në radhë të parë si qytetar i thjeshtë dhe pastaj si ish Pedagog Profesor pranë Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike të Universitetit Politeknik, të pushuar padrejhtësisht nga ish rektorja e këtij Universiteti Tamara Eftimi dhe të rikthyer në detyrën e nderuar të Profesorit në sajë të punës dhe përpjekjeve Tuaja.

Megjithëse unë personalisht ju isha drejtuar disa ministrave nga të cilët nuk mora asnjë përgjigje “pasi janë shumë të zënë” dhe pas një kalvari të gjatë katër veçar në gjykatat e Tiranës, nuk arrita që të fitoj asnjë gjë.

Prandaj, me këtë rast, me këtë letër të thjeshtë, por shumë domethënëse, Ju shpreh edhe një herë falenderimin tim, të familjes time dhe të kolektivit ku unë u ripanova me dashamirësinë më të madhe.

Edhe një herë, mirënjohjen më të thellë për Ju dhe Institucionin Tuaj, që është vënë në shërbim të halleve dhe problemeve të qytetarëve të këtij vendi, për t'i zgjidhur ato me preokupimin dhe angazhimin maksimal brenda të gjitha normave dhe ligjeve të Republikës së Shqipërisë.

*Tiranë, më 10.11.2004*

**Me respekt**  
**Prof.Dr. Aleksandër Bushati**

## Tabela dhe grafiket

### Shtypi i shkruar per vitin 2004

NR	DATA	GAZETA	TITULLI	RUBRIKA
1	04.01.2004	SHEKULLI	Në vëmendje të Avokatit të Popullit: Të kesh a të mos kesh KESH.	Artikull
2	07.01.2004	SHEKULLI	Përfundimet e ekspertëve deklarohen sot nga Dobjani	Artikull
3	08.01.2004	KORRIERI	Ekspertët dorëzojnë ekspertizën për çmimet e telefonave dhe dritave.	Artikull
4	08.01.2004	KOHA JONE	Akademikët reagojnë ndaj Albtelekomit.	Njoftim
5	14.01.2004	ATSH	Avokati i Popullit inkurajon prokurorinë për zbardhjen e tragjedisë së 9 Janarit.	Njoftim
6	14.01.2004	KOHA JONE	Dobjani, ngushëllime për viktimat e tragjedisë.	Njoftim
7	14.01.2004	DITA	Dobjani: Edhe ne, hetime per ngjarjen.	Prononcim
8	14.01.2004	Gazeta "55"	Avokati i Popullit inkurajon prokurorinë për zbardhjen e tragjedisë së 9 Janarit	Njoftim
9	14.01.2004	KORRIERI	Avokati i Popullit: "Inkurajon prokurorinë për zbardhjen e tragjedisë"	Prononcim
10	14.01.2004	ALBANIA	Avokati i Popullit: "Të zbardhet tragjedia"	Prononcim
11	20.1.2004	ALBANIA	Avokati i Popullit: Shteti denoncon shtetin	Artikull
12	20.01.2004	GAZETA SHQIPTARE	Avokati i Popullit Dobjani: Duhet bërë më shumë në luftën antitrafik	Prononcim
13	20.01.2004	SHEKULLI	Avokati i popullit, Ermir Dobjani ka kërkuar forcimin dhe zbatimin e ligjit për dënimin e trafikantëve	Prononcim
14	20.01.2004	PANORAMA	Avokati i Popullit: Struktura të Shtetit përfshihen në trafik	Prononcim
15	20.01.2004	PANORAMA	Avokati i Popullit: Lëvizja e lirë, stop barrierave	Prononcim
16	20.01.2004	PANORAMA	Avokati i Popullit: Trafik fëmijësh me birësime ndërkombëtare	Prononcim
17	20.01.2004	ZERI I POPULLIT	Avokati i Popullit: Lufta kundër Trafikut të Fëmijëve, prioritet politik që shoqërohet me masa	Artikull

18	22.01.2004	GAZETA SHQIPTARE	Dobjani: Po punojmë për ngjarjen e 9-janarit	Prononcim
19	22.01.2004	KOHA JONE	Avokati i Popullit në Shkodër pranë familjeve që humbën të afërmit në tragjedinë e Jonit	Artikull
20	22.01.2004	ATSH	Avokati i Popullit diskuton mbi projektligjin për krijimin e Komitetit për Parandalimin e Krimit	Njoftim
21	23.01.2004	SOT	Avokati i Popullit mbi projektligjin për krijimin e Komitetit për Parandalimin e krimit	Njoftim
22	28.01.2004	GAZETA SHQIPTARE	Studenti i Inxhinierise troket te Avokati i Popullit	Artikull
23	29.01.2004	GAZETA SHQIPTARE	"Ti jepet diploma studentit fetar", Avokati i Popullit: "Vendimi nuk ka mbështetje ligjore"	Intervistë
24	29.01.2004	GAZETA SHQIPTARE	"Buka" mbërrin te Avokati i Popullit	Njoftim
25	05.02.2004	ATSH	Avokati i Popullit, Dobjani, takon ambasadorin e ri të Greqisë në Tiranë, Carabassis	Njoftim
26	06.02.2004	ZERI I POPULLIT	Dobjani, ambasadorit grek Carabassis: Lehtësim procedurash për legalizimin e shqiptarëve	Njoftim
27	10.02.2004	SHEKULLI	Avokati i Popullit i dorëzon KLD ankesat për 7 gjyqtarët	Njoftim
28	11.02.2004	PANORAMA	Avokati i Popullit në takim me të dënuarit grevistë	Intervistë J.Dhrami
29	12.02.2004	PANORAMA	E ëma e njërit prej nxënësve ankohet te Dobjani	Njoftim
30	12.02.2004	PANORAMA	Komisionerët e Avokatit të Popullit konstatojnë dy raste	Njoftim
31	12.02.2004	KORRIERI	Zbardhet "kercënimi" i mësueses. Prindërit e 15-vjeçarit i janë drejtuar Avokatit të Popullit	Prononcim
32	12.02.2004	ATSH	Avokati i Popullit kërkon nga ERE, rishikimin e tarifave të shitjes së energjisë elektrike	Njoftim
33	13.02.2004	PANORAMA	Avokati i Popullit: Çmimi i energjisë u rrit 38 për qind	Njoftim
34	13.02.2004	DITA	Avokati i Popullit reagon publikisht ndaj rritjes së çmimit të energjisë elektrike	Artikull

35	13.02.2004	R.D.	Avokati i Popullit i ka kërkuar ERE-së të rishikojë tarifat, çmimi i energjisë është rritur 30 për qind	Artikull
36	13.02.2004	KOHA JONE	Avokati i popullit: Enti Rregullator duhet të ulë tarifat	Njoftim
37	13.02.2004	KORRIERI	Raporti i grupit të ekspertëve pranë Avokatit të Popullit ka zbardhur të vërtetën mbi çmimin e energjisë	Artikull
38	13.02.2004	SHEKULLI	Avokati i Popullit: Energjia elektrike është shtrenjtuar 38%	Artikull
39	13.02.2004	GAZETA SHQIPTARE	Avokati i Popullit dhe debati për çmimet e KESH-it	Artikull
40	13.02.2004	ALBANIA	Avokati i Popullit kërkon rishikimin e tarifave të shitjes së energjisë elektrike	Konferencë shtypi
41	14.02.2004	ALBANIA	Ministria dhe KESH-i kundër Avokatit të Popullit dhe akademikëve	Artikull
42	14.02.2004	GAZETA SHQIPTARE	Dobjani paditi fshehjen e çmimit	Njoftim
43	14.02.2004	R.D.	Avokati i Popullit, Dobjani, denoncon mashtrimin e qeverisë me kompensimin	Artikull
44	16.02.2004	PANORAMA	Kreu i shtetit në krahun e akademikëve dhe të Avokatit të Popullit	Artikull
45	16.02.2004	SHEKULLI,	Presidenti priti ministrin e Energjitikës, kreun e Akademisë së Shkencave dhe Avokatin e Popullit	Artikull
46	16.02.2004	DITA	Presidenti takon drejtues të Akademisë së Shkencave, Avokatin e Popullit dhe ministrin e Energjitikës	Artikull
47	16.02.2004	PANORAMA	Avokati i Popullit: Do të kontaktojmë me homologët për të ekstraduarit	Prononcim
48	18.02.2004	ATSH	OSBE: Avokati i Popullit ka fituar besimin e publikut.	Prononcim O.Lipponen
49	19.02.2004	ATSH	Ministri i Drejtësisë Xhafa, thekson rëndësinë e bashkëpunimit me Avokatin e Popullit në mirëfunksionimin e drejtësisë	Njoftim
50	19.02.2004	REPUBLIKA, TEMA, PANORAMA	Fernhout: Ombudsmani Kombëtar Hollandez në Tiranë, për më shumë bashkëpunim	Njoftim
51	20.02.2004	ATSH	Hollanda do të mbështesë Shqipërinë në forcimin e institucionit të Avokatit të Popullit	Njoftim

52	20.02.2004	REPUBLIKA	Dobjani: Shqiptarët në Hollandë të barabartë me vendasit	Njoftim
53	20.02.2004	KORRIERI, ZERI I POPULLIT,	Avokati i Popullit të Hollandës takon Ministrin e Drejtësisë Xhafa, dhe Kryetarin e Gjykatës Kushtetuese Fehmi Abdiun	Njoftim
54	20.02.2004	BALLKAN	Avokati i Popullit ka fituar një besim më të gjerë nga publiku	Njoftim
55	21.02.2004	SOT, KOHA JONE, REPUBLIKA	Hollanda ndihmë ndaj Avokatit të Popullit	Njoftim
56	21.02.2004	KOHA JONE	Avokati i Popullit takohet me komisarin në grevë urie.	Njoftim
57	24.02.2004	ATSH	Ambasadori amerikan, Jefffrey, shpreh mbështetjen për institucionin e Avokatit të popullit	Njoftim
58	25.02.2004	DITA	Energjia, Xhefri përgëzon Dobjanin	Njoftim
59	25.02.2004	REPUBLIKA	Avokati i Popullit takon Ambasadorin amerikan	Njoftim
60	25.02.2004	PANORAMA	Xhefri-Dobjani: Qytetarët kanë nevojë për mbrojtje	Njoftim
61	25.02.2004	R.D.	Ambasadori amerikan ka mbështetur Avokatin e Popullit në iniciativën për uljen e tarifave të KESH dhe Albtelekom	Njoftim
62	25.02.2004	ZERI I POPULLIT	Ambasadori amerikan, Jeffrey, mbështet institucionin e Avokatit të Popullit	Njoftim
63	25.02.2004	KORRIERI	Xhefri, Avokatit të Popullit: Qytetarët kanë nevojë për një palë të tretë	Njoftim
64	25.02.2004	ALBANIA	Ambasadori amerikan vlerëson oponencën e Avokatit të Popullit	Njoftim
65	26.02.2004	DITA	Dobjani ngushëllon familjet e viktimave të Selenicës	Prononcim
66	26.02.2004	ATSH	Avokati i Popullit takon familjaret e minatoreve që humbën jetën në minierën e Selenicës	Njoftim
67	27.02.2004	REPUBLIKA	Dobjani: "Të bllokohet miniera e Selenicës"!	Njoftim
68	27.02.2004	GAZETA SHQIPTARE	Avokati i Popullit të afërmve të viktimave: Denonconi francezin në Gjykatë	Artikull
69	27.02.2004	BALLKAN	Avokati i Popullit: Sekuestroni minierën	Prononcim
70	27.02.2004	SOT	Dobjani me familjarët e viktimave	Njoftim

71	27.02.2004	ZERI I POPULLIT	Si institucioni i Avokatit të Popullit, ne rekomandojmë që pasuria e sipërmarrësit francez në Shqipëri, të vihet nën sekuestro	Njoftim
72	27.02.2004	R.D.	Avokati i Popullit denoncon abuzimet e punëdhënësve në minierën e bitumit	Prononcim
73	03.03.2004	SHEKULLI	Avokati i Popullit: Ambasadat nuk respektojnë shqiptarët	Artikull
74	10.03.2004	REPUBLIKA	Avokati i Popullit raporton në parlament	Njoftim
75	10.03.2004	GAZETA SHQIPTARE	Raporti i Avokatit të Popullit në Kuvend	Njoftim
76	10.03.2004	DITA	Ambasada italiane reagon mbi vërejtjet e bëra nga Avokati i Popullit: Ja rastet për të cilat jepen arsytet e refuzimit të vizave	Artikull
77	10.03.2004	"55"	"Avokati i Popullit": Ulje në detyra vetëm për shkeljet e vogla	Artikull
78	10.03.2004	"55"	Dobjani: Korrupsioni po paralizon administratën shtetërore	Prononcim
79	10.03.2004	KOHA JONE	Avokati i Popullit raporton në Kuvend për veprimtarinë e vitit 2003	Artikull
80	10.03.2004	KORRIERI	Dobjani: Moisiu mund të falë të dënuarit në Greqi	Artikull
81	10.03.2004	ALBANIA	Dobjani: "Keqtrajtme të shumta në komisariate"	Artikull
82	10.03.2004	PANORAMA	Avokati i Popullit kërkoi që të garantohet e drejta e votës në të gjithë burgjet shqiptare	Artikull
83	10.03.2004	BALLKAN	Avokati i Popullit: Presidenti mund të falë të ekstraduarit nga Greqia	Artikull
84	10.03.2004	SOT	Avokati i Popullit në Kuvend: Të forcohet ligji	Artikull
85	10.03.2004	R.D.	Avokati i Popullit paraqet në Parlament raportin e vitit 2003 për të Drejtat e Njeriut	Artikull
86	16.03.2004	ATSH	Avokati i Popullit, Dobjani, takon Ombudsmanin e Polonisë, z. Andrzej Zoll	Njoftim
87	17.03.2004	ATSH	Kryetari i Kuvendit, Pëllumbi, dhe Avokati i Popullit të Polonisë, vlerësojnë për Avokatin e Popullit në Shqipëri	Njoftim
88	17.03.2004	SOT	Dobjani takon homologun Polak	Njoftim
89	18.03.2004	GAZETA SHQIPTARE	Ombudsmani polak takon krerët e drejtësisë	Njoftim
90	18.03.2004	PANORAMA	Pëllumbi takon Avokatin e Popullit	Njoftim

91	19.03.2004	BALLKAN	Pas ankesës së djemve për rihënien e pensionit nga autoritetet franceze, ndërhyt Avokati i Popullit	Artikull
92	Mars 2004	Tribuna Juridike	Aksesi i Avokatit të Popullit në dokumentet zyrtare	Artikull Ermir Dobjani
93	Mars 2004	Tribuna Juridike	Mbrojtja me avokat e personit gjatë kohës së shoqërimit, ndalimit, ose arrestimit në flagrancë	Artikull Sotiraq Nushi
94	Mars 2004	Tribuna Juridike	Ekzekutimi i vendimeve penale me burgim	Artikull Harallamb Bano
95	30.03.2004	REPUBLIKA	Komisioni i Venecias i përgjigjet Avokatit të Popullit për pronat	Artikull
96	09.04.2004	DITA	Komisioni i Venecias mbështet ankesat e Dobjanit	Artikull
97	12.04.2004	PANORAMA	Avokati i Popullit: Ministri të presë të shkarkuarit	Prononcim Ermir Dobjani
98	14.04.2004	ZERI I POPULLIT	Avokati i Popullit nxit përmirësimin e marrëdhënieve të KESH-it me konsumatorin	Njoftim
99	14.04.2004	SOT	Avokati i Popullit përkrah KESH	Njoftim
100	20.04.2004	KORRIERI	Avokati i Popullit ka rekomanduar fillimin e hetimeve për ish-prokurorin, pasi la në qeli dy persona të cilëve u kishin mbaruar afetet e dënimit.	Artikull
101	21.04.2004	REPUBLIKA	Të "shkarkuarit" e policisë, tek Avokati i Popullit	Prononcim
102	21.04.2004	REPUBLIKA	Avokati i Popullit u jep të drejtë pronarëve	Prononcim
103	06.05.2004	DITA	Avokati i Popullit thekson nevojën e përmirësimit të raportit mes individit e pushtetit	Artikull
104	06.05.2004	GAZETA SHQIPTARE	Avokati i Popullit nis hetimin e Bovillës	Njoftim
105	12.05.2004	ATSH	"Roli i Ombudsmanit në një shoqëri të bazuar në shtetin e së drejtës" diskutohet në një seminar në Turqi	Njoftim
106	14.05.2004	SHEKULLI	Avokati i Popullit i Greqisë i konfirmon Avokatit të Popullit të Shqipërisë trafikun e fëmijëve nga institucionet greke.	Artikull



107	15.05.2004	ZERI I POPULLIT	Avokati i Popullit vlerëson si pozitive kontrollet e Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit	Artikull
108	15.05.2004	PANORAMA	Avokati i Popullit: Fëmijët janë zhdukur, por s'janë trafikuar	Artikull
109	15.05.2004	SHEKULLI	Raporti i plotë i Ombudsmanit grek tregon se 510 fëmijët shqiptarë u zhdukën nga neglizhenca e palës greke	Artikull
110	15.05.2004	REPUBLIKA	Ombudsmani grek ka mirëpritur kërkesën e Avokatit të Popullit për fëmijët e zhdukur në vitet 1998-2002	Artikull
111	15.05.2004	TEMA	Avokati i Popullit: Asnjë koment lidhur me ekzistencën e trafikut	Prononcim Artur Lazebau
112	15.05.2004	BALLKAN	Zbardhet letra e nën/Ombudsmanit grek për Avokatin e Popullit, e dërguar më 6 maj të këtij viti	Artikull
113	16.05.2004	BALLKAN	Zhdukja e fëmijëve shqiptarë në Athinë	Njoftim
114	16.05.2004	ZERI I POPULLIT	Dobjani: 487 fëmijë shqiptarë në Greqi të humbur por jo të trafikuar	Artikull
115	27.05.2004	ATSH	Avokati i Popullit diskuton me Ambasadorin e OSBE-së, Lipponen për projekte të përbashkëta.	Njoftim
116	28.05.2004	REPUBLIKA	Takimi Dobjani-Lipponen: "Zgjedhjet 2005 votat të numërohen nga gjyqtarët"	Artikull
117	28.05.2004	R.D.	Dobjani propozon numërim votash nga gjyqtarët	Artikull
118	28.05.2004	KOHE JONE	Dobjani: Votimet e 2005 numërim nga gjyqtarët e Faktit	Njoftim
119	28.05.2004	ZERI I POPULLIT	Avokati i Popullit me Ambasadorin e OSBE-së, Lipponen për projekte të përbashkëta	Njoftim
120	28.05.2004	SOT	Dobjani: Gjyqtarët të numërojnë votat	Njoftim
121	10.06.2004	KORRIERI	Raporti: Pse u zhdukën 560 fëmijë shqiptarë	Artikull
122	15.06.2004	KORRIERI	Të paguash për të hyrë në shtëpinë tënde	Artikull
123	19.06.2004	DNEVNIK	Ombudsmani - një institucion që respektohet si në Maqedoni ashtu dhe në Shqipëri	Njoftim
124	19.06.2004	FLAKA	Avokati i Popullit kontrollues i pushtetit	Artikull
125	20.06.2004	MAKEDONIA	Ombudsmani - kusht i rëndësishëm për futjen në B.E.	Konferencë shtypi Ermir Dobjani, B.Naumovski
126	20.06.2004	FAKTI Maqedoni	Ombudsmanët thellojnë bashkëpunimin	Artikull

127	26.06.2004	RD	Avokati i Popullit kritikon politikën e emerimeve në Ministrinë e Rendit.	Artikull
128	26.06.2004	DITA	Dobjani : Të krijohet Sindikata e Policisë	Artikull
129	26.06.2004	KORRIERI	Besimi publik, sfida e policisë	Ermir Dobjani, Artikull
130	26.06.2004	KOHA JONE	"Besimi publik-Sfidë për policinë". Dobjani përplasat me Tosken.	Artikull
131	26.06.2004	DITA	Dobjani-Toskës : Jepini fund luftës së klaneve në Ministrinë e Rendit.	Artikull
132	26.06.2004	REPUBLIKA	Dobjani kritikon Toskën.	Artikull
133	04.07.2004	ALBANIA	Avokati i Popullit kundërshton spastrimet në Ministrinë e Rendit.	Interviste E.Dobjani
134	12.07.2004	DITA	Avokati i Popullit : Jemi shembull i mirë i bashkëpunimit dhe korrektesës.	Interviste E.Dobjani
135	14.07.2004	GAZETA SHQIPTARE	Avokati i Popullit : Do nisim hetime po kerkuan familjaret.	Prononcim
136	14.07.2004	SOT	Gjirokastër: Avokati i Popullit mbledh ankesat	Artikull
137	22.07.2004	SOT	Avokati i Popullit Dobjani : Durrësi i molepsur	Artikull
138	16.09.2004	KORRIERI	Avokati i Popullit, hetim me grekët për trafikun e të miturve	Njoftim
139	16.09.2004	DITA	Dobjani ka marrë në dorë hetimin e trafikut të foshnjave	Artikull
140	16.09.2004	ATSH	Avokati i Popullit merr pjesë në Konferencën e Institutit Ndërkombëtar të Ombudsmanit dhe në Forumin e Ombudsmanit Frankofon	Njoftim
141	17.09.2004	KORRIERI	Policia e Shtetit i dërgon Avokatit të Popullit listën e fëmijëve të zhdukur	Artikull
142	21.09.2004	ZERI I POPULLIT	Avokati i Popullit: Ja lista e 32 fëmijëve shqiptarë të zhdukur në vitet 2000-2004	Artikull
143	21.09.2004	KORRIERI	Hetimi i "Agia Varvara" me nismën e Avokatit të Popullit	Njoftim
144	02.10.2004	ATSH	Avokati i Popullit në Beograd, në mbështetje të bashkëpunimit rajonal	Njoftim
145	04.10.2004	PANORAMA	Zjarrfikësit ankohen tek Avokati i Popullit	Artikull
146	05.10.2004	SHEKULLI	Avokati i Popullit i përgjigjet negativisht kërkesës së 178 familjeve, për të ndërhyrë që kullat Hawai të mos prishen	Artikull

147	13.10.2004	ATSH	Avokati i Popullit tregon përvojën e tij në Jordani	Njoftim
148	31.10.2004	"55"	Avokati i Popullit apelon për më shumë kujdes dhe profesionalizëm në marrëdhënie me individët	Artikull
149	16.11.2004	ATSH	Ambasadori i OSBE-se, Pavel Vacek, Siguron Avokatin e Popullit për Mbështetje të mëtejshme	Njoftim
150	19.11.2004	ALBANIA	Kur të flasë Ombudsmani të heshtë qeveria	Artikull
151	19.11.2004	ALBANIA	Avokati i Popullit bën analizën e mandatit të tij të parë.	Intervistë Ermir Dobjani
152	20.11.2004	KORRIERI	Zgjedhjet, votat t'i numërojnë gjyqtarët	Artikull
153	21.11.2004	SOT	Beja: Dobjani-Zogu, ide utopike	Artikull
154	21.11.2004	BALLKAN	A do të aplikohet propozimi i Dobjanit për Zgjedhjet?	Artikull
155	22.11.2004	SHEKULLI	Votat t'i numërojnë gjyqtarët	Artikull
156	26.11.2004	PANORAMA	Nënkryetari i PD-së kundërshton numërimin e votave nga togat e zeza	Artikull
157	14.12.2004	KORRIERI	Organizata Botërore Kundër Torturës informon Avokatin tonë të Popullit	Artikull

## Media elektronike per vitin 2004


Nr.	ORGANI	DATA	RUBRIKA	PASQYRIMI
1	TVSH, News 24, Top Chanel, Tv.Klan, TVA	09.01.2004	Avokati i Popullit në Analizën Vjetore të Ministrisë së Rendit Publik	Njoftim
2	TVSH, TVA, News 24, TNSH, Top Chanel, Tv. Klan, Shijak Tv.	19.01.2004	Avokati i Popullit në Konferencën Kombëtare kundër Trafikut të Fëmijëve	Njoftim
3	News 24	19.01.2004	Avokati i Popullit për operacionin "Rrjeta e hekurt" dhe sekuestrimet	Intervistë
4	Zëri Amerikës, Top Albania, Tv.Shkodra, Tv.Rozafa, Radio Tirana	21.01.2004	Avokati i Popullit viziton familjet e viktimave të 9-janarit	Intervistë
5	Zëri Amerikës, Top Albania, Tv.Shkodra, Tv.Rozafa, Radio Tirana	21.01.2004	Avokati i Popullit për krijimin e Komitetit Kombëtar për parandalimin e krimit	Njoftim
6	Tv. Klan, ATN, News 24, Alsat, Albania 1, Vizion +,	28.01.2004	Liria fetare, e drejtë kushtetuese	Prononcim A.Lazebeu
7	TVA	06.02.2004	Dobjani pret Ambasadorin e ri grek Carcabassis	Njoftim
8	TVSH, TVA, News 24, TNSH, Top Chanel, Tv. Klan, Shijak Tv. etj	12.02.2004	Avokati i Popullit kërkon rishikimin e tarifave të KESH	Konferencë Shtypi

9	TVSH, TVA, News 24, TNSH, Top Chanel, Tv. Klan, Shijak Tv. etj	15.02.2004	Avokati i Popullit dhe Akademikët tek Presidenti	Prononcim Ermir Dobjani
10	TVSH, TVA, News 24, Alsat	19.02.2004	Kërkohe ndihmë për trajnimin e avokatëve dhe gjyqtarëve	Njoftim
11	TVSH, TVA, News 24, Alsat, Tv.Klan	19.02.2004	Ombudsmani Hollandez dhe Avokati i Popullit takojnë Kryetarin e Gjykatës Kushtetuese dhe Ministrin e Drejtësisë	Njoftim
12	TVSH	20.02.2004	Kryetari i Kuvendit pret ombudsmanin hollandez	Njoftim
13	TVSH, TVA, News 24, TNSH, Top Chanel, Tv. Klan, Shijak Tv. etj	24.02.2004	Ambasadori amerikan Jeffrey shpreh mbeshtetje për Avokatin e Popullit	Njoftim
14	Tv.Koha	26.02.2004	Avokati i Popullit kërkon përgjegjësinë e francezitetit për viktimat e Selenicës	Intervistë Ermir Dobjani
15	TVA, TVSH, Tv.Klan, TNSH	26.02.2004	Avokati i Popullit ngushëllon familjet e viktimave të minierës Selenicë	Njoftim
16	Tv.Koha	28.02.2004	Speciale me Avokatin e Popullit	Intervistë Ermir Dobjanu+E27
17	TVSH	28.02.2004	Avokati i Popullit jo hetim paralel me Prokurorinë	Prononcim Artur Lazebeu
18	TVSH, TVA, News 24, TNSH, Zëri i Amerikës, Top Chanel, Tv. Klan, Shijak Tv. etj	09.03.2004	Avokati i Popullit raporton në Parlament	Njoftim
19	TVSH, TVA, Vizion +	16.03.2004	Avokati i Popullit pret Ombudsmanin e Polonisë	Njoftim

20	TVSH	17.03.2004	Kryetari i Kuvendit pret Ombudsmanin Polak	Njoftim
21	Tv.Shijak	19.03.2004	Mbi mbrojtjen e të dhënave personale	Emision Artur Lazebeu
22	Nesër TV	12.04.2004	Të mos fyhet figura e policit të Shtetit	Prononcim Ermir Dobjani
23	Tv.Klan	20.04.2004	Po shqyrtojmë ankesat e oficerëve madhore të Policisë	Prononcim Jorgo Dhrami
24	Top.Chanel	12.05.2004	Avokati i Popullit merr përgjigje nga Ombudsmani grek mbi trafikun e fëmijëve	Intervistë Ermir Dobjani
25	Top.Chanel	14.05.2004	Fëmijë të humbur, por jo të trafikuar	Intervistë Ermir Dobjani
26	Tv.Klan	14.05.2004	Fëmijë të humbur, por jo të trafikuar	Intervistë Ermir Dobjani
27	TVSH, TVA, Tv.Klan, Vizion+, News 24, TNSH	27.05.2004	Shefi i zyrës së OSBE-së z. Lipponen shpreh mbështetjen për Avokatin e Popullit	Njoftim
28	Tv.Klan	10.06.2004	Avokati i Popullit dhe antitrafiku i fëmijëve	Intervistë Artur Lazebeu
29	Vizion +	15.06.2004	Tarifa të parregullta të Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare	Prononcim Ervin Karamuço
30	MTV	19.06.2004	Ombudsmani Shqiptar takon Presidentin Maqedonas	Njoftim
31	Tv.Klan	26.06.2004	Avokati i Popullit kritikon gabimet në polici.	Njoftim
32	Top.Chanel	16.07.2004	Avokati i Popullit: Çështja Vavacula në derën e drejtësisë Greke.	Intervistë Artur Lazebeu
33	Top.Chanel	27.07.2004	Avokati i Popullit viziton të burgosurit në Kosovë të Lushnjës	Prononcim Ermir Dobjani
34	Top.Chanel	16.09.2004	Policia e Shtetit i dërgon Avokatit të Popullit, listën e fëmijëve të zhdukur	Prononcim Artur Lazebeu
35	News 24	16.09.2004	Ambasadori i OSBE-së, Pavel Vacek, siguron Avokatin e Popullit për mbështetje të mëtejshme	Njoftim
36	News 24, Real Tv, Nesër Tv	19.11.2004	Avokati i Popullit denoncon "aleancen" kundër qytetarëve për energjinë	Prononcim Ervin Karamuço
37	Top.Chanel	22.11.2004	Avokati i Popullit në Top Show mbi fëmijët e rrugës	Emision Artur Lazebeu

38	Tv.Klan	23.11.2004	Ballafaqimi për rritjen e çmimeve te energjisë	Emision Ervin Karamuço
39	Top.Chanel	23.11.2004	Avokati i Popullit në Top Show mbi trafikimin e fëmijëve	Emision Artur Lazebeu
40	Top.Chanel	24.11.2004	Avokati i Popullit, "Votat t'i numërojnë gjyqtarët"	Interviste Ermir Dobjani
41	Zeri i Amerikës	02.12.2004	Avokati i Popullit mbi trafikimin e fëmijëve	Interviste Artur Lazebeu


**Ankesat e trajtuara gjatë vitit 2004**  
**Totali 2520**




- Numri i ankesave të ardhura gjithsej gjatë vitit 2004, pa përfshirë 1320 ankesa që ju është dhënë përgjigje menjëherë
- Numri i ankesave të mbartura nga viti 2003




**Mënyra e zgjidhjes së ankesave dhe kërkesave të përfunduara gjatë vitit  
2004, pavarësisht nëse kanë qenë brenda ose jashtë juridiksionit  
Totali 2112**



**Mënyra e zgjidhjes së ankesave dhe kërkesave që kanë qenë brenda  
juridiksionit gjatë vitit 2004  
Totali 1055**




**Gjendja e ankesave në fund të vitit 2004**  
**Totali 2520**




- Ankesa të përfunduara gjatë vitit 2004
- Ankesa që vazhdojnë të jenë në shqyrtim gjatë vitit 2005

**Ankesa dhe kërkesa të paraqitura verbalisht pranë  
Zyrës së Pritjes së Popullit gjate vitit 2004  
Totali 1941**




- Ankesa verbale të regjistruara në sekretari për shqyrtim, pasi u bënë me shkrim
- Ankesa dhe kërkesa verbale, të cilave iu është dhënë përgjigje menjëherë, në zbatim të nenit 17/a dhe 17/b të ligjit.


**Ankesa, kërkesa dhe njoftime të trajtuara nga zyra e AP gjatë vitit 2004**  
**Totali 3840**



**Shperndarja e ankesave te trajtuara gjate vitit 2004 sipas institucioneve**  
**Totali 2520 raste**



**MEDIA E SHKRUAR PER VITIN 2004**



### MEDIA ELEKTRONIKE PER VITIN 2004

